



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 16 QERSHOR 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
16. JUNA 2011. GODINE**

**QERSHOR – JUNI
2011**

E enjte, më 16 qershor 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Para se të fillojmë me punën, në emër edhe të Kuvendit, një përshëndetje për Komisionin e Kontrollit të Buxhetit të Parlamentit Evropian!

(Duartrokitje)

Në mbledhje janë të pranishëm 77 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupeve parlamentare zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta. Ju e dini që kjo kohë është e rezervuar për deklaratimet e deputetëve dhe jo për të tjerët, edhe replika nuk ka, këtë e dini.

Vazhdojmë, veç është mirë ta dimë kush është në emër të grupeve parlamentare, kush lajmërohet në emër të tij personal.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, të Kuvendit të Kosovës, dy tema, shpejt.

Tema e parë është testi i maturës. Me siguri jeni dëshmitarë të gjithë, të gjithë jemi dëshmitarë se sukcesi po shkon duke rënë vit pas viti. Testi po bëhet më i lehtë e më i lehtë, në të njëjtën kohë më pak e më pak njerëz ose nxënës po e kalojnë këtë test, që domethënë se kualiteti i arsimit në Kosovë po shkon duke rënë, përkundër të gjitha investimeve për të cilat po flet Qeveria e Kosovës. Dua t'ju përkujtoj një fjalë timen këtu në Kuvend të Kosovës, para tri viteve e kam pas pyetur ish ministrin e Arsimit pse po të kushton Abetarja 15 euro? Përgjigjja e ministrit ka qenë - nuk e kam ditur që je kundër librave. Mund t'ju them se këto përgjigje nuk donë koment, e gjendja në të cilën kemi ardhur, përkundër se ato abetare janë dhënë falas për popullin, me para të popullit, ne kemi arritur në këtë pikë.

Çështja tjetër, po ashtu është shumë aktuale. Me siguri secili prej jush e keni dëgjuar shprehjen tonë "me e shtrydh si limonin". Çka do të thotë? Ta shtrydhësh si limonin domethënë t'ia nxjerrësh diçkafit ose dikujt krejt çka ka që vlen për një interes çfarëdo qoftë, pa pasur fare mëshirë se çka ndodhë me atë limon që ka mbetur. Edhe po ju them kështu: Vendimi i Qeverisë së Kosovës për të importuar vetura më të vjetra, do të thotë deri 13 vjet, e ka ekzakt për qëllim ta shtrydh si limonin popullin e Kosovës. Ta bëjë asi soji që edhe ata njerëz që i kanë 2 ose 3000 euro kursime, ta blejnë një veturë që ka për

t'ju bërë një 2 vjet e shteti ta marrë akcizën edhe taksat, ose edhe ma keq, t'i shtijë ata njerëz për të marrë kredi nëpër banka dy ose 3000 euro e t'ia lajnë shtetit akcizën e prapë shteti t'i marrë paratë e veta e populli të shtrydhet si limoni. Domethënë, net efekti i këtij vendimi ka për të qenë që Qeveria ka për t'i marrë disa mjete për shkak se duhet ta shtrydhë si limonin popullin tash, se është duke e bankrotuar shtetin. Duhet t'i detyrojë krejt të varfëritë e Kosovës indirekt, domethënë si nëpër kazino që i detyrojnë, kushtimisht, për t'i shpenzuar edhe ato që i kanë, t'i shpenzojnë edhe ato që kanë për t'i marrë në 2 ose 3 vjet që vinë, për shkak se papërgjegjësia ekstreme e Qeverisë po e bankroton shtetin e Kosovës.

Dua gjithsesi këtë fjalën time ta përfundoj me një pyetje: Kur donë të ndalen, bre? Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar i Parlamentit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Procesverbali i seancës parlamentare të 5 majit, ku u trajtua tema rreth shtrirjes së sovranitetit të shtetit në veri të Kosovës, e ngritur nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, pas vendosjes në Web faqen zyrtare të Kuvendit, u bë publike edhe nga instituti KDI. Për disa ditë rresht, ky procesverbal në të cilën votat e 4 deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës figurojnë me jo për shtrirjen e sovranitetit në veri, u komentua edhe nga mediat, të cilat unë sot shfrytëzoj rastin t'i përshëndes, të cilët e trajtuan këtë temë me shumë objektivizëm sepse, t'ju them të drejtën, sikur unë të isha në vendin e tyre, do të komentoja më shumë dhe më gjatë.

Kjo çështje në gjithë vendin ngjalli habi dhe shqetësim, por më së shumti na shqetësoi neve deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës, të cilët ishim aq të sigurt në votën tonë, sa që nuk u fokusuam ta kontrollojmë se si na është regjistruar vota. Kjo gjë nuk besoj që do të ndodhë më. Ne u gjendëm para një situatë shumë të pakënaqshme, sepse asnjëri nga ne nuk kishte votuar “kundër”. E theksoj që ne mbrojmë qëndrimin që asnjë nga deputetët nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë asnjëherë kundër shtrirjes së sovranitetit, përndryshe nuk do të duhej të ishte pjesë e këtij Kuvendi.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës duhet të zbatohet në çdo milimetër të territorit të Kosovës. Ne nuk duam të besojmë se regjistrimi i votës sonë “jo” ka qenë i qëllimshëm për të diskredituar deputetë të caktuar, sepse jemi të bindur që ishte një gabim teknik. Prandaj, edhe kërkojmë nga Administrata e Kuvendi që ky gabim të përmirësohet dhe në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm, sepse nga 17 mund të na dalin 70.

Për hirrë të përgjegjësisë që ndiejmë ndaj votuesve tanë në të gjithë Kosovën, e në veçanti në këtë rast për votuesit tonë në Mitrovicë, e ndjej për obligim moral që të

deklaroj sot publikisht se Xhavit Haliti, Lumnije Morina, Valbone Dibra dhe unë, Ganimete Musliu, me datën 5 maj nuk votuam kundër shtrirjes së sovranitetit në veri të Kosovës. Vota jonë ishte dhe do të jetë çdo herë që na kërkohet “po” për shtrirjen e sovranitetit në tërë territorin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit, Krasniqi,

Kolegë deputetë të nderuar,

Unë do të ngrejë dy çështje, në emër të grupit.

E para, është çështja e dialogut për çështje teknike me Serbinë.

Ka disa muaj, me disa runde që janë zhvilluar bisedat ose dialogu me Serbinë për çështje teknike në Bruksel, me një ritëm të veçantë, i cili ritëm është prishur, së paku në bazë të deklaratave publike në muajin e fundit, sepse është shtyrë për një kohë më vonë. Unë këtu nuk dua të flas për ritmin, sepse atë ritëm të panatyrshëm të shpejtuar e kam kundërshtuar në bankat e këtij Kuvendi vetë dhe Grupi ynë Parlamentar. Ajo që unë dua të shtroj këtu sot, është që ne nuk kemi edhe sot e kësaj dite një transparencë të plotë, një paraqitje të plotë të kërkesave në këtë dialog teknik, ndonëse emri thotë dialog teknik, që të gjitha komentimet rreth dhe për këtë dialog qojnë kah ajo që do të rrëshqas në një dialog politik. Unë nuk dua në emër të grupit tash ta cilësoj si të tillë, por po them në bazë të komentimeve rreth dhe komentime rreth gjithmonë ka, nëse nuk ka informata direkte në institucion. Në institucion, kur flas, flas për Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse Kuvendi është implikuar rreth këtyre bisedimeve ose këtij dialogu për çështje teknike me një rezolutë, e cila është bërë për t'i vënë kufij këtij dialogu të mos rrëshqas në bisedime politike, nën një. Dhe, dy, që të merret detyrimi institucional që të informohet Parlamenti çka po ndodhë.

Deklarimet e kryenegociueses sonë, zëvendëskryeminstres Edita Tahiri, në ditët e fundit, po them, jo në institucion këtu, po në publik, thonë që: “Jemi afër që të lidhim disa marrëveshje” dhe ajo që për mua pak më sinjifikative është cilësimi - ato mund të jenë të panënshkruara. A ratifikon Kuvendi ynë marrëveshje të panënshkruara? Çfarë statusi do të kenë ato marrëveshje që nuk nënshkruhen? Kush do t'i implementojë ato, kush merr përgjegjësi nga ana e Kosovës që të implementojë marrëveshjet që nuk nënshkruhen, sepse Kuvendi me rezolutë thotë marrëveshjet ndërkombëtare do të ratifikohen me dy të tretat. Çfarë do të quhen ato marrëveshje, a janë marrëveshje ndërkombëtare ato që nuk nënshkruhen dhe këtu ne do të dalim para një seri pikëpyetjesh, në cilat deshëm s'deshëm, sot o nesër do të merret ky Kuvend, për të mos ardhur në pozitën - merre ose lëre Kuvendi i Kosovës, për marrëveshjet në të cilat s'është i implikuar dhe i informuar. Unë kërkoj që të bëhet transparente çdo gjë që mund të bëhet.

Çështja e dytë, që dua ta ngrejë sot në emër të grupit, është çështja e një marrëveshjeje në mes të dy ministrive. Po thuhet që është një projekt pune që ka dalë në publik, sido

që të jetë është diskutuar kaq shumë publikisht që më nuk është çështje e një komunikimi në mes dy ministrive, në mes FSK-së dhe Ministrisë së Rendit. Komentet janë edhe institucionale, kanë kaluar edhe një komision parlamentar. Çështja është që komentet publike më pastaj kanë derivuar në dy anë, në njërën anë, që ajo s'ka qenë asgjë dhe, në anën tjetër, që është një marrëveshje me substancë të veçantë për sigurinë e Kosovës. Ne mendojmë që çështjet e ministrive, qofshin në marrëveshjet e ndërmjetvetshme, nuk janë çështje të atyre ministrive, nuk janë as çështje të Qeverisë së Kosovës, janë probleme që i takojnë gjithë Kosovës dhe duhet të dalin dhe të ndriçohen e të diskutohen në Parlament. Dhe, për të mos e çuar më andej problemin, FSK-ja duhet të profesionalizohet tash për tash kryej detyrat që i ka me ligj dhe duhet të profesionalizohet të bëhet ushtri, por jo FSK-ja të mendojë që po bëhet më funksionale duke marrë detyrat të policisë. Ky është gabim i madh, mendoj unë, strategjik, sepse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputetja Alma Lama e ka kërkuar fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me gjithë deklaratat pompoze të disa muajve me radhë se Qeveria e Kosovës do të ndërmarrë masa reciprociteti ndaj produkteve të Serbisë në kuadër të mosrespektimit të Marrëveshjes së tregtisë së lirë Cefta, kjo nuk ka ndodhur. Nuk ka ndodhur madje as vendosja e taksës doganore, e cila gjithsesi nuk është reciprocitet me shtetin fqinj, që realisht bllokoi çdo mall me vulën e Kosovës që të eksportohet apo të kalojë nëpër Serbi.

Kjo situatë po vazhdon prej tre vitesh dhe asnjë moment nuk është marrë seriozisht nga Qeveria. Në fakt, një politikë e tillë frikacake e ka shndërruar Kosovën në një treg të Serbisë, e cila eksporton prodhime të saj pa asnjë lloj pengese në vlera rreth 300 milionë euro në vit, pa llogaritur këtu kontrabandimin. Ministria e Tregtisë nuk ka guxim të ndërmarrë masa reciprociteti, madje nuk ka guxim as të respektojë vendimin e saj se me datë 15 qershor do të fillojë masa e parë e reciprocitetit, siç e quajnë ata, që është aplikimi i taksës doganore prej 10%, edhe pse është e kuptueshme se kjo taksë doganore ka për qëllim për të mbushur buxhetin e Kosovës i cili është në krizë të thellë, e jo vendosjen e reciprocitetit. Kuptohet, koston e çmimeve të larta, si pasojë e taksës, do ta paguajnë pikërisht konsumatorët.

Madje në media kemi dëgjuar informacionin se aplikimi do të fillojë pas një konference, e cila do të zhvillohet kur të kthehet ministrja nga Gjermania. Një qasje e tillë aq jo serioze dhe mungesë respekti për vendimet e veta shpjegohet me maninë për të zgjatur problemet, për t'i stërzgatur në fakt dhe për t'i siguruar vetes një rol të përhershëm në skenën mediale. Aktrimi para publikut dhe jo puna për të zgjidhur problemet është sëmundja e gjithë Kabinetit qeveritar, që po merr përmasat e epidemisë. Por nuk

përrjashtohet mundësia që ministrat janë nën presionin e përfituesve nga kjo situatë, që mbërthen pas vetes miliona.

Një arsye tjetër mund të jetë presioni i cili vjen nga bisedimet që po zhvillohen nga Qeveria e Kosovës me Serbinë, ku kjo Qeveri ka shkuar me dy qëndrime të cilat janë të pakoordinuara për sa i përket Ceftas.

Nga ana tjetër, është e papranueshme që të vendosen në një rrafsh dhe të trajtohen me një gjuhë të njëjtë problemet që shteti i Kosovës ka me Serbinë, me disa mosmarrëveshje minore që ka me doganat e Shqipërisë, të cilat probleme zmadhohen në mënyrë të qëllimshme. Nga informacionet që kemi ne, së pari, Shqipëria nuk ka probleme me doganën, por për shkaqe objektive ka vonesa në përpunimin e mallit në doganë dhe kjo në palën e Doganës së Kosovës, pra jo në palën shqiptare. Arsyet janë sepse pala e Kosovës punon me orar deri në orën 18:00 dhe është fjala për punonjësit e përpunimit të dokumentacionit për mallrat. Zgjidhja është që pala e Kosovës të shtyjë orarin e përpunimit deri në orën 22:00, gjë të cilën nuk e ka bërë deri tani dhe pse-në e dinë ata që derdhin vrer në mënyrë të panevojshme, duke kërcënuar për reciprocitet njëjtë si me Serbinë.

Së dyti, për sa i përket patates, vlerësimi bëhet mbi bazën e referencave. Nuk ka munguar asnjë qas vullneti nga pala shqiptare për të biseduar në rrugë diplomatike që produktet e Kosovës, e theksoj, produktet e Kosovës, jo produktet e Serbisë, të cilët kalojnë nëpërmjet Kosovës, të vendosen çmime mbi bazën e referencave. Mirëpo, edhe kjo ngecje vjen si pasojë e dëshirës për të bërë zhurmë e jo për zgjidhur problemet.

Lëvizja “Vetëvendosje” me kohë ka kërkuar orientimin e tregut, importit dhe eksportit nga Shqipëria, por në vend të kësaj dëgjojmë pandehma apo panik se po i bllokuam mallrat serbe, ngelim pa bukë. Arsyetim qesharak ky si për faktin se pohohet që Kosova varet nga Serbia, ashtu edhe për faktin se nuk kanë gjetur asnjë lloj mbështetje as tek vetë tregtarët. Tregu i gjen gjithmonë shtigjet e veta, por janë politikat qeveritare ato që e drejtojnë një treg në mënyrë të drejtë ose të gabuar.

Ne i bëjmë thirrje edhe një herë Qeverisë që të vendosë marrëdhënie të plotë reciprociteti me shtetet që nuk e pranojnë vulën e Kosovës dhe të filloj bashkëpunimin me Shqipërinë në mënyrë të sinqertë, duke e lënë me një anë propagandën patriotike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Para disa ditëve Organizata Joeveritare “Fol” publikoi rezultatet e një hulumtimi të tyre mbi pasurinë e deklaruar të disa deputetëve të Kuvendit.

Me këtë rast u përmendën shifra marramendëse. Më konkretisht, u theksua se ka deputetëve që ndërmjet dy deklarimeve të pasurisë ju ka shtuar pasuria për vlerë prej qindra, mijëra euro, gjysmë milioni, mbi një milionë e deri te mbi dy milionë euro. Vërtet kjo është një informatë që shkakton habinë dhe nxitë kureshtjen për të menduar te çdo person i ndërgjegjshëm i Kosovës.

Personalisht, edhe unë që nga ajo ditë kam menduar dhe analizuar, se si është e mundur që dikush, madje edhe deputet apo ministër qoftë ai, në një vend kaq të varfër, siç është Kosova, ta shtojë kaq shpejt pasurinë e vet për shifra milionëshe. Shumë pyetje i kam bërë vetes. A thua si e kanë rritur kaq shumë pasurinë e vet për një kohë kaq të shkurtër këta deputetë të zgjedhur nga populli? A thua e kanë shtuar pasurinë vetëm me angazhimet e tyre politike, apo edhe me punë biznesore. Pastaj, nëse kanë pasur biznese kaq të suksesshme, përse merren me politikë dhe sa kohë kanë shpenzuar për biznese personale e sa për punë në Kuvend? Pasur parasysh pagën e deputetit, sipas logjikës dhe matematikës më të thjeshtë, një deputet nuk mund të bëhet milioner edhe sikurse të ketë mandatin 80 vjeçar, gjë që as fizikisht, por as politikisht nuk është e mundur, përveç nëse është magjistar dhe të hollave të tija të fituara ua shton ndonjë zero ose është fatlum dhe fiton llotari në ndonjë shtet të BE-së.

Jam i sigurt se elektorati dhe i tërë populli i Kosovës do të dëshironte të dinte se si mund të rritet në përmasa milionëshe pasuria e deputetëve të Kosovës për vetëm një mandat, madje jo të plotë. Prandaj, kërkoj që në këtë Kuvend të debatohet për të dhënat dhe informatat mbi pasurinë e deputetëve të këtij Kuvendi, fillimisht të verifikohet se sa janë të sakta të dhënat e Agjencionit Kundër Korrupsionit dhe OJQ-së “Fol” e më pastaj të shihet se cila është formula për pasurimin kaq të shpejtë të tyre.

Nëse formula e pasurimit të shpejtë është e rregullt dhe në pajtim me ligjin, atëherë personat e tillë të shpallen hero të paqes dhe të dekorohen me të gjitha shpërblimet e mundshme shtetërore. Por, nëse formula e pasurimit të tyre është e kundërligjshme, për të mos thënë kriminale, atëherë fillimisht të njoftohet elektorati dhe t’i bëhet me dije se kujt ia ka dhënë besimin me votën e vet, e më pastaj të njoftohen organet shtetërore, siç janë prokuroria speciale, gjykatat që ato të merren me çështjen e pasurimeve të shpejtë të tyre.

Diskutimin do ta përfundoj me këtë apel: -Votues i Kosovës, herëve të tjera ke kujdes se kujt do t’ia japësh votën tënde të shenjtë, atyre që bëhen milioner brenda një mandati jo të plotë, apo atyre që do ta ruajnë dhe menaxhojnë me kujdesin më të madh buxhetin e tubuar nga taksat dhe djersa jote! Ju faleminderit!

KRYETARI: fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, poštovani predsjedniče!

Poštovani narodni poslanici,

Učešće u radu parlamenta, kao učešće u formiranju vlade u dva mandata, Samostalna liberalna stranka i njen poslanički klub dao je veliki doprinos u radu Skupštine, kao i u radu celokupne vlade.

Samostalna liberalna stranka preko svojih poslanika koji radi na izradi i donošenju zakona preko komisije i samim direktnim učešćem u radu parlamenta, veoma pažljivo i strpljivo je pratila izlaganja pojedinih poslanika koji su u opozicionim partijama, ali i u koalicionim partnerima SLS-u i koji su u svoje ime ili u ime svojih poslanika poslaničkih klubova govorili.

Pojedini poslanici su nedolično govorili o srpskom narodu i u svojim govorima pokušavaju da ceo narod okrive za ratna dešavanja na Kosovu koja su se desila u prethodnom periodu.

Mi molimo te poslanike da u svojim govorima izuzmu te termine koji vode na mržnju i bes prema drugom narodu. Bolje bi bilo da u svojim govorima i sakupljanu dnevno političkih poena govore o miru, toleranciji i pomirenju, jer je to jedini put ka boljem životu i suživotu svih etničkih zajednica na Kosovu, kao i Evropskim integracijama kojima teži ceo region Zapadnog Balkana.

Na plenarnoj sednici koja je održana 27.05.2011. godine, govorilo se o uzurpiranim albanskim stanovima u Kosovskoj Mitrovici. I mi kao poslanici dajemo punu podršku da se problemi tih ljudi reše i da ponovo svako dobije svoj imovinu. Ali gospodo poslanici, ne smemo zatvoriti oči ne pomenuti i srpske stanove i imanja koja su uzurpirana. Ne smemo govoriti samo o problemima jedne zajednice, a probleme drugih zajednica ignorisati i ponašati se kao da njih nema. Samo sagledavanjem činjenica i rešavanjem problema svih zajednica na Kosovu, bez obzira na njihovu etničku pripadnost, možemo ići napred. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Është shqetësues vazhdimi i qëndrimit ende në grevë i disa pjesëtarëve të UÇK-së për një ligj i cili është dashur të miratohet qysh në legjislaturën e parë, po le të mbetet në ndërgjegjen e atyre që në legjislaturat e kaluara nuk e bënë një gjë të tillë. Andaj, unë më 19 maj kam kërkuar që ky ligj të vijë sa më shpejt në parlament, për miratim, ngase kam theksuar se asnjëri nga ne nuk do ta ndiej veten mirë, derisa ky ligj të mos miratohet.

Edhe greva më pastaj me disa pjesëtarë të UÇK-së ka bërë që çështja e ligjit të sensibilizohet edhe më shumë. Greva ka arritur efektin e vet dhe ligji besoj shumë shpejt do të vijë dhe do të miratohet nga ky parlament. Andaj, edhe konsideroj që edhe qëndrimi në grevë i mëtutjeshëm është i panevojshëm.

Por tani shqetësues është një fakt tjetër, si po tentohet të politizohet çështja e grevës? Një tendencë që grevës t'i jepet kahe politike ndodhi në ditën e 22-të të grevës, kur

Albin Kurti vizitoi grevistët. Ai duke ndejtu ulur mes grevistëve, tentoi të ofendojë dhe të njollosë një pjesë tjetër të pjesëtarëve të UÇK-së dhe ai t'i vlerësojë se cili nga ata ende vazhdojnë të jenë patriotë, e cilët jo, thua se ky i ka librezat e patriotizmit. 12 vjet pas përfundimit të luftës, i ra në mend Albin Kurtit të tregojë se kush vazhdon të jetë patriot, e kush jo, dhe atë ulur në mes të Prishtinës, në mes të disa pjesëtarëve të UÇK-së, mes atyre që kishte refuzuar t'ju bashkohej 12 vjet më parë, në kohë lufte. Hipokrizi e llojit të vet. Ai kështu tentoi vetëm të përçajë luftëtarët e UÇK-së. Ai i cili kishte refuzuar në kohë të vështira t'ju bashkohej pjesëtarëve të UÇK-së, tani tentoi të përçajë dhe tenton të dalë si shpëtimtar i tyre. Kot e ka zoti Kurti, nuk mund të hyjë në mes mishit e thoni, nuk e mban organizmi i pjesëtarëve të UÇK-së.

Dhe një tendencë dua t'ju kujtoj të gjithë të pranishmëve se prej se Partia Demokratike ka ardhur në pushtet, është një ngritje e pensioneve, pjesëtarë të familjeve të dëshmorëve i marrin pensionet me ngritje, invalidët gjithashtu i marrin pensionet me ngritje edhe besoj që shumë shpejt edhe çështja e veteranëve do të zgjidhet me ligj dhe kjo çështje nuk ka nevojë të politizohet e as të krijohet përshtypje se, me demokraci, ligji do të miratohet nën presion dhe nga presioni pa vullnetin e të gjithë neve të pranishëm këtu.

Dhe, një çështje tjetër, një tendencë, çështje e dytë që dua të ngrejë këtu, është tendenca e krijimit të një përshtypjeje se, demokraci, ne po bankrotojmë, se shteti është në rrezik, se çështjet tjera ekonomike, se do të falimentojmë. Por kjo është si mungesë e disave nga opozita të cilët nuk kanë pasur opsione për zgjidhjen e problemeve qytetare, nuk kanë pasur opsione për zgjidhjen dhe ngritjen e pagave të qytetarëve dhe nuk kanë, ende vazhdojnë të mos kenë opsione për zgjidhjen e problemeve të vazhdueshme të qytetarëve, por me tendencën e ngritjes së frikës tek qytetarët se a po bankrotojmë apo nuk po bankrotojmë, e dinë vet qytetarët të cilët i marrin pagat dhe pagesat....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: faleminderit!

Deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuari kryetar,

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra të nderuar,

Kolegë dhe kolege deputetë të nderuar,

Menjëherë pas përfundimit të luftës, në Kosovë ka filluar interesimi i vëllezërve tanë që jetojnë në diasporë për pajisje me dokumente. Megjithatë, në kohët e fundit ne e dimë që janë bërë shumë përparësi në këtë drejtim, por megjithatë ka ngecje dhe vështirësi. Vështirësitë veçanërisht janë prezente për vëllezërit dhe motrat tona që jetojnë në shtetin e Turqisë, ku sipas statistikave jo zyrtare, atje është se diku 7 deri 8 milionë shqiptarë jetojnë në shtetin e Turqisë. Ne e dimë se në periudhën e hershme të komunizmit shumë shqiptarë, nga të gjitha trevat shqiptare, e gjithashtu nga Kosova, u dëbuan nga ky vend, ku shkuan dhe u integruan si pjesë integruese të atij shteti. Shteti i Turqisë megjithatë i ka trajtuar barabartë shqiptarët, ashtu si shtetasit e saj, por megjithatë shtrohet pyetja se çka po bëjmë ne për vëllezërit tanë të cilët jetojnë atje. Ata kanë shprehur shqetësimin e

tyre se po kanë shumë vështirësi procedurale në pajisje me dokumente identifikimi, qoftë me letërnjoftim apo pasaportë. Kështu, shumë prej tyre të cilët kanë ardhur pas mbarimit të luftës në Kosovë që të pajisen me këto dokumente, janë kthyer duarthatë në pamundësi që të pajisen me këto dokumente.

Unë, si deputet kërkoj një bashkëpunim të mirëfilltë nga ministri i porsazgjedhur i Diasporës, ministri i Administratës Publike, ministri i Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me Ambasadën e Kosovës në Ankara, që duke i zbatuar këto lehtësime ligjore të marrin parasysh brengat e shqiptarëve të cilët jetojnë një numër mjaftë të madh atje dhe dëshirojnë që të jenë pjesë e Kosovës, nga që shteti i Turqisë iu ka lënë dyert hapur që të kenë edhe shtetësinë turke, po të kenë edhe shtetësinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutuesi i fundit, deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULTETA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Në Rezolutën për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, që u miratua në këtë Kuvend, thuhet: “Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon të drejtën kushtetuese për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që nënshkruan Qeveria e Republikës së Kosovës”.

Udhëheqësja e delegacionit të Kosovës, Edita Tahiri, para pak ditësh deklaroi: “Në qoftë se rezultatet e marrëveshjeve do të konsiderohen sikur standarde obligative për të dy palët, mund të jenë në formë standardesh, që do të thotë se nuk do të ketë nënshkrime, rrjedhimisht nuk do t’i ofrohen Kuvendit fare për ratifikim, por do të zbatohen drejtpërdrejtë në terren nga Qeveria”.

Ndërkaq, shefi i ekipit serbë për dialog, Stefanoviq, deklaroi se nuk do të nënshkruaj kurrfarë marrëveshje me përfaqësuesit e ekipit kosovar, por vetëm se marrëveshjet e arritura do t’i implementojnë qeveritë, ndërsa do të mbikëqyren nga BE-ja.

Të nderuar deputetë,

Ky është një tregues i qartë se Qeveria e Kosovës për marrëveshjet që do t’i arrijë, nuk do të ketë guxim të provojë të marrë pëlqimin as të atyre deputetëve që votuan pro këtyre bisedimeve, e lëre më më tepër. Kjo nuk është aspak e papritur, sepse kemi të bëjmë me një rezolutë që i është imponuar në mënyrë të padrejtë Kosovës përmes deformimit të vullnetit të qytetarëve të saj në Kuvend. Edhe pse rezoluta për bisedime që është miratuar në këtë Kuvend është legale, sepse mjafton shumica e thjeshtë për të miratuar një rezolutë, bisedimet që bazohen mbi të janë jolegjitime.

Deputetët që kanë votuar “pro” këtyre bisedimeve kanë mbi 4000 vota të qytetarëve më pak se ata që kanë votuar “kundër”. Legaliteti i rezolutës është produkt i vendeve të rezervuara e të garantuara për pakicat. Këtu për bisedime me Serbinë ka vendosur vullneti i pakicës e jo i shumicës.

Për çështje të tilla me rëndësi për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme të një kombi duhet të ekzistojë një “po” më e fuqishme dhe shumë më e argumentuar sa ajo që kjo rezolutë e ka marrë në këtë Kuvend.

Në anën, tjetër kjo nuk do të thotë se zgjidhja qëndron në ndërhyrjen e njëanshme me njësi policore në pjesën veriore të vendit. Në këtë rast, para së gjithash duhet të kemi parasysh një fakt themelor. Çështja e veriut nuk është çështje sigurie, por është çështje politike. Andaj, edhe zgjidhja nuk arrihet me masa që janë të parapara për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë, por me veprim politik.

Ndërhyrja e dhunshme dhe e njëanshme pa koordinim me faktorin ndërkombëtar, në atë pjesë do të shkaktonte konflikt të armatosur dhe të krijonte të gjendje të jashtëzakonshme, e cila do të pasohej me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar dhe krijimin e një zone të mbrojtur, në të cilën institucionet e Kosovës nuk do të gëzonin edhe qasjen që kanë pasur deri më sot në atë pjesë.

Kjo do të shkaktonte një situatë të pariparueshme, sepse kjo ndërhyrje e dhunshme dhe nevoja për ta mbrojtur atë do të merrej shkak që asaj pjese shumë më lehtë t’i sigurohet statusi i veçantë. Për më tepër, kjo do të bënte që në kuptimin territorial problemi të zgjerohej nga tri komunat e veriut, në tërë territorin përtej lumit Ibër.

Nëse marsi i vitit 2004, dje u mor si shkas për pakon e Ahtisarit, një mars tjetër do të merret shkas për pakon e Ahtisarit plus. Ky është kurthi në të cilin Serbia pret të bien shqiptarët. Kjo është edhe arsyeja pse unë nuk kam votuar për pikën e dytë të mocionit, për çka u bë shumë zhurmë dhe u shpreh shumë naivitet.

Në këtë situatë, Lëvizja për Bashkim kërkon ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Hajt, 30 sekonda! Në këtë pikë mos kërkonit zgjatjen e diskutimeve, kjo të jetë e fundit.

AGIM KULTETA: Në këtë situatë, Lëvizja për Bashkim kërkon të ndërpriten menjëherë bisedimet me Serbinë dhe që në Kuvend të fillojë debati i mirëfilltë rreth përmbajtjes së një platforme për zgjidhjen e problemit të vetëm të mbetur shqiptaro – serbë, e ky problem përfshinë tri komunat me serbë në veri të vendit dhe 3 komunat me shqiptarë në Kosovën lindore.

Çështja e pjesës veriore të Mitrovicës nuk është pjesë e këtij problemi, atje thjeshtë duhet të kthehen rreth 12 mijë banorë të dëbuar me dhunë nga pronat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë, kemi harxhuar kohën prej 30 minutash, bile pak më tepër.

Tani Qeveria mund t'i shfrytëzojë minutat e vet. Ministri i Financave, zoti Bedri Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuri zoti kryetar,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Çështja e importimit të veturave është çështje dhe vendim i cili është mirë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ende ky vendim nuk është proceduar dhe nuk është marrë në Qeveri, që nuk do të thotë që nuk do të merret në një nga mbledhjet e ardhshme. Është praktikë e cila është aplikuar në Kosovë në vitin 2005 mbi bazën e një rregulloreje të UNMIK-ut, në kohën kur nuk kanë ekzistuar qendrat e homologimit. Nuk është praktikë e tillë në asnjë nga vendet e Evropës, nuk ka kufizim të vjetërsisë. unë jam shumë i sigurt që të gjithë ne duhet të kërkojmë që qendrat e homologimit ta kryejnë punën e vet. Me rastin e propozimit të këtij vendimi për Komisionin për Buxhet dhe Financa ne kemi pasur në konsideratë 4 aspekte. Aspektet buxhetore, domethënë që të kemi të hyra për buxhetin e Kosovës, kemi pasur në konsideratë dhe kemi qenë shumë të kujdesshëm edhe sa i përket çështjes ambientale dhe të gjitha veturat e prodhuara nga viti '96 e kanë sistemin e motorëve EKO2, kemi pasur në konsideratë çështjet e sigurisë dhe çështjet sociale. Kemi stimuluar, blerjen e veturave të reja ku akciza është e përshkallëzime dhe veturat me zero kilometrazh e kanë akcizën zero dhe, varësisht nga vjetërsia, u shkuar duke u rritur edhe norma e akcizës. Prandaj, vendimi është marrë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe mbi bazën e këtij vendimi sigurisht në një nga mbledhjet e ardhshme do të procedohet edhe në Qeveri dhe normalisht që ne kemi pasur në konsideratë këto 4 elemente që i përmenda. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni të japë disa sqarime lidhur me disa nga diskutimet që kishin të bënin me dialogun teknik.

E para, dua të siguroj që asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk do të ketë tema politike apo tendenca të rrëshqitjes në tema politike. Dialogu teknik dhe angazhimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë dialog mbështeten në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës, e cila ka bërë të qartë vijat e kuqe dhe ato janë që çështja e statusit është kapitulli i mbyllur, sovraniteti, pavarësia, integriteti territorial edhe rregullimi i brendshëm i Kosovës janë çështje të sovranitetit të autoriteteve të Kosovës dhe askush tjetër, përveç Kosovës, nuk mundet, sigurisht, të ndërhyjë në këto. Po ashtu, më lejoni t'ju them se mbështetje për dialogun teknik kemi nga Bashkimi Evropian, si dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat po ashtu mbështesin një dialog teknik, i cili ka për

objektiv që të përmirësojë jetën e qytetarëve, të përmirësojë bashkëpunimin rajonal dhe, mbi të gjitha, të ofrojë Kosovën me Bashkimin Evropian.

Prandaj, unë do të kisha thënë se nuk do të duhej të ngriten shqetësime për këtë punë, sidomos prej atyre të cilët njohin mirë edhe angazhimet e Kosovës tash 20 vjet për pavarësi dhe vendosmërinë për këto çështje. As në Rambuje, as në Vjenë, as edhe tash në Bruksel ne, pra, nuk do të shkojmë përtej asaj që është vullneti i popullit të Kosovës dhe çka thotë Rezoluta e Kuvendit të Kosovës.

Tjetër, desha të them se çështjet të cilat janë diskutuar tashmë, janë 10 çështje për të cilat kemi folur në parlament, në të ardhmen mund të hapen çështje tjera, por esenca e temave është tema praktike që mund të përmirësojnë jetën e qytetarëve, mund të përmirësojnë bashkëpunimin rajonalë, si dhe mund të ndikojnë në përmirësimin e marrëdhënieve fqinjësore midis dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, që është një prej kushteve të kritereve të Kopenhagës dhe që të dy vendet, edhe Kosova, edhe Serbia e dinë se për t'u afruar me BE-në duhet të përmirësojnë marrëdhëniet ndërfqinjësore.

Për sa u takon masave të reciprocitetit, sigurisht se Kosova pas 11 vjetësh do të vendosë masa reciprociteti në qoftë se dialogu nuk do të japë rezultate lidhur me tregtinë e lirë. Ne jemi në pritje që Serbia pra të njeh vulat e doganave të Kosovës, por në qoftë se ata do të zvarrisin këtë proces, sigurisht që Qeveria do të lëvizë me vendosjen e masave të reciprocitetit dhe kjo do të ndodhë së shpejti.

Sigurisht se 11 vjetëve të asimetrisë në marrëdhënie tregtare ju ka ardhur fundi dhe vjen një moment kur duhet reciprociteti të jetë vlerë midis këtyre dy shteteve, siç Kosova ka pra marrëdhënie të lira tregtare me vende tjera. Ne jemi si shtet i ri për parimet fundamentale të tregtisë së lirë, të lëvizjes së lirë dhe vlerave tjera. Në qoftë se do të ketë vullnet nga Serbia, do të zbatohen këto parime evropiane, nëse jo, atëherë Kosova është e detyruar të vendos marrëdhënie reciprociteti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Replikë, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!
Zonja zëvendëskryeministre,
Vjershën e Evropës, të Amerikës, të dialogut e tjera e kemi mësuar. Ti vetë e the që jemi një brez që qe 20 vjet kështu edhe ashtu merremi me këto probleme. Insistimi im ishte konkret dhe bazohej pak a shumë edhe në deklaratat tuaja që kanë qenë publike, s'kanë qenë në parlament, por kanë qenë publike. A do të ketë marrëveshje që nuk nënshkruhen, a do të ketë marrëveshje që s'janë marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk kalojnë me votë me dy të tretat në Kuvend? Këto ishin pyetjet e mia fundamentale, që nuk mora përgjigje.

Edhe tjetra, ai program që thuhet që ekziston për këto bisedime, a do të vijë në parlament, a do të vijë te kryetari i Parlamentit sepse, ju zonja zëvendëskryeministre, para komisionit ka gati 3 muaj që keni thënë, të hënë e ardhshme, posa të kthehet kryetari i Parlamentit, do ta ketë në tavolinë, dhe unë jam edhe pjesëmarrës, edhe dëshmitar i këtyre

marrëveshjeve. Kështu që sa i përket punës, a bisedohet për tema politike a apolitike, këto janë nuanca. Për mua të gjitha këto janë politike, për ju po thoni që s'janë. Ky është problem i perceptimit. Me Serbinë asnjë temë që bisedohet sot, në gjendjen që jemi, s'mund të mos jetë politike. Ky është perceptimi im. Ju thoni - ka, se kur të bisedohet për doganat dhe për lëvizjet, për pranimin e dokumenteve, për mua, më falni, janë politike. Nuk thashë që duhet të iket, por unë thashë po rrëshqasin. Unë nuk thashë as s'duhet iket, as duhet iket, se nuk është bisedë politike vetëm vjersha s'lejojmë, territorialiteti dhe pavarësia. Nuk janë veç ato dy tema politike, janë makro politike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po më duket e kemi edhe Almën, e pastaj replikon me të dytë. Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Zoti kryetar, Zëvendëskryeministria Tahiri sërish tha të njëjtën gjë që ne po themi vazhdimisht. Do të vendosen masa reciprociteti. A po pritet të merret leje nga Serbia që të vendosen këto masa? Sa të lejoj ajo, nuk do ta japi. 3 vjet janë më së të mjaftueshme për të kuptuar që Serbia nuk e ka këtë vullnet.

Tjetra është që Cefta është marrëveshje e tregtisë së lirë, ku shtet hyjnë me vullnet në rast se kanë leverdi. Është fare e qartë që Kosova nuk ka leverdi për të hyrë në këtë marrëveshje. Prandaj, pyetja është – kur, sepse e kemi dëgjuar se reciprociteti do të vendoset, po kur? Kjo ishte vërejtja ime në fjalim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Zëvendëskryeministre, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar deputet Hamiti, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk punon mbi perceptime, punon mbi dokumente themelore. Njëri prej tyre është Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, e dyta është platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ta kryej, zoti Hamiti...

(Ndërhyrje e deputetit Sabri Hamiti nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

EDITA TAHIRI: Po, zoti Hamiti, këtu ka një farë kodi dhe një farë kulture demokratike. Ju folët, unë ju dëgjova, tash ju dëgjoni!

(Ndërhyrje e deputetit Sabri Hamiti nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

EDITA TAHIRI: A e kreve Sabri, a mund të vazhdoj tash unë? Mos më ndërhy, të lutem! Pra, Qeveria nuk punon mbi perceptime, po mbi dokumente dhe mbi vullnetin e popullit të Kosovës. I përmenda dokumentet. Sa ju takon intervenimit tuaj, deputete Alma Lama, për sa i takon qëndrimit, rezistencës, fuqisë tonë për pavarësinë, ne e dëshmuam, prandaj Serbia e ka kuptuar qartë leksionin që ja dha populli i Kosovës dhe udhëheqja e saj dhe besoj që e keni parasysh që nuk është fjalë për leje, por është fjalë që t'i japim rast

dialogut teknik, por në qoftë se Serbia zvarritë çështjen e marrëdhënieve të tregtisë së lirë, ne lëvizim me reciprocitet. Ndërsa, sa i takon çështjes së platformës, Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, ka shpalosur platformën e dialogut teknik në interpelancën, e cila u mbajt para një kohe dhe në një, do të thosha paraqitje shumë orëshe ka folur detajisht për të gjitha elementet.

Edhe diçka, po shqetësohem shumë. Pavarësia, sovraniteti, integriteti territorial dhe rregullimi i brendshëm nuk janë vargje ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Jo, jo, ju lutem, a. Urdhëro, replikë një minutë, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Nuk mora përgjigje në dy pyetjet fundamentale dhe e dija që s'do të marrë, por u desh të artikulohen në Kuvend, nën një. Nën dy, nuk mund të flitet për popullin. Po thotë - populli e di! Populli në bisedime s'ka shkuar, janë përfaqësuesit. Dhe, problemi i perceptimit, çdo gjë bëhet perceptim, nëse vendimet nuk janë transparente. Për mua, nëse s'bien dokumente, edhe kjo që thotë zëvendëskryeministrja është një perceptim. Faleminderit! Edhe demokracia s'është mashtrim, është të dëgjohet secili, po të ketë fakte, argumente. Kaq.

KRYETARI: Faleminderit!

Replikë një minutë, deputetja Alma.

ALMA LAMA: Desha ta falënderoj zëvendëskryeministren Tahiri, e cila sa po pohoi atë që unë thash në fjalim, kur thashë - ka mungesë koordinimi total mes Ministrisë së Tregtisë dhe zëvendëskryeminstres, e cila përfaqëson bisedimet në Cefta, sepse ministrja ka thënë që më 15 qershor do të vendoset marrëdhënia e reciprocitetit me Serbinë.

Ndërsa, zëvendëskryeministrja sapo pohoi se po pritet rezultati i bisedimeve, për të shkuar me hapa të mëtejshëm me reciprocitetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Hajt, një replikë, edhe të fundit. Urdhëro, zëvendëskryeministre!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Për sa i takon koordinimit në relacion me masat e reciprocitetit, ne si Qeveri udhëhiqemi me sens strategjik, pra i koordinojmë hapat dhe në momentin e duhur marrim vendimet.

Ndërsa, për sa i takon çështjes së përgjigjeve, dialogu teknik ka origjinën te Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, dhe se kjo rezolutë kërkon që dialogu teknik të ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Është Bashkimi Evropian ai i cili do të propozojë modalitetet e marrëveshjeve se çfarë do të jenë dhe mbi atë pastaj ne do të shqyrtojmë, pra, ato modalitete dhe mbi atë vendim do t'ju njoftojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Konsideroj që u krye kjo, por edhe unë dua t'i them nja dy fjalë. Po e shfrytëzoj këtë pozitë, pasi s'e kam nënkryetarin këtu.

Mendoj që çështja e reciprocitetit, si është thënë nga ministrja e Tregtisë, duhet të saktësohet. Nuk është reciprocitet nëse mallrat e Serbisë doganohen 10%, se ajo ngarkesë i bëhet qytetarit të Kosovës dhe nuk është reciprocitet. Reciprocitet është kur ndalohen mallrat e Serbisë apo edhe të Bosnjës që i pengojnë mallrat e Kosovës. Do të thotë, është mirë të saktësohet çka është reciprocitet dhe çka nuk është reciprocitet.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, është e kufizuar në 60 minuta.

Deputeti për një mbledhje, mund të parashtrojë më së shumti dy pyetje. Por, para se të fillojmë me pyetjet, është mirë që ministrat që kanë pyetje dhe nuk janë prezentë në seancën plenare, ta njoftojnë Kuvendin cila është arsyeja e mospjesëmarrjes së tyre në këtë pikë të rendit të ditës, për faktin se, nëse janë në Kosovë, ata nuk kanë obligim më parësor se sa t'iu përgjigjen pyetjeve të deputetëve.

Vazhdojmë me pyetjen e parë.

Deputetja Afërdita Berisha- Shaqiri, pyetje për ministrin Blerand Savilevci. Deputete, a dëshironi ta bëni pyetjen pasi ministri nuk është këtu? Mirë. Ju faleminderit, deputete!

Deputeti Arsim Bajrami, a është këtu? Po, ka pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputet, e ke fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Anëtarë të Kabinetit,

Zëvendëskryeministër

I nderuar ministër Buja,

Pyetjen që do ta shtroj, e shtroj me kërkesën edhe porosinë e profesorëve të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik, njëkohësisht edhe të rreth 15.000 studentëve dhe ka të bëjë me kushtet e pavoritshme të punës në këto dy institucione kryesore të Universitetit të Prishtinës, në të cilat gjatë ditës gravitojnë rreth 10.000 studentë. Në fakt, këto dy fakultete kanë qenë edhe fakultetet themeluese të Universitetit të Prishtinës dhe ato e shfrytëzojnë një objekt që në të kaluarën ka shërbyer si kazermë ushtarake. Ky objekt as për së afërmi nuk i plotëson kushtet elementare për punë, duke qenë se numri total i studentëve është diku rreth 15.000, por vetëm gjatë një dite gravitojnë rreth 10.000 studentë. Ambientet e këtij fakulteti nuk i plotësojnë as kushtet akademike, as kushtet higjienike, as kushtet tjera për një mësimdhënie çfarë kërkohet.

Qeveria e Kosovës, në të kaluarën, kryeministri Thaçi, ka dhënë një premtim publik medial, që do të fillojë ndërtimi i objektit të Fakultetit Juridik, ndërkaq Ministria e Administratës Publike, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, në vitin 2008, e kanë dizajnuar dhe projektin për ndërtimin e një godine të Fakultetit Juridik, në mënyrë që Fakulteti Juridik të ketë një godinë për të lënë hapësirën e mjaftueshme për Fakultetin Ekonomik.

Zoti ministër, pyetja ime është- deri ku kanë arritur angazhimet e Ministrisë dhe Qeverisë që të realizohet ky projekt? Unë e di që projekti nuk është përfshirë në vitin buxhetor 2011, por jam i sigurt që Qeveria dhe ju personalisht do të insistoni që në vitin 2012 të përfshihet kostoja buxhetore dhe të fillojë puna në këtë objekt. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ministri Ramë Buja, e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të respektuar dhe të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Bajrami,

Unë besoj se jeni në dijeni të gjithë rrjedhës, por meqë keni, domethënë për obligim që ta bëni pyetjen nga profesorët e Fakultetit Juridik dhe Fakultetit Ekonomik, atëherë unë dua ta respektoj këtë gjë dhe të jap përgjigjen që, përsëri po them, ju e dini, sepse keni qenë ministër i Administratës Publike dhe e dini krejt rrjedhën se si ka shkuar. Por, unë dua t'ju them një gjë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke pasur parasysh mungesën e hapësirës në Fakultetin Juridik, në vitin 2009 ka kërkuar nga niveli komunal ndarjen e hapësirës adekuate për ndërtimin e këtij fakulteti, brenda kompleksit universitar, njëherësh ka përcaktuar edhe përmbajtjen dhe madhësinë e sipërfaqes.

Në kohën kur ne kemi kërkuar, komuna për shkak të planeve rregullative të hartuara nuk ka ndarë hapësirë brenda hapësirës universitare, po as nuk ka dal me propozimin për lokacion tjetër të përshtatshëm për këtë fakultet.

Me çështjen e ndërtimit të Fakultetit Juridik, është përcaktuar të merret Ministria e Administratës Publike, andaj MASHT-i ia ka dorëzuar propozimin dhe kërkesat drejtuar komunës së Prishtinës, në Ministrinë e Administratës Publike.

Njëherësh, pasi që Ministria e Administratës Publike, është përcaktuar të merret me këtë çështje, ajo sigurisht edhe ka bërë tanimë propozimin për Projektbuxhetin e vitit 2012, për ta realizuar këtë ndërtim të këtij objekti, që është vërtet shumë i nevojshëm. Andaj, nëse ka nevojë për sqarime plotësuese, unë kam gjithë dokumentacionin shoqërues për këtë gjë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

ARSIM BAJRAMI: Dëshiroj të falënderoj ministrin për informatën dhe dëshiroj ta inkurajoj që të bëjë përpjekje që t'i renditë aktivitetet me ministrin e Administratës Publike, në mënyrë që të realizohet ky projekt shumë i rëndësishëm, ky projekt shumë ekzistencial, sepse jemi edhe në prag të pranimit të gjeneratës së re të studentëve dhe absolutisht do të jetë e pamundshme që këto dy institucione të zhvillojnë mësimin në kushte normale me këtë numër të madh të madh të studentëve në këto kushte.

Së fundi nuk do të jetë fortë e rëndësishme se cila ministri do ta bartë, është me rëndësi që të realizohet ky premtim i Qeverisë, i cili është pritur jashtëzakonisht mirë në Universitet, sidomos tek stafi i këtyre dy fakulteteve dhe unë ju inkurajoj që ju t'i vazhdoni angazhimet edhe me komunën e Prishtinës, në mënyrë që komuna e Prishtinës, ta japë sa më shpejtë lejen, sepse bëhet fjalë për hapësirën universitare, një hapësirë të cilën e ka Universiteti në shfrytëzim dhe në vitin e ardhshëm, të vendoset gurthemeli i ndërtimit të këtij objekti, për shkak se projekti veç është kryer, është i gatshëm, është marrë modeli i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Gracit, në cilin Fakulteti Juridik edhe ka ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Afërditë, e ke edhe një pyetje, por ministri nuk është këtu.

Regjia, fjalën deputetes Afërdita Berisha- Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA SHAQIRI: Pyetja ime i adresohet zëvendëskryeministres, Mimoza Kusari –Lila. Meqenëse ajo nuk është këtu, pyetja ka qenë lidhur me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ambientin biznesor. Në qoftë se do të merrja përgjigjen nga ndonjëri prej anëtarëve të Kabinetit qeveritar, do ta bëja pyetjen, përndryshe nuk kam arsye.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputete, e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja është për ministrin Nenad Rashiq.

Ligji i punës nr 03-L-2012, i dekretuar me datën 1 nëntor 2010, në nenin 49.1, thotë: “Femra e punësuar gëzon të drejtën prej 12 muajsh të pushimit të lehonisë”. Sa është duke u respektuar ky ligj, e sidomos neni 49 për pushimin e lehonisë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine, predsedniče!

Poštovani zameniče premijera,

Kolege ministri,

Narodni poslanici,

Gospodo Kadrijaj,

Kao što znate, od početka ove godine Zakon o radu je stupio na snagu i samim tim i deo 49. koji predviđa trudničko bolovanje. Ja mogu samo ukratko da vas informišem koji su, kakao je stanje stvari u vezi implementacije Zakona i šta je Inspektorat za rad uradio u ovoj godini. Od početka godine, bilo je 2.433 inspekcija, od toga je bilo 262 opomene ili upozorenja, rekomandime, i 26 je bilo finansijskih kazni. E, sada, kada kažete kako se, koliko se Zakon implementira ili koliko se poštuje, verovatno je to neko pitanje koje ćemo tačnije moći da damo odgovor tek u kasnijem periodu.

Ja znam da je trudničko bolovanje jedno od stvari koje je bilo potencirano nekoliko puta, da se iz toga izvadi što bolji, ostvari što bolji rezultat. Verovatno će jasnija slika biti u drugom delu, u drugoj polovini ove godine. Zbog toga, verovatno znate da je 6 meseci prvih, odnosno ovih 6 meseci i dosada bilo regulisano UNMIK-ovom Uredbom o Zakonu o radu, znači ona Uredba ili Rregullorja, koja je bila na snazi, je već pre toga bilo regulisano 6 meseci, a mi inače do sada, do današnjeg dana nismo dobili nijednu žalbu ili neki zahtev poseban za utvrđivanje prava određenog radnika na određenom radnom mestu. Znači, nije do sada bilo nikakvih primedbi. Zakon se implementira normalno, a imamo naše strukture, Inspektorat za rad koji se bavi tim poslovima, tako da do sada se Zakon implementira onako kako je bilo i predviđeno. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

TIME KADRIJAJ: Sipas analizës së GAP-it, del se nuk respektohet orari i punës, nuk respektohen kontratat e punës, librezat e punës, në shumë institucione edhe publike edhe private, domethënë del se nuk respektohet Ligji i punës.

Në një prononcim të kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, në një gazetë ditore, i pyetur për të njëjtën arsye, për pushimin e lehonisë, thotë, po citoj: “Ligji i punës zbatohet vetëm për punonjësit e kompanive private, publike, të shëndetësisë dhe arsimit”, ndërsa FSK-ja, Policia dhe shërbyesit civilë nuk i nënshtrohen këtij ligji. Si e komentoni ju këtë, ministër, kur dihet se Inspektorati është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe implementimit të këtij ligji?

KRYETARI: Ministër, vazhdoje!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!
U jednom delu Zakona o radu se kaže: „Sve grupacije čija su prava regulisana posebnim zakonom, ne spadaju pod Zakon o radu“, znači u ovom slučaju vi ste spomenuli grupacije FSK-a i Policije i što je najbitnije, pomenuli ste civilne službenike. Mi smo, juče sam razgovarao sa ministrom Mahirom, mi smo već juče doneli, promenili, harmonizovali naše zakone. Znači, u ovom slučaju Zakon o civilnom stafu jeste bio drugačiji, ali harmonizacijom jučerašnjom, ponavljam, svi civilni službenici će ući u okvir Zakona o radu, odnosno njihovih osnovnih prava, znači ovaj problem konkretno koji sete vi pomenuli je jučerašnjim datumom regulisan, tako da će civilni službenici uživati ista prava koja su predviđena za otale zaposlene kroz Zakon o radu. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Vazhdojmë. Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Deputete, e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Pyetja është për ministrin Mahir Yagcilar.

Pas shumë debateve, tryezave të organizuara nga Grupi i Grave Parlamentare dhe Rrjeti i Grave, është arritur që në Ligjin e punës të rregullohet pushimi i lehonisë sipas nenit 49.1. Pse Ligji i shërbyesve civil nuk është harmonizuar me Ligjin e punës, në mënyrë që lehonat ta gëzojnë pushimin e lehonisë sipas ligjit e jo sipas tekeve të departamenteve të Administratës të Ministrisë suaj? Edhe një përgjigje e ministrit më parë, a është dashur të bëhen pyetjet parlamentare që të takohen dy ministrat për harmonizimin e ligjeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Kadrijaj,

Duke falënderuar në pyetje, dëshiroj t'ju informoj se deri tash në shërbimin civil, pushimet e lehonisë janë rregulluar me Udhëzimin administrativ të vitit 2003, ndërsa Ligji i Shërbimit Civil, është miratuar në vitin e kaluar dhe ka hyrë në fuqi në muajin qershor, ndërsa Ligji i punës, i cili më saktë rregullon pushimin e lehonisë, u miratua në Parlament në vitin e kaluar, në muajin nëntor, ndërsa ka hyrë në fuqi në muajin dhjetor. Vërtet Ligji i punës, ka caktuar më saktësisht pushimin e lehonisë, ndërsa Ligji i Shërbimit civil, me nenin 40, është përcaktuar vetëm të bëhet një rregullore me të cilën do të saktësohen pushimet e veçanta, si pushimi i lehonisë.

Në takimin e djeshëm, pas konsultimeve me ministrin e Financave dhe me Ministrinë së Administratës Publike, është dërguar në Qeveri dhe dje është miratuar Rregullorja për pushimet në shërbimin civil ku janë transferuar të gjitha dispozitat nga Ligji i punës për pushimet e lehonisë. Kështu që prej sot nuk ekziston disharmoni. Besoj që ligji dhe rregullorja do të miratohen ose do të implementohen në një mënyrë unanime.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë, meqenëse e more përgjigje?

TIME KADRIJAJ: Çka do të ndodhë me lehonat që i keni diskriminuar deri tani me ligjin e juaj?

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit!

Unë thashë se Ligji nuk jep detaje rreth pushimit të lehonisë, ndërsa, Projekt- rregullorja ka transferuar të gjitha dispozitat nga Ligji i punës, kështu që Ligji i punës dhe Ligji i Shërbimit Civil, është në harmoni për pushimet e lehonisë.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër.

Vazhdojmë. Kjo ishte përgjigja në pyetjen e fundit. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit, sipas nenit 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e rashës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 31 maj dhe 3 qershor 2011

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 31 maj dhe 3 qershor të vitit 2011. Pyes, a keni vërejtje në këto procesverbale?

Fjalën e ka kërkuar deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Përshëndetje, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam një vërejtje për Transkriptin e mbledhje së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 31.05.2011, përkitazi me faqen e fundit, ku do të duhej të përfshihej edhe propozimi im, pavarësisht që ka rënë, nuk është përshkruar. Dëshiroj që të bëhet përmirësimi nga ekipi që bën transkriptin dhe të figurojë në dokumentacionin e Kuvendit. Kaq. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe pse ne po e miratojmë procesverbalin, jo transkriptin, kërkoj që të bëhet plotësimi i kërkuar.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

4. Ratifikimi i Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor

Por konsideroj që për këtë pikë të rendit të ditës nuk e kemi kuorumin. Vazhdojmë me pikën e radhës, nr. 5, pasi kërkohen 2/3. Ne në sallë i kemi 69 deputetë. Regjia, i bie ziles për të ardhur deputetët në sallën e Kuvendit. Sipas kartelave, prezentë janë 96 deputetë.

Po presim edhe pak. Sipas numërimit fizik, kemi 82 deputetë. Ju e dini që neve na nevojiten 2/3 për të votuar për ratifikimin... Regjia, bjeri edhe një herë ziles për të ardhur, se me kartela janë 96 deputetë. Një është pa kartelë.

Pra, fillojmë procedurën.

Tani kemi 85 deputetë. Pika e katërt, Ratifikimi i Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar për ratifikim në Kuvend Konventën për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për ratifikim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, si propozues i çështjes, në emër të Qeverisë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar, zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,
Ministria e Financave ka filluar procedurën e aplikimit për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave, me seli në Bruksel.

Anëtarësimi i Doganës së Kosovës në këtë organizatë botërore është i një rëndësie relevante, në veçanti duke pasur parasysh përfitimet e shumëfishta në zhvillimin e standardeve globale, thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave doganore, që do të ndihmojnë: qarkullimin e mallit, zinxhirin e furnizimit të sigurisë, të tregtisë, lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, përmirësimin e aktiviteteve në pajtueshmëri me doganat tjera anëtare të Organizatës Botërore të Doganave, ngritjen e iniciativave kundër falsifikimit dhe piraterisë, partneritetet publiko-private, promovimin e integritetit, si dhe një sistem të qëndrueshëm doganor global në trajtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore brenda administratave doganore me programet e ndryshme.

Ne në të kaluarën, por edhe sot kemi investuar shumë në ngritjen dhe zhvillimin e një administrate doganore në përputhje me standardet më të larta evropiane.

Na gëzojnë shumë raportet e organizatave të ndryshme ku tregojnë se administrata e Doganave të Kosovës, është në nivel mjaft të zhvilluar dhe është mbi nivelin e shumë doganave të rajonit. Andaj, anëtarësimi në Organizatën Botërore të Doganave, vetëm se do të ndihmojë që kjo administratë të zhvillohet edhe më tutje.

Për të përfunduar procedurën e aplikimit, ne jemi të obliguar për të ratifikuar Konventën për themelimin e Këshillit për Bashkëpunim Doganor të vitit 1952, në vështirësi të nenit 18 të Kushtetutës të Republikës të Kosovës.

Ratifikimi i Konventës sot do të na mundësojë deponimin e instrumentit të ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit për Bashkëpunim Doganor. Instrumentin e ratifikimit, jemi të obliguar për ta depozituar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Belgjikës, e cila pastaj do ta dorëzojë tek Organizata Botërore e Doganave, për konsideratë nga trupi vendimmarrës, Këshilli i organizatave Botërore të Doganave.

Organizata Botërore e Doganës, anëtarëve të saj i ofron një gamë të konventave dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, asistencë teknike dhe shkëmbim të praktikave më të mira, në veçanti për vendet të cilat janë në zhvillim. Duke promovuar nevojën e krijimit të një ambienti doganor të ndershëm, transparent dhe të parashikueshëm, Organizata Botërore e Doganës, kontribuon në mënyrë direkte në mirëqenien ekonomike dhe sociale të anëtarëve të saj.

Të nderuar deputetë,

Sot kërkoj miratimin tuaj të kërkesës së Ministrit të Financave, që Doganat e Kosovës të ofrohen sa më afër anëtarësimit në Organizatën Botërore të Doganave. Ne kërkojmë votën e juaj për ratifikimin e Konventës për themelimin e Këshillit për Bashkëpunim Doganor, i cili do t'i mundësojë Doganave të Kosovës, që në sesionin e radhës të kësaj organizate, t'iu shqyrtohet kërkesa për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave.

KRYETARI: Ju faleminderit ministër!

Në emër të komisionit funksional, zëvendëskryetari, deputeti Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur me 2 qershor, ka shqyrtuar Konventën për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor, dhe ka vlerësuar si të rëndësishme anëtarësimin e Doganave të Kosovës në Organizatën Botërore të Doganave, si mekanizëm i rëndësishëm botëror dhe duke pasur parasysh përfitimet e shumëfishta në zhvillimin e standardeve globale, vlerësimin e tregtisë ndërkombëtare dhe përmirësimin e aktiviteteve në pajtueshmëri me doganat tjera anëtare. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar se kostoja shtesë buxhetore e miratimit të kësaj Konvente, përafërsisht është 25.000 euro në vit, mjete që do të përdoren për pagesën e anëtarësimit të Doganave të Kosovës në këtë institucion ndërkombëtar, e që do të sigurohen nga buxheti i Doganave të Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim për miratim sipas procedurave që kërkohen për miratimin e konventave me 2/3 e votave. Nëse më lejoni, zoti kryetar, kisha shprehur edhe qëndrimin e Lidhjes Demokratike që e mbështet Konventën dhe që do ta votojë në tërësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Safete Hadergjonaç e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Konventën për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor dhe është e mendimit që ta përkrahë ratifikimin e kësaj konvente për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Nga “Vetëvendosja”, e ka fjalën deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet ratifikimin e marrëveshjes apo Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor. Konsiderojmë që kjo marrëveshje ose kjo Konventë dhe pjesëmarrja apo anëtarësimi i Doganave të Kosovës në Organizatën Botërore të Doganave, do t’i ndihmojë në aspektin teknik të avancimit të Doganave të Kosovës dhe është e rëndësishme që Doganat e Kosovës, të jenë si palë e barabartë në këtë organizatë. Mirëpo, po ashtu desha ta përmend vetëm, ta ceku një fakt një çështje që u ngrit këtu nga ministri, për përfitimet e mundshme që mund t’i ketë Kosova në aspektin ekonomik dhe social. Konsideroj që kjo shumë më shumë varet nga politika qeveritare se sa nga avancimi teknik i Doganave dhe në këtë drejtim, natyrisht që kjo konventë nuk e ndihmon shumë Kosovën po qe se politikat qeveritare do të jenë të gabuara siç kanë qenë deri tash. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet ratifikimin e Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe të gjithë deputetët e seancës.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re, ka shqyrtuar vendimin për ratifikimin e Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues

Doganor dhe në përgjithësi e përkrah këtë ratifikim të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor, e cila mundëson Kosovën që të anëtarësohet në Organizatën Botërore të Doganave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

I Samostalna liberalna stranka, to jest Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke će podržati ratifikaciju Konvencije o osnivanju Carinskog saveta za saradnju.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit “6+”, deputetja Duda Bale e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Za Konvenciju o osnivanju Carinskog saveta za saradnju, članovi Parlamentarne grupe „6+“ su mišljenja da data konvencija predstavlja korak napretka pridruživanju Svetske carinske organizacije koja će za našu državu, pored brojnih prednosti doneti samo jednu finansijsku obavezu vezanu za tarifu koju će carina plaćati u ime pridruživanja Svetskoj carinskoj organizaciju u visini od 25 hiljada eura godišnje. Ovu vrednost će Carina Kosova ... u okviru odobrenog budžeta za 2011.godinu, što znači da predlog ne predstavlja dodatno opterećenje za budžet Republike Kosova. Konvenciju smatramo pozitivnom. Ocenjujemo kao pravac modernizacije i podržavamo je u potpunosti.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Të lajmëruar nga radhët e deputetëve nuk kemi. Atëherë hyjmë në procedurën e votimit. Në sallë kemi prezentë 94 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë, tash.

Konstatohet se me 93 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi ratifikon Konventën për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor. Ju faleminderit!

Vazhdojmë pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për personat e zhdukur

Në bazë të nenit 56 të Rregullores të Kuvendit, Komisioni funksional, ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj ministrin Ibrahim Makolli, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantoj; arsyetimin e Projektligjit.

MINISTRI IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për personat e zhdukur është miratuar nga Qeveria, me vendim numër 03/15, të datës 18 maj 2011.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji, konsiston në numrin më të madh të personave të zhdukur, fati i të cilëve ende nuk është zbardhur, ndërkaq, deri me tash nuk ka ekzistuar legjislacion adekuat për rregullimin e kësaj fushe. Projektligji për personat e zhdukur, ka për qëllim t’i mbrojtë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre, e në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur në Kosovë.

Projektligji përcakton të drejtat e personave të zhdukur, të drejtat e familjarëve për t’u informuar për fatin e personave të zhdukur, të drejtat e familjarëve në lidhje me statusin ligjor të personave të zhdukur. Projektligji po ashtu përcakton ndërprerjen e kërkimit për personin e zhdukur, duke përcaktuar që kërkimi për personin e zhdukur,

konsiderohet i përfunduar kur të jetë gjetur personi apo kur të jenë identifikuar mbetjet mortore të tij ose të saj. Po ashtu, në këtë projektligj, përcaktohet që në qoftë se personi i zhdukur shpallet i vdekur sipas Ligjit për procedurën jo kontestimore, përkatësisht neneve 59 dhe 72 të këtij ligji, kërkimi për personin e zhdukur vazhdon derisa të jetë gjetur personi apo të jetë bërë identifikimi i tij.

Kjo gjë është duke u bërë, duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe shqetësimet e të afërmeve të personave të zhdukur. Me këtë projektligj, përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit qeveritar për personat e zhdukur, si organ qeveritar i cili do të koordinojë aktivitetet me institucionet vendore si dhe do të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e tjerë me qëllim të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur.

Anëtarët e Komisionit, do të jenë nga të gjitha institucionet që në një mënyrë apo tjetër, merren me fatin e personave të zhdukur. Komisioni do t'i mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre. Komisioni do t'i informojë familjarët e personave të zhdukur, duke bashkëpunuar me shoqatat që kanë të bëjnë me personat e zhdukur.

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj do të krijohet regjistri qendror për personat e zhdukur. Në regjistrin qendror, do të mbahen të dhënat të cilat janë marrë nga të gjitha burimet në dispozicion për të ndihmuar gjatë gjetjes së identitetit të tyre, si dhe vendit dhe rrethanave të zhdukjes së tyre. Qasja në regjistrin qendror, do t'u mundësohet familjarëve ose përfaqësuesve ligjor të personave të zhdukur ose organizatave të tjera, që e kanë mandatin për të kryer kërkim, gjetje dhe identifikimin e personave të zhdukur. Të dhënat nga regjistri, do të jenë në dispozicion në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Autoriteti mbikëqyrës për monitorimin dhe zbatimin e këtij ligji, është Zyra e Kryeministrit. Projektligji për personat e zhdukur, është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me standardet e BE-së. Para dhe gjatë hartimit të këtij projektligji, janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjëra nga natyra e kësaj fushe.

Të nderuar deputetë,

Ju propozoj që këtë projektligj ta miratoni në parim, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë, të vihen në suazat e Kornizës ligjore adekuate. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Dhe urime për prezantimin e parë, por një fjali që e lexove, “monitorimin e ligjit, zbatimin e tij e bën Kuvendi”, zbatimin e bën Zyra e Kryeministrit, por monitorimin e bën Kuvendi, që edhe ashtu, e keni edhe nenin 17. Nejse, ajo është gabim, gabim shtypi.

Vazhdojmë. Suzan, a e doni fjalën ju? Mirë, fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në takimin e mbajtur më 10 qershor 2011, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se projektligji është i një rëndësie të veçantë. I njëjti i plotëson kushtet në aspektin formale-juridik, përmban memorandumun shpjegues, deklaratën financiare, dekoratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Projektligji në tërësi përmban 5 kapituj, 19 nene, përmban dispozitat e përgjithshme materiale, dispozitat materiale procedurale, ndëshkimore, përfundimtare, dhe të hyrjes në fuqi. Projektligji është i hartuar relativisht mirë dhe të njëjtin e kemi miratuar në parim në Komision.

Kryetar, nëse më lejoni, dua ta shpreh qëndrimin e Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, i cili në parim e përkrah Projektligjin për Personat e Zhdukur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Kurtan Kajtazi.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për personat e zhdukur, është shqyrtuar edhe nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Ky projektligj është i rëndësishëm ngase rregullohen çështjet të cilat kanë të bëjnë me kërkimin dhe gjetjen e vendndodhjes së personave të pagjetur, të drejtat e familjarëve të personave të pagjetur dhe në veçanti përcakton mandatin e Komisionit qeveritar dhe aktorëve të tjerë në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të pagjetur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Projektligji konsiderohet i rregulluar mirë sipas strukturës dhe dispozitave në tërësinë e tij dhe ne, si grup parlamentar e mbështesim dhe anëtarët tanë në Komisionin funksional, do të japin kontributin gjatë amendamentimit të këtij projektligji.

Me qenë se ky projektligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i nevojshëm, ne e përkrahim në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Rita Hajzeraj - Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ - BEQAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për persona të zhdukur dhe konsiderojmë se ky projektligj, sipas memorandumit shpjegues, thotë se ka për qëllim që të mbrojë të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e të pagjeturve, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar 1998 dhe deri në periudhën 31 dhjetor 2000. Unë mund të them me plotë kompetencë se projektligji nuk e trajton thelbin e çështjes për të cilën thirret, por është aq i mangët dhe i paqartë sa që çështja kryesore që zë vend në këtë projektligj, janë kompetencat për Komisionin Qeveritar për personat e zhdukur, ku do të thotë përfshihen dhe përsëkruhen kompetencat një nga një të këtij komisioni.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se ky projektligj është shumë i rëndësishëm, sidomos për familjet e të pagjeturve, e çka do të duhej të fokusohet kryesisht me çështjet, problemet dhe kërkesat e këtyre familjeve. Unë po i quaj të pagjetur, sepse është një kontradiktë jashtëzakonisht e madhe, nëse e shohim titullin e projektligjit, sepse projektligji thirret për personat e zhdukur, ndërsa përkthimi në anglisht e ka missing people, çka do të thotë se personat të cilët na mungojnë apo të humbur dhe nuk është adekuat që të themi se janë personat e zhdukur përderisa ata persona mund të gjenden dhe nuk janë më të zhdukur nëse gjinden trupat e tyre dhe varrosen.

Unë konsideroj që ky projektligj, është sjellë po ashtu siç ka qenë edhe në mandatin e kaluar, i cili ka pasur jashtëzakonisht probleme të mëdha dhe tani ka probleme të mëdha, ka kontradikta të mëdha dhe kolizione të mëdha në mes Komisionit Qeveritar dhe të drejtave për familjet e të pagjeturve. Konsideroj që ky projektligj duhet të përkrahet për të vetmen arsye sepse është jashtëzakonisht i rëndësishëm nga kërkesat e familjarëve të pagjeturve, por me kushtin e vetëm që në Komisionin përkatës, të bënë ndryshime dhe të plotësohen, të riamendamentohet me plotësimet e nevojshme për të cilat edhe vjen, do të thotë për qëllimin për të cilin vjen projektligji. Pra, për kërkesat e familjarëve të pagjeturve, për mundësinë e gjetjes të personave të zhdukur të cilët ende janë, do të thotë të zhdukur, të cilët ende nuk kanë përgjigje as familjarët e tyre dhe as anëtarët më të ngushtë të familjeve të tyre.

Andaj Lidhja Demokratike e Kosovës, e përkrah në parim vetëm me kushtin që ky Projektligj të riamendamentohet dhe të plotësohet për qëllimin do të kishte qenë mirë ta kishte. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” e ka fjalën Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Ju faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Ligji për personat e pagjetur është një ligj i rëndësishëm së veçantë që synon të trajtojë çështjen e dhimbshme të personave të pagjetur e që është zvarritur tash e 12 vjet.

Sikurse edhe te disa ligje tjera, edhe procesi i hartimit të këtij projektligji, është përcjell me probleme edhe politizime të shumta. Qëndrimi i Lëvizjes “Vetëvendosje”, është shumë i qartë në këtë drejtim. Ne angazhohemi për respektimin e plotë të standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut, që ekzistojnë në nivel të Kombeve të Bashkuara, për trajtimin e çështjes së personave të zhdukur apo të pagjetur.

Kur flasim për këto standarde, duhet theksuar se që nga 23 dhjetori i vitit 2010, ka hyrë në fuqi Konventa për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë. Kjo konventë njeh të drejtën e çdo njeriu për të mos iu nënshtruar zhdukjes me forcë si dhe njeh të drejtën e viktimave për drejtësi e për dëmshpërblim, të drejtën e çdo viktime për të njohur të vërtetën mbi rrethanat e zhdukjes me forcë dhe për të mësuar mbi fatin e personit të zhdukur, si dhe të drejtën e lirisë për të mbledhur, marrë dhe shpërndarë informacione për këtë qëllim.

Nëse ky projektligj, të cilin e kemi sot në dorë, nuk merr për bazë parimet dhe vlerat njerëzore të përcaktuara nga konventa e lartcekur, atëherë e vërteta mbi fatin e të zhdukurve më shumë ka një prapavi politike se sa humane, më shumë se një barazim faji, se sa dënimin e Serbisë për krimet e kryera.

Kolegë deputetë,

Nëse ky ligj i apostrofohet luftës çlirimtare në Kosovë, atëherë duhet të vlejë për periudhën gjatë kohës kur është zhvilluar lufta në Kosovë, e që përfshin periudhën 1 janar 1998, 20 qershor 1999, datë kjo kur edhe zyrtarisht ka përfunduar lufta në Kosovë. E, nëse në këtë projektligj tentohet që të përfshihet edhe periudha e pasluftës, deri me 31 dhjetor 2000, atëherë kemi të bëjmë me degradimin e luftës sonë çlirimtare dhe barazimin e viktimës me xhelatin.

Shihni vetëm tendencën e Serbisë dhe fatkeqësisht edhe të disa faktorëve ndërkombëtarë, për fryrjen e shifrave të të zhdukurve serbë. Ata po mundohen që të përfshijnë periudhë sa më të gjatë, me qëllim që barazimi i shifrave të zhdukurve, barazimit të dëmeve dhe të fajeve, njollosjen e luftës çlirimtare dhe sakrificës të popullit tonë. Po mundohen që të fusin edhe raste që nuk kanë të bëjnë me luftën, rastet e konflikteve private dhe natyrës e rrethanave krejt tjera e që nuk kanë të bëjnë aspak me rrethanat e luftës dhe mënyrën se si janë zhdukur shqiptarët gjatë luftës.

Çështja e diskutimit të fatit të pagjeturve në negociatat me Serbinë, ka cenuar dhe shkelur dinjitetin e familjarëve të zhdukurve, gjë për të cilën Serbia është e obliguar të japë informata për rrethanat dhe mënyrën e zhdukjes së tyre. Ata janë vrarë qëllimisht dhe kjo politikë, kjo luftë e Serbisë, ka pasur një zinxhir komandues, një administratë, një strategji dhe një plan-projekt për vrasjen dhe zhdukjen e shqiptarëve. Serbët i fshehin informatat e ne po i lusim ata për diçka që ata janë të obliguar edhe me konventa ndërkombëtare. Serbia, edhe pse ka ushtruar dhunë të vazhdueshme, ka kryer krime e gjenocid, ajo prapë po del fituese duke shfrytëzuar edhe situatën e të pagjeturve, hapjen e varrezave masive dhe këtë vetëm e vetëm për të fituar poenë politike.

Ajo do të përfitojë përmes këtij projektligji në formën si e kemi edhe sot. Një e metë tjetër e hasur në analizën e këtij projektligji, është që nuk janë paraparë edhe beneficionet për familjarët e të zhdukurve. Beneficionet që duhet të parashihen në këtë projektligj, kanë të bëjnë më shumë me dinjitetin se sa me çështjen materiale, dhe duke iu referuar gjithë kësaj vijmë në përfundim se parim themelor i këtij projektligji duhet të jetë- të zhdukurit janë si rezultat i luftës në mes Kosovës dhe Serbisë, dhe se periudha të cilën duhet të përfshijë ky ligj, ritheksoj duhet të jetë 1 janar 1998, 20 qershor 1999 dhe jo 1 janar 1999, 31 dhjetor 2000. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Kimete Bajraktari.

KIMETE BAJRAKTARI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Familjarët me personat e zhdukur shpresojnë se dita e nesërme do të sjellë diçka të re. E drejta e tyre për të ditur për fatin e më të dashurve të tyre, kthimi i mbetjeve mortore, është e drejtë e siguruar sipas konventave ndërkombëtare.

Projektligji për personat e zhdukur, në mënyrë të saktë dhe precize përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, ndërsa për të drejtat e personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre, ky projektligj është i mangët. Gjatë leximit të këtij projektligji krijohet përshtypja se është përpiluar për Komisionin për Personat e Zhdukur, e jo për personat zhdukur dhe familjarët e tyre.

I tërë ligji, në përmbajtjen e vet përfshin vetëm 4 nene për të drejtat e personave të zhdukur dhe të drejtat e familjarëve të tyre, kur ky ligj ka gjithsej 19 nene, shprehur në përqindje 21% e projektligjit i dedikohet të drejtave për personave të zhdukur.

Në këtë projektligj, nuk janë përfshirë të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur, si të drejtën e tyre për mbështetje financiare, përcaktimin e vlerës së ndihmës financiare, ndërprerjen e të drejtës për ndihmë financiare, zbatimin e procedurës për të ushtruar të drejtën e mbështetjes financiare, krijimin e fondit për personat e zhdukur. E drejtë tjetër e familjarëve për personat e zhdukur, e cila nuk figuron në ligj, është siguri i shpenzimeve themelore për zhvarrimin dhe identifikimin e personave të zhdukur. Nuk janë të përfshira procedurat për përcaktimin e lokacioneve, për ngritjen e monumenteve për personat e zhdukur.

Te Kreu IV, neni 13, Regjistri qendror i personave të zhdukur, nuk është caktuar afat ligjor se kur do të kompletohet ky regjistër me të dhënat për të gjithë personat e zhdukur.

Përfshirja e mekanizmave juridike, administrative, sociale, mundëson që problemi i personave të zhdukur të zgjidhet në mënyrë sistemore dhe gjithëpërfshirëse, duke e respektuar të drejtat dhe nevojat e familjarëve me persona të zhdukur.

Grupi Parlamentar i AAK-së në parim e voton këtë projektligj, në mënyrë që gjatë amendamentimit të përfshihen vërejtjet e bëra. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kush e do fjalën?
Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Kryetar, si duket nuk më dëgjuat. Më herët u deklarova se e përkrahim në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Po unë e kam njëfarë rendi, shkoj sipas rendit. Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, a e do dikush fjalën? Nuk kemi të lajmëruar, në të vërtetë fjalën e ka Biserka Kostiq, deputete.

BISERKA KOSTIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poslanički klub Samostalne liberalne stranke je pažljivo razmotrio Nacrt zakona o nestalim licima. Ističem da je naša Grupa u prošlom sazivu bavila se pitanjem i problemom ovog istog zakona. Zapravo, kroz aktivno učešće članova Poslaničkog kluba u Komisiji za ljudska prava, polnu ravnopravnost, peticije i nestala lica, kao i u Komisiji koja je zapravo nadležna za ovaj nacrt zakona, daće svoje doprinose.

Smatramo da je ovaj zakon od velikog značaja i važnosti za našu zajednicu, kao i za sudbine nestalih lica i njihovih članova i njihovih porodica. Samostalna liberalna stranka podržaće izglasavanje ovog zakona u načelu, ali će svakako i kroz komisije učestvovati kada je u pitanju izmena i dopuna ovog zakona, jer pored lošeg prevoda zakona, postoji i drugi članovi zakona koji se kose sa interesima naše zajednice, kao i za zajednice ostalih manjina. Konkretno, radi se o ograničavanju vremenskog perioda, koji u Zakonu stoji za određivanje statusa nestalog lica. Ograničenje za vremenski period glasi od 1. januara 1998. do 31. decembra 2000. godine, što smatramo neprihvatljivim i nerealnim. Mislimo da nema potrebe za tim ograničenjem, jer nestali su nestali, nekima je sudbina poznata, a nekima ne. Zato, ne treba praviti razliku među ljudima koje je ista nesreća zadesila.

Svakako, na osnovu pojedinih saznanja koje mi imamo, znamo da iznad ovog okvira ima dosta kidnapovanih i nestalih iz naše zajednice. Zato, insistiraćemo kroz rad u Komisiji da se ovi vremenski periodi koji su ograničeni za kidnapovane i nestale prošire, a daćemo kasnije i tačne okvire u komisiji.

Mi kao Poslanički klub i poslanici u ovoj Skupštini, pitamo se šta će biti sa kidnapovanim i nestalim i kakav je status njihovih porodica koje je nesreća zadesila izvan ovog vremenskog perioda, koji je ograničen, i da li je neko imao to u vidu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+” deputetja Duda Balje, e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem! Zakon o nestalim licima sa ciljem da zaštiti prava i interese nestalih lica i porodica nestalih podržavamo u načelu i smatramo ga za vrlo značajnim, sa jednom primedbom vezanom za period koji je određen od 1. januara 1998.

do 31. decembra 2000. godine, jer znamo da postoji određen broj ljudi koji su nestali i posle u ovom zakonu napomenutog perioda i smatramo da i oni treba da budu obuhvaćeni ovim zakonom da ne bi bili diskriminirani, jer je njihov nestanak direktno je vezan za posledice rata na Kosovu. Zahvaljujem!

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fakti që kanë kaluar 12 vite pas përfundimit të luftës dhe 3 vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe nuk kemi pasur një projektligj për personat e zhdukur apo të pa gjetur, i cili do të përmbushte kërkesat e familjeve të tyre, është një argument i fuqishëm se institucionet tona nuk e kanë kryer obligimin e tyre institucional. Mirëpo, më mirë është vonë se kurrë. Ardhja e këtij projektligji për t'u shqyrtuar duhet që njëherë e përgjithmonë të rregullojë çështjet në interes të familjeve të personave të zhdukur. Ky projektligj duhet në mënyrë më të mirë të mbrojtë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjeve të tyre, sidomos familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur gjatë periudhës 1 janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000.

Mendoj se në këtë drejtim duhet të bëhen analiza të detajuara ligjore konform të gjitha konventave ndërkombëtare. Projektligji duhet të japë të drejtën familjarëve të dinë rreth fatit të njerëzve apo të afërmeve të tyre gjithnjë deri sa të zbardhet fati i të zhdukurit të fundit.

Ligji për statusin dhe të drejtat e martirëve, sipas asaj që e konsiderojnë familjarët të zhdukur dhe viktimat civile që janë martirë, konsiderohet se është shumë i mangët dhe nuk rregullon asgjë që ata jo vetëm se e duan, por e kanë të nevojshme dhe fundja u takon ta kenë një mbrojtje të familjes, një mbrojtje të atyre që janë zhdukur e janë vrarë dhe një mbrojtje të atyre që ende nuk janë gjetur.

E vërteta është se ka dy apo tri nene që e mbrojnë kërkimin e të zhdukurit dhe e mbrojnë të drejtën për të kërkuar dhe për ta gjetur, sepse këtë e obligon edhe e drejta njerëzore e ndërkombëtare.

Por, ajo që është shumë e rëndësishme dhe thelbësore në këtë ligj, është se:

1. Së pari, nuk është caktuar drejt data e trajtimit të atyre që quhen të zhdukur apo të vrarë gjatë konfliktit. Data 1 janar 1998 dhe deri më 31 dhjetor 2000 del jashtë konfliktit dhe barazohen ata që janë vrarë dhe janë dhunuar edhe si kufoma duke u bartur nëpër gropa masive dhe janë fshehur duke lënë në ankth deri në çrregullime mentale të familjarëve. Vrasjet të cilat supozohet se janë kryer pas qershorit 2000, nuk i përkasin konfliktit që quhet luftë e që në këtë luftë janë vrarë, me dënime arbitrare janë dënuar qëllimisht me tendenca shumë armiqësore dhe janë planifikuar nga relacioni shtetëror i Serbisë, siç thotë populli, pa pas hak as hile.

2.Unë mendoj se vrasjet, nëse ka pasur pas qershorit të vitit 1999, duhet të trajtohen në ndonjë tjetër rregullore, apo diç tjetër.

3.Pastaj janë benificionet. Askund në ligj nuk flitet për mbrojtjen materiale të familjarëve dhe për benificione të tjera, siç është caktuar për kategoritë e tjera të luftës.

Prandaj, shtrohet pyetja, si duhet të kompensohen këto familje? Familjet e martirëve të kombit të rrëmbyer e të pagjetur kërkojnë që e drejta e bazës në pension njëherësh edhe benificionet të jenë të barabarta, pa marrë parasysh gjendjen ekonomike të familjeve. Pra, duhet të qartësohet dhe të rregullohet e drejta në pension dhe benificione për familjet e dëshmorëve dhe të zhdukure të luftës së UÇK-së. Familjarët e martirëve të kombit të rrëmbyer e të pa gjetur kërkojnë që pagesat e këtyre benificioneve të fillojnë në vitin 2011, pa dallim të kategorive të dala nga lufta, duke u nisur nga sakrificat dhe kontributi i të gjithë të rënëve gjatë luftës në Kosovë të vitit 1998 – 1999, të cilët derdhën gjakun, dhanë më të shtrenjtën jetë, për një ideal, për atë që e mbrojtën atdheun e tyre, për lirinë që e gëzojmë ne sot.

Dhe, krejt në fund, rekomandoj që Projektligji për persona të zhdukur do të duhej të emërohej: Projektligji për statusin dhe të drejtat e martirëve të kombit, të rrëmbyer e të pa gjetur dhe të familjeve të tyre.

Pse e them këtë? Sepse, me këtë rast qëllimi është të mbrohen të drejtat dhe interesat e martirëve të kombit e jo termi “të zhdukur”, të rrëmbyer dhe të pa gjetur dhe familjeve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur më shumë për fatin e martirëve të kombit të rrëmbyer e të pa gjetur gjatë periudhës janar 1998 dhe 12 qershor 1999, gjatë luftës dhe gjenocidit, jo termi “konflikt”, të kryer në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputetja Blerta Daliu – Kodra.

BLERTA DELIU- KODRA: I nderuari kryesues,

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Që nga viti 1999 e gjer më sot, në Kosovë janë gjetur rreth 3.500 mbetje mortore dhe të gjitha u janë kthyer familjeve të tyre. 12 vjet pas përfundimit të luftës, fati i 1.800 personave edhe më tutje nuk dihet. Procesi i identifikimit të personave të pa gjetur ka rënë dukshëm. Vetëm në komunën e Mitrovicës janë edhe 132 persona të pa gjetur, përderisa brenda këtij viti është identifikuar dhe i është kthyer familjes vetëm 1 person. Në rast se vazhdon ky trend, duhet të priten edhe 131 vite që ky proces të përfundojë në këtë regjion.

Grupet dialoguese nuk kanë dhënë rezultate të pritura, edhe pse tashmë është e qartë se adresa dhe çelësi i gjetjes së të pa gjeturve është Beogradi, i cili edhe më tej ngurron të ofrojë informacione lidhur me vendndodhjen e varrezave të tjera. Tanimë edhe nuk po

mbahen takime të tjera, meqë edhe nga kontaktet fillestare në Bruksel nuk ka ende takim zyrtar lidhur me fatin e 1.800 personave të pa gjetur.

Krahas kësaj, së fundmi ka rezultuar edhe krijimi i Institutit për Krime të Luftës, i krijuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili po kompletohet me profesionistë dhe i njëjti institut do të merret me analizën e krimeve të kryera në Kosovë, mbledhjen e fakteve, të dëshmive për secilin rast. Njëherësh, ky institut do të bëjë edhe ngritjen e padive kundër atyre që kanë bërë krime në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Konsideroj se komunikimi dhe afërsia me shoqatat familjare për të pa gjeturit duhet të jetë më serioze dhe më e afërt, sepse shoqatat posedojnë thesar të madh të informacioneve të cilat askush deri më sot nuk i ka mbledhur dhe asortuar në mënyrë institucionale. I mbetet Institutit për Krime të Luftës që sa më parë të vë kontakte me këto shoqata dhe të krijojë afërsi me familjarët.

Duhet të mendohet edhe për krijimin e një monumenti të tipit të holokaustit, i cili do të bënte edhe konservimin e artefakteve të të gjitha krimeve të kryera në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës në vitin 2008 e nxori Ligjin mbi themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, organ ky i cili duhet të avancohet dhe të mbështetet në ngritjen e kapaciteteve profesionale vendore.

Ne sot flasim për Projektligjin për persona të zhdukur. Me Ligjin për të zhdukurit do të mbrohen të drejtat dhe interesat e familjarëve të personave të zhdukur. Me këtë ligj ne do të tregojmë se ndjejmë dhembjen dhe jemi më afër me familjarët të cilët edhe më tutje nuk dinë për fatin e më të afërmve të tyre. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Justina Pula.

JUSTINA PULA: I nderuari kryesues,

Të nderuar ministra, të nderuar deputetë,

Projektligji për personat e zhdukur ka për qëllim të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur, të drejtat e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur të cilët janë zhdukur në periudhën 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës së Kosovës në vitin 1998 – 1999. Ky projektligj, kështu i propozuar, nuk ka gjallëri dhe nuk do t'i shërbejë qëllimit dhe krijimit të infrastrukturës ligjore. Mirëpo, për shkak të rëndësisë dhe peshës, ky projektligj duhet të miratohet në parim, duke plotësuar dhe avancuar me të gjitha sugjerimet që do të propozohen në këtë Kuvend dhe duke u bazuar në praktikat e vendeve të ndryshme që kanë kaluar përafërsisht fazën në të cilën ka kaluar edhe Kosova.

Në memorandumin shpjegues, Ligji thirret në legjislationin ndërkombëtar për persona të zhdukur, mirëpo në asnjë dispozitë të Ligjit nuk ka referencë për ndonjë dokument apo konventë për persona të zhdukur, e cila është adresuar përmes këtij ligji. Për shkak të ndjeshmërisë së çështjes dhe të implikimeve ndërshtetërore, mendoj dhe sugjeroj që të

propozohen dokumentet si Konventa Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Protokollet Shtesë, Konventat e Gjenevës mbi Mbrojtjen e Viktimave të Luftës e tjera. Pra, dokumente mbi parimet e të cilave duhet të hartohet ky ligj.

Qëllimi i ligjit i përcaktuar në nenin 1.1, është të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur. Edhe pse në një dispozitë të këtij ligji, neni 4, thuhet se të drejtat dhe interesat e personit nuk paragjykojnë, mirëpo qëllimi i këtij ligji duhet të jetë avancimi i hetimeve në raport me personat e zhdukur dhe adresimi i të drejtave dhe autorizimeve të familjarëve të tyre në informacion dhe realizimi i të drejtave sociale dhe jo ligj për mbrojtjen e të drejtave të personave të zhdukur.

Qëllimi i ligjit, pra, duhet të jetë: avancimi i hetimeve dhe i procesit të kërkimit të personave të zhdukur, të drejtat dhe autorizimet e familjarëve për realizimin e të drejtave sociale. Për shkak të peshës, rëndësisë dhe qëllimit të ligjit, përmes të cilit anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur u bëhet hapësirë në këtë ligj, konsideroj se duhet identifikuar se cilët janë anëtarët e familjes të cilët mund të përfitojnë nga garancionet, autorizimet dhe të drejtat të cilat u njihen me këtë ligj, dhe jo vetëm referohet si anëtar i familjes i përcaktuar me dispozitën e Ligjit mbi familjen, neni 2.1.2 i Projektligjit.

Neni 5.4 i Projektligjit përjashton përgjegjësinë penale për persona të cilët kërkojnë të dinë për fatin e familjarëve të zhdukur. Cili është qëllimi i kësaj dispozite, cila do të mund të ishte përgjegjësia penale e familjarit për kërkim të informacionit dhe me çka mbrohet ky familjar? Kjo dispozitë nuk do të duhej të ishte fare në këtë ligj, nuk është e kuptueshme se në çfarë konteksti përjashtohet përgjegjësia penale.

Neni 6.2 i Projektligjit, mendoj se kjo dispozitë ligjore është shumë e përgjithësuar në kuptim që mund të ketë fëmijë vetëm të moshës madhore dhe me aftësi të plotë veprimi, pa nevojë për përcaktimin e kujdestarit, të riformulohet për të lexuar: “caktohet kujdestari nën kushtet e përcaktuara me ligj”.

Disa situata apo nene të cilat u referohen rregullimit me ligje të tjera, përmbajnë referenca në dispozitat relevante në numër të atij ligji dhe disa të tjera vetëm i referohen emrit të ligjit.

Në këtë drejtim, dispozitat e këtij projektligji duhet të jenë konsistente, duke sugjeruar të mos u referohen dispozitave konkrete të ligjeve të tjera, por vetëm ligjeve të tjera përmes emërimit të tyre.

Dispozita e projektligjit nuk përcakton se çfarë ndodhë në situatën e personit të zhdukur kur të ndërpritet kërkimi në raport me këtë ligj, domethënë çfarë bëhet me informacionin lidhur me këtë person, a mund të ketë qasje në ato informacione kush mund të ketë qasje dhe afatet e përcaktuara.

Në ligj përcaktohet përbërja e komisionit, mirëpo sugjerohet që të përcaktohet numri i anëtarëve të komisionit, si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesit të shoqërisë civile, respektivisht të shoqatave që janë të përfaqësuar anëtarët e familjeve të zhdukura.

Në nenin 8.3 të projektligjit nuk përcaktohet për çfarë qëllimi do të shfrytëzohen donacionet. A do të shërbejnë si ndonjë fond i posaçëm për përkrahje të anëtarëve të familjes, si për shembull, procedurat e varrimit, rivarrimit, shkollimin e anëtarëve të familjes apo forma të tjera, apo është menduar që këto donacione të përdoren për shpenzimet e komisionit qeveritar për personat e zhdukur. Mendoj se është e nevojshme me ligj të përcaktohen shpërndarja dhe struktura e donacioneve.

Mendoj se projektligji ka paraparë vetëm qasje në informata, por nuk lehtëson qasjen e familjarëve të personave të zhdukur në realizimin e të drejtave të tyre. Pra, përpos të drejtave në informim për statusin e personave të zhdukur, nuk ka mekanizëm për realizimin e të drejtave të familjarëve të zhdukur. Në veçanti ligji duhet të përkufizojë procedurat për realizimin e të drejtave, organet të cilat duhet të zhvillojnë procedurat, sanksionet për personat zyrtarë që nuk japin informata të sakta, të shpejta dhe të mjaftueshme.

Të nderuar deputetë,

Mendoj se ky projektligj, edhe pse ka shumë mangësi, duhet të miratohet në parim për të dhënë mundësi të plotësohet dhe avancohet për shkak të rëndësisë dhe nevojës për implementim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja e zotërinj deputetë,

Pothuaj se në përgjithësi shqetësimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës përafërsisht janë të njëjta, kështu që u shpenzuan edhe shumë nga vërejtjet apo u përmendën shumë nga vërejtjet qoftë nga grupi im parlamentar dhe të tjerë, vërejtje të cilat do të duhej të ngrihen patjetër në këtë ligj.

Por, sidoqoftë, dua të shpreh vlerësimin tim që ky ligj është shumë i nevojshëm për shoqërinë e Kosovës, e në veçanti edhe për kategoritë, siç janë familjet e të zhdukurve. Pra, ky ligj shpresojmë se ta zbus brengën dhe dhembjen shumë të madhe të këtyre familjeve dhe njëkohësisht të jetë një zgjidhje ligjore për trajtimin e kësaj kategorie shumë të rëndësishme dhe njëkohësisht të ndjeshme për shoqërinë e Kosovës. Por, përveç se një rutine si pasojë e shtytjes së rutinës së zakonshme, ky ligj nuk duhet të jetë kështu, por ky ligj duhet të jetë vërtet një obligim ndaj kësaj kategorie dhe ndaj kategorive tjera, siç janë edhe kategoritë tjera të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, më konkretisht, siç janë edhe veteranët grevistë.

Por, sidoqoftë, vërejtjet e mia do të fokusoheshin kryesisht në vërejtjen më të madhe që u bë në këtë ligj, siç është vërejtja lidhur me përfshirjen e periudhës që trajton ky ligj. Dihet, po dihet qartë tendenca e përfshirjes së kësaj periudhe dhe nëse llogarisim nga

janari i vitit 1998 dhe të përfundojmë në fundin e vitit 2003, kjo po shihet qartë se tendenca është për ta përfshirë brenda këtij ligji për afërsisht një vit e gjysmë të kohës së luftës dhe një vit e gjysmë të kohës së pas luftës, kur unë mendoj se është shumë, shumë e padrejtë për shkak se të zhdukurit janë të zhdukur, qoftë në luftë, qoftë pas lufte dhe qoftë para lufte.

Ky lloj barazimi vërtet është i pakuptimtë dhe nuk duhet të vazhdohet më me këso lloj barazimesh politike, me tendenca të politizimit edhe të kësaj çështjeje shumë të ndjeshme për shoqërinë e Kosovës dhe jo vetëm për shoqërinë e Kosovës.

Pastaj, një vërejtje tjetër që vërehet në projektligj, qysh në nenin 1, është lidhur me përkufizimet, përkufizimi – personi i zhdukur quhet vetëm personi i cili është zhdukur brenda kësaj periudhe dhe personi i cili është zhdukur pas kësaj periudhe nuk përfshihet, pra të quhet person i zhdukur, personi i cili është zhdukur vetëm brenda kësaj periode, mendoj se është, ndoshta jo vetëm teknikisht, por si do qoftë, së paku teknikisht është e padrejtë. Dhe në anën tjetër, nëse një person i zhdukur i cili manipulohet dhe shpeshherë ka diversione gjatë tekstit në mes personit të zhdukur dhe personit të pagjetur, mendoj se kjo duhet të definohet saktësisht se këta persona janë të zhdukur, janë të pagjetur apo cili është statusi i saktë i tyre për shkak se para familjarëve quhen persona të zhdukur, në vend tjetër quhen persona të pa gjetur dhe në raste tjera edhe quhen persona që mungojnë.

Sidoqoftë, rreth nocioneve ne duhet të kemi më shumë sukses se sa është kushtuar në këtë kontekst. Ne, për shkak të nevojës së domosdoshme të këtij ligji, do ta përkrahim në leximin e parë, ne do të japim kontributin tonë edhe si grup parlamentar, edhe si deputet që ky ligj të dalë pa tjetër në funksion të këtyre kategorive. Nëse nuk përfshihen këto vërejtje që thuhet janë shumë esenciale, atëherë do ta shqyrtojmë edhe një herë me voton tonë dhe përkrahjen tonë në leximin e dytë por, sidoqoftë, mendoj që fokusi kryesor jo vetëm i imi, por i gjithë deputetëve këtu ishte sa i përket kohës së përfshirjes, të cilën e konsiderojmë një tendencë jo serioze sidomos për këtë kategori e cila ka dhënë dhe ka vuajtur shumë e po vazhdon të vuaj akoma. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Diskutuesi i fundit është kryetari i Grupit të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit zoti nënkryetar!

Unë, shumë shkurt, vetëm dëshiroj t'i them dy-tri çështje, u thanë edhe nga kolegët deputetë, shumica.

Është e padiskutueshme që ligji është i nevojshëm, por është një ligj më shumë përshkrues, më shumë një lloj satisfaksioni, të mos them moral, se sa që rregullon diçka veçmas karshi familjarëve. Aspak nuk merret me statusin e familjeve të të pagjeturve, veçmas me statusin, që u tha edhe nga parafolësit, e tyre material.

Konsideroj se ky ligj duhet të plotësohet veçmas në këtë pjesë dhe po ashtu duhet të shikohet mundësia, ndoshta edhe e riformulimit të vetë titullit të projektligjit, sepse në një pjesë të madhe bëhet fjalë edhe për familjet, gjë që mund të ishte ndër të tjera si

Projektligj për personat e pa gjetur dhe familjet e tyre, por kjo mbetet të shikohet gjatë amendamentimit.

Konsiderojmë se si duket, qëllimi i këtij projektligji, përpos anës së mirë të nevojshme dhe kahe të nevojshme, sikur është dashur t'i iket koston financiare. Mendoj që nuk mund të jetë kurrfarë justifikimi mungesa eventuale e mjeteve financiare, gjë që unë nuk besoj se ka mungesë mjeteve financiare që ky projektligj të mos ketë edhe këtë pjesë që ka të bëjë me gjendjen ose situatën materiale të familjeve të të pagjeturve.

Ne jemi koshientë dhe shohim edhe raste kur Qeveria, edhe për çështje që s'janë shumë të rëndësishme, gjen forma dhe mënyra për gjetjen e këtyre mjeteve materiale.

Prandaj, konsiderojmë që përpos atje që e keni pa në pjesën që ka të bëjë me 200.000 euro, pra kostoja që ka të bëjë me funksionimin e Komisionit qeveritar, e tjera, e tjera, mendoj që gjatë diskutimeve publike, me kyçjen aktive, të rolit aktiv gjatë amendamentimit të këtij projektligji edhe të shoqatave të familjarëve të të pagjeturve, jam i bindur që kjo pjesë veçmas ka mundësi të rregullohet dhe në asnjë mënyrë të mos kalojë, pas leximit ose në leximin e dytë, pa u rregulluar edhe statusi, thjeshtë, material sepse vetëm me fjalë të kota dhe të përshkrimit të asaj se çfarë detyrash ka Komisioni qeveritar dhe të tjerët, mendoj që nuk është as satisfaksion, as nuk e kryejmë obligimin që e kemi karshi kësaj kategorie të rëndësishme të shoqërisë sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! S'ka më të tjerë që e duan fjalën Përfaqësuesi i Qeverisë, a e do fjalën? Nuk e do fjalën përfaqësuesi i Qeverisë.

Ju bëj me dije se në sallë janë 72 deputetë. Unë kërkoj edhe prej deputetëve, edhe prej regjisë që të bëhemi gati ta miratojmë në parim Projektligjin për personat e zhdukur, votojmë tash:

Me 70 vota "për", asnjë abstenim dhe asnjë "kundër", miratohet në parim Projektligji për personat e zhdukur.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet dhe rekomandimet.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmën shtetërore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin e financave, zotin Bedri Hamza, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ta paraqesë para deputetëve dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e ke fjalën!

MINSITRI BEDRI HAMZA: I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ministër i nderuar,

Kam kënaqësinë që sot para jush të paraqes Projektligjin për ndihmën shtetërore, që është një nga fushat prioritare në procesin e integritimit evropian dhe atë të ndihmës shtetërore.

Që nga viti 1999 e deri më tani nuk kemi pasur ligj dhe nuk kemi pasur trupa administrativë të ngritur për dhënien apo kontrollimin e ndihmës shtetërore. Por, duke pasur parasysh se në Kosovë janë zbatuar dhe zbatohen skemat e ndryshme të mbështetjes së financuar nga ana e shtetit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapa seriozë në fushën e ndihmës shtetërore për përgatitjen e një kuadri ligjor dhe institucional, i cili bën të mundur jo vetëm ndërgjegjësimin e të gjithë akterëve për legjislacionin në këtë fushë, por duke krijuar në të njëjtën kohë mekanizma të domosdoshëm për vendosjen e një disipline të tillë edhe në Kosovë. Më pas ne kemi marrë për bazë edhe obligimet që dalin nga Traktati i energjetikës, palë e së cilës është edhe Kosova dhe kërkesat nga Raporti i progresit.

Takime të shumta të ekspertëve vendorë me ata të Drejtoratit gjeneral të konkurrencës të Komisionit Evropian në Bruksel dhe me ekspertët e Traktatit të energjisë në Vjenë të Austrisë na kanë afruar një projektligj shumë kualitativ për ndihmat shtetërore.

Qëllimi i Projektligjit është të përcaktohen parimet dhe procedurat me të cilat lejohet ndihma shtetërore, me qëllim që të mbështetet zhvillimi ekonomik dhe social, të zbatohen parimet e funksionimit të ekonomisë së tregut, të mbrohet konkurrenca, si dhe të përmbushen detyrimet ndërkombëtare të dala nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës.

Fushëveprimtaria e Projektligjit shtrihet për të gjithë sektorët e prodhimeve dhe shërbimeve që veprojnë në Republikën e Kosovës, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë dhe peshkimit, që është edhe rregull brenda Bashkimit Evropian.

Ne në këtë projektligj kemi paraparë ndihmat shtetërore të cilat janë të lejueshme, e këtu hyjnë:

- ndihmat e karakterit social;
- ndihmat në rastet e shkaktuara nga fuqitë natyrore, dhe
- ndihmat deminimis, nëse nuk kalon shumën 30.000 euro.

Më pas, kemi ndihma që mund të lejohen, siç janë:

- ndihmat që jepen për të promovuar zhvillimin ekonomik në rajonet e Republikës së Kosovës, ku standardi i jetesës është jashtëzakonisht i ulët apo papunësia është shumë e lartë;
- ndihmat që jepen për të mënjeluar çrregullimet serioze në ekonominë kosovare;
- ndihmat që lehtësojnë zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, e cila nuk ndikon negativisht në kushtet e tregut, dhe
- ndihmat që nxisin kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë.

Gjithashtu, me këtë projektligj vendosim bazën ligjore për ngritjen dhe funksionalizimin e strukturave të kontrollit të ndihmës shtetërore, të cilat duhet të luajnë një rol të rëndësishëm rregullator për një zbatim sa më eficient të politikave që do të ndiqen për nxitjen dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorëve dhe rajoneve të veçanta të vendit.

Ndër hapa të rëndësishëm që do të ndërmerren në këtë periudhë, do të jetë ngritja e Komisionit dhe Zyra e Ndhmës Shtetërore. Sikurse na është kërkuar nga Komisioni Evropian, Zyra e Ndhmës Shtetërore që merret me kontrollin e ndihmave shtetërore do të jetë e pavarur në funksionet e saj. Kjo zyrë për qëllimet e pavarësisë dhe transparencës do të themelohet në Komisionin Kosovar të Konkurrencës.

Kemi paraparë edhe themelimin e Komisionit vendimmarrës të ndihmës shtetërore. Ky komision do të jetë i përkohshëm deri në integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, më pas kjo kompetencë kalon në nivel të Komisionit Evropian. Anëtarët e paraparë të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, si strukturë vendimmarrëse, janë me një përfshirje të gjerë që përfaqësojnë shoqërinë civile dhe ministritë që nuk janë dhënëse të drejtpërdrejta të ndihmës shtetërore. Ky është një parakusht mjaft i rëndësishëm për të siguruar edhe këtu pavarësinë vendimmarrëse të komisionit, i cili ka të gjitha fuqitë ligjore të autorizojë skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale, si dhe të kërkojë kthimin e ndihmave që janë dhënë në mënyrë të paligjshme apo janë keqpërdorur.

Të nderuar deputetë,

Aprovimi i këtij projektligji përbën një mundësi për të hartuar politika që do të çojnë në nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja, apo ndërhyrje të tjera mbështetëse në ata sektorë apo industri që potencialisht mund të jenë konkurrues në tregun rajonal apo edhe atë evropian. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se buxheti ynë është mjaftë i limituar, kërkohet një vlerësim i plotë i masave të tilla, në mënyrë që të monitorohet efektiviteti i tyre dhe ndikimi që ato do të kenë në konkurrencë. Më pas, raportimi i rregullt i ndihmave të dhëna janë disa nga masat kryesore për të siguruar transparencë edhe të përdorimit eficient të fondeve publike. Të gjitha këto masa synojnë një zhvillim të qëndrueshëm të vendit, por mbi të gjitha do të krijojnë mundësinë që ekonomia jonë të jetë më dinamike dhe e aftë për të përballuar kërkesat dhe standardet tash të vendosura nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Duke ju falënderuar për vëmendjen e juve, ju ftoj që ta votoni këtë projektligj dhe, normalisht, pres kontributin e juaj gjatë komisioneve funksionale dhe begatimin e këtij dokumenti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fillojmë diskutimin në parim për këtë Projektligj për ndihmën shtetërore. Kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, a e do fjalën? Deputetja Safete Hadërgjonaj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ndihmë shtetërore në mbledhjen e mbajtur me datën 8.6.2011 dhe e ka miratuar këtë projektligj njëzëri.

Me këtë projektligj rregullohet mundësia e lejimit të ndihmës shtetërore për sektorët e ndryshëm me qëllim të përkrahjes së zhvillimit ekonomik dhe social, kurse çdo formë e ndihmës shtetërore e cila është në kundërshtim me rregullat e konkurrencës së lirë dhe parimet e ekonomisë së tregut të lirë, me këtë ligj është e ndaluar.

Sipas Projektligjit për dhënien e ndihmës shtetërore, janë kompetentë organet qendrore dhe ato lokale dhe rregullativa e ndarjes së këtyre ndihmave është e përcaktuar qartë me projektligj.

Në nenin 5 të projektligjit janë të përcaktuara rastet në të cilat jepet ndihma shtetërore. Po ashtu, në nenin 6 të këtij projektligji janë të specifikuar edhe rastet specifike në të cilat shteti mund të japë ndihmë.

Ligji ka paraparë mekanizmat e zbatimit. Ligji për këtë qëllim parasheh formimin e Zyrës për Ndihmë Shtetërore, e cila do të themelohet në kuadër të Komisionit të Pavarur të Konkurrencës. Kjo zyrë ka kompetencë që të kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore dhe parandalimin e dhënies së ndihmës shtetërore, e cila e cenon konkurrencën e tregut dhe të sigurohet se një ndihmë e tillë mund të bëhet vetëm në rastet specifike. Për rastet e ofrimit të ndihmës shtetërore, me projektligj parashihet formimi i Komisionit për Ndihmë Shtetërore.

Projektligji i plotëson kërkesat formale për t'u miratuar në lexim të parë, sepse përveç strukturës së standardizuar, përmban edhe dokumentet përcjellëse, si deklaratën për përputhshmëri me standardet e Bashkësisë Evropiane dhe deklaratën për implikimet financiare që mund t'i ketë ky projektligj.

Sipas Deklaratës së Agjencionit për Integritet Evropian, projektligji nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të Bashkësisë Evropiane dhe në përgjithësi përmban rregulla ligjore, që sipas direktivave të Bashkësisë Evropiane, nuk lejon dhënien e ndihmës shtetërore që dëmton tregun e lirë dhe konkurrencën. Ndihma shtetërore lejohet vetëm për raste specifike të cilat janë të lejuara edhe brenda vetë shteteve anëtarëve të Bashkësisë Evropiane.

Projektligji i ka disa implikime buxhetore të cilat janë të specifikuar në deklaratën financiare. Këto shpenzime kanë të bëjnë me themelimin e Zyrës për Ndihmë Shtetërore

dhe për anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore të cilat janë të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Shpenzimet për dhënie e ndihmës shtetërore duhet të parashihen me plane të veçanta, të cilat duhet të jenë edhe pjesë e ndarjeve buxhetore të parapara me Ligjin për buxhetin. Dhënia e ndihmës shtetërore duhet të marrë miratimin nga Komisioni për Ndihmë Shtetërore dhe pastaj planifikohen në Ligjin për buxhet. Për këtë arsye, është parapara që zbatimi i këtij projektligji të fillojë nga janari i vitit 2012.

Në projektligj është e nevojshme të precizohen më mirë disa çështje, siç janë:

- qartësimi i rolit dhe funksionit të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, sepse do të merret me një veprimtari mjaft komplekse dhe që kërkon eksperiencë të veçantë;
- rregullimi më i detajuar i funksionimit të Zyrës për Ndihmë Shtetërore;
- Po ashtu, është shumë e rëndësishme që të bëhet harmonizimi i këtij ligji me disa ligje tjera, siç janë Ligji për konkurrencën; Ligji për rezervat shtetërore; Ligji për menaxhimin e financave publike, si dhe Ligji për menaxhimin e financave lokale, por edhe me ndonjë ligj tjetër me të cilin mund të bie ndesh ky projektligj.

Komisioni për Buxhet dhe Financa është i mendimit se Projektligji i plotëson kushtet formale dhe përmbajtësore dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë në parim, kurse plotësim-ndryshimet e nevojshme të këtij projektligji komisioni do t'i bëjë gjatë amendamentimit dhe në bazë të amendamenteve të cilat eventualisht mund të vijnë nga deputetët e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Hadërgjonaj! Në emër të Grupit të PDK-së, deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për ndihmë shtetërore dhe ka vendosur që ta mbështesë në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit të LDK-së, Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Pas shqyrtimit të këtij projektligji, Grupi Parlamentar i LDK-së nxjerr këtë përfundim dhe ka këto vërejtje:

Me këtë Projektligj Qeveria ka dashur të shtojë numrin e ligjeve të cilat vështirë se do të mund të implementohen ndonjëherë, aq më pak tani duke pasur parasysh realitetin e krijuar buxhetor të Kosovës. Por, edhe nëse vetëm për pak lëmë në një anë implementimin e tij, edhe si ligj në letër, nuk ka dal aq i mirë.

Projektligjet që vijnë nga Qeveria janë të hartuara dobët deri në papërgjegjësi. Edhe këtë ligj mund ta lexoni disa herë dhe të mos kuptoni qëllimin e tij të vërtetë. Ne deputetët tanimë u lodhëm duke bërë vërejtje të njëjta, por si duket Qeveria nuk po lodhet së përsërituri gabimet e njëjta.

Në ligj ka edhe formulime të panatyrshme dhe të vështira për t'u kuptuar, siç është rasti në nenin 3 pika 1.1. ku kemi një përkufizim të asaj çka është ndihma shtetërore. Citoj: "Ndihma shtetërore është çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore në cilëndo formë, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë cenon ose rrezikon konkurrencën, duke u dhënë përparësi një ose disa ndërmarrjeve të caktuara për prodhimin e produkteve të caktuara".

Ky përkufizim nuk është në rregull. Kosova as që do të mund të bëjë ndonjë gjë të tillë ndonjëherë dhe përse ta ketë një ligj të përkufizuar shumë negativisht.

Ne jemi vend me kufij të hapur për të gjithë, edhe për ata të cilët i kanë mbyllur kufijtë për neve dhe as që bëhet fjalë ndonjëherë që do të mund t'u dalim në ndihmë ndërmarrjeve të caktuara në masën që e cenojnë konkurrencën.

Ne që thirrëmi në ekonominë e tregut dhe që synojmë të jemi pjesë e familjes evropiane, duhet të kemi një ligj përmes të cilit ju ofrojmë ndihmë ndërmarrjeve të cilat për një varg arsyesh nuk janë të barabarta me konkurrentët në treg, i subvencionojmë ato për t'i vënë në pozitë të barabartë me të tjerët.

Nëse është ashtu siç thuhet në nenin 3, atëherë po në këtë ligj duhet të cekën të gjitha rastet kur një ndihmë e tillë mund të jepet, sepse në nenin 6 ajo është shumë e përgjithësuar.

Madje kemi një formulim shumë kontradiktor të nenit 4, i cili thotë: "Ndalimi i ndihmës shtetërore, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj". Ndihma shtetërore, ashtu siç është definuar në nenin 3 të këtij ligji, ndalohet.

Këtu kemi një mohim të dyfishtë, i cili mund të kuptohet se në rastet e definuara ndryshe nga ky ligj, mund të gëzojnë ndihma shtetërore.

Një gjë tjetër shumë shqetësuese për të gjithë ne është edhe zbatimi i Ligjit pasi që i njëjti të miratohet. Në dokumentet përcjellëse flitet për koston vjetore të Zyrës, e cila do të jetë në kuadër të Komisionit të Konkurrencës, e cila mund të arrijë shumën prej 30 deri në 35.000 euro në vit, por nuk flitet aspak se sa kanë buxhet organet shtetërore të definuara në nenin 3 pika 1.2. për të ofruar ndihmë shtetërore, e cila mund të jepet në njërin nga format e përkufizuara në nenin 3, pika 1.1. Dhe nuk flitet fare se çfarë implikime mund të ketë ky ligj në buxhetin e Kosovës në përgjithësi.

Qeveria duhet të ketë program, buxhet pra, siç duhet të përshkruhen në këtë ligj. Duhet të cekim patjetër se gjatë vitit të kaluar, çmimi i bukës është ngritur 4 herë, duke dëmtuar

dhe cenuar nivelin minimal të standardit të jetës së shumë qytetarëve të Kosovës. Mosndërhyrja e Qeverisë në asnjë formë, nuk miun të themi se ka qenë mungesa e këtij ligji, por përkundrazi, edhe pasi që ky ligj të aprovohet, Qeveria nuk ka ndonjë strategji se si t'i mbrojë qytetarët në situata të kështilla. Furrtaarët kanë kërkuar vazhdimisht nga Qeveria që të hiqet tatimi mbi vlerën e shtuar për bukën, por kjo nuk ka ndodh, e raste të tilla ka mjaft.

Si përfundim, Ligji ka mjaft mangësi. Ne si Grup Parlamentar do të japim kontributin tonë si parti nëpër komisionet përkatëse, duke shpresuar se Qeveria do ta zbatojë këtë ligj duke mbrojtur gjithnjë interesin e qytetarëve të vendit dhe duke krijuar kushte të njëjta për ndërmarrjet tona, por duke mos ndërhyrë në mekanizmat e tregut dhe konkurrencën e lirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sot e kemi këtu përpara një ligj, i cili fatkeqësisht, po them prapë, është më shumë ligj që për t'iu pëlqyer tjerëve, se sa për të na shërbyer ne.

Pra, Projektligji për ndihmën shtetërore, siç u përmend, domethënë edhe këtu në disa raste, i ka disa mangësi shumë të mëdha përbrenda tij, edhe në disa nene, dhe në ato nuk do të hyja, meqë është leximi i parë tash, pra janë vërejtje të cilat ne do t'i shtrojmë përmes komisionit funksional që ishte dashur ta shqyrtojë këtë ligj, e siç mora vesh sot, nuk e ka shqyrtuar fare.

Mirëpo, kisha dashur të ndalem pak te ndihma shtetërore dhe te rëndësia e ndihmës shtetërore që ka veçanërisht për ekonominë e Kosovës dhe atë që unë mendoj se ky ligj në fakt nuk po e mbulon si duhet, për shkak se këtu po flitet për një ndihmë shtetërore, e cila do të jepet përmes Agjencionit për Konkurrencë, pra një ndihmë shtetërore e cila do ta garantonte një lloj konkurrence përbrenda tregut, gjë që është e rëndësishme, natyrisht, mirëpo jo më e rëndësishme se ajo që i nevojitet sot ekonomisë së Kosovës.

Ekonomia e Kosovës sot ka nevojë për ndihmë shtetërore, veçanërisht në ato aspekte ku tregu nuk funksionon fare, pra ku tregu ka dështuar, siç është rasti për shembull me industrializimin e vendit apo riindustrializimin e vendit, ku ne po shohim se kjo ekonomi e tregut vetëm sa po e dëmton atë, e jo që po e ngjall as industrinë e kaluar të Kosovës, e lëre më që ta zhvillojë atë tutje dhe në këtë drejtim ndihma e shtetit është e pazëvendësueshme.

Ky ligj nuk e mbulon këtë lloj ndihme dhe nuk flet për këtë lloj ndihme, gjë që konsideroj se do ta shndërrojë këtë ligj edhe në një prej ligjeve që do ta kemi në sirtar dhe do të mund t'u flasim të huajve që e vizitojnë Kosovën se e kemi edhe këtë ligj, pa kurrfarë dobie që do të ketë ekonomia e Kosovës nga ky ligj.

Prandaj, duhet përmendur se Lëvizja Vetëvendosje do ta votojë në parim këtë ligj, me shpresë që ato vërejtjet tona që do t'i shtrojmë në Komision do të merren parasysh. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Në këtë Projektligj përcaktohen parimet dhe procedurat në përputhje me të cilat lejohet dhe kontrollohet ndihma shtetërore me qëllim që të mbështetet zhvillimi ekonomik dhe social. Dhënësit e ndihmës shtetërore janë të gjitha organet e administratës qendrore dhe të qeverisjes lokale, ndërmarrjet publike apo autoritetet që veprojnë në emër të shtetit dhe japin përfitim për ndërmarrje apo sektorë të veçantë.

Ndihma shtetërore jepet sipas skemës së ndihmës, neni 1 pikë 5. Ndihma shtetërore kontrollohet nga Zyra e ndihmës shtetërore dhe krijohet në kuadër të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, ndërsa organ vendimmarrës është Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, shefja e re e këtij grupi, Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh rëndësinë e Projektligjit për ndihmën shtetërore dhe vërejtjet e progresit të vitit 2010, të cilat i potencoi edhe ministri i Financave, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re përkrah në parim Projektligjin për ndihmën shtetërore, i cili mundëson rregullimin e procedurave dhe ndihmën shtetërore dhe kontrollin e tyre.

Duke marrë parasysh se kjo është edhe një pjesë e kornizës ligjore, e cila duhet të plotësohet për funksionimin e një shteti demokratik, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah në parim Projektligjin dhe vërejtjet e sugjerimet e tij do t'i japë në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonjë! Fjalën e merr deputeti Rasim Demiri, për Grupin “6+”.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

Nakon svih analiza i razmatranja, Nacrt zakona o državnoj pomoći ispunjava sve uslove i ne ugrožava osnovna načela zakonodavstva.

Nacrt zakona o državnoj pomoći usklađen je sa međunarodnim standardima i najboljim evropskim zakonodavnim praksama.

Parlamentarna grupa “6+” u načelu podržava Nacrt zakona o državnoj pomoći.

KRYESUESI: Grupi SLS, a është paraqitur kush? Nuk është paraqitur! Nuk kemi të paraqitur tjerë. Le të thirren deputetët për votim!

Të pranishëm tani janë 61 deputetë! E kemi kuorumin që të votojmë. Ju them deputetëve dhe regjisë të bëhemi gati për votimin në parim të Projektligjit për ndihmën shtetërore. Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 3 “kundër” dhe 3 abstenime, konstatoj se ky projektligj u votua në parim.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet dhe rekomandimet.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës.

Veç një moment! Këtu kemi **Shqyrtimin e parë të Projektligjit për nisma legislative**. Ju e keni marrë këtë projektligj dhe ky ka hyrë në rend dite. Megjithatë, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, ky ligj nuk mund të shqyrtohet sot për shkak se nuk kanë kaluar dy javë nga koha e shpërndarjes për deputetët dhe unë propozoj që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, që i bie në javën e ardhshme. Nuk janë plotësuar pra kushtet që ligji të shqyrtohet, aq më tepër nuk ka kaluar edhe në Komisionin për Legjislacion, si komision paraprak. Pse? Po shihet se ekziston një vullnet i Kuvendit që të jetë shumë aktiv në shqyrtimin e legjislacionit, pra le të presin edhe dy-tri ditë, në javën e ardhshme.

Vazhdojmë tutje, në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Para se të procedojmë me votim të amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik që ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju informoj se Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Energji e ka shqyrtuar këtë projektligj në mbledhjen e vet të radhës, i ka konsideruar edhe plotësimet dhe diskutimet e nevojshme edhe të Grupit punues dhe si të tillë e aprovon ose kërkon trajtimin e mëtejshëm të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë i lus deputetët të rrinë në sallë se do të votojmë! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 5 amendamente nga komisioni funksional. Unë tash kërkoj të dimë numrin e deputetëve në sallë!

Në sallë kemi të pranishëm 62 deputetë. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport.

Regjia dhe deputetët, ju lutem të bëhemi gati. Votojmë amendamentin numër 1, tash:

Me 56 vota “për” dhe 1 “kundër”, kalon amendamenti 1.

Bëhemi gati ta votojmë amendamentin numër 2 dhe votojmë tash:

Me 55 vota “për”, zero “kundër”, zero abstënim, kalon amendamenti numër 2.

Vazhdojmë dhe ju thërras ta votojmë amendamentin numër 3, tash:

Me 58 vota “për”, zero “kundër”, zero abstënim, kalon amendamenti 3.

Bëhemi gati të votojmë amendamentin numër 4 dhe votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstënim, kalon amendamenti numër 4.

Votojmë amendamentin numër 5, tash:

(mungon konstatimi i rezultatit të votimit)

Në sallë kemi të pranishëm 64 deputetë. Tash ju thërras, zotërinj deputetë, ta votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, duke përfshirë edhe amendamentet që sapo i miratuar.

Votojmë tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “abstënim”, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim.

Unë tash ju jap pushim të drekës, deri në orën 15:00.

Vazhdimi i mbledhjes pas puze

Mbledhjen drejton: Xhavit Halit, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë seancën e para ditës. Duhet t’ju njoftoj se pika 9 e rendit të ditës shtyhet deri sa të vjen ministri për arsyet që dihen, kanë një takim me një delegacion nga SHBA dhe, besoj, po sa ta kryej, vjen.

Atëherë, vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Projektplanit hapësinor të Kosovës për periudhën 2011 – 2020

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar Projektplanin hapësinor të Kosovës 2011 – 2020, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor, zotin Dardan Gashi, si propozues të çështjes.

MINISTRI DARDAN GASHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që me pak fjalë të paraqes para jush dokumentin më të rëndësishëm të sektorit të planifikimit hapësinor, si dhe njërin ndër dokumentet më të rëndësishme të Qeverisë në përgjithësi.

Plani hapësinor i Kosovës është ndërtuar në bashkëpunim me të gjithë sektorët e rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë edhe profesionistë të dalluar të fushës, institucionet e ndryshme shkencore, Universiteti, organizata të ndryshme jo qeveritare, zyrtarë të nivelit lokalë dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare të kësaj lëmie.

Plani hapësinor i Kosovës 2010-2020 ka për bazë draftin e dokumentit të aprovuar në parim nga Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur në janar të vitit 2007. Nga ajo kohë, deri në fillim të vitit 2009, kur është iniciuar plotësimi i dokumentit, kanë ndodhur ndryshime të cilat është dashur të reflektohen në dokumentin e plotësuar. Fjala është në radhë të parë për ndryshimet politike të cilat sollën shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe më pas pakon e aprovuar të ligjeve.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës është krijuar një bazament krejtësisht i ndryshëm që kërkon qasje dhe veprim sinergjik në të gjitha fushat që ndikojnë në zhvillimin e vendit. Me këtë dokument, Kosova në mënyrë të pavarur orienton kahet e zhvillimit, rregullimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të territorit të vet.

Plani hapësinor i Kosovës është dokument që garanton respektimin e të gjitha të drejtave dhe lirive të gjithë qytetarëve që jetojnë në të, gjithëpërfshirja, zhvillimi i baraspeshuar dhe i qëndrueshëm, promovimi i transparencës së plotë në planifikim, janë disa nga parimet që dëshmojnë se dokumenti është në përputhje me standardet kryesore që dalin nga ligjet e vendit dhe rregullativat ligjore evropiane.

Jemi të sigurt se Plani hapësinor i Kosovës 2010-2020 nuk është në konflikt me asnjë dokument tjetër të Qeverisë së Kosovës dhe se strukturat e përpunuara të dokumentit janë në përputhje të plotë me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe aktet që dalin prej tij.

Duke i pasur të gjitha këto parasysh, besojmë se Plani hapësinor i Kosovës paraqet bazë të mirë për zhvillimin e qëndrueshëm hapësinor të Kosovës dhe ju lus që ky plan të ketë edhe miratimin tuaj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje kolegë,

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 6.6.2011 ka shqyrtuar Planin hapësinor 2011 – 2020 dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta votojë këtë. Komisioni pas shqyrtimit të Planit vlerësoi se ky plan i plotëson kushtet e parapara të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Është me rëndësi të theksohet këtu se me anë të këtij plani ose në mbështetje të këtij plani kanë punuar dhe është mbështetur nga ekspertë të pavarur, institucionet përkatëse, HABITAT-i, Instituti për banim dhe studime urbane, Riinvest, Universiteti i Prishtinës, Zyra Civile Ndërkombëtare, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Energjisë dhe e Minierave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Transportit, Ministria e Tregtisë, Ministria e Shëndetësisë. Mund të them se në këtë plan kanë punuar bashkërisht të gjithë dhe ky plan është i rekomanduar nga komisioni që të miratohet, sepse më i mirë është një plan kështu, se pa plan hiq. Prandaj, kërkoj nga deputetët që ta mbështesin dhe votojnë Planin hapësinor të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Kosova më në fund e ka një Projektplan të zhvillimit hapësinor për dhjetë vitet e ardhshme. Ky plan i ka munguar për një kohë shumë të gjatë dhe ka lënë pasojë të mëdha për shkak të shfrytëzimit të egër të resurseve tona të cilat janë shkakuar si pasojë e nevojave të mëdha të qytetarëve tanë.

Ky është dokument themeltar i cili hapësirën fizike të Kosovës, me të gjitha burimet e saj, do t'i afrojë për shfrytëzim të planifikuar të gjithë nevojtarëve, pa shkaktuar konflikte të thella të interesave në mes tyre.

Për dhjetë vitet e ardhshme, ky plan, ky dokument do të bëhet pikë referimi për të gjithë sektorët dhe nënsektorët dhe zhvillimi i tyre do të marrë dorë aty. Ky plan në kuadër të interesave të përbashkëta do t'i hapë rrugë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, duke i mbrojtur resurset, mjedisin dhe trashëgiminë kulturore të vendit tonë.

Hartimi i kësaj strategjie ka marrë një kohë të gjatë dhe vazhdimisht është varur nga presioni i akterëve të ndryshëm, të cilët në mënyrë të pa planifikuar i kanë shfrytëzuar këto resurse deri më tash.

Këto nevoja do të harmonizohen më shumë me këtë plan dhe njerëzit të cilët janë pjesëmarrës të tyre kanë qenë shumë aktivë në hartimin e saj. Kjo është një shenjë e mirë se ky dokument do të jetë i qëndrueshëm gjatë dhjetë viteve të jetës së tij.

Ne mund të shpresojmë se në 10 vitet e ardhshme do të kemi më shumë zona të mbrojtura, më shumë infrastrukturë, më pak ndotje të mjedisit, më pak humbje të tokës bujqësore, më pak migrim të popullsisë.

Ky plan shpresojmë se do t'i motivojë komunat të cilat nuk i kanë aprovuar planet zhvillimore të tyre, që ato t'i hartojnë dhe miratojnë sa më shpejt.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se kjo strategji do të duhej të ishte më e mirë dhe si e tillë do të zgjidhte të gjitha nevojat në rritje të popullsisë së re të Kosovës, por për këtë fazë mendojmë se do të japë efekte pozitive.

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka marrë vendimin që ta miratojë këtë plan dhe si të tillë ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, nuk është paraqitur askush. Deputeti Liburn Aliu, e ka fjalën! Më falni, LDK-ja qenka në radhë. E ka fjalën deputeti Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Më fal Liburn!

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar Planin hapësinor të Kosovës dhe njëkohësisht ka paraqitur disa nga të metat kryesore të këtij plani hapësinor të Kosovës.

Gjatë periudhës së hartimit të Planit hapësinor të Kosovës kishte mungesa të shumta të dhënave për fusha të ndryshme tematike dhe gjithashtu ato të dhëna që ishin në dispozicion ishin shumë të vjetra. Së pari, nuk kishte të dhëna mbi situatën demografike në Kosovë, pasi që regjistrimi zyrtar i popullsisë është bërë në vitin 1981, kishin kaluar më shumë se 20 vite nga regjistrimi i popullsisë dhe gjendja demografike kishte ndryshuar dukshëm, sidomos pas atyre rrjedhave të konfliktit të fundit.

Gjithashtu, të dhënat ishin shumë të mangëta edhe në fushën e zhvillimit ekonomik, shfrytëzimit të tokës, banimit, infrastrukturës, si dhe në sektorë tjerë.

Për të gjitha fushat e përmbledhura në Plan janë shfrytëzuar të dhënat mjaft të vjetruara dhe gjithashtu edhe vlerësimet në të shumtën e rasteve nuk ishin të sakta.

Mungesa dhe vjetërsia e të dhënave ishte një e metë mjaft e madhe për këtë dokument për faktin se nuk ka mundur të paraqitet një gjendje reale e situatës ekzistuese dhe më pas vështirë që të mund të jenë planifikuar saktë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Kemi të dhëna që janë paraqitur që nga viti 1981, duhet të bëhet abdeit me të dhëna të reja sipas regjistrimit të popullsisë, si dhe me të dhëna tjera.

Vonesa gjatë hartimit dhe procedurat e aprovimit të planit. Plani hapësinor i Kosovës ka filluar të hartohet që nga viti 2001, drafti i parë i këtij dokumenti ka përfunduar në vitin

2005, më pas nuk shkon për aprovim për faktin se vije në shprehje edhe pakoja e Ahtisarit, e cila tanimë duhet të inkorporohet në këtë dokument. Kështu fillon sërish puna me kompletimin e draftit të planit. Tani kur gjendemi në vitin 2011, ky dokument është në procedurë për aprovim dhe pret miratimin e tij.

Kjo pa dyshim se sjell me vete edhe shumë të meta dhe vështirësi, sidomos në implementimin e tij. Deri sa në këtë plan janë paraparë projekte të rëndësishme nacionale për t'u realizuar, mos aprovimi i këtij plani ka ndikuar që edhe një pjesë e konsiderueshme e këtyre projekteve të mos implementohet.

Në këtë plan hapësinor si kritika janë paraqitur edhe analiza e gjendjes, papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme, ku Kosova është vendi me shkallë më të lartë e papunësisë në rajon. Kjo normë e papunësisë sillet rreth 49% sipas të dhënave të vitit 2003, nga raporti i Ri-investit, ndërsa kur jemi në vitin 2011 papunësia në Kosovë akoma është më e madhe dhe në rritje. Njëkohësisht, varfëria e lartë dhe në rritje të vazhdueshme sipas të dhënave të këtij plani hapësinor gjatë vitit 2000 dhe 2003 në përqindje kemi 37% e popullatës që jeton në varfëri të plotë, që do të thotë 1.42 euro/cent për person të rritur në ditë. Ndërsa 15.2% jetojnë në vijën ekstreme të varfërisë, që do të thotë 0.93 cent/euro në ditë për person, ndërsa tash jemi në vitin 2011, varfëria në Kosovë vazhdon të jetë ende në rritje dhe njëkohësisht në shumën më të madhe.

Përkujdesja shëndetësore, e paraqitur në këtë raport hapësinor është në nivel të ulët dhe dëshmitë në dispozicion tregojnë për rezultate shumë të dobëta të shëndetësisë, të cilat janë ndër më të dobëtat në Evropën Juglindore.

Zhvillimet që po ndodhin në Kosovë janë kryesisht nga ky plan dhe në të shumtën e rasteve përfaqësojnë interesat e grupeve të caktuara, përderisa zyrtarët e Ministrisë së Ambientit raportojnë para komisionit se në 13 komuna kanë miratuar planin urbanistik, pa miratimin e këtij plani të Kosovës nga Parlamenti i Kosovës.

Është thënë, krejt në fund, se do të bëhet revidimi në bazë të shifrave të dhëna dhe të reja, andaj ne si Grup Parlamentar kërkojmë që ka edhe ndryshime, do të thotë, në kuadër të shifrave, kërkojmë që ky plan duhet të modifikohet dhe duhet të jenë shifrat më të sakta dhe më reale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Planin hapësinor të Kosovës 2010-2020 plus, Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” e ka pasur në trajtim dhe konsideron që në shumë aspekte dhe në shumë lëmi ky plan hapësinor i Kosovës jep informacione mjaft të detajuara, përpos që në shumë aspekte po ashtu mbetet i mangët për shkak të regjistrimit të popullsisë ku në këtë rast, për shembull, në një vend thuhet se Prishtina e ka dyfishimin e popullsisë dhe gjendja reale, në bazë të regjistrimit të fundit, del krejtësisht ndryshe.

Ajo çka do të doja të theksoja më tepër, është që ky plan është gati që nga viti 2006 dhe është pritur që në vitin 2006 të aprovohet. Arsyeja e mos aprovimit në vitin 2006, fakti se ky nuk është aprovuar në atë kohë, ka sjell deri te shumë ndërmarrje në aspektin e zhvillimit të Kosovës, që janë bërë pa pasur plan hapësinor, respektivisht planet hapësinore të komunave që janë zhvilluar, duke mos qenë i aprovuar plani, edhe pse janë bazuar në të, pra realisht nuk ka pasur bazë ligjore në këtë aspekt.

Ndërsa, ajo çka do të duhej të theksoj, më tepër është e meta e kësaj që ky plan nuk është aprovuar deri tani i ka konvencuar, mund të themi Qeverisë, sepse për shumë ndërmarrje të veta që i ka bërë në ekonomi, në disa prej tyre është bazuar në draft planin dhe në disa të tjera nuk është bazuar fare. Pra, kjo mundësi që shumë ndërmarrje të bëhen duke mos pasur ndonjë bazë, vetëm thjeshtë të merren veprime pa një analizë paraprake, kanë sjell edhe te pasojat dhe sot ky plan, tani që e kemi në para vites, në raport me planin e vitit 2006 ka ndryshime të cilat janë, mund të themi, në shumë aspekte edhe të pa pranueshme, sidomos për ato që lidhen me pjesën e pakos së Ahtisarit.

Ta zëmë, në këtë plan, tani janë inkorporuar Termoelektrana, pra Kosova e Re, po ashtu po të ishte ky plan i miratuar me kohë, autostrada që sot po ndërtohej, nuk do të kishim dilema se çfarë trase do të marrë kjo autostradë. Po ashtu, në këtë plan tani është shtuar edhe Hidrocentrali i Zhurit, pa e pasur ndonjë analizë pra edhe në marrëdhënien me Shqipërinë, me këtë rast, dhe prioritetet që kanë qenë sipas planit, sidomos për infrastrukturën rrugore, nuk janë respektuar të këtij plani, pra si draft. Është ideja pra e unazës në nivel të Kosovës dhe të gjitha këto pra kanë lejuar që Qeveria ka pasur mundësinë për disa lëmi të bazohet në planin, në draft plan dhe për disa lëmi tjera të ndërmarrë veprime krejtësisht që nuk janë në plan.

Dhe ajo çka është më e rënda, që e bën tani këtë plan po thuaj të papranueshëm, është inkorporimi i zonave të veçanta sipas planit të Ahtisarit, ku normalisht në vitin 2006 nuk kanë qenë në këtë plan dhe tani të gjitha këto zona, ashtu siç kanë rrjedhë nga procesi negociator në Vjenë, siç e kemi pra nga produkti i pakos së Ahtisarit, në të njëjtën mënyrë me ato harta, me atë territor, është inkorporuar, gjë që Kosovës përgjithësisht, trashëgimisë kulturore në Kosovë i bën jashtëzakonisht dëm të madh.

Të gjitha këto modifikime të këtij plani hapësinor pra, modifikime të cilat gjithnjë iu kanë përshtatur situatave dhe jo që janë analizuar paraprakisht, kanë bërë që ky plan sot të ketë diskrepanca në mes asaj të mëparshmes që kishte së paku një vizion e që bazohej diku dhe kompromiseve të bëra në kohë apo interesave të ngushta të qeverive apo të Qeverisë, ta themi, në kohë të caktuar kur bëhej fjalë, ta zëmë, për rrugën apo për ndonjë investim tjetër, siç është rasti me Kosovën e Re.

Prandaj, shikuar nga ky aspekt, konsiderojmë që Plani hapësinor duhet të rishikohet dhe të bazohet në atë të vitit 2006 dhe çfarëdo analizë të bëhet bazuar në atë dhe jo në marrëveshjet politike të cilat kanë qenë të imponuara për Kosovën.

Fakti se brenda këtij plani janë të përfshira zona të veçanta të pakos së Ahtisarit, për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” e bën të papranueshëm edhe përkundër vlerave të shumta që i përmban ky plan në vetvete, që janë dhe mund të themi se është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe në të, mirëpo është pikërisht pjesa e pakos së Ahtisarit, është ajo pjesa politike e cila këtë plan e bën të papranueshëm dhe e dëmton jashtëzakonisht shumë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Nuk e kam në plan t’ju lodh sot. Ma merr mendja se jam ndër njerëzit që ka folur më së shumti për këtë plan deri në vitin 2007. Disa kolegë që folën par meje, i përmendën disa nga ndryshimet që kanë ndodhur që atëherë. Ka pasur edhe disa paradokse lidhur me planin, e një prej paradokseve është se Plani hapësinor i Kosovës në vitin 2007 ka kaluar në parim. Në vetvete, kalimi në parim i këtij plani është paradoks për shkak se ky është një plan i cili kalon ose nuk kalon dhe nuk ka lexim të dytë, nuk mund të kalojë në parim dhe të mos jetë në fuqi.

Legalisht, plani ka qenë në fuqi, po një fjalë e përdorur pa vend një herë në vitin 2007, se ligji ka kaluar në parim, e ka bërë Qeverinë e Kosovës edhe atëherë, shumicën e zyrave, por edhe qeverinë tjetër që të mos e marrë parasysh Planin hapësinor të Kosovës i cili esencialisht u tha edhe prej parafolësve të mi, ka qenë goxha i mirë dhe i përgatitur profesionalisht. - esenca e tij është se është përgatitur profesionalisht, mirëpo duhet ta votojë politika, definitivisht.

Në plan janë inkorporuar disa aspekte energjetike. Gjatë inkorporimit ka pasur edhe lëshime teknike, është bërë një punë e madhe dhe duhet të kihet kujdes që ato lëshime mos të rrinë kështu si janë, për shembull keni legjenda në gjuhën angleze në disa pika. Vetëm sa për ilustrim, e keni në faqen 86 një legendë në anglisht, ka edhe tjera. Do të thotë, duhet të përmirësohen e këto kryesisht kanë të bëjnë me aspektet të cilat, siç thashë më përpara, janë inkorporuar te energjetika, do të thotë janë marrë prej planeve që i kanë bërë.

Një çështje tjetër që është tepër me rëndësi, që mendoj se duhet të thuhet këtu, është se diskutimet publike, diskutimet në Kuvendin e Kosovës, diskutimet nëpër komuna të cilat kanë ndodhur në vitin 2003, 2004, 2005 dhe 2006 kanë pasur disa qëllime. Fillimisht, të mbledhen informacionet prej terrenit, të informohen prej komunave, prej qytetarëve dhe prej shoqërisë civile se cilat janë prioritetet e tyre, po në të njëjtën kohë ka qenë edhe një lloj kampanje në mënyrë që pas aprovimit të çdo komunë, të çdo ministri, ta ketë në tavolinën e punës Planin hapësinor të Kosovës. Do të thotë, që të shërbehet me këtë plan.

Fakti që kanë kaluar më shumë se 3 vite, do të thotë 4 vite prej kohës kur është miratuar dhe prej kohës kur kanë ndodhur diskutime publike, ka bërë që Plani hapësinor i Kosovës të mos jetë më në tryezë, të mos jetë më në agjendë të punës të komunave, të cilat nuk kanë pasur zgjidhje tjetër përpos se t’i adoptojnë planet e veta urbane rregullative, se nuk

kanë pasur çka të bëjnë, kanë qenë të detyruar t'i bëjnë këto punë. Do të thotë, kjo ka bërë që ky Plan hapësinor i Kosovës edhe nëse adoptohet sot, nuk ka për ta pasur peshën dhe nuk ka për ta pasur efektin të cilin është supozuar se do ta ketë pas aprovimit. Do të thotë, është krijuar ajo kulturë e punës pa Plan hapësinor të Kosovës.

Sidoqoftë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e voton Planin hapësinor të Kosovës, sepse mendojmë që është më mirë ta kemi këtë plan, se sa të mos kemi plan tjetër, edhe pse është me një vonesë në atë kuptim, u përmend edhe çështja e regjistrimit të popullsisë dhe mendimi ynë është se do ta votojmë dhe mbështesim këtë Plan hapësinor të Kosovës.

Do të kisha dashur me nja dy fjali të them edhe diçka tjetër, zoti nënkryetar. E kemi pasur një pikë në agjendë para kësaj pike dhe është korniza afatmesme e shpenzimeve.

Ministri nuk është këtu dhe është shumë e vërtetë, atë që e bëtë ju. Mirëpo, kisha dashur të them që nëse ministri vjen këtu pas orës 17, në mënyrë që të mos ketë transmetim kur të diskutojmë për tema të rënda, ne nuk do të diskutojmë për atë temë, do ta bojkotojmë. Transmetimi është për të dëgjuar publiku se çka flasim ne dhe çka bëjmë. Nëse dikujt i intereson që publiku mos të dëgjojë, atëherë jemi kundër asaj mënyre të punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne kemi mund të fillojmë edhe pa atë, nëse dëshironi, s'e kam ndonjë problem. Po ishte një kërkesë e tij dhe mendova, pa ndonjë qëllim, çfarë po e thoni ju. Në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit! I nderuar zoti kryesues,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Nga pjesa hyrëse shihet se para pesë vitesh për planin 2005-2015 janë zhvilluar shumë konsultime me institute përkatëse shkencore, vendore dhe të jashtme dhe komunitete, kurse për versionin 2010-2020 nuk shihet se janë bërë konsultime të tilla, por projeksionet janë bazuar në konsultimet e vjetra dhe projeksione të asaj kohe.

Shtrohet pyetja: sa janë valide në kushte të reja, pasi që shumë gjëra kanë ndryshuar, të përfshihet edhe në versionin e kabinetit qeveritar?

Si do që të jetë, ne si Grup Parlamentar do ta përkrahim këtë plan. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!
Samostalna liberalna stranka, tojest Poslanički klub SLS će glasati za Nacrt prostornog plana Kosova za 2011 - 2020. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar “6+”, nuk është paraqitur askush. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja e zotërinj deputetë, ju përshëndes!

I nderuari ministër,

E mbështes Planin hapësinor të Kosovës, se është dashur një plan i tillë i Kosovës dhe uroj që ai të prodhojë efekte pozitive. Mund të thuhet se ka ardhur me vonesë, megjithatë edhe Kosova e ka paguar një kosto të lartë të kësaj vonese.

Edhe pse nuk e mbaj veten ekspert, njohës të çështjes që po bisedojmë, megjithatë kam përshtypjen se është një prirje që çështja e planifikimit hapësinor të reduktohet në çështje thjeshtë ambientaliste, ndoshta edhe për shkak se është futur në kuadër të Ministrisë së Ambientit dhe mendoj që kjo do ta dëmtonte thelbin, si të tillë, të Planit hapësinor të Kosovës.

Unë do të dëshiroj të vë theksin te dy-tri çështje që i konsideroj edhe të rëndësishme, edhe aktuale.

Kosova, tashmë është thënë disa herë, ka një zhvillim disproporcional dhe ka një prirje për ta thelluar këtë dezekuilibrim të zhvillimit. Planin hapësinor do të duhej ta adresonte siç duhet. Nuk e ka bërë këtë! Përkundrazi, kam përshtypjen se e legjitimon atë.

Për të mos marrë shumë kohë, shikojeni ju lutem, edhe skemën që është dhënë në ballinën e Planit, edhe brenda.

Gjithë materia çon në përfundimin se po thellohet dallimi midis pjesëve të Kosovës, sidomos në dëm të pjesës jug-lindore të Kosovës. Pjesa veri-perëndimore e Kosovës ka, ta zëmë, edhe hekurudhën, edhe autostradën dhe rrugët tjera me kujdes të veçantë, derisa pjesa jug-lindore nuk e ka as një rrugë, as tjetër, kurse edhe ato rrugë terciare janë si mos më keq.

Ka pasur zëra dhe unë shfrytëzoj rastin ta afirmoj edhe një herë edhe thirrjen që e ka bërë Grupi i intelektualëve të Anamoravës dhe Gallapit, që kjo çështje të merret seriozisht në shqyrtim.

Është theksuar me të drejtë, por ka rënë në veshshurdhër edhe kërkesa që të rishqyrtohet edhe drejtimi i autostradës. Nuk kontestohet ajo prej andej nga ka nisur e deri në Prishtinë, por prej qendrës së Kosovës ka hapësirë për të bërë edhe llogari edhe financiare, por edhe gjeostrategjike, demografike, nëse është me mend që ajo të shkojë në një drejtim që nuk dihet a do të ketë pastaj takim në anën tjetër, apo të synojë një drejtim tjetër, që e ka më afër autostradën edhe me Serbinë që synon, por do të kishte lidhje edhe me Maqedoninë, nëpërmjet saj lidhje më të shkurtër me Bullgarinë dhe pse jo edhe me Greqinë dhe Turqinë. Por, edhe më e rëndësishme se kjo, është lidhja me viset shqiptare në Preshevë, Bujanovc e Medvegje, të cilat nuk guxojnë të mbeten jashtë kujdesit institucional dhe planifikimit të zhvillimit hapësinor të Kosovës.

Për më tepër, në këtë mënyrë do të mund të bëhej edhe një kursim tjetër, do të kishte mundësi që në vend se të bëhen shpenzime me qesen e zbrazët të Kosovës dhe pa gjasa që të rritet, në vend se të bëhen shpenzime në dy drejtime autostradash, do të mund të bëhej kjo me një dhe kjo do të kishte efekte të shumëfishta. Për pjesën e Anamoravës, kjo do të kishte rëndësi vitale.

Çështja e dytë, që desha ta shtroj, është nevoja imanente, do të thosha, emergjente për të mbrojtur tokën bujqësore. Nuk është adresuar sa..., as në të shkruar, kurse nuk po bëhet asgjë në praktikë. Është ndoshta rasti për ta ngritur këtë çështje.

Rrugët gjithandej po ndërtohen midis, mes përmes fushës dhe për pasojë vendbanime po shkojnë te rruga, në vend që rruga të shkojë te vendbanimet. Malësia po zbrazet, nëse nuk është zbrazur po thuaj se e tëra në pjesë të Kosovës. Ku do të arrijmë me këtë tendencë?

Përpara ka pasur megjithatë disa masa që kanë parandaluar diçka. Tani jo vetëm që nuk ka, por përkundrazi ka masa që stimulojnë të kundërtën. E njëjta gjë mund të thuhet për pyjet që po rrezikohen me të madhe dhe nuk ka kurrfarë kujdesi, jeta urbane që po ashtu po rrezikohet me të madhe dhe vlerat e shumta po shkatërrohen, e për të mos e anashkaluar as çështjen tepër të politizuar, paradoksalisht të etnicizuar të mbrojtjes së monumenteve, e cila nuk po konsolidohet, nuk merr dimensionin gjithëpërfshirës, por është e strukturuar në atë mënyrë që duhet të lejojë politizimin e një përkatësie të monumenteve, nëse mund të themi edhe të etnicizimit të tyre dhe injorimit të monumenteve të tjera.

Uroj që ky plan të studiohet, të përpunohet dhe të prodhojë rezultatet e pritura. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, deputeti Lutfi Haziri!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti ministër, faleminderit,

Të nderuar deputetë,

Unë po i paraqes shkurtimisht disa nga shqetësimet që kanë të bëjnë me këtë ligj. Unë e di që ministri Gashi e ka marrë detyrën vonë në këtë mandat dhe nuk e di sa ka pasur mundësi për të punuar në këtë ligj, në mënyrë që të na demantojë atë që e tha edhe kolegu im Hydajet Hyseni, që është në disfavor të regjioneve zhvillimi hapësinor dhe para masat që janë marrë për këtë ligj në kurriz të regjioneve të caktuara, sepse ky dokument është i varur 100% në planet rregullative të komunave, në politikat sektoriale, në strategjitë e Qeverisë, qofshin ato për zhvillim ekonomik, qofshin për zhvillime sektoriale i ka anashkaluar sepse plani është punuar në vitin 2006, në fund të vitit 2006 ka qenë i gatshëm për miratim, është kthyer mbrapa për 3 vjet, ka pushuar, është adoptuar me vendime të ardhshme që kjo Qeveri në kabinetin e parë dhe tash i ka ndërmarrë. Regjioni i jug-lindjes mbetet jashtë këtij plani, përveç nëse realizohet strategjia për ndërtimin e autostradës që lidhë Prishtinën me Shkupin, por që i përjashton 600.000 banorë, sipas shifrave të vjetra, nga aksi i autostradës së kombit. 600.000 banorë të Kosovës do të

duhej ta shfrytëzojnë korridorin tjetër – Selanik – Shkup për të pasur një aks apo një mundësi më të mirë të komunikimit dhe të hyrjes në këto angazhime, nën një.

Nën dy, 13 komuna u përmendën, janë pa plane rregullative. Është detyrë ligjore që në rast se komuna dështon, ndërhyrja e Qeverisë përmes Ministrisë së Planifikimit dhe Ambientit është obligative, është mandatore. Nëse 13 komuna kanë dështuar në hartimin e planeve rregullative, është dashur të marrë kohë Ministria t'i ndërtojë edhe këto plane.

Sidoqoftë, së paku besoj se një agjendë zhvillimore lokale është respektuar, që nuk shihet, deri në lexim të dytë ka mundësi të përmirësohet jashtëzakonisht shumë dhe të mos harrojmë vendet e zhvilluara, vendet normale demokratike ku funksionon shteti, miratimi i planit dhjetëvjeçar është njëra prej detyrave më të mëdha që mund ta ketë një organ çfarë jemi ne, pas buxhetit, normalisht, sepse për dhjetë vjet e ardhshëm ne vendosim se si do të dukej dhe si do të shihej zhvillimi kryesisht në Kosovë.

Këto janë dy probleme kryesore që unë i paraqes, besoj që mundësinë komisionet funksionale të përmirësojnë diçka e kanë të vogël, por së paku të riparojnë dhe së paku të kenë mundësi që për t'i trajtuar barabar të gjitha pjesët e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Tani përfaqësuesi i Qeverisë nëse e dëshiron fjalën, zoti Gashi!

DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në përgjithësi pajtohem se një pjesë e kritikave qëndrojnë. Logjika me të cilën kemi menduar se duhet ta prezantojmë megjithatë këtë plan, është që të parandalohen zhvillimet, pjesërisht si zhvillime të egra në zhvillimet ekonomike dhe të ndërtimtarisë në Kosovë. Praktikisht ky nuk është ndonjë dokument i vdekur, i cili në atë moment që pranohet edhe aprovohet, nuk ka mundësi të ndryshimit, edhe komunat, edhe ministrinë përkatëse, sektorët përkatës do të kenë mundësi në të ardhmen që të amendamentojnë ose të kërkojnë ndryshime përkatëse, kështu që megjithatë ju kisha lutur që ky dokument, për arsye që janë cekur edhe prej deputetëve, të miratohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e Projektplanit hapësinor të Kosovës për vitin 2011 – 2020.

Ju njoftoj se në sallë janë 82 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatohet se me 48 vota “për”, 1 abstenim, 30 “kundër”, Kuvendi miratoi Planin hapësinor të Kosovës për periudhën e vitit 2011-2020.

(Ndërhyrje)

48 vota, plus 1, 2 pa kartelë, 50 vota qenkan!

Atëherë, ministri s'ka ardhur për pikën e nëntë të rendit të ditës. Unë kërkoj falje në qoftë se nuk kërkoja votim për ta shtyrë, por nëse jeni dakord, po e fusim edhe pse s'ka ardhur ose e shtyjme për seancën e ardhshme.

A keni ndonjë mendim lidhur me këtë, ju kryetarët e grupeve parlamentare. Të shtyhet? Ta presim ministrin apo mos ta presim? Atëherë, të mos e presim.

(Ndërhyrje)

Zoti Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Unë mendoj, megjithë dëshirën për të mos dyshuar, mendoj që nuk është rastësisht që ajo pikë po shtyhet dhe është pikë shumë e rëndësishme, e edhe ne si Grup Parlamentar nuk pajtohemi që ajo të vihet prej orës 17:00 e tutje, duhet të jetë pikë që të jetë publike – transparente. Nëse jo, atëherë duhet të shtyhet për një tjetër ditë, jo sot, në asnjë mënyrë. Ose, tash! Le të vjen ministri, se punë më të mençme... Unë jam kah habitem me këta njerëz! Shikojeni, asnjë ministër, me përjashtim... Qe, ai e kreu pikën dhe iku. Kjo është jo serioze për çështje të debateve, në seancë të mungojnë ministrat. Kjo ndodh vetëm me Qeverinë e pa përgjegjshme.

KRYESUESI: Unë, meqë është paraqitur më herët, jam detyruar mendoj... për të qenë bashkëpunues dhe për të toleruar për një pikë të rendit të ditës dhe ne e kemi shty. Ideja është, problemi është a ta fillojmë diskutimin për këtë pa prezencën e ministrit, apo ta shtyjme për seancën e ardhshme. Zoti Grabovci e ka fjalën, në emër të grupit parlamentar!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ne të gjithë e dimë që ministri e ka një arsye të fortë pse mungon. Ka kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës fillimisht të vihet më herët ose të lihet pas takimit që e ka.

Ne, si Grup Parlamentar, mendojmë që të vazhdojmë më tutje, jo pa prezencën e ministrit. Kur të kthehet ministri, të procedohet me këtë pikë të rendit të ditës. Dhe, në anën tjetër, duhet ta kemi parasysh të gjithë se korniza kushtetuese e shpenzimeve buxhetore ka pasur, nuk ka qenë e obligueshme edhe të dalë në debat në Parlament, vetëm si informatë. I dimë rregullat të gjithë, nuk votohet, megjithatë Qeveria ka shprehur dëshirën që edhe të debatojë dhe jemi të gatshëm të debatojmë, por jo pa prezencën e ministrit, sepse e humb çdo kuptim. Dhe ne jemi të mendimit se duhet të vazhdojmë më tutje kur të vjen ministri.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për sa i përket gatishmërisë së Qeverisë për debat, po shihet, s'janë asnjëri këtu. S'di qysh po donë të bëjnë debat me ne, ndoshta me SMS-a.

Ne konsiderojmë që kjo pikë duhet pështyhet për një seancë tjetër të radhës dhe të jetë një pikë ose një nga pikat e parë e seancës së ardhshme dhe të obligohen ministrat dhe jo vetëm ministri i Financave, për shkak se kjo kornizë afatmesme iu takon shumë ministrive, të obligohen nga Kuvendi që të jenë këtu, nëse duan debat për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, edhe një herë, zoti nënkryetar!

Mendoj dhe unë e thash në një formë atë që ne po mendojmë. Nuk mund të diskutohet për materien para se ministri të na tregojë se çka ka menduar me këto që i ka shkruar, do të thotë nuk mund të diskutojmë, por unë po ju them edhe një herë, kjo pikë e rendit të ditës tanimë ose duhet të shtyhet për nesër dhe ta vazhdojmë seancën nesër, ose për një seancë tjetër, meqenëse është jashtëzakonisht me rëndësi të ketë transmetim direkt, që populli i Kosovës të shohë për çka po diskutojmë dhe të informohet për atë çka ka në këtë material për kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Nëse dikujt i pengon transmetimi, mua më vjen keq për ta, por të kthehem te temat të cilat i kemi diskutuar shumë shpesh në Kuvend të Kosovës. Ne nuk mund të vazhdojmë më tutje për shkak se as për materie tjera nuk kemi përfaqësues adekuat, të ministrive adekuate të ekzekutivit, kështu që i kisha lutur që t'i anulojnë nesër takimet para dite dhe të vazhdojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se dokumenti nuk votohet dhe të gjithë jemi të njoftuar se kemi një mysafir në shtetin tonë, atëherë mund të shkohet me një pikë të rendit të ditës tjetër dhe kur të vjen ministri, le të debatohet kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve. Jemi të vetëdijshëm se të gjithë kemi qenë në mbledhje të Kryesisë kur është vendosur rendi i ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues!

Meqenëse ishte një dilemë se çfarë kërkuam, ne kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën tjetër, përndryshe ne nuk marrim pjesë, sepse nuk janë ata që duhet të jenë këtu. Kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve ka të bëjë me krejt Qeverinë, krejt resorët dhe nëse nuk ka çka të fshihet, nuk ka as arsye pse PDK-ja, të insistojë që sot të jetë gjithsesi. Ne s'po dyshojmë apriori, por s'kemi për t'i treguar, më së pari atyre që duhet të jenë prezent edhe opinionit, prandaj është një kërkesë e arsyeshme që të shtyhet për tjetër ditë.

KRYESUESI: Jo, jo, nuk ka Shaipi kurrë. Jo, jo, kryetarët e grupeve. A ke sqarim ti, se the Shaipi, thashë mos mu ka paraqitur Shaipi, se janë paraqitur edhe disa deputetë edhe nuk po dua... Ok.

Zoti Adem Grabovci, me kartelë të Shaip Mujës.

ADEM GRABOVCI: Unë vetëm po e sqaroj edhe një herë. Ne akordohemi me pjesën e parë të kërkesës të shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, se s'ka kuptim vërtet të debatohet për kornizën, pa prezencën e ministrit. Mirëpo, mendojmë që nuk kemi nevojë të humbim kohë, të vazhdojmë posa të vijë ministri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Sidoqoftë, nuk ka konsensus për këtë çështje.

Vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës edhe e shohim qysh po rrjedh... Nuk di çka të bëj. Nëse doni, ta vëmë në votim, ju e dini rezultatin.

Atëherë, vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

(Reagim nga salla)

Po, kemi tjera pika. Vazhdojmë me pikën e 11-të të rendit të ditës. Ta kryejmë edhe pikën e 11-të, pastaj shohim.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, Zenun Pajazitin, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: I nderuar kryesues,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të neni 72 të Rregullores të Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10.5 e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe ka vendosur që me rekomandim ta qojë më tutje në Parlament, pra për miratim. Megjithatë, më lejoni t'ju informoj se është ndër raportet që ka ngjallur diskutimin më të madh të këtij komisioni për sa i përket trajtimit të raporteve të agjencioneve që janë në varësi të kuvendeve. I kemi pasur parasysh po ashtu edhe kushtet edhe kohën e shkurtër e funksionimit, kur po them kushtet, ky agjencion funksionon në një kat të Kuvendit, atje në disa zyra, me hapësirë jo të mjaftueshme e tjerë, por megjithatë raporti nuk është ndër më të mirët, për të mos e përdorur një gjuhë më të lehtë, lë shumë për të dëshiruar.

Unë shpresoj që grupet parlamentare, gjegjësisht deputetët do ta shqyrtojnë mirë këtë raport dhe po ashtu mendoj që do të ngritën edhe disa çështje që janë jetike për sa i përket funksionimit të këtij mekanizmi. Në ndërkohë, ne e kemi marrë po ashtu edhe një raport të ekspertëve, të ekspertit evropian mbi gjendjen në këtë mekanizëm. Është një dokument që duhet të na shërbej neve si Kuvend, për ta trajtuar në të gjitha aspektet këtë autoritet. Po ashtu dëshiroj t'i theksoj edhe te mandatet. Në ligjin paraprak, mandati njëvjeçar është i kryesuesit të këtij bordi, në ndërkohë që ligji i ri nuk e precizon fare dhe ka paqartësi serioze për mandatin e kryesuesit. Jam i mendimit që Kuvendi duhet seriozisht ta trajtojë jo vetëm këtë raport, por në përgjithësi funksionimin e këtij mekanizmi që është në varësi të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESEI: Ju faleminderit!

E ka fjalën zëvendëskryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 2 qershor, ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010, dhe ka marrë disa sqarime lidhur me pyetjet të cilat janë bërë në komision. Dhe, komisioni thjesht ka vlerësuar se raporti i prezantuar i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji mbi menaxhimin e financave publike, si dhe nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit në fjalë, kështu që komisioni ia ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë raportin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani e kanë fjalën kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar atë PDK-së, deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëritje zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Ju të gjithë të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka analizuar me vëmendje raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, nuk është marrë vetëm me raportin i cili na është servuar, na është sjellë në Kuvend, në formën e shkruar, mirëpo duke qenë të vetëdijshëm se institucionet e pavarura të cilat i themelon Kuvendi i Kosovës, ne duhet të kemi një vëmendje shumë më të përqendruar se sa ndaj të tjerave dhe e kemi analizuar punën e këtij institucioni edhe përtej asaj që është e shkruar në raportin në fjalë.

Autoriteti i Konkurrencës, e ushtron veprimtarinë e tij si një institucion publik, i pavarur me mision mbrojtjen e konkurrencës së lirë, efekteve për një treg sa më funksional, me synim final, realizimin e përfitimeve më të mëdha të mundshme për konsumatorët, gjithmonë duke u mbështetur në praktikën më të mira të përvojës evropiane, përshtatur edhe në specifikat e Kosovës siç janë: madhësia e tregut, masa e informalitetit ekonomik e tjera.

Objektiv kryesor që e ka ky institucion, siç thuhet në raport, në faqen 6, është ta ruajë dhe ta nxisë konkurrencën duke mbrojtur lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve në treg, përmes përcaktimit të rregullave të sjelljes së tyre.

Në themel të Ligjit të konkurrencës është kryesisht parandalimi ose ndalimi i tri lloj praktikave:

Nën 1, Marrëveshjet e ndaluara antikonkuruese, veçanërisht kartelat që fiksojnë çmimin ose ndajnë tregun;

Nën 2, Abuzimi me pozitën dominuese që njihet ndryshe si monopol, kur ndërmarrjet në mënyrë të vetëdijshme, nëpërmjet caktimit të çmimeve mbi nivelet konkurruese, ruajnë apo forcojnë fuqinë e tyre në treg, duke krijuar kështu pengesa për hyrësit e rinj apo daljen e konkurrentëve më të vegjël nga tregu, dhe

Nën 3, Përqendrimet apo bashkimet antikonkuruese.

Ligji për konkurrencën në Kosovë, ka hyrë në fuqi në vitin 2004. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, është themeluar më vonë, me ndryshimin, avancimin e rrjedhave ekonomike dhe politike të Kosovës, e që ishte edhe imperativ për tregun e Kosovës, bëhet plotësim-ndryshimi i këtij ligji. Me hyrje në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, në dhjetor të vitit 2010, institucioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, është plotësisht kompatibil dhe njësoj i avancuar me vendet me përvojë në regjion dhe më gjerë.

Hapja e tregjeve, zgjerimi i tyre përmes lehtësimit të pengesave tekniko-administrative, janë objektivat e këtij institucioni: parandalimi i abuzimit me pozicion dominues, ndërprerja e marrëveshjeve me pasoja të rënda për konkurrencën, mbrojtja e konsumatorëve, respektimi i konkurrencës së lirë, duke rritur kështu mirëqenien e konsumatorit dhe duke konstatuar se aq sa konkurrenca ndihmon konsumatorin edhe konsumatori e ndihmon konkurrencën, kështu që krijojnë një raport të ndërsjellë.

Të gjitha këto janë shtylla me të cilat duhet të merret ky institucion, mirëpo duke pasur parasysh se edhe në çfarë rrethanash funksionon ky institucion, ka hasur në vështirësi dhe pengesa të ndryshme, por vështirësitë më tepër i ka pasur të natyrës teknike për shkak të hapësirave tepër të kufizuara të punës. Mirëpo, ajo që vlen të përmendet sot, gjatë këtij shqyrtimi, është se ne edhe si grup parlamentar i kemi vërejtjet tona.

Pikërisht te neni 25, te i cili nuk është zbatuar plotësisht ky ligj, neni 25 thotë kështu: “Anëtarët e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, e zgjedhin një anëtar për të shërbyer si kryesues. Kryesuesi ka mandat për 1 vit”. Andaj, në përputhje me këtë ligj, tanimë të shfuqizuar, sepse është bërë plotësimi dhe ndryshimi i ligjit, kryesuesi i tanishëm, në momentin prej se është mandatar, domethënë në vitin 2008, veni re, e ushtron këtë detyrë, në ndërkohë që ligji ia jap vetëm një mandat. Kështu që kryesuesi i autoritetit ka ushtruar edhe mandatin e kryesuesit prej emërimit deri me sot dhe me ligjin kur është emëruar, ka pasur mandat vetëm një vit.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin në vitin 2010, ku me nenin 69 ka shfuqizuar ligjin e mëparshëm për konkurrencën dhe aktet tjera nënligjore, që janë në kundërshtim me këtë ligj. Ligji në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës, me nenin 68, ka njohur mandatin e anëtarëve të emëruar nga Kuvendi, citoj: “ Anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të emëruar pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të punojnë deri në skadimin e periudhës për të cilën ata janë emëruar”. Por, në bazë të një interpretimi të gjerë të kësaj dispozite edhe pse ligji ua njeh mandatin të emëruarave, nuk do të thotë që ia ka njohur edhe kryesuesit mandatin për të vazhduar në krye të këtij autoriteti.

Ne si komision parlamentar, e kemi pasur një vërejtje me shkrim nga një anëtar i këtij komisioni të konkurrencës, i cili e ka alarmuar për situatën çka domethënë se edhe raportet ndërnjerëzore nuk janë në nivelin e duhur dhe është një komunikim shumë i dobët dhe përçarjet që janë brenda këtij Bordi, na bëjnë të kuptojmë se nuk pritet cilësi ose punë efektive nga ky institucion, kështu që domethënë, këto raporte reflektohen direkt në punën e autoritetit në përgjithësi.

Përveç kësaj, ne si grup parlamentar, kemi pasur rastin ta kemi në dorë edhe një raport të një eksperti evropian mbi gjendjen që ka dhënë sugjerime për të forcuar Autoritetin Kosovar të Konkurrencës. Edhe në atë raport paraqitet, domethënë eksperti nga TAJEKS-i e paraqet si alarmuese situatën në këtë institucion, për të cilat neve si deputetë dhe si Parlament, duhet të na provokoj bukur shumë kjo situatë, sepse ne jemi themelues të këtij institucioni. Më lejoni t’i përmend vetëm disa fakte dhe disa parregullsi që cekën në raportin në fjalë. Thotë se, e cek se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është institucion i pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Paraqet përbërjen e atij institucioni dhe mangësitë që paraqiten ... procesi aktual i hetimeve të rasteve, i kryen kryetari, ndërsa konsultohet me komisionarët dhe vendos që një nga komisionerët të merret me ankesën ose informacionet e reja që vijnë për shkelje të mundshme të konkurrencës. Ndonjëherë, thekson se dy ose tre komisionarë, autorizohen për të hetuar të njëjtin rast. Kjo na qon në logjikën, sepse gjatë hetimit të këtyre rasteve, kemi konflikt interesi, sepse nuk mund vetë të jetë hetues dhe vetë gjykatës në rastet e tilla, që janë në kundërshtim me Ligjin për konkurrencën. Mandej, mangësitë tjera, ky raport i këtij eksperti evropian, paraqet se komisionarët luajnë rolet që tejkalojnë rolin e tyre dhe funksionet e drejtpërdrejta të një anëtari të Këshillit të Autoritetit të Konkurrencës.

Komisionarët thotë duhet të veprojnë si anëtarët e Këshillit që të marrin vendime në raste. Normalisht ky rol është i ngjashëm me një rol të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë. Në parim, çdo komisionar luan në të njëjtën kohë disa role të cilat janë si më poshtë dhe i cek se çfarë rolesh luajnë këta komisionarë, unë po ua cek vetëm një që ta kursej kohën për kolegët tjerë.

Marrja në përgjegjësi të rastit, mbledhja e informatave, organizon marrjen në pyetje inspektimin, hetimin e tjera. Mandej, mangësi tjetër dhe dobësi tjetër ky ekspert evropian paraqet edhe një rast tjetër kur thotë se autoriteti Kosovar i Konkurrencës, nuk

ka raporte të nevojshme me institucionet tjera publike, si për shembull: Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; Ministrinë e Tregtisë dhe Ministrinë e Jashtme apo rregullatorët e tregut, për shembull Zyrën e Prokurimit Publik, Zyrën e Rregullatorit të Telekomunikacionit, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë e tjera. E cek në formën më alarmante edhe konfliktin e interesave në mes funksionimit dhe fuqisë së komisionarëve dhe aktivitetet të tyre aktual, kështu që ky raport është i përfshirë në disa faqe, po unë nuk dua t'ju marrë kohë dhe ata që ju interesojnë, mund ta marrin mund ta kenë në dorë këtë raport, por për mua është një sinjal që edhe si Kuvend, po edhe si komision parlamentar që jep sugjerimin edhe në fund duhet që të merremi hollësisht më për së afërmi, me punën dhe aktivitetin e këtij autoriteti që e ka themeluar Kuvendi në bazë të ligjit në fjalë.

Në fund, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ju ftoj që të mos miratohet ky raport dhe kërkoj nga Komisioni funksional, në këtë rast, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri, të merret me monitorimin e zbatimit të Ligjit dhe monitorimin e punës së këtij autoriteti për të cilin besoj që edhe personat në fjalë, që janë pjesë e atij stafi, nuk do të na keqkuptojnë, po do të na kenë në lehtësim të punës së tyre, pengesat që i kanë në hapësirat fizike të punës, por edhe pengesat tjera që e kanë në zbatim të ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë,

Raporti që po e shqyrtojmë sot tregon se Autoriteti i Konkurrencës, tanimë duket i konsoliduar, duke marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara, e që përmbledhen në hetimin e disa rasteve konkrete që janë konsideruar shkelje e konkurrencës së lirë në ekonominë tonë.

Përpos kësaj, Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar aktivitetet e tij në forcimin e kapaciteteve institucionale si dhe angazhimit të drejtpërdrejt në hartimin e ligjit të ri mbi konkurrencën, i cili ka hyrë në fuqi në fund të vitit të kaluar dhe është në përputhje të plotë me legjislacionin e Unionin Evropian. Pas rasteve të para të hetimeve të zhvilluara nga Autoriteti i Konkurrencës, që kanë të bëjnë me fiksime të çmimeve, ne kërkojmë që aktivitetet të fillojnë të shtrihen edhe në fushat tjera, siç janë parandalimi i abuzimit me pozicionin dominues në treg, ndërprerja e marrëveshjeve me pasoja të rënda për konkurrencën si në nivel prodhimi, shërbimi apo tregtimi, ndalimin e përqendrimeve apo bashkimeve anti-konkurrese si dhe mbrojtjen e konsumatorëve dhe respektimin e konkurrencës së lirë.

Politika e konkurrencës, nuk duhet parë e shkëputur nga politikat tjera ekonomike, si ajo tregtare, anti-damping, ndihma shtetërore, politikat industriale të zhvillimit rajonal, pronësisë industriale, investimeve, politikat fiskale e tjera.

Ligi i konkurrencës duhet të mbrojë tregun, duke shmangur dhe penguar jo vetëm praktikën e parregullta të subjekteve private, por edhe nga ndërhyrjet e institucioneve shtetërore, nëpërmjet akteve normative të ndërmarra prej tyre. Prandaj, zbatimi i suksesshëm i Ligjit të konkurrencës, kërkon pavarësi, transparencë, profesionalizëm dhe efektivitet të autoritetit të konkurrencës, e këto mund të arrihen vetëm përmes përcaktimit të qartë të objektivave, që kanë të bëjnë me punësimin e stafit të kualifikuar, me njohuri të thella në fushën e ekonomisë, dhe të së drejtës, sigurimin e transparencës së plotë në procedurat e vendimmarrjes dhe zbatimit të kompetencave të tij, bashkëpunimin e ngushtë me institucionet e tjera rregullatore dhe autoritetet gjyqësore, si dhe udhëheqja nga parimet e drejtësisë, barazisë dhe të paanshmërisë në zbatimin e përgjegjësiave të tij.

Ne jemi të vetëdijshëm se autoritetin e konkurrencës e presin punë dhe sfida të mëdha, mos themelimi për një kohë të gjatë i institucioneve për monitorim dhe kontrollim të tregut, siç është autoriteti i konkurrencës, ka lënë hapësirë për zhvillime të palejueshme në treg, e që drejtpërdrejt cenojnë konkurrencën e lirë. Disa raste tanimë të hulumtuara në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, japin shenja se edhe në Kosovë mund të ketë tendenca të cenimit të konkurrencës së lirë nga ana e bizneseve të caktuara apo grupe të bizneseve përmes përcaktimit të nivelit të çmimeve për produkte apo shërbime të caktuara përmes marrëveshjeve të ndaluara.

Qëllimi primar i Autoritetit të Konkurrencës, duhet të jetë identifikimi i këtyre fenomeneve dhe natyrisht luftimi i tyre. Megjithatë, luftimi i këtyre dukurive duhet të bëhet me kujdes. Ne nuk mund t'i qasemi asnjë sektori i cili funksionon në mënyrë të rregulluar nga forcat e lira të tregut, me paragjykimin se ai sektor dominohet dhe kontrollohet nga ndonjë grup e bizneseve. Qasja e tillë, do të shkaktonte më shumë dëme se sa përfitime për ekonominë. Asnjë institucion nuk guxon të pretendojë dirigjimin e tregut, sepse koha e dirigjimit të tregut nga cilido institucion shtetëror, i takon të së kaluarës. Por, çdo herë duhet pasur parasysh që tregu i lirë nuk e nënkupton edhe anarkinë. Prandaj, qëllimi i Autoritetit të Konkurrencës, duhet të jetë luftimi i anarkisë, në mënyrë që ajo mos të shndërrohet në rregull.

Mbrojtja e ekonomisë së tregut të lirë, me konkurrencë të shëndoshë, duhet të jetë qëllimi parësor i Autoritetit të Konkurrencës.

Grupi Parlamentar i LDK-së, kërkon forcimin e mëtutjeshëm të këtij institucioni shumë të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së tregut në vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Ju faleminderit!

Raporti i Komisionit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010, kur lexohet të lë shumë për të dëshiruar në informatat që i jep, por edhe mënyrën siç është përpiluar. Dhe, konsideroj që vetë raporti, mënyra qysh është përpiluar ai edhe mangësitë në te, e dëshmojnë qartë se sa i dobët është ky komision, si në personelin e angazhuar, po ashtu

edhe në nevojat tjera që mund t'i ketë një komision i tillë për të funksionuar, siç duhet, për shkak se, nëse Autoriteti i Konkurrencës është një e mirë publike e shtetit të Kosovës, e cila e mbron konkurrencën efektive në treg, duke pasur pra si qëllim final rritjen e mirëqenies së konsumatorit, krijimin e një ambienti ligjërish të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në të gjitha hapësirat e tregut relevant të Kosovës, atëherë në këtë raport nuk e kemi të qartë se si ky komision e ka bërë këtë promovim të konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë siç edhe obligohet me ligj ta bëjë.

Pra shikuar nga ky aspekt, ky komision më shumë është fokusuar në ato raste në të cilat ka vepruar, në mbrojtjen dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, se sa në mbrojtjen e konsumatorëve.

Sipas nenit 20.2 të Ligjit të konkurrencës, Komisioni Kosovar i Konkurrencës, duhet të ketë personel të mjaftueshëm ndihmës për t'i mundësuar atij që në mënyrë efikase dhe profesionale t'i ushtrojë funksionet e veta, të cilat janë paraparë në paragrafin 1 të atij neni. Mirëpo, nga raporti se numri i të punësuarve është mjaft i vogël, gjë që ka rezultuar për vitin 2010, në një punë jo edhe aq efikase të këtij komisioni. Për shembull, ka vetëm një të punësuar në Departamentin Juridik, departament ky që është madje i ndarë në dy sektorë kur dihet se, sipas nenit 23 të ligjit, te funksioni i akteve nënligjore, KK-ja do të hartojë, miratojë dhe publikojë aktet e hollësishme nënligjore për zbatimin e këtij ligji, e po ashtu me këtë ligj është paraparë si çështje tjetër që KK-ja të organizojë seminare dhe kurse trajnimi me qëllim të njoftimit të personave e veçanërisht juristëve dhe ekonomistëve, gjë që siç shihet nga raporti i këtij Komisioni, nuk i është kushtuar rëndësi e duhur trajnimit për persona të cituar siç edhe obligohen me ligj.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit për konkurrencën mbi marrëveshjet të cilat mund të ndikojnë negativisht në tregtinë e brendshme të Kosovës, në tri rastet e hetuara nga ky komision, dy prej tyre janë përmbyllur me shqiptim të gjobave apo dënimeve administrative të përcaktuara me ligj, në ndërkohë që njëri prej vendimeve, i cili përmendet në faqen 19, e që ka të bëjë me pompat e benzinës në rajonin e Gjilanit. Marrëveshja verbale është shfuqizuar, mirëpo aty nuk ceket për kurrfarë gjobe që i është dhënë apo me të cilën janë dënuar apo janë sanksionuar këto. Pra, këtu shihet që ka qenë një, të them ashtu prej tri vendimeve që i ka marr ky komision, njëri prej tyre nuk ka qenë i njëjtë me të dy tjerat kur po ashtu është vlerësuar që marrëveshja verbale në mes pompave të benzinës ka qenë e dëmshme për konkurrencën dhe për tregun.

Po, natyrisht që në tregun e Kosovës, veçanërisht në aspektin e konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit, kemi dëme shumë më të mëdha se sa ato me të cilat është marrë komisioni. Për shembull, në raport askund nuk flitet për masat e ndërmarra në hulumtimin e tregjeve të Telekomit, PTK-ja, IPKO-ja, interferenca e operatorëve të huaj pa licenca në Kosovë, gjë që e dimë që u shkakton një dëm të madh, jo vetëm kompanive të Kosovës, veçanërisht Kompanisë publike të Kosovës PTK-së, mirëpo edhe e pengon operimin e lirshëm të dy agjentëve me konkurrencë të garantuar meqenëse operatorët e huaj, të cilët nuk kanë licenca në Kosovë, nuk i nënshtrohen

kurrfarë ligji të Kosovës dhe rrjedhimisht janë të lirë të bëjnë çfarë të duan në territorin e Kosovës, me frekuencat e Kosovës, në kundërshtim me rregullat dhe institucionet e Kosovës.

Po ashtu, Komisioni nuk ka ndërmarrë kurrfarë hetimi të kamatave në banka, apo në kompanitë e sigurimeve për të cilat do të flas më vonë. Ne e dimë dhe e kemi parë në disa media që disa herë është ngrehur dyshimi se bankat kanë arritur marrëveshje që t'i mbajnë nivelet e tyre të kamatave të larta, nivel ky i cili po i dëmton qytetarët e Kosovës për çdo ditë dhe ekonominë e Kosovës, veçanërisht duke nxjerrë shumë para në formë depozitash në banka dhe duke mos e kredituar ekonominë për shkak të kamatave të larta. Pra ky Komision nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash ndaj kësaj ose të paktën ta hetojë rastin dhe të shohin se çfarë ka ndodhur vërtet apo çfarë po ndodhë me bankat.

Për sa i përket kompanive të sigurimeve, aty është shqiptuar një gjobë nga Komisioni gjatë vitit 2010, për një marrëveshje që e kanë arritur degët e kompanive të sigurimeve në Gjakovë, për fiksime të tregut, mirëpo ne e dimë që në nivel Kosovë, Shoqata e Kompanive të Sigurimeve është ajo që në mënyrë arbitrare, vendos për çmimet e policës kufitare shtesë, dhe ky është një problem i cili është ngritur disa herë nga lëvizja "Vetëvendosje".

Sipas çmimoreve së përcaktuar nga Shoqata e Kompanive të Sigurimeve, çdo veturë me targa të huaja që futet në Kosovë, paguan 50 euro policë kufitare shtesë për një muaj. Si pasojë secili mërgimtar që vjen në pushime në Kosovë, paguan dy herë për sigurimin e automjeteve, një herë në vendin prej nga vjen dhe herën tjetër për kohën sa qëndron këtu në Kosovë, pra e dimë që shuma e gjithmbarshme që mbledhet brenda vitit, është diku prej

12 deri në 15 milionë euro dhe pjesa më e madhe e kësaj shume që mbledhet faktikisht, është fitim i pastër për kompanitë e sigurimeve, për shkak se shumë pak prej këtyre parave, pra paguhen për t'i mbuluar aksidentet eventuale që bashkatdhetarët tanë pësojnë sa janë në Kosovë.

Bordi i drejtorëve të Shoqatës të Kompanive të Sigurimeve, përbëhet nga drejtorët e kompanive të sigurimeve dhe vendimi për caktimin e çmimit të përbashkët bie ndesh me Ligjin për konkurrencën. Pra këtu shihet qartazi që monopolizimi i këtij tregu është bërë me qëllim të përfitimeve personale ngase nga këto polica grumbullohen miliona euro për çdo vit, siç e thashë.

Po ashtu raporti i Komisionit, përveç këtij hetimi që e ka marrë në Gjilan sa i përket derivateve, pra nuk ka marrë kurrfarë hetimi për sa i përket pjesëve tjera të Kosovës dhe intervenimeve që ndodhin për çdo ditë në tregun e Kosovës në intervenime edhe konkurrenca jo lojale dhe e padrejtë që e dëmton këtë treg, veçanërisht në Kosovë, pra ne e dimë për derivatet të cilat shiten në pjesën veriore të Kosovës të kontrabanduara, të cilat fatkeqësisht i pasurojnë jo vetëm strukturat paralele atje të Serbisë atje, mirëpo edhe disa bashkëpjesëmarrës apo bashkë tregtar nga pjesët tjera të Kosovës dhe kjo

ndërhyrje në tregun e Kosovës, është çështje e Ligjit të konkurrencës dhe ishte dashur që të hetohet nga agjencioni.

Pra, nga skema organizative e agjencionit, vërehet se ka mungesë në kuadër, siç e thashë edhe më herët dhe do të kishte qenë e pritur ndoshta edhe do të kishte qenë e udhës që agjencioni me qenë se është i mangët në resurse dhe në staf, të jetë i përqendruar fillimisht në ata sektorë të tregut të cilat janë shumë profitabil edhe në të cilat dihet se ka shumë e shumë shkelje të rregullave të tregut të lirë dhe të konkurrencës siç janë për shembull: në tregun e derivateve, duhanit, të Telekomit, të bankat, sigurimet dhe energjetika edhe xehet, dhe Komisioni, fatkeqësisht gjatë vitit 2010, nuk e ka bërë një gjë të tillë. Prandaj ne konsiderojmë që është e domosdoshme që Kuvendi por edhe të gjitha agjencitë tjera shtetërore, përfshirë këtu edhe agjencitë qeveritare, që të angazhohen shumë më shumë në mënyrë që ta forcojnë Komisionin dhe t'ia mundësojnë Komisionit që ta bëjë punën e tij ashtu siç duhet dhe siç obligohet me ligj. Përndryshe, në mungesë të një Komisionit të tillë dhe në mungesë të një komisioni efikas që e rregullon ligji në Kosovë, fatkeqësisht qytetarët e Kosovës do të jenë ata të cilët do ta paguajnë këtë neglizhencë të institucioneve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ymeri!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Neziri, me kartelë të huaj, në emër të Kymete Bajraktarit.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Autoriteti i Konkurrencës, siç e cekën edhe grupet tjera parlamentare, nuk e ka kryer detyrën ashtu siç është i përshkruar në ligj, për arsye të shumta, në radhë të parë mosfunksionimi i këtij autoriteti, mandej mosrespektimi i ligjit, gjithashtu pasi që është kërkuar që edhe ligji të plotësohet dhe të ndryshohet, do të thotë edhe vet ligji i ka të metat e veta.

U përmendën disa aspekte se Autoriteti i Konkurrencës, sidomos në disa raste ku paraqitet monopol siç është tregu financiar, tregu i naftës dhe sisa tregje tjera, nuk e ka kryer punën për çka edhe është themeluar, për arsye se ky autoritet është dashur, në radhë të parë të luftojë për mbrojtjen e konsumatorit, gjë që nuk e ka bërë. Sidomos në këtë lëmin financiare, te kamatat që i përmendi deputeti Ymeri dhe në disa lëmi tjera që goditet më së tepërmi konsumatori, do të thotë qytetari i Kosovës, ky autoritet nuk e ka bërë asnjë hulumtim dhe nuk e ka bërë asnjë hap. Mirëpo, ne si grup kërkojmë që ky autoritet të kryej punën e vet, të kompletohet në radhë të parë stafi, të jetë i përgatitur dhe me ndryshimet e ligjit që do të bëhen, shpresojmë që do ta kryejë punën me ligj ashtu siç e parasheh ligji dhe ashtu për çka është themeluar. Ju faleminderit!

KRYESUESEI: Ju faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës Kosovare 2010.

Duke marrë parasysh se ky raport është bazuar në bazë të Ligjit 03-L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, i cili ka kaluar në Kuvend në dhjetor të vitit 2010, me plotësim ndryshimet nga ligji i kaluar dhe duke u bazuar në fushëveprimtarinë e këtij agjencioni, i cili është i bazuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, shihet se ky është raporti i dytë i këtij agjencioni brenda Kuvendit të Kosovës.

Në raport shihen se ky komision i konkurrencës apo Agjencion i Konkurrencës Kosovare, ka filluar të bëjë disa hetime nëpër pikat e derivateve të naftës, nëpër pikat e arkave, në kompanitë e sigurimeve, ku shihet se ka edhe probleme me ligjet të cilat nuk janë të harmonizuara për një konkurrencë dhe ekonomi të lirë të tregut.

Në parim Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, e përkrah raportin dhe inkurajon që agjencionet e pavarura të punojnë në bazë të ligjeve të cilat janë nxjerrë. Ju faleminderit!

KRYESUESEI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, nuk është.

Atëherë, vazhdojmë me diskutuesit e paraqitur.

Deputeti Hashim Deshishku është paraqitur.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar, kryesues i Parlamentit, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Qëllimi i formimit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, nuk ka qenë vetëm për mbushjen formale e një obligimi ligjor. Në fakt kemi pritur se përmes punës së tij, do të krijohet disiplinë në treg, dhe do të luftohen rastet që rrezikojnë konkurrencën e lirë.

Mjerisht ky synim nuk është arritur. Mungesa e efekteve konkrete nuk mund të arsyetohet në ambientin e ngushtë për punë, mungesën e stafit apo përvojën e shkurtër që ka ky autoritet. Ndodhë se nuk duhet injoruar edhe këto vështirësi për të cilët një pjesë të fajit e ka edhe ky Kuvend si themelues i këtij agjencioni, mirëpo ka edhe shumë dobësi të tjera të cilat nuk mund të ndërlidhen me arsyetimet që i ceka më parë. Ato janë produkt i mosnjohjes së punës dhe përgjegjësisë që kanë, mos organizimit, mosnjohjes së ligjeve, nivelin e ulët profesional, si dhe të shkallës së ulët të njohurive për funksionimin e tregut dhe të ndërtimit të raporteve ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në te.

Këtë e kanë dëshmuar me vendimet që kanë marr, por këtë e thonë edhe raportet e ekipeve profesionale. Po fillojmë me radhë. Komisioni i Konkurrencës ka dënuar kompanitë e sigurimeve me nga 100 mijë euro apo në total me 1 milion euro, sepse siç thuhet në këtë arsyetim të vendimit, ata paskan vërë marrëveshje për caktimin e çmimit të policave të sigurimit të auto përgjegjësisë ndaj palës së tretë. Por, për një vendim të këtillë, atij i mungojnë faktet. Meqenëse nuk i mjafton vetëm një letër e nënshkruar nga personat e paautorizuar të kompanive të cilët në fakt kanë arritur një

ujdi që citoj: “të ruhet tregu i sigurimeve”. Në esencë, kjo ujdi nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër, pos që të konsolidojë edhe të ndërtojë raporte korrekte në tregun e sigurimeve apo më saktësisht që asnjëra kompani të mos përdorë mjetet ilegale me qëllim të krijimit të pozitës dominuese në treg, siç janë provizionet e ndaluara.

Sipas kësaj del se Komisioni i konkurrencës ndërhyr që të bllokojë një qëllim të mirë të kompanive të sigurimit. Këtë të drejtë ai nuk e ka.

Nën dy, dështimi i dytë ndodhë kur ai si arsye për gjobitjen e kompanive merr çmimin e policave të sigurimit. Është absurde mungesë e njohurive dhe jo profesionalizëm të thuhet se kompanitë janë marrë vesh për nivelin e çmimit, kur ai caktohet dhe kontrollohet nga Banka Qendrore e Kosovës, në rregullin 3 të BQK-së, neni 8.2 e përshkruan saktë si kompanitë e sigurimit e ndërtojnë strukturën e tarifës së sigurimit...

Ndërkaq, në nenin 8.3 përshkruan saktë autorizimin e Bankës Qendrore të Kosovës për miratimin e tarifës. Do të thotë se fjalën përfundimtare e ka autoriteti mbikëqyrës të cilën kompanitë detyrimisht duhet ta respektojnë. Në të kundërtën ndëshkohen apo edhe e rrezikojnë licencën e tyre. Është shqetësuese fakti kur Komisioni i konkurrencës insiston që në kompanitë të veprojnë jashtë një standardi që ka miratuar Banka Qendrore. Nëse rregulli 3 i Bankës Qendrore është në kolizion me Ligjin e konkurrencës, ndoshta më mirë ka qenë që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës këtë çështje ta rregullojë me Bankën Qendrore e të mos

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010.

Duke marrë parasysh se ky raport është bazuar në bazë të ligjit 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, i cili ka kaluar në Kuvend në dhjetor të vitit 2010 me plotësim ndryshimet nga ligji i kaluar dhe duke u bazuar në fushëveprimtarinë e këtij agjencioni, i cili është i bazuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, shihet se ky është raport i dytë i këtij agjencioni brenda Kuvendit të Kosovës.

Në raport shihet se ky Agjencion i Konkurrencës Kosovare ka fillua të bëjë disa hetime nëpër pika të derivateve të naftës, nëpër pika të arkave, në kompanitë e sigurimeve, ku shihet se ka edhe probleme me ligjet të cilat nuk janë të harmonizuara për një konkurrencë dhe ekonomi të lirë të tregut.

Në parim, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re përkrah raportin dhe inkurajon që agjencionet e pavarura të punojnë në bazë të ligjeve të cilat janë nxjerrë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq. Nuk është.

Atëherë, vazhdojmë me diskutuesit e paraqitur. Deputeti Hashim Deshishku është paraqitur.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryesues i Parlamentit, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Qëllimi i formimit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nuk ka qenë vetëm përmbushje formale e një obligimi ligjor. Në fakt, kemi pritur se përmes punës së tij do të krijohet disiplinë në treg dhe do të luftohen rastet që rrezikojnë konkurrencën e lirë. Mjerisht, ky synim nuk është arritur, mungesa e efekteve konkrete nuk mund të arsyetohet me ambientin e ngushtë për punë, mungesën e stafit apo përvojën e shkurtë që ka ky autoritet. Ndodhë se nuk duhet injoruar edhe këto vështirësi për të cilët një pjesë të fajit e ka edhe ky Kuvend, si themelues i këtij agjencioni. Mirëpo, ka edhe shumë dobësi të tjera të cilët nuk mund të ndërlidhen me arsyetimet që i ceka më parë. Ato janë produkt i mosnjohjes së punës dhe përgjegjësisë që kanë, mosorganizimit, mos njohjes së ligjeve, nivelin e ulët profesional, si dhe të shkallës së ulët të njohurive për funksionimin e tregut dhe të ndërtimit të raporteve ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në te. Këtë e kanë dëshmuar me vendimet që kanë marrë, por këtë e thonë edhe raportet e ekipeve profesionale. Po fillojmë me radhë.

Komisioni i Konkurrencës ka dënuar kompanitë e sigurimeve me nga 100 mijë euro, apo në total me 1 milion euro, sepse si thuhet në këtë arsyetim të vendimit, ata paskan bërë marrëveshje për caktimin e çmimeve të policave të sigurimit, të auto përgjegjësisë ndaj palës së tretë. Por, për një vendim të këtillë atij i mungojnë faktet. Me qenë se nuk mjafton vetëm një letër e nënshkruar nga personat e paautorizuar të kompanive, të cilët në fakt kanë arritur një ujdë që, citoj: “të ruhet tregu i sigurimeve”. Në esencë, kjo ujdë nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër, pos që të konsolidojë dhe të ndërtojë raporte konkrete në tregun e sigurimeve apo, më saktësisht, që asnjëra kompani të mos përdor mjetet ilegale me qëllim të krijimit të pozitës dominuese në treg, si janë provizionet e ndaluara. Sipas kësaj del se Komisioni i Konkurrencës ndërhyjnë që të bllokojë një qëllim të mirë të kompanive të sigurimit. Këtë të drejtë ai nuk e ka.

Nën dy, dështimi i dytë ndodhë kur ai si arsye për gjykitjen e kompanive merr çmimin e policave të sigurimit. Është absurde, mungesë e njohurive dhe joprofesionalizëm të thuhet se kompanitë janë marrë vesh për nivelin e çmimit, kur ai caktohet dhe kontrollohet nga Banka Qendrore e Kosovës, në rregullën 3 të BQK-së, nenin 8.2 e përshkruan saktë se si kompanitë e sigurimeve e ndërtojnë strukturën e tarifës së sigurimit, TPL-in.

Ndërkaq, në nenin 8.3 përshkruan saktë autorizimin e Bankës Qendrore të Kosovës për aprovimin e tarifës, do të thotë se fjalën përfundimtare e ka Autoriteti mbikëqyrës, të cilin kompanitë detyrimisht duhet ta respektojnë, në të kundërtën ndëshkohen apo edhe rrezikojnë licencën e tyre.

Është shqetësuese fakti kur Komisioni i Konkurrencës insiston që kompanitë të veprojnë jashtë një standardi që ka miratuar Banka Qendrore. Nëse rregulli 3 i Bankës Qendrore është në kolizion me Ligjin e konkurrencës, ndoshta më mirë ka qenë që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës këtë çështje ta rregullojë me Bankën Qendrore e të mos tu bie në qafë kompanive të sigurimit.

Pa pasur argumente bindëse, Komisioni i Konkurrencës është marrë me tregun e karburanteve, ndonëse këtu kompani shpëtuën pa gjoba, për fat të mirë. Bazuar vetëm në marrëveshjet gojore, ai fajëson pronarët e pikave për shitjen e karburanteve se janë marrë vesh për çmimet.

Rasti i tretë, arkat fiskale. Është një ndërhyrje e vonuar e këtij autoriteti, mirëpo defekti i këtij problemi qëndron në faktin se Autoriteti i Konkurrencës fare nuk merret me institucionin që ka licencuar kompanitë “Dukagjini” dhe “GEKOS”, Ministrinë e Financave. Ajo fare nuk është e interesuar si po funksion tregu dhe sa po respektohen kushtet e licencimit. Gabimet janë duke vazhduar edhe më tutje. Me qenë se edhe licencimi i operatorëve të tjerë nuk ka sjell ndonjë ndryshim në treg në biznes, biznesi vazhdon të paguaj çmim të lartë për këtë pajisje elektronike. Ndërkohë për mos instalimin e tyre, mirëmbajtjen nuk është i rregullt, ndërsa imponohet edhe furnizimi material shpenzues.

Lëshimet e këtyra janë rezultat i gjendjes konfuze që mbretëron brenda këtij autoriteti. Që të jemi korrektë, dua të citoj raportin e ekspertëve evropian mbi gjendjen dhe për të forcuar AKK-në, të datës 20 maj 2010.

E para, sekretari i përhershëm nuk funksionon si kreu i administratës, por si udhëheqës i financave, i çështjeve të përgjithshme.

E dyta, kryetari pas konsultimeve vendos që njëri nga komisionerët të merret me ankesat ose me informacionet për shkeljet e mundshme, por ndodhë që për të njëjtën rast paralelisht të punojnë dy apo tre komisionerë.

E treta, komisionerët tejkalojnë rolin dhe funksionin e një anëtari të këshillit.

E katërta, që është edhe më e rëndë. Secili komisionarë voton për rastin që e prodhon vetë, duke u bërë faktor me rëndësi dhe të vendos, përkatësisht të gjykoj për rezultatet e veta. Ky është konflikt interesi. Sipas praktikave më të mira, komisioneri duhet të abstenojë nga votimi për rastin që ka hetuar vetë.

E pesta, situata bëhet dramatike pasi që për shkak të mos organizimit rreth një rasti punojnë 2 – 3 komisionerë dhe, në rast të abstenimit të tyre, nuk ka kuorum për votim dhe ata prapë marrin vendime.

E gjashta, komisionerët nuk janë të specializuar për hulumtimin e rasteve, pastaj ata nuk dinë se në cilën sferë do të punojnë në rastin që vijon.

Këto janë vërejtje na Raporti i Komisionit Evropian, të datës 20 maj 2010.

Duke pasur parasysh këto defekte, të cilat vërtet janë të mëdha, atëherë nuk mund të presim të AKK-ja me sukses ta përmbush obligimin ligjor që ka. Duke krijuar rend në

treg, por edhe duke ruajtur bizneset, me këtë problem Kuvendi duhet të merret më seriozisht, me qenë se po besojnë tatimpaguesit më të mëdhenj të biznesit kosovar.

Së fundit, të hetohet edhe një problem që ndërlidhet me buxhetin e AKK-së. Ka vend të dyshohet për keqmenaxhimin e tij. Në faqen 39 të raportit financiar thuhet se për paga dhe mëditje janë shpenzuar 90.082 euro, ndërkaq për shpenzimet e udhëtimit janë paguar gati sa edhe për paga, saktësisht 80.713 euro. Pyes, sa ka qenë e arsyeshme që për këtë, për 10 vetë të bëhen kaq shumë shpenzime për udhëtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne po hymë në një rreth vicioz, nga i cili vështirë se mund të dalë Kosova. Po shohim shumë raporte që vinë nga agjenci, komisione, këshilla të pavarur të formuara nga Qeveria, disa tjera të formuara nga Parlamenti i Kosovës dhe po e kemi një problem të përbashkët.

Këto agjencione nuk po kanë strukturën e organizimit të brendshëm funksional, nuk po kanë kapacitete profesionale dhe kredencialet e duhura që të jenë funksionale dhe në të njëjtën kohë po kanë probleme në lidhje me autoritetin e përgjegjësive që ato duhet të ushtrojnë, sepse janë pjesë e politikës në kuptimin e politikave ditore dhe keqpërdorimit të tyre, jo të përdorimit të tyre në interes të qytetarëve të Kosovës.

Këto probleme po hasën sot dhe po dëmtohet interesi i qytetarëve të Kosovës në qoftë se i shohim disa çështje. Në qoftë se shohim normat e interesit, në qoftë se shohim policat e sigurimit, në qoftë se shohim vendimet e Qeverisë për të bërë monopolizimin e disa produkteve ushqimore të cilat futen në tregun e Kosovës apo produkte të naftës dhe nafta vetë, apo çështje të arkave fiskale të cilat u përmendën këtu. Janë disa probleme të cilat realisht po dëmtojnë interesin e qytetarëve të Kosovës dhe kanë krijuar kushte monopoli për disa kompani, të cilat nuk bazohen në konceptin primar që ka Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që thotë ekonomia e tregut të lirë. Ne nuk kemi ekonomi të tregut të lirë në këta sektorë që u përmendën, sepse agjencia nuk ka krye punën e vetë, as kjo agjenci dhe as agjencitë tjera.

Prandaj, jemi në një situatë ku interesi i qytetarëve të Kosovës është dëmtuar dhe ku realisht kostoja e jetës për qytetarët e Kosovës është shumë e lartë në qoftë se e marrim koston e banimit. Në qoftë se dikush do të interesohej që të merrte një kredi banimi, shihni se sa janë interesat në banka, në qoftë se dikush synon ta sigurojë një makinë, e shihni se cilat janë dëmet që i shkaktohen dhe në qoftë se shohim disa elemente tjera sa i përket produkteve ushqimore, me vendime të Qeverisë që të monopolizohet importi i mishit apo produkte të tjera, në qoftë se shohim çështjet e naftës dhe në qoftë se shohim probleme me arka fiskale.

Prandaj, mendoj që ky koncept i qeverisjes është një koncept i gabuar, i cili realisht dëmton interesin e qytetarëve të Kosovës dhe ky lloj qeverisjeje nuk duhet të lejohet të vazhdojë më sepse po dëmtohet Kosova në aspekt afatgjatë dhe në kuptimin e qëndrueshmërisë edhe sociale edhe ekonomike, edhe ligjore, sepse krejt këto agjenci janë nën kontrollin dhe menaxhimin e strukturave joformale dhe në kuptimin e veprimtarisë të tyre, por edhe në kuptimin e mbrojtjes së interesit të qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, unë mendoj se ky raport që na është prezantuar këtu sot është një raport jo profesional, kjo agjenci nuk ka përmbushur interesin e qytetarëve të Kosovës, nuk ka përmbushur obligimet e veta ligjore dhe funksionale dhe mendoj se duhet të refuzohet si i tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se çështja e krijimit të kushteve për konkurrencë të barabartë, respektivisht mbrojtjen e konkurrencës është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për arsye se një nga pengesat kryesore e cila na paraqitet vazhdimisht në hulumtimet me biznese, është konkurrenca jo e barabartë. Ky agjencion është krijuar rishtas dhe ka probleme me funksionimin e tij. Prandaj, ne nuk mund të presim që brenda një viti, një vit e gjysmë agjencioni të bëhet i përsosur. Udhëheqësi i këtij agjencioni në Komisionin për Buxhet ka shprehur problemet që ka në konsolidimin e tij, konsolidimin e stafit, konsolidimin e hapësirës. Prandaj, ne duhet t'i japim mbështetje që ky agjencion i ri të ekipohet dhe të ketë parasysh edhe sugjerimet nga Komisioni Evropian. Përndryshe, nuk mund të mohohet se ky Komision me forcat që i ka, ka targetuar disa çështje të ndejshme të konkurrencës, edhe te nafta, edhe te sigurimet, edhe ka filluar një aktivitet për bankat, edhe për arkat fiskale. Prandaj, ne duhet ta mbështesim këtë autoritet, po duhet të kërkojmë që të ekipohet, t'i krijohen kushtet. Problem i ka dy zyre dhe janë probleme që duhet t'i ndihmohet. Në vend që të shkatërrohet diçka që ka fillua të ndërtohet dhe që është e rëndësishme që në embrion, mendoj që përgjegjësia e këtij Kuvendi është që të kërkojë që ky agjencion të konsolidohet dhe të ndihmohet në konsolidimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të punës të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010.

Në sallë janë 78 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Konstatoj që nuk miratohet, 32 vota “kundër”, 11 abstenime, dhe 22 vota “për”. Konstatoj që Kuvendi nuk miratoi Raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Faleminderit!

Tani, sipas kërkesës së ministrit dhe sipas qëndrimeve të kundërta në sallë, duhet t'i kthehemi pikës së nëntë të rendit të ditës, që është:

9. Shqyrtimi i Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014

Propozim-kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2012 – 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar në Kuvend, për informim.

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar dhe Kuvendit ia ka propozuar për shqyrtim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, si propozues i çështjes ta marrë fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht, deputetë të nderuar, më lejoni t'ju kërkoj falje për ndryshimin e agjendës, mirëpo kam qenë në takim me zotin Gordon dhe besoj që kjo falje e imja e ka arsyeshmërinë e vet dhe do të pranohet nga ju, por edhe një herë ju kërkoj falje!

Sigurimi i efikasitetit të shpenzimeve publike është qenësor për arritjen e zhvillimeve socio-ekonomike të Kosovës. Korniza afatmesme e shpenzimeve e cila sot po prezantohet para jush, është edhe një dokument i cili për ne jo vetëm që përbën një obligim ligjor, por edhe paraqet përkushtimin tonë drejt avancimit të politikëbërjes.

Ekzistojnë disa rrugë përmes të cilave funksionimi i rregullt i procesit të menaxhimit të financave publike ndikon në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Së pari, përmes prioritizimit të politikave Qeveria synon që me mjetet e kufizuara buxhetore të adresojë nevojat më të rëndësishme të shoqërisë.

Së dyti, përmes ... të mjaftueshëm të resurseve buxhetore, Qeveria ka për qëllim të ngrehë efikasitetin e shërbimeve publike dhe në këtë mënyrë të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit, mbështetjes shëndetësore dhe përkrahjes sociale. Për më tepër, përkushtimi ynë drejt ngritjes së efikasitetit të shpenzimeve publike luan rol kyq në pranimin e ndihmës direkte buxhetore.

Me këto qëllime të deklaruara, kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2012 – 2014, kornizë kjo e cila përcakton ndarjet buxhetore në vlerë mesatare prej rreth 1.5 miliardë euro për periudhën afatmesme.

Më lejoni që para se të filloj me prezantimin më të detajuar të përmbajtjes së dokumentit që ju keni para jush, të themi se kjo kornizë brenda një afati të shkurtër kohor është shndërruar në një vegël të dobishme për implementimin e vizionit të zhvillimit ekonomik të Kosovës, të aprovuar javë më parë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përmes kësaj Kornize afatmesme të shpenzimeve ne kemi krijuar mekanizëm të planifikimit ekonomik dhe financiar, si dhe një praktikë e mirë e cila do të na japë

mundësinë për të matur suksesin tonë në realizimin e synimeve të vizionit të zhvillimit ekonomik. Shkurtimisht, tani e tutje Korniza afatmesme e shpenzimeve do të ketë dy skenarë.

Skenari, bazë, i cili do të përdorë për parashikimin e të hyrave buxhetore dhe skenarin e vizionit të zhvillimit ekonomik, i cili do të përdoret për përpilimin dhe fokusimin e politikave konkrete në funksion të zhvillimit ekonomik në të ardhmen. Pra, skenari i zhvillimit do të përcaktojë politikat ekonomike dhe rrjedhimisht edhe veprimet konkrete në zbatimin e këtyre politikave.

Kur këto politika do të fillojnë së implementuari, atëherë ato do të bëhen pjesë e skenarit bazë, do të bëhen pjesë e parashikimeve tona të të hyrave buxhetore dhe rrjedhimisht do të përcaktojnë parashikimet tona për disponueshmërinë e fondeve që e financojnë shpenzimet buxhetore në planin afatmesëm.

Më lejoni që në vazhdim të prezantoj një përmbledhje të konkluzioneve kryesore që dalin nga korniza makro-fiskale për tri vitet e ardhshme.

Siç u tha, përgatitja e profesionale makroekonomike për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012 – 2014 është bërë në dy drejtime.

Skenari bazë, i cili do të përdoret për nxjerrjen e projeksionit të të hyrave buxhetore në periudhën afatmesme 2012-2014, parasheh një rritje mesatare ekonomike prej 5.5% gjatë viteve 2012 – 2014.

Nga ana tjetër, skenari i vizionit zhvillimor, i përpiluar mbi bazën e përkushtimeve dhe përpjekjeve të intensifikuara rreth përmirësimit të ambientit të përgjithshëm ekonomik, i cili ka për qëllim të prodhojë politika konkrete ekonomike, parasheh rritje ekonomike mesatare vjetore prej rreth 7% gjatë viteve 2012-2014.

Parashikimet e çmimeve tregojnë për një normë inflacioni prej 5.3% në vitin 2011 dhe një normë mesatare prej 1.7% gjatë viteve 2012 dhe 2014.

Në vazhdim, më lejoni të theksoj që viti 2010 ishte vit i suksesshëm sa i përket zhvillimeve në sektorin fiskal, ku të hyrat totale ishin një miliard e 126 milionë, apo një realizim i planit i paraparë në nivel prej 101%.

Në strukturën e të hyrave brenda vitit 2010 u arketuan 701 milionë euro nga tatimet në kufi, ndërsa 221 milionë euro nga tatimet në vend, duke tejkaluar në mesatare nivelin e planifikuar të hyrave buxhetore.

Edhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe atij komunal u arketuan në vlera më të larta se sa që ishin projektuar në buxhetin e vitit 2010, çka flet për maturinë tonë në projektimin e të hyrave.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore për vitin 2010 janë realizuar në normën 94%, si stimul i mirë fiskal ndaj ekonomisë së vendit, duke rezultuar nga përmirësimi i kapaciteteve planifikuese dhe kapaciteteve për ekzekutimin e buxheteve nga ana e institucioneve publike.

Janë shpenzuar 455 milionë euro për 91% e shpenzimeve të buxhetuara kapitale, çka paraqet edhe normën më të lartë të realizimit të buxhetit në historikun e shkurtër fiskal të institucioneve tona.

Edhe shpenzimet në kategoritë tjera ekonomike janë realizuar me norma të ngjashme dhe në përgjithësi niveli i shpenzimeve totale arrin në një miliard e 272 milionë.

Vlen të përmendet që në projeksionet e prezantuara në këtë dokument janë të përfshira edhe kostot për implementimin e ligjeve për kategoritë e dala nga lufta, Ligji për pensionet dhe Ligji i punës.

Projeksionet e të hyrave buxhetore bazohen në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesorë makroekonomikë, përfshirë këtu lëvizjet e importit, çmimet, si dhe vlerësimin mbi rritjen e performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave, siç janë Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Në këtë drejtim, të hyrat e përgjithshme buxhetore deri në fund të vitit 2014 pritet të arrijnë në shumë prej 1 miliard e 431 milionë euro ose të jenë 13% më të larta se projeksionet për vitin 2011.

Ndërsa, të hyrat tatimore të cilat përfshijnë të hyrat nga tatimet në kufij dhe të hyrat nga tatimet brenda vendit deri në fund të vitit 2014 pritet të arrijnë në shumë prej 1 miliardë e 243 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 17%, krahasuar me projeksionet për vitin 2011.

Për periudhën e parashikuar 2012 – 2014 rritja mesatare e të hyrave të përgjithshme buxhetore pritet të jetë rreth 4.3%. Këto parashikime burojnë nga skenari bazë. Nëse gjatë periudhës afatmesme ne arrijmë të implementojmë të gjitha politikat e deklaruara në skenarin e vizionit të zhvillimit ekonomik, atëherë pritet që deri në vitin 2014 të hyrat buxhetore të tejkalojnë vlerën prej 1.6 miliardë euro.

Shpenzimet e përgjithshme gjatë periudhës së projektuar 2012 – 2013 pritet të shënojnë ngritje të vazhdueshme duke arritur vlerën prej 1 miliardë e 487 milionë euro gjatë vitit 2013, një rritje këtu prej 4% krahasuar me vitin 2011.

Duke pas parasysh vullnetin e shprehur, prioritetin e Qeverisë së Kosovës për integrimin e përsheptuar në Bashkimin Evropian, korniza e cila sot po prezantohet parasheh që deri në vitin 2014 pakoja jonë fiskale të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e Kopenhagës, çka do të thotë se deficiti i përgjithshëm në vitin 2014 do të jetë më i ulët se 3% e bruto produktit vendor.

Pas përfundimit të autostradës “Ibrahim Rugova”, niveli i përgjithshëm i shpenzimeve buxhetore nuk do të rritet me trendin e mëparshëm, sepse parashihet që projektet e mëdha kapitale të financohet përmes financimeve alternative.

Mesatarja e deficitit të përgjithshëm gjatë vitit 2012 – 2014 do të jetë rreth 2.1% e bruto produktit vendor.

Edhe më tutje, gjatë periudhës 2012 – 2014 shpenzimet kapitale do të vazhdojnë të përbëjnë përqindjen më të lartë të shpenzimeve të përgjithshme, duke ruajtur nivelin e tyre prej rreth 40%.

Niveli më i lartë i shpenzimeve kapitale pritet të ndodhë gjatë vitit 2013, ku vlera e shpenzimeve kapitale pritet të arrijë në 605 milionë euro. Duhet cekur se në kuadër të shpenzimeve kapitale janë përfshirë një numër i madh i projekteve infrastrukturore që përfshijnë ndërtimin e autostradës, projekteve tjera rrugore, ndërtimin e shkollave, spitaleve, si dhe investime tjera shtesë që kanë për qëllim mënjanimin e problemeve strukturore që karakterizojnë ekonominë e Kosovës.

Shkurtimisht, shpenzimet në bazë të kategorive ekonomike të projektuara në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012 – 2014 do të jenë, që i keni tabelat, mos t’ju ngarkoj me këto shifra. Vlen të përmendet që nga viti 2012 është planifikuar që kategoria e shpenzimeve nëpërmes memorandumeve të mirëkuptimit të shpërndahet nëpër kategoritë ekonomike, kjo me qëllim të lehtësimit në projekte dhe prezantim.

Nevojat për financim gjatë vitit 2012 – 2014 do të ngushtohen në nivel të pranueshëm dhe të përgjegjshëm fiskal përmes financimit të siguruar nga bilanci i akumuluar i parasë së gatshme nga të hyrat e njehershme, nga ndarja e aksioneve publike në sektorin privat, nga mbështetja e pritshme buxhetore dhe huamarrjet e jashtme në institucionet financiare ndërkombëtare.

Bazuar në të hyrat e projektuara, është bërë edhe parashikimi i vlerës së përgjithshme të granteve komunale. Si rezultat i të hyrave në rritje, vlera e granteve qeveritare për kompetencat vetanake të komunave do të shënojë një ngritje nga 241 milionë, sa ishin në vitin 2010, në 306 milionë në vitin 2014.

Në përgjithësi, përmes Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2012 -2014, ne jemi munduar të ofrojmë një planifikim gjithëpërfshirës dhe të balancuar. Natyrisht, jemi treguar edhe të përgjegjshëm, duke prezantuar projeksione konzervative. Në kohën e tashme e kemi një vizion, i cili besoj se deri në rifreskimin e ardhshëm të Kornizës afatmesme të shpenzimeve do të mundësojë të jemi edhe më afër në arritjet tona në përmirësimin e standardeve të jetesës së Kosovës.

Krejt në fund, më lejoni t’ju informoj, deputetë të nderuar, se si rezultat i zhvillimeve dhe ecurisë së indikatorëve makroekonomikë, një prej tyre siç është edhe inflacioni, si rezultat i ndryshimeve në relacionet me institucionet financiare ndërkombëtare dhe rrethanave tjera, Ministria e Financave ka në planet e veta të punës që këtë dokument

gjatë muajve korrik dhe gusht ta rishikojë, ta rifreskojë dhe ky dokument t'i paraprijë buxhetit të vitit 2012. Ne sot i mirëpresim diskutimet e juaja. Sigurisht se këto diskutime do të kontribuojnë në përmirësimin e këtij dokumenti. Ne e dimë që nuk është një dokument ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

MINISTRI BEDRI HAMZA: ...dhe ne presim që gjatë muajit korrik dhe gusht ta përfundojmë këtë dokument dhe normalisht ky të jetë bazë për hartimin e buxhetit 2012 dhe të buxheteve vijuese. Faleminderit! Edhe një herë kërkoj falje, ju lutem!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Sipas radhës, tani e ka fjalën zëvendëskryetari i parë i Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Qeveria deri më 30 prill të secilit vit kalendarik i dorëzon Kuvendin Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin e ardhshëm fiskal, si dhe vlerësimin për dy vitet e ardhshme fiskale. Këtë e thashë, zoti nënkryetar, për t'i hequr ato dilema që i deklaruan disa kryetarë, shefat e grupeve se a do të debatohet apo jo.

Ministri i Financave, në pajtim me nenin 5 të Ligjit të përmendur, do të azhurojë përmbajtjen e kornizës për të lejuar dorëzimin e buxhetit të Republikës së Kosovës në Qeveri dhe Kuvend, në pajtim me nenin 21 dhe nenin 22 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe nenin 7 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 2 qershor, ka shqyrtuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2012 – 2014 dhe ka vendosur që t'i rekomandojë Kuvendit në shqyrtim Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2012 – 2014.

Kuvendi debaton për Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në fund mund të nxjerrë rekomandime që do të mund të merren parasysh nga ministri i Financave me rastin e azhurimit të Kornizës afatmesme të shpenzimeve, i cili dokument është pjesë përbërëse e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Për të qenë më i qartë, zoti nënkryetar, ky dokument debatohet në parlament, mirëpo sipas ligjit nuk e përcakton që Kuvendi duhet të marrë vendim lidhur me këtë dokument, mirëpo debatet që rrjedhin në Kuvend, ministri obligohet t'i azhurojë në kuptimin e asaj që të bëjë një dokument më të mirë në kuptimin e asaj që Ligji për buxhetin të dalë nga ky dokument sa më i mirë dhe më i garantuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani e kanë fjalën përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Korniza afatmesme e shpenzimeve 2012 – 2014 është në përputhje me Ligjin mbi financat publike dhe përgjegjësitë. Korniza shërben si dokument kryesor i planifikimit të politikave qeveritare dhe si kornizë shërben si dokument po ashtu që paraqet komponent të rëndësishëm të procesit të përgjithshëm buxhetor. Njëherësh, ky dokument paraqet edhe bazë për hartimin e buxhetit për vitin 2012.

Korniza afatmesme e shpenzimeve 2012 -2014 nuk është një dokument statik, mund të plotësohet dhe të ndryshohet duke iu përshtatur realitetit të krijuar. Me këtë kornizë projeksionet e të hyrave buxhetore bazohen në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesorë makroekonomikë, duke përfshirë këtu lëvizjet e importit, çmimet, si dhe vlerësimet mbi rritjen e performancës të institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave, siç janë doganat dhe ATK-ja.

Duke marrë parasysh se si të hyrat e jashtme kryesisht janë të hyrat nga doganat, ku deri në vitin 2014 pritet një rritje rreth 13%, po ashtu edhe nga ATK-ja një ngritje rreth 17%.

Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, në bazë të Kornizës afatmesme të shpenzimeve parashihet një ngritje rreth 4%, krahasuar me këtë vit. Ndërsa mesatarja e deficitit pritet të jetë rreth 2.1% e bruto produktit vendor të planifikuar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah dhe e përgëzon Qeverinë që në kohë e ka sjellë këtë dokument në parlament dhe iu ofron mundësinë deputetëve që të japin kontributin e tyre për plotësimin e këtij dokumenti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues, ne edhe më herët lutëm për mirëkuptimin tuaj, duke e ditur seriozitetin e pikës, pavarësisht që informatë e të gjithave që u thanë, duke e ditur që edhe pika vijuese e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, po ashtu kërkon që do të duhej të dëgjohet, ne propozojmë që të vazhdojë debati nesër në orën 10:00 dhe me pika tjera, është kërkesë e Grupit Parlamentar të LDK-së.

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë jam i detyruar që ta nxjerr ose t'i pyes e përfaqësuesit tjerë të grupeve parlamentare ose me konsensus të merremi vesh. Unë po e kuptoj, po i kuptoj të gjitha palët në këtë rast shumë mirë ku është qëllimi, u tha edhe një herë publikisht. Mendoj që edhe ministri

do të duhej ta thoshte edhe ky fjalën e tij, nuk e di a keni qenë këtu apo jo, është kërkesë e tre grupeve parlamentare që debati të shtyhet për shkak se pas orës 17:00 nuk ka transmetim në televizion. Nuk e di, të dy grupet... Adem, a e deshe fjalën për kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së? Zoti Grabovci, e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Shiko, jo veç deklaram. Për mua më duket absurde ne t'i ndërpresim punimet e Kuvendit, trajtimin e një çështje tepër të rëndësishme, siç është Korniza afatmesme e shpenzimeve. Unë isha në emër të Grupit Parlamentar kundër vazhdimit të debatit rreth kësaj çështje pa prezencën e ministrit. Ministri ka ndërprerë takimin atje, ka ardhur. Mendoj se nuk ka asnjë arsye që mos të vazhdojmë ne me punën. Për mua është, nëse është në pyetje televizioni, të kërkojmë, më arsyeshme është të kërkojmë një orë të vazhdojë transmetim RTK-ja, se sa të humbim seriozitetin si institucion vendimmarrës. Pse dikush po dashka të dalë në televizion, por ne s'na pengon, nuk kemi nevojë për propaganda, po ne jemi të interesuar vërtetë të bëjmë punën.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Ymeri e ka kërkuar fjalën, Visar Ymeri. Regjia deputetit Ymeri, fjalën.

VISAR YMERI: faleminderit, zoti kryesues!

Nuk po flasim këtu për çështje propagande e as për çështje të dëshirës së dikujt për të dalë në televizion, kjo është çështje e transparencës. Këtu po flasim për një dokument që është tejet i rëndësishëm, pra po flasim për shpenzimet e planifikuara dhe buxhetin e planifikuar të Qeverisë për dy vitet e ardhshme, që ka shumë rëndësi për secilin qytetarë të Kosovës. Prandaj, konsiderojmë që është shumë e rëndësishme që këta qytetarë të Kosovës të kenë qasje në debatin në Kuvend për këtë çështje.

Po ashtu, ne këtu Kornizën afatmesme të shpenzimeve po e diskutojmë me praninë e vetëm një ministri, ministrin e financave, që në raport me këtë kornizë, pa keqkuptime, është domethënë përgjegjësi më shumë teknike, se sa politike. Nuk i kemi personat që e kanë bërë këtë politikë dhe rrjedhimisht konsideroj që një debat i tillë do të ishte i mangët pa këta persona. Është e domosdoshme që një pjesë e konsiderueshme e Qeverisë, e veçanërisht ata ministra që i mbulojnë resorët për të cilat këtu është planifikuar të shpenzohet më shumë si prioritet, të jenë këtu të pranishëm dhe ta dëgjojnë debatin me deputetët e Kuvendit të Kosovës, e veçanërisht është e rëndësishme të jetë edhe kryeministri, për shkak se ai është shefi i krejt kësaj Qeverie dhe rrjedhimisht i bije të jetë shefi edhe i kësaj Kornize afatmesme të shpenzimeve.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" konsideron që është e domosdoshme që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër apo për nesër, kur ta kemi të mundshme që t'i kemi edhe ministrat tjerë këtu dhe që të kemi kohë më të mirë për të debatuar për këtë çështje, e cila është shumë e rëndësishme.

Mosprania e Qeverisë këtu tregon se Qeveria edhe një herë fizikisht po do të na dëshmojë se ajo nuk qanë kokën fare për atë që thotë Kuvendi, e që mendoj se është një gabim tejet i madh dhe një dëm shumë i madh që i bëhet demokracisë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar, zoti Ardian Gjini.

ARDINA GJINI: Faleminderit, edhe një herë, zoti nënkryetar!

Diçka u tha, po mendoj se edhe ne në emër të grupit t'i japim disa qëndrime. Sikur të kishte qenë hera e parë që ndodhë kështu, ndoshta edhe kishim kaluar nëpër këtë punë, se nuk e kishim ditur cila është metoda e punës. Ka ndodhur me dhjetëra herë që Qeveria e Kosovës, kur ka pasur për të kaluar ose debatuar materiale të cilat kanë qenë dëshmi e dështimit të Qeverisë, ka provuar ta shtyjë debatin pas orës 17:00, kur ndërkehet transmetimi. Po them edhe një herë, nuk është hera e parë edhe e dimë mirë këtë metodë të punës. Nuk është mirë kështu, nuk është mirë për Kosovën, nuk është mirë as për Qeverinë të bëjë kështu. Papërgjegjësia është diçka tjetër e prezencës së ministrave, por unë duhet t'i përsëris ato që i thanë kolegët e mi përpara. Shumë prej nesh këtu jemi dalë me mijëra herë në televizion. Ne nuk e kemi hallin tonë për të dalë në televizion edhe një herë. Ne e kemi hallin ta përdorim të vetmin mjet të punës në demokraci, e ajo është që opinionin publik në Kosovë ta kuptojë edhe të shohë se cili është debati mes Qeverisë dhe opozitës, të shohë se çka dallojmë ne mes veti, edhe ky është i vetmi mjet i punës që ne e kemi. Nëse Qeveria provon të na marrë edhe këtë mjet të punës, atëherë unë po ju pyes juve - çfarë mjete të punës i mbesin në dorë opozitës për të punuar në këtë vend? Ne insistojmë që debati të shtyhet atëherë kur populli mund të dëgjojë dhe të shohë se çka debatohet këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupet tjera parlamentare nuk e kanë kërkuar fjalën. Zoti ministër, keni diçka të thoni?

MINISTRI BEDRI HAMAZA: Faleminderit, kryesues!

Unë, për arsyen e mungesës teme në atë kohë kërkoja falje dhe është ashtu qysh e thashë, kam pasur takim me zotin Gordon.

Çështja tjetër është, vendimet e Kuvendit për mua janë vendimet të cilat i ekzekutoj. Vetëm e kam një lutje. Sido që të vendoset, nesër ju kisha lutur që seanca, prapë nuk është ..., po dua të kërkoj diçka, po është një takim që është me krejt ambasadorët e vendeve në Kosovë, përfaqësuesit e FMN-së dhe Bankës Botërore, është nga ora 10:00 dhe deri në orën 11:00. Nuk do dua ta paragjykoj vendimin e Kuvendit, por deri në ora 11:00 ju kisha lutur për mirëkuptim, nëse vendoset që seanca të shtyhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Mirë, mirë, po këta shumica nuk janë për ta shtyrë. Okej, e qesim në votim. Në sallë janë të pranishëm 64. Votojmë me dorë apo me elektronikë?

(Ndërhyrje)

Ku t'i thërras unë, thirrni ju, ju jeni përgjegjës për deputetë, unë s'jam, po kryetarët e grupeve parlamentare. Domethënë, ne jemi mësuar të votojmë, votojmë me elektronikë përnjëherë, kështu më mirë.

Kush është për ta shtyrë, e shtyp Yes, kusht është për të mos e shtyrë, me qenë se është propozimi për ta shtyrë, po e qesim të parën Yes, se ashtu e kemi të shkruar tash dhe s'kemi çka bëjmë. Kush është kundër, e shtyp "kundër" dhe kush abstenon, abstenon.

Atëherë, në sallë janë 70 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Atëherë, seanca shtyhet për nesër në orën 11:00.

E thashë, seanca nesër në ora 11:00 vazhdon.

E premte, më 17.06.2011, vazhdimi i seancës

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë seancën,

Gati kem duke e kaluar pikën e nëntë, po mbasi erdhi ministri, po e vazhdojmë me **Shqyrtimin e Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014.**

Radha ka qenë për shefat e grupeve parlamentare. Partia Demokratike e ka thënë fjalën e vet. Tani është radha për kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në emër të LDK-së, deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Ne, Grupi Parlamentar i LDK-së, kemi analizuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2012 -2014 dhe pa tjetër dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë fillimisht lidhur me thellimin e krizës ekonomike, që erdhi në Kosovë si rezultat i kësaj qeverisje aktuale. Kjo u vulos dhe u legalizua me aprovimin e buxhetit të vitit 2011, e që u konfirmua me prishjen e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Dokumentin të cilin e kemi para nesh, nuk është i azhurnuar, sepse ky dokument nuk përkon me realitetin e krijuar pas 30 majit, ku Fondi Monetar Ndërkombëtar del nga marrëveshja Stand- by, duke i pamundësuar Kosovës që të përfitojë 157 milionë nga FMN-ja, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian të premtuara për buxhetin e vitit 2011, të cilat për çudi ende janë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, në faqen 51, tabela numër 3.

Të nderuar, ne sot po e diskutojmë këtë kornizë, sipas të cilës Qeveria ende llogaritë në 87 milionë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, 50 milionë nga Komisioni Evropian dhe 20 milionë nga Banka Botërore. Këto para Qeveria i humbi, këto para nuk guxojnë të jenë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Qeveria humbi 157 milionë dhe bëhet kinse nuk ka ndodhur asgjë.

Ju lutem shumë, kjo është papërgjegjësi, jo seriozitet dhe fyerje edhe për Kuvendin dhe për të gjithë qytetarët.

Kryeparlamentari dje shpjegoi shumë mirë reciprocitetin. Kishte për të qenë shumë mirë që të definohet pak edhe kjo kornizë e formuluar me këto terma.

Duke marrë parasysh këtë fakt, kjo kornizë nuk i plotëson as kushtet bazike që debatohet në parlament. 157 milionë më pak në buxhetin e vitit 2011, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e këtij viti, por kanë ndikim edhe në vitet në vijim. Me minus 157 milionë, këtë vit Qeveria do të duhet të rrudhë shpenzimet, por ku, në mallra dhe shërbime, paga mëditje apo investime kapitale?

Pa marrë parasysh se ku Qeveria do të kursej, kjo do të ketë efekte në buxhetet e viteve në vijim. Për këtë arsye, edhe një herë po e them se ky dokument është plotësisht jo real dhe i pa pranueshëm.

Ne jemi të vetëdijshëm se Qeveria do të gjejë forma për plotësimin e 157 milionëve, siç kemi pah kohëve të fundit, rritja e akcizës për shumë produkte vetëm me qëllim për të mbushur arkën e shtetit. Dhe nuk do të jetë çudi që nesër të rrisë taksa e tatime të ndryshme, duke bërë qytetarët e Kosovës që të paguajnë për pamaturinë e kësaj qeverie dhe të paguajnë çmimin e fitores së PDK-së në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 2010.

Nëse Qeveria në këtë formë do të mbushë arkën e shtetit, këto politika duhet të figurojnë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, sepse rritja e tatimeve, të taksave dhe të akcizave ndikon drejtpërdrejt në jetën e çdo qytetari dhe në suksesin e çdo biznesi në Kosovës.

Analiza jonë për Kornizën afatmesme të shpenzimeve lidhet shumë me realitetin e krijuar nga degradimi i marrëdhënies me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sepse ne mendojmë se pasojat e humbjes së kësaj marrëveshje do të lënë gjurmë në zhvillimet ekonomike dhe politike të vendit për këtë vit dhe për vitet në vijim. Kosova në relacion me FMN-në më 30 maj kaloi nga statusi i përfituesit, në statusin e të monitoruarit dhe është papërgjegjësi shumë e madhe e zyrtarëve të qeverisë, të cilët mendohen të na bindin se kjo kinse është pozitive më e mirë, kinse më mirë qenka të jemi të monitoruar, se sa të përfitojmë nga FMN-ja.

FMN-ja me marrëveshjen e re do ta monitorojë Qeverinë deri në fund të vitit 2012 dhe pastaj do ta vlerësojë kredibilitetin e saj për të vendosur të kthej statusin e përfituesit. Pos humbjes së 157 milionëve, po t'i shtojmë kësaj edhe 300 milionë nga PTK-ja nga shitja e aseteve të PTK-së, të cilat nuk janë të sigurta që do të hyjnë në këtë vit, atëherë në fund të vitit Qeveria do të ngelet, do të ketë minus 457 milionë, duke pasur kështu vetëm 10 milionë në llogarinë e saj në fund të vitit. Cila Qeveri në botë dhe cili institucion do t'i besojë një vendi, i cili në fund të vitit ka vetëm 10 milionë, do të thotë është po thuaj se para falimentimit.

Në aspektin politik, sipas marrëveshjes së re Kosova ka bërë një hap prapa sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare. Anëtarësimi në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim as që mund të flitet, po thuaj se është i pamundshëm dhe në institucionet të tjera. Thënë shkurt, Qeverisë së Kosovës nuk po i besohet më. Sinjalet e para nga Komisioni Evropian janë se raporti i progresit do të jetë raport i regresit.

Integrimi në Evropë dhe lëvizja pa viza, e premtuar nga Qeveria, është një iluzion nga ana e Qeverisë dhe është mashtrim për qytetarët e Kosovës. Opsioni për financimin përmes lëshimit të letrave me vlerë është praktikisht i pamundur. Edhe sikur Parlamenti ta rrumbullakësojë legjislacionin për lëshimin e letrave me vlerë, më tregoni se kush do të blejë letra me vlerë nga një Qeveri e cila ndodhet para falimentimit.

Sipas marrëveshjes së re me FMN-në, legjislacioni që pritet të aprovohet në këtë parlament dhe që mund të ketë implikime financiare sa i përket pagave, asistencës sociale dhe ndihmave të tjera për kategoritë e ndryshme, do të monitorohet, fillimisht do të aprovohet nga FMN-ja.

E para, kjo nuk reflektohet në Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

E dyta, ky është cenim i sovranitetit të vendit, i cili që 3 vite ka shpallur pavarësinë.

Qeveria e Kosovës duhet të jetë e ndërgjegjshme dhe të pranojë para qytetarëve të saj dhe t'ju thotë: Nuk do të ketë asistencë sociale, rritje të asistencës sociale, nuk do të ketë rritje të asistencës për invalidë dhe kategori të tjera të dala nga lufta, nuk do të ketë paga retroaktive.

Kryeministri ka një marrëveshje me sindikatat për paga retroaktive, ka një marrëveshje me pensionistët dhe ka një marrëveshje me kategoritë të dala nga lufta, të cilat nuk po i zbaton. Çudi, ata që guxuan të rrisin pagat përkundër çdo norme të pranueshme për institucionet ndërkombëtare, sot nuk kanë guxim të dalin para qytetarëve dhe t'ju thonë se nuk ka paga retroaktive, po atë që nuk ua thotë Qeveria, ua themi ne. Qytetarë të nderuar, nuk ka paga retroaktive për janar dhe shkurt. Shumën e pagave retroaktive në masën prej 10 milionë eurove Qeveria e ka tërhequr në një llogari të veçantë, e ka paraqitur para FMN-së si kursim nga fondi i pagave për muajt e fillimit të këtij viti.

Deficiti buxhetor dhe zvogëlimi i rezervave qeveritare gjatë vitit 2011 do ta rrezikojnë seriozisht sistemin financiar të vendit edhe për vitet në vijim. Rritja e pagave gjatë këtij viti po thuaj se është amortizuar krejtësisht nga inflacioni i lartë i shkaktuar nga kjo rritje e pagave. Në muajt e parë të këtij viti, inflacioni i përgjithshëm ka arritur në normën deri në 10% krahasuar me vitin 2010. Inflacioni për produktet bazë, si buka dhe vaji, ka qenë mbi 40%. Ata që nuk hanë bukë dhe hanë mish, nuk e dinë këtë normë të inflacionit. Duke marrë për bazë këtë inflacion, rritja nominale e pagave prej 23% ka mbajtur të pandryshuar fuqinë blerëse të 78 mijë familjeve kosovare dhe ka dëmtuar shumë standardin e 280 mijë familjeve të tjera.

Pavarësisht normave të larta të inflacionit, në Kornizën afatmesme të shpenzimeve pagat do të mbesin të njëjta për 3 vitet e ardhshme. Familjet në asistencë sociale, familjet e

invalidëve të luftës, dëshmorët, pensionistët dhe kategoritë të tjera duhet ta rrudin konsumin. Buxheti për këto kategori është i njëjtë dhe kjo është shenjë se Qeveria e di se niveli i varfërisë në Kosovë do të mbetet i njëjtë edhe për tri vite të tjera.

Në kornizë janë të inkorporuara edhe elementet e planit ashtuquajtur - Planit Banjsko, i cili në vetvete është shumë konfliktuoz. Gjatë tri viteve të kaluara rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga sektori publik, e cila rritje ka qenë shumë e koncentruar në një kategori të vogël përfituesish dhe, si rezultat i kësaj, niveli i varfërisë ka qenë i njëjtë. Tani situata ka ndryshuar. Rreth gjysma e investimeve kapitale janë të koncentruara në një projekt të vetëm, të cilin e implementon Bechtel & Enka, e si rezultat i kësaj shumë kompani që merren me ndërtimtari dhe infrastrukturë janë në falimentim e sipër.

Projekti i autostradës përveç që siguron paga shumë të ulëta dhe kushte jashtë çdo standardi të lejuar për 3000 punëtorë vendorë, nuk ka kurrfarë efekte multiplikuese për ekonominë vendore. Kjo nënkupton se rritja ekonomike nuk pritët të vijë nga sektori publik. Qeveria nuk ka treguar në kornizë se nga do të vijë rritja ekonomike e paraqitur në dy skenarë në një situatë inflacioni, ku kemi një sektor privat me investime në rënie dhe me këtë paqëndrueshmëri fiskale. Në kornizë duhet të adresohen pyetjet - nga do të vijë rritja ekonomike, si do të shpërndahet ajo, kush do të përfitojë nga kjo rritje ekonomike, edhe pse ne mendojmë se kur jemi të rritja ekonomike, Qeveria ka shprehur një optimizëm të pajustificuar. Qeveria e bazon rritjen ekonomike sipas kornizës 7 deri 8% në përmirësimin e ambientit të biznesit. Arritja në top 40-shin e reformatorit të raportit të Bankës Botërore të bezh biznes në Kosovë në vitin 2014 përmes eliminimit të 50% të licencave dhe lejeve, nuk do të rrisë investimet. Kosova ka probleme dhe kufizime të tjera të cilët duhet ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, vazhdoje deputete, pasi Teuta nuk do ta marrë fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: ...eliminimi do të thotë i 50% të licencave nuk do të bëjë ndonjë mrekulli, përpos që është i pamundshëm. Investimet e huaja nuk rriten, nëse i eliminojmë këto leje dhe licenca. Kosova ka probleme dhe kufizime të tjera të cilat duhet të adresohen. Kosova ka një imazh tepër të dëmtuar ndërkombëtar, Kosova është treg të vogël, me një fuqi tejet të limituar blerëse, ka probleme sa i përket eksportit për shkak të bllokadës që na bëjnë vendet fqinje. Të gjitha këto ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e investimeve të huaja dhe rrjedhimisht edhe në rritjen ekonomike. Iluzion është edhe rritja e papunësisë prej 8 deri 10%, sepse kjo nënkupton që 33 mijë vende të reja të punës do të krijohen për të papunët tashmë të regjistruar dhe 25 mijë deri 30 mijë për punëtorët e rinj që hyjnë për herë të parë në tregun e punës.

Subvencionet nga Ministria e Bujqësisë janë 7.4 milionë, që është pak për të siguruar rritje të prodhimit bujqësor. Kjo është 0.5% e shpenzimeve totale të Qeverisë. Kjo tregon kujdesin e kësaj qeverie përmbi gjysmën e popullsisë që jeton në zonat rurale. Pavarësisht planit të Qeverisë për rritje të buxhetit të bujqësisë deri në 3%, të Ministrisë së Bujqësisë deri në 3% të buxhetit total, kjo prapë është pak, për më tepër, forma e mbështetjes së këtij sektori nuk po jep efekte. Dhënia e subvencioneve në mënyrë ad-hoc është më tepër

formë e ekzekutimit të buxhetit, se sa program për zhvillimin e sektorit. Merrni me mend, subvencionet në bujqësi jepen në kohën e korrjeve. Në këtë kohë, ato para nuk shfrytëzohen për bujqësi, por shfrytëzohen për konsum.

Qeveria duhet të ketë programe për zhvillimin e sektorit, të cilat programe fermerët e ogrobizneset duhet të jenë në dijeni ku mund të planifikojnë mbështetje nga Qeveria. Ne konsiderojmë se bujqësia është sektori kyç në ekonominë e Kosovës për të absorbuar te të papunët dhe për të krijuar efekte multiplikuese ekonomike.

Sipas buxhetit 2011, 79 milionë ju jepen ndërmarrjeve publike. Në Kornizën afatmesme të shpenzimeve nuk është parashikuar se si do të zvogëlohet ose si do të eliminohet pavarësia nga buxheti i këtyre ndërmarrjeve publike. Në kornizë nuk parashihen se këto huat do të kthehen. Ne po paguajmë dy herë rrymën, një herë përmes buxhetit taksave tona dhe një herë me faturat që na vinë nga KEK-u. Vlerësimet janë se mbi 10% e shpenzimeve të bizneseve shkojnë për të siguruar burime alternative të energjisë.

Veriu i Kosovës vazhdon të mbetet pikë e zezë për ekonominë kosovare. Kontrabandimi i mallrave nga atje çrregullon konkurrencën në vend, po i nxjerr nga tregu shumë prodhues dhe biznese vendore dhe po zvogëlon buxhetin e Kosovës.

Në fund, masat e premtuara të reciprocitetit ndaj Serbisë dhe Bosnjës nuk do të implementohen asnjëherë. Atë çfarë ministrja e Tregtisë dhe Industrisë dhe zëvendësministra e Kosovës ka deklaruar se do të vendos, është taksë doganore në produktet e importuara nga këto vende. Fillimisht as kjo po shihet që nuk do të mund të vendoset, po edhe nëse vendoset, kjo nuk është reciprocitet dhe kjo e rëndon shumë konsumatorin kosovar, sepse në fund është ai i cili do të paguaj, e jo Serbia.

Përfundimisht, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e mbështet këtë dokument, sepse nuk është real. Qeveria duhet ta përgatisë një dokument i cili ka baza reale, ku të hyrat janë reale e jo fiktive, ku shpenzimet janë aq sa janë të hyrat reale dhe një dokument i cili respektohet, sepse Qeveria nuk e ka respektua Kornizën afatmesme të shpenzimeve në të kaluarën, Qeveria nuk po e respekton Ligjin e buxhetit të vitit 2011, ajo e ka tejkaluar shumë herë numrin e punëtorëve, i cili përcaktohet në këtë ligj me qeverinë e saj megalomane. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Është mirë t'i harmonizoni qëndrimet në grupin parlamentar.

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri apo kush e donë fjalën?

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Dokumenti që e kemi sot përpara - Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitet 2012-2014, të prezantuar nga Qeveria e Kosovës, do ta quaja një dokument interesant dhe është interesant në disa aspekte.

Në aspekt të vërtetësisë së projeksioneve dhe numrave që paraqiten në të, të cilat në disa raste shumë të rëndësishme janë jashtëzakonisht larg realitetit që po e shohim. Në aspekt

të synimeve të Qeverisë, të cilat në disa raste bien ndesh me interesat e vendit, si dhe në aspekt të kohezionit të brendshëm të dokumentit, ku shihet qartë që një pjesë e konsiderueshme e atyre që janë shkruar aty, janë thjeshtë dëshira të Qeverisë më shumë, se sa projeksione të bazuara dhe të argumentuara mirë.

Por, fillimisht duhet të flasim për logjikën dhe rendin e dokumenteve.

Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument i cili paraqet një planifikim më afatgjatë të shpenzimeve për ta realizuar një plan të caktuar ekonomikë drejt përmbushjes së interesave dhe synimeve afatgjate që mund t'i ketë vendi. Pra, është dokument që synon planifikimin afatmesëm, në këtë rast, për t'i ikur sado pak vendimeve ad-hoc, që të pabazuara në ndonjë plan më afatgjatë, përfundojnë së përmbushuri vetëm nevoja afatshkurtra të momentit.

Me qenë se është plan me afatgjatë, atëherë të gjitha dokumentet tjera që kanë të bëjnë me periudha të kufizuara në kohë dhe afat shkurtër, siç është për shembull buxheti, do të duhej të përpiloheshin për brenda kësaj kornize dhe në përputhje të plotë me te. Por në Kosovë kjo logjikë është e kthyer mbrapshtë, Qeveria e Kosovës e ka kthyer këtë logjikë mbrapshtë.

Këtu Korniza afatmesme i nënshtrohet buxhetit afatshkurtër. Pra, pjesëza qëndron përmbi tërësinë, vendimet e momentit e mbizotërojnë planifikimin afatgjatë. Kjo përveç që është e palogjikshme, është edhe tejte e dëmshme për shkak se vendimet e momentit, pa një vlerësim historikë të tyre dhe pa planifikim të pasojave të tyre, zakonisht dalin të jenë shumë të dëmshme në afat të gjatë. Tash e 12 vite ekonomia e Kosovës udhëhiqet nga një logjikë e tillë qeverisje, e cila logjikë ka marrë përmasa alarmuese me këtë qeveri në mandatin e parë dhe veçanërisht në këtë të dytin. Dhe për gjatë këtyre viteve ne po e shohim se në çfarë gjendje ekonomike e sociale kemi arritur, si pasojë e mungesës së planifikimit strategjik dhe peshimit afatgjatë dhe historik të vendimeve të së tashmes.

Në ekonomi nuk ka zhvillim afatshkurtër. Aty mund të ketë vendime të së tashmes, por nëse nuk vlerësohen historikisht, ato sjellin vetëm dëme e jo dobi. Kjo mënyrë e ecjes para, është ecje para me sy të mbyllur pa e ditur se ku po shkon dhe pa e ditur se ku po shkel.

Po, t'i kthehemi dokumentit, pra kornizës. Aty thuhet se ky dokument është bazuar kryesisht në vizionin e Qeverisë për zhvillim ekonomik, të cilin e njohim më shumë me emrin - Plani Banjsko, kryesisht, e jo tërësisht, gjë që e dëshmon atë që e thashë më lartë, se afatshkurtra e mbizotëron afatgjatën. Pastaj, korniza rendit prioritetet e Qeverisë së Kosovës, me të cilat kuptohet se asgjë nuk do të ndryshojë nga qeverisja e deritashme: ndërtime rrugësh, privatizim të vazhdueshëm të çdo gjëje publike, qoftë privatizim të plotë apo të pjesshëm përmes partneritetit publiko-privat, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e fraza të tjera të tilla, të cilat në realitet nuk po shihet se po ndodhin.

Thuhet se do të investohet në arsim cilësor, siç është thënë edhe deri tash, dhe se do të privatizohet tërësisht sektori i energjisë. Po ashtu, edhe thuhet se do të rritet punësimi dhe do të rriten investimet private. Ne deri tash e kemi parë se privatizimi, por as investimet

në infrastrukturë nuk kanë gjeneruar punësim intensiv e as të qëndrueshëm, e lëre më rritje të tij. Përkundrazi, privatizimi i deritashëm ka rezultuar në humbje të mëdha të vendeve të punës dhe është një ndër shkaktarët më të mëdhenj të kësaj papunësie që e kemi. Përmes privatizimit, baza industriale prodhuese e Kosovës thuhet se u shkatërrua tërësisht, ndërkohë që sipas BSPK-së 60% të punëtorëve të ndërmarrjeve të Kosovës e kanë humbur vendin e punës, si pasojë e drejtpërdrejtë e privatizimit.

Investimet private të cilat Qeveria i planifikon të rriten për 165 milionë prej vitit 2011, në vitin 2012, janë me kundërshtim me realitetin, pra me atë se çfarë po ndodhë në të vërtetë, kur ne po shohim se ka rënie të investimeve në sektorin privat. Ato investime bazohen kryesisht në investime të pritura në Aeroport, kur tash Qeveria po na thotë përmes kornizës se do të investohen 150 milionë, e jo 100 milionë, siç thuhej kur nënshkruhej kontrata, dhe në investimet e mundshme në PTK pas privatizimit.

Edhe po të jetë kështu, këto investime nuk do t'i sjellin kurrfarë dobie ekonomisë së Kosovës për shkak se do të jenë investime të cilat as nuk e risinë punësimin, e as nuk e risinë prodhimin, duke pasur parasysh se çfarëdo që investohet, do të importohet nga jashtë. Edhe investimet në rrugë, e veçanërisht investimet në autostradën të cilën po e ndërton Bechteli, e kemi parë se jo vetëm që nuk e rrisin punësimin, jo vetëm që numri i të punësuarve në të është shumë i vogël, por edhe ata të punësuar aty paguhen me rroga shumë të vogla minimale dhe eksploatohen egërsisht nga një korporatë e cila nuk kontrollohet nga askush. Pra, investime të tilla dhe projekte të tilla ka të ngjarë që shumë më shumë ta dëmtojnë ekonominë e Kosovës, se sa t'i sjellin asaj dobi, pra që janë në kundërshtim me atë që thuhet në hyrje të Kornizës afatmesme të shpenzimeve se kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve do ta zhvillojë ekonominë e Kosovës dhe do ta zhvillojë shoqërinë e Kosovës.

Rritja ekonomike sipas kësaj kornize shihet se planifikohet të bazohet në masë të madhe në konsum të importuar nga jashtë. Të hyrat vazhdojnë të planifikojnë të na vinë nga importi, gjë që nënkupton se do të vazhdojnë me pasurimin e ekonomive të tjera dhe varfërimin e ekonomisë sonë përmes eksportit të parësë. Kjo dëshmohet edhe në projeksionin e Qeverisë për rritje të të hyrave dhe inflacionit, ku për bazë merren planifikimet e FMN-së për lëvizshmërinë e çmimeve në tregun ndërkombëtar, e jo të bazuara në një lëvizshmëri të mundshme të çmimeve të tregut ose të prodhimeve vendore që do të ndodhnin përbrenda tregut të Kosovës.

Thuhet po ashtu që do të luftohet ekonomia jo formale përmes incentivave, kur ne e dimë që deri tash disa incentiva i janë dhënë ekonomisë formale për t'u formalizuar dhe një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Pra, ekonomia formale nuk përmirësohet vetëm përmes incentivave, pa i forcuar edhe institucionet të cilat merren me zbatimin e ligjeve për sa i përket zbatimit të normave të tatimeve dhe kontributeve të tjera që aplikohen në Kosovë.

Korniza afatmesme e shpenzimeve shihet që bazohet në të dhëna apo në numra të cilat realisht nuk janë të vërteta. U përmendën këtu pra të hyrat apo financimi i jashtëm, që vazhdon të qëndrojë në këtë kornizë, te tabela në faqe numër 51, ku në vitin 2011 Qeveria

vazhdon të planifikojë se do të ketë financim nga institucionet ndërkombëtare financiare, si nga FMN-ja, Banka Botërore, Komisioni Evropian e të tjera, kur ne e dimë të gjithë tashmë dhe është bërë publike se këto para nuk do të vinë në vitin 2011. Pra, janë bërë projeksione për sa i përket qëndrueshmërisë fiskale të Kosovës, duke u bazuar në para të cilat nuk do t'i kemi, pra janë projeksione të cilat jo vetëm i shtrëngojnë planifikimet për vitin 2011, por i shtrëngojnë edhe planifikimet për vitet e ardhshme 2012, 2013, 2014 e të tjera. Këto, përveç që i shtrëngojnë planifikimet dhe projeksionet, e bëjnë edhe buxhetin e Kosovës, i cili aktualisht po zbatohet, si buxhet të jashtëligjshëm për shkak se kur është votuar nga ky Kuvend, ai buxhet është votuar me disa shifra dhe me disa numra, me disa para të hyra të cilat janë planifikuar të vinë, e që nuk do të vinë. Pra, buxheti i Kosovës përveç kontrabandimit të privatizimit të PTK-së, kontrabandoi edhe të hyra fiktive të cilat nuk do t'i kemi.

Prandaj, kjo Kornizë afatmesme e shpenzimeve, me qenë se nuk bazohet në realitet dhe me qenë se edhe po të bazohej në realitet, duket të jetë mjaftë e dëmshme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe ku planifikohet që të investohen më shumë ose të financohen më shumë ekonomitë jashtë vendit, se sa ekonomia e vendit, është një dokument i cili fatkeqësisht do t'i shkaktojë, nëse zbatohet, më shumë dëme Kosovës, se sa dobi Kosovës.

Pra, në këtë rast unë do ta them një fjali, e cila aplikohet vetëm në këtë rast. Shpresoj që në këtë rast Qeveria e Kosovës do të jetë ajo Qeveri që jemi mësua ta shohim, pra që nuk do ta zbatojë këtë dokument, në mënyrë që po të zbatohet një tjetër, atëherë ekonomia e Kosovës do t'i kishte punët më mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, ministër,

Kisha pas për të bërë një marrëveshje me ministrin sot unë, po flas për të marrë vesh populli, e ky duhet të flasë për të marrë vesh kolegët e vet ekonomistë se çka ka bërë me këtë dokument, ndoshta është më fer kështu, për shkak se kolegët e vet e kuptojnë pak më ndryshe.

Kisha dashtë t'ju them që një element që del përnjëherë në fillim të këtij dokumenti, është se pa i dënuar njerëzit fort, pa i shtrydhur si limonin, qysh ju thashë dje, nuk do të ketë as gjasa teorike të bëhet diçka që mundet as edhe për së afërmi t'iu përshtatet shifrave të cilat i shohim nëpër tabela dhe nëpër grafikone në këtë dokument.

Krejt çka bën ky dokument fillimisht ose jep dy opsione, që është gabim, fundi i fundit. Njëri opsion, po ju tregoj, është opsioni për FMN-në, i keni nga 4 opsione diku, por gjithmonë një me vi të trashë është për FMN-në, por ai është skenari më i keq i mundshëm, edhe duke e ditur kulturën e punës të kësaj Qeverie, këta kurrë nuk na prezantojnë neve skenarin më të keq të mundshëm, po atyre nuk kanë pasur qare pa ua shpjeguar, edhe i kanë qitur në letër, e kanë qitur në letër skenarin real, e kanë qitur në

letër edhe skenarin që duhet t'ia prezantojnë popullit për t'i qitur hi syve, edhe vazhdojmë të flasim në këtu me njëri me tjetrin. Shembull ta marrim, e keni te grafiku 2, në faqe 15, thotë - te skenari bazë i lëvizjes së bruto produktit vendorë GDP, në vitin e ardhshëm do të kemi rënie nga 5.5 në 5.1%. Ky është skenari bazë, ky skenar i paraqitet FMN-së, jo neve. Përderisa skenari tjetër që këta thonë se është reali, e rritë diku enorm shumë bruto produktin vendor. Edhe kjo tregon se Qeveria nuk është që nuk po e dinë çka po ndodhë, po e dinë saktë për atë që po bënë, për atë që po ndodhë.

Ulja e bruto produktit vendor në një vend me ekonomi kaq të vogël, në një vend i cili nuk ka politikë monetare, do të thotë recesion. Me siguri këtu ka njerëz që kanë për të mbërri për ta shpjeguar pak më në detaje, por po ju them edhe një herë, ulja bruto produktit vendor në një vend si Kosova, detyrimisht do të thotë recesion, e recesion ulje e prodhimit, do të thotë ngritje e varfërisë, e më vonë do të kaloj në disa pika dhe të tregoj se vetë në këtë dokument Qeveria tregon se në vitet që vinë varfëria në Kosovë do të rritet.

Kjo kornizë që keni para veti e parasheh që bilanci i përgjithshëm buxhetor nga minus 227 milionë, sa është aktualisht, do të thotë nga minus një çerekë miliardi euro, deri në vitin 2014 do të shkojë diku në minus 32 milionë, për të njëjtën kohë parasheh ulje të bruto produktit vendor. Edhe mund t'ju them që ministri duhet t'ju shpjegojë kolegëve të vet ekonomistë, qysh bën kështu, qysh bën të ulet rritja ekonomike efektivisht, e të zvogëlohet deficit, domethënë të mblidhen më shumë para, prapë po ju them ..., vetëm duke i shtrydhur njerëzit si limonin. Gjithë parametrat tregojnë se do të kemi rënie, e këta provojnë ta ulin deficitin, e në të njëjtën kohë duke i rritur shpenzimet buxhetore. Këtë duhet t'ua shpjegojë kolegëve të vetë ekonomistë, ministri.

Në faqe 38, Qeveria në këtë kornizë thotë kështu: “Ngritja e nivelit të çmimeve nuk ka ndikuar në uljen e kërkesës agregate”. Kjo është fjali që prapë e shpjegon kulturën mashtruese. Në vend të kësaj fjalie, Qeveria është dashur të thotë kështu, që “ngritja e pagave nuk ndikon në rritjen e konsumit”. E njëjta gjë është, do të thotë rritja e pagave që ka ndodhur nuk ka ndikuar në rritjen e konsumit, çka do të thotë është ekzakt ajo që tha parafolësja më herët, që edhe pse ka ndodhur rritje e pagave, nuk po rritet konsumi për shkak se inflacioni e ka mbytur rritjen e pagave dhe të njëjtën kohë kjo fjali më e saktë kish për të qenë përgjigje në një pyetje, e cila i është bërë Qeverisë, pyetje e cila thotë: A është i vërtetë konkludimi se ngritja e pagave ka shkaktuar ngritje të çmimeve dhe, si rrjedhojë, ulje të kërkesës agregate, e ulja e kërkesës agregate shkaktonte ulje të pagesave të taksave në doganë, e ulja e pagesave të taksave në doganë shkaktonte deficit, e ju suficit, qysh po e parashohin këta ta ulin deficitin.

Më tutje, kjo Qeveri në këtë dokument të vetin thotë kështu: “Rreziku i vetëm potencial për financimin e buxhetit mbetet pranimi i mbështetjes buxhetore nga donatorët dhe me vazhdimin”, po citoj: “me vazhdimin e procesit të ndarjes së aksioneve publike me sektorin privat”. Për këtë çështje kemi folur më herët. Këta në vend se të thonë të shiten ndërmarrjet publike, këta thonë të ndahen asetet prej sektorit publik në sektorin privat, domethënë e kanë këtë shprehje, e kanë bërë si klishe dhe nuk po mërzhiten prej saj, edhe pse po e dinë që krejt bota po di çka janë kah thonë, të shitet, po thonë. Tash në të njëjtën

kohë thotë që rreziku kryesor është mos marrja e donacioneve, e në të njëjtën kohë i kanë prishur marrëdhëniet me FMN-në, edhe po ju them që kjo ka ndodhur gjatë kësaj kohe për shkak se ky dokument që e keni para vetes nuk është përgatitur për një ditë, as për një javë po është përgatitur diku para 3 ose 4 muajve. Do të thotë, krejt tjetër send thonë, krejt tjetër send bëjnë, edhe ju thashë në fillim që janë të vetëdijshëm, nuk janë të pavetëdijshëm, mirëpo aq po ju bën se çka ka për të ndodhur me këtë vend edhe do ditë.

Tjetër, vetë Qeveria parasheh përkeqësim të bilancit tregtar të Kosovës. Shihni çka thotë Qeveria. Kjo parasheh që bilanci ynë tregtar nga minus 1 miliard 684 milionë euro sa është sot, domethënë ne më shumë importojmë se sa që eksportojmë, në vitin 2014 do të shkojë 2 miliard e 75 milionë euro. Do të thotë, ky bilanc ose bilanc negativ tregtar i Kosovës do të rritet, e në të njëjtën kohë, në faqen 82, kur flet Qeveria për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, thotë do të bëjmë çmos për ta rritur prodhimin vendor. Tani prapë ministri duhet t'ju shpjegojë kolegëve të vet ekonomistë, qysh bën të rritet enorm prodhimi vendor, e të rritet enorm edhe bilanci negativ tregtar. Nëse ne prodhojmë karrige, çka kemi nevojë të blejmë karrige. Domethënë, kjo Qeveri krejt tjetër send thotë prapë, krejt tjetër send bën.

Do të ndalem shumë pak te disa aspekte sektoriale, që dëshmojnë edhe një herë varfërimin e popullit të Kosovës.

Shihni, e keni diku në faqen 150, te Ministria e Shëndetësisë, ku thotë se shpenzimet operative të kësaj ministre do të mbesin të njëjta deri në vitin 2014. Kjo do të thotë që nuk do të rriten pagat, nuk do të rritet sasia e mjeteve e cila ndahet për barëra esenciale, as për preparate nëpër spitale, as për pastrim të spitaleve, kurgjë nuk do të rritet, absolutisht hiq. Ndërsa, shumë pak më herët, në faqe 49 të këtij dokumenti, Qeveri thotë që për çdo vit parashihet se Kosova do të ketë 33 mijë frymë më tepër, do të thotë popullsia e Kosovës do të rritet për 33 mijë banorë për çdo vit. Hiqja inflacionin, hiqja problemet financiare, hiqja tregjet ndërkombëtare, nëse Qeveria e ndanë një shumë të caktuar të mjeteve vit për vit, e popullata rritet, nuk do mend se kjo do të thotë që Qeveria vazhdimisht do të ndaj më pak e më pak për kokë banori për shëndetësi. Nëse ka parametër që saktë e dëshmon se çka e rritë varfërinë një vend, është parametri i shpenzimit që e bën Qeveria në sektorin publik të shëndetësisë, Qeveria shpenzon më pak, popullsia rritet, është varfërim.

Shkojmë te Ministria e Punëve të Jashtme, është interesant shumë. Edhe këtu shpenzimet operative mbesin të njëjta deri në vitin 2014, absolutisht të njëjta, kurgjë nuk ndryshon, edhe dikujt i shkon mendja, paramendoni, të na njohë Spanja neve, duhet ngarë vrap për të hapur ministrinë. Por këta, po më duket, nuk parashohin as njohje të reja. Qysh të parashohin njohjet e reja, domethënë e kanë bllokuar edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme. Bile më shkoj mendja, isha duke e parë në BAB.com, është Kompania e Aviacionit British Airlines, atje hala Prishtina ish Serbi, edhe në Ministrinë tonë të Jashtme, një shtet që na ka njohur, ndër të parët që na ka njohur, nuk i ka shkuar në mend dikujt t'i thërras e t'ju thotë, këqyr bre se Prishtina nuk është në Serbi, Prishtina është në Kosovë, se ne jemi shpallur shtet i pavarur dhe shteti juaj na ka njohur.

Te rrugët e reja, për shembull, në fillim të dokumentit Qeveri thotë se do të vazhdohet me ndërtimin e rrugëve të reja, por shihni çka thotë korniza nëpër tabela të veta, vetë i kanë shkrua, s'i kemi shkruar ne. Në vitin 2012 do të shpenzohet 8 milionë euro për rrugë të reja, 8 milionë. Po e abstrahojmë Bechtel & Enkën një ditë dhe autostradën Vërmicë – Arllatë, se për ato do të flasim të hënën me siguri. Domethënë, 8 milionë më 2012, 4 milionë më 2013, e keni në tabelë, në faqe 81, edhe 8 milionë më 2014, kaq do të shpenzoj Qeveria e Kosovës për rrugë të reja gjatë viteve që vinë dhe kjo është arsyeja pse ministri i rrugëve është këtu, çka ka për të bërë, s'ka buxhet, s'ka çka të bëjë, një rrugë është duke u mbaruar dhe natën e mirë.

Tash, në vitin 2013, të bëjmë një komparacion, në vitin 2013 buxheti i Zyrës së kryeministrit do të jetë 9.809.000 euro, do të thotë afërsisht 10 milionë euro buxheti i Zyrës së kryeministrit me 6 zëvendëskryeministra, një 600 këshilltarë, e për rrugë do të shpenzohen 4 milionë. Edhe duke pasur parasysh sa i kushton kilometri i rrugës Qeverisë sonë, do të bëhet një gjysmë kilometri rrugë, diku ku të vendosin këta, një gjysmë kilometri kanë për ta ndërtuar, një rrugë me siguri fenomenale me standarde evropiane, me drita që thyhen e me vija që fshihen për dy javë.

Definitivisht, për autostradën do të flasim të hënën, mirëpo vetëm një send ka dalë këtu. Kryeministri në këtë foltore ka thënë, autostrada do të kushtojë diku rreth 700 milionë euro, nëse i mbledhni shifrat në tabelën 3, faqe 81, do të ju dalë që kushton 804...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë!

ARDIAN GJINI: ... më pak milionë, shpejtë e shpejtë, po s'është me rëndësi, nuk është huqje e madhe ajo, se ka për t'ju dalë diku një 300 milionë më tepër. Fundi i fundit, po them edhe një herë, do të duhet kjo Qeveri para se t'i përfundojë të gjitha këto që i thash unë, t'i shpjegojë ministri i Financave për kolegët e vet ministra, të na thotë edhe diçka për reciprocitetin, se është shumë në modë reciprociteti këto ditë, ta shohim se çka ka për t'i sjell popullit të Kosovës. faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet angazhimin e Ministrisë së Financave për të hartuar Kornizën e re të shpenzimeve afatmesme, jo vetëm për shkak se është një obligim ligjor, por për shkak se në situatën të cilën ndodhet ekonomia e vendit, në situatën të cilën ne ndodhemi, një dokument konzisten mbi kornizën e shpenzimeve afatmesme, i cili do të riestablojë, do të rikthejë më mirë të themi, stabilitetin makroekonomik dhe fiskal në Kosovë, është më se i domosdoshëm.

Gjithashtu, Grupi ynë Parlamentar kërkon fuqishëm që Korniza e shpenzimeve afatmesme, si një dokument bazik mbi të cilin mbështeten politikat ekonomike, sidomos politika fiskale, duhet të rritë rejtingun e tij, duhet të rritë nivelin e përdorimit të tij të mirë në Qeverinë e Kosovës në dobi të përmirësimit të qeverisjes ekonomike dhe në dobi të krijimit të politikave konzistente makroekonomike dhe të evitimit të situatave të marrjes së vendimeve ad-hoc, gjë që mendoj se ky është një nga obligimet themelore të cilët duhet t'i ketë Qeveria, jo vetëm për faktin se kjo kërkohet edhe në raportet e progresit, e ne shqetësohemi tepër për raportet e progresit, por duhet të shqetësohemi shumë më tepër për nevojat që ne kemi që të prodhojmë një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe një stabilitet makroekonomik dhe fiskal, kështu që ne mendojmë dhe e mbështesim ministrinë që të vazhdojë aktivitetin në këtë dokument, për arsye se ky dokument duhet të ripunohet, këtë në një mënyrë e pohoit edhe dje ministri, duhet të ripunohet sepse në rend të parë duhet të ripunohet për shkak se kemi dy skenarë dhe, e dyta, pse janë çrregulluar deri diku marrëdhëniet në institucionet financiare ndërkombëtare me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Me këto dy momente të reja nuk mund të vazhdohet si me situatën paraprake qysh e kemi. Në këtë drejtim, unë mendoj që sado që e përshëndes edhe unë, po edhe grupi ynë parlamentar që të kemi më shumë skenarë, edhe të kemi më shumë variante, gjithmonë për të marrë vendime të mira duhet shqyrtuar më shumë variante, nuk është e zakonshme që kornizat e shpenzimeve të mbështeten në dy skenarë, në dy mundësi.

Prandaj, ne e mbështesim ministrinë që të ripunojë këtë dokument dhe të krijojë një skenarë në bazë të këtyre dy skenarëve, ku njëri është më pesimistë, tjetri thuhet më optimist, por duhet të prodhohet një skenar dhe mbi të mbështeten dhe të krijohen politikat. Natyrisht që mund të ekzistojë diku një rezervë, një skenar për situata të vështira, por ne duhet të kemi një skenar mbi të cilin do të punojmë dhe do t'i mbështetim aktivitetet tona të cilat do të prodhojnë një rritje ekonomike së paku 7%. Kosovës kjo i duhet dhe ne kërkojmë këtë prej Qeverisë. Ne kërkojmë një dokument, të silltet një dokument në Kuvend, një dokument konsistent, i cili duhet të prodhojë atë rritje ekonomike.

Sa u përket këtyre skenarëve që janë këtu, njeri është, kuptohet, skenar i Ministrisë së Financave, i harmonizuar deri diku me Fondin Monetar Ndërkombëtar, dhe skenari i cili ka dalë, domethënë, gjatë punës së ekspertëve të Qeverisë dhe të tjerëve në prodhimin e vizionit të Qeverisë. Ku ndryshojnë këta dy skenarë? Përpos në rritjen ekonomike, domethënë, që i pari prodhon një rritje mesatarisht mbi 5%, tjetri prodhon rritje ekonomike diçka mbi 7%. Por, nëse i shihni bilancet, aty shohim se do të kemi një konsum, kuptohet më të madh në qoftë se realizohet skenari, edhe do të kemi investime private, por çka do të gjenerojë në këtë konsum dhe në këtë rritje ekonomike, çka qëndron mbrapa këtyre, janë investimet private, gjë që natyrisht ne kemi kërkuar që rritja ekonomike të mbështetet në investime private dhe ne do të mbështesim këtë orientim. Mirëpo, nëse e shihni diferencën e investimeve private mes skenarit, të them ashtu, pesimist dhe skenarit optimist, është 644 milionë për këto tri vjet më shumë në skenarin optimist. Ndërsa, rritja ekonomike është diferenca prej 5 në 7%. Për ta prodhuar këtë rritje ekonomike, për ta ngritur këtë rritje ekonomike prej 5 diku 7%, me këtë diferencë domethënë, me këtë diferencë në investime private, atëherë duhet të bëhet një kthesë tejet

e madhe në mirëqeverisje dhe në efektivitetin dhe eficiencën e investimeve. Domethënë, nëse e fusim në një model, po them, mos të hyj tash në teori, por po të futeshim në një model thjeshtë ekonomik apo ekonometrik, do të na dilte se duhet të ngrihet dhe të përmirësohet qeverisja dhe efektiviteti diku 70%. Natyrisht që kjo nuk është e pamundur, por kjo nuk shihet në dokument. Ne duhet ta shohim në dokument të përpunuar detajisht, në mënyrë që të monitorojmë aktivitetin e Qeverisë, i cili aktivitet duhet të na sjellë deri te kjo rritje 7% e cila është e domosdoshme për ekonominë e Kosovës. Ajo që shohim ne, që e shohim në dokument dhe e shohim këtu, mendohet që do të zvogëlohen licencat 50% edhe kjo do të krijojë një mjedis dhe do të vinë investimet. Mund të vinë pak më shumë investime, por në qoftë se nuk përmirësohet qeverisja në përgjithësi e menaxhimit të investimeve, prapë ne nuk do ta kemi rritjen 7%, domethënë po e theksoj, duhet të rritet efektiviteti ose efienca e investimeve 70%.

Mu për këtë, unë mendoj se ishte i drejtë edhe ai propozimi që ne duhet të punojmë shumë në imazh, duhet të punojmë shumë jo vetëm te licencat, licencat janë problem dhe duhet të mbështetim atë aktivitet edhe në nivel qendror, edhe në nivel lokal, sepse është një veprim në drejtimin e duhur, por imazhi është shumë me rëndësi. Bashkë me imazhin janë zbatimi i kontratave. Ne duhet çdo afaristi, çdo kontratë që lidhet në Kosovë, qoftë me kosovarëve, qoftë me investitorë të jashtëm, duhet të garantojmë se ajo kontratë do të zbatohet dhe do të trajtohet në gjyq në mënyrë fer dhe në mënyrë efektive. Ne deri sot këtë nuk mund ta bëjmë dhe ne duhet të kërkojmë që kjo të ndodhë, përndryshe nuk ka shumë investime, nuk do të ketë shumë investime. Ne po e shohim, edhe interesi për objekte aq atraktive, siç është Telekomu edhe disa të tjera, nuk është ai që duhet, do të duhej të pritej, mu për shkak të imazhit edhe problemeve me gjyqësi, problemeve me zbatim të ligjit, problemeve të luftimit të korrupsionit e të ngjashme për të cilat kemi folur disa herë.

Pra, ne do të kërkojmë që Qeveria, siç tha edhe ministri dje, gjatë korrikut dhe gushtit të punojë në këto çështje, të cilat sot po i theksojmë, dhe para buxhetit të ri kur do ta diskutojmë, ta kemi dokumentin konzistent, i cili me të vërtetë do të na siguroj një rritje të tillë dhe ne mund ta mbajmë Qeverinë për fjale, sepse nuk mund të kemi një dokument prapë që e aprovon Qeveria ose ne, ku i kemi 5% ose 7%. Ministri tha dje që në qoftë se realizohet diçka prej 7%, ne e marrim e fusim në skenar. Kjo është në rregull, por ajo që realizohet, ajo futet në raport, jo në skenar. Ne duam ta shohim në skenar, në politikë, në një zotim të Qeverisë, në një obligim të Qeverisë që ne do ta mbajmë përgjegjëse Qeverinë që ta zbatojë atë, edhe atë, edhe marrëdhëniet me fondin. Në këtë drejtim, pra, duhet të mbështesim, na pret një punë, e pret Qeverinë sidomos një punë e madhe që të na sjellë një dokument, i cili do të na bind se ne mund të arrijmë ato synime të rritjes ekonomike 7%, që janë më se të domosdoshme.

Për lidhje me marrëdhëniet e reja, situatën e re me FMN, u fol, unë nuk dëshiroj ta përsëris, por besoj se kjo duhet të reflektohet në dokument edhe në tekst, edhe në... Teksti i Kornizës së shpenzimeve afatmesme që aprovohet një muaj gati mbas situatës që ka ndodhur me FMN-në, me asnjë fjali nuk e përmend këtë situatë. Ne duhet të shohim çfarë është situata dhe si mendon Qeveria të rikuperojë këtë. Ajo që unë mendoj se duhet të punojmë si Qeveri dhe si Kuvend, është që të ngrehim cilësinë e marrjes së vendimeve

makroekonomike, cilësinë e qeverisjes makroekonomike. Ne na duhen statistika më të mira, na duhen analiza më të mira, na duhen procedura më të mira të vendimmarrjes në qeverisjen ekonomike. Këtë unë nuk po shoh sa duhet përpjekje në këtë drejtim dhe unë kisha inkurajuar edhe ministrin, edhe ministrinë edhe krejt që kësaj çështje t'i kushtojnë kujdes, sepse vetë fakti që na vjen një dokument neve me dy skenarë, tregon se diçka me procedura, diçka me përgatitje, diçka me angazhime duhet të ndryshohet dhe duhet të ndodhë diçka e re. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të SLS-së, deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke, podržava ministra i Ministarstvo o Nacrtu predloga srednjoročnog okvira troškova, sa napomenom da se mora još dosta doraditi, kao što su i ostale kolege napomenuli. Ali kao predlog trebamo dati mogućnost za dalju doradu i tako omogućiti da Vlada donese jedan dobar dokumenat. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “6+”, deputeti Fikret Damka, e ka fjalën.

FIKRET DAMKA: Sayın Meclis Başkanı, değerli Bakanlar ve milletevkilleri.

Hükümetin 2012-2014 yılları arası hazırlamış olduğu norta vadeli harama çerçevesini dikkatlice incelediğimizi ve bu yıllar aarsı bir artının olduğunu gördük.

Bu çerçevede özellikle makroekonominin denge sağlanması ve işsizliğin azaltılmasına yönelik yapılan planlamanın doğru olduğunu, tarıma, eğitime ve özel sektörüne yatırım yapabilmesi için ortamın ahzırlanamsı, enerji sektöründeki sorunun kalıcı çözüme kavuşturulması gibi biraçok planlamanın doğru yapıldığını ve yıllar içerisinde bu çerçevede öngörüldüğünü görmek bizi memnun etmektedir.

Diğer yandan tüm bu harcamaların sadece gümrük verielri ile karşılanamsı sorun teşkil etmektedir. Kosova sadece ithal eden ülke olmamalı, aynı zamanda ihracat yapan ülke olmalı, bunun için üretim yapabilen ve yapmayı planlayan özel sektöre önem önem veremliyiz. Özel sektörü teşvik etmeliyiz, vergileri hammadede düşürmeliyiz, üretim vergilerini azatmalıyız.

Genel anlamda öngörülen yüzde 7'lik bu büyüme Kosova için memnun edicidir ve bu çerçevede kalınacağını umut ederek 6+ Parlamenter Grubu adına deskelemektedir. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit!

Shefat e grupeve parlamentare e kryen. Ministri e ka kërkuar fjalën. Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAZMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Fillimisht, më lejoni t'i falënderoj të gjithë deputetët që në emër të grupeve parlamentare me diskutimet e tyre kontribuan rreth këtij dokumenti, i vlerësoj shumë kritikën, mirëpo me më kënaqësi i kisha vlerësuar alternativën, që realisht pak, po kenë të pakta edhe propozimet, pjesa dërmuese ke e fokusuar në kritikë, që megjithatë i mirëpres.

Edhe dje e theksova që Korniza afatmesme e shpenzimeve është një dokument i cili jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha vendet tjera rifreskohet dhe rishikohet. Ky dokument të cilin ju sot e keni para veti, ka qenë obligim i yni ligjor që ne ta përgatisim dhe ta procedojmë në Kuvend deri më datën 30 prill, obligim ligjor. Ne e kemi kryer këtë obligim ligjor, e kemi përmbushur këtë afat ligjor. Ngjarje të cilat janë zhvilluar pas përfundimit të këtij dokumenti, siç është edhe relacioni me Fondin Monetar Ndërkombëtar, misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar ka qëndruar në Kosovë nga data 17 deri më 30 maj dhe këto nuk kanë mundur të reflektohen në këtë dokument, këto do të jenë pjesë e dokumentit të rishikuar që ne planifikojmë ta bëjmë gjatë muajit korrik dhe gusht.

U tha kriza ekonomike. Asnjë nga ne këtu nuk thotë që Kosova i ka punët mirë ekonomikisht, e kemi papunësinë, e kemi varfërinë, e kemi deficitin e lartë tregtar, mirëpo asnjë këtu nga ne nuk e mohojmë që Kosova për vitin 2010 vlerësohet që ka pasur një rritje ekonomike prej 4%, për herë të parë, edhe pse në mënyrë shumë simbolike, duke iu referuar Raportit të progresit ka arritur që ata që hyjnë në tregun e punës, t'i absorbojë tregu i punës, Kosova ka arritur që ta përmbush planin e të hyrave 100% dhe Kosova për herë të parë ka arritur që ta ketë ekzekutimin e buxhetit prej 95%.

U përmend ngritja e tatimeve dhe akcizave. Ju lutem, kur të flasim për ngritje të tatimeve dhe akcizave, të flasim në mënyrë specifike. Cili tatim, cila normë e tatimit është ngritur. Unë e them që asnjë normë e tatimit gjatë vitit 2011 nuk është ngritur. Paratë e humbura, nuk dua as qytetarë, as deputetë, sa i përket humbjes apo mos humbjes së parave, që ta marrin fjalën time. Le të bisedojnë me Komisionin Evropian, le të bisedojnë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, le të bisedojnë me Bankën Botërore. Thuhet se Kosova nuk ka marrëveshje me FMN-në dhe mbas dy fjalive kthehet se Kosova ka një marrëveshje me FMN-në. Kosova ka pasur një marrëveshje me FMN-në që u thirr Stend-by arazhman, i kam shpjeguar arsyet cilat kanë qua deri te situata dhe Kosova e ka një marrëveshje që quhet program i monitoruar nga stafi, i cili i ka kushtet e veta, nuk janë të lehta, po janë të mundshme për t'u implementuar. Implementimi i suksesshëm i kësaj marrëveshje, rishikimi i parë pozitiv i kësaj marrëveshje i hap mundësinë Kosovës që 20 milionë euro të premtuara nga Banka Botërore, që janë pjesë e këtij buxheti, të derdhen në fundin e këtij vitit. Implementimi i plotë dhe i suksesshëm i kësaj marrëveshje, që prapë po e them - nuk është e lehtë, i hap Kosovës rrugë për një marrëveshje të re me Fondin Monetar Ndërkombëtar në fillim të vitit të ardhshëm, që i jep Kosovës mundësi për të pasur qasje në kreditë e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe në paratë e premtuara nga Komisioni Evropian.

Anëtarësimi në institucionet financiare ndërkombëtare. Asnjërin prej nesh këtu nuk nga gëzon fakti nëse na vijnë në situatë që nuk mundemi të anëtarësohemi. U dua t'ju informoj, deputetë të nderuar, që Kosova është duke punuar dhe është shumë më afër anëtarësimit në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Jemi afër, shpresojmë që brenda këtij vitit, duke punuar të gjithë bashkarisht do të arrijmë që ne të jemi anëtar të këtij institucioni shumë të rëndësishëm.

Tregjet financiare. Ne presim që deri kah fundi i vitit, eventualisht fillimi i vitit të ardhshëm të fillojmë me emitimin e bonove të Thesarit. Ka institucione financiare në Kosovë, banka që janë të interesuara që sa më shpejt të zhvillohet ky treg.

Përkrahje për kategoritë e dala nga lufta. Këto janë taksa të taksapaguesve të Kosovës, nuk janë taksat e asnjë subjekti politik, nuk janë taksa dhe para të asnjë institucioni, por janë taksa të taksapaguesve. Mirëpo, për hir të korrektësisë rritja për kategoritë e dala nga lufta, për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës kanë ndodhur. Pjesë e këtij projekcioni, është edhe kostoja për mbulimin e Ligjit për kategoritë e dala nga lufta, Ligjin e pensioneve dhe Ligjin e punës.

Pagat. E kuptoj që inflacioni e varfëron xhepin e qytetarëve, të gjithë e kuptojmë, mirëpo nuk mund të amortizohet rritja e pagave në përqindjen e cila ka ndodhur me mesataren e inflacionit, e cila është duke ndodhur, sepse mesatarja e inflacionit për këtë periudhë të vitit, ka qenë rreth 10%, ndërsa periudhën e ardhshme dhe trendët aktuale duke i përfshirë majtë e fundit, inflacioni është në rënie.

U përmend çështja e investimeve dhe thanë se investimet nuk gjenerojnë punësim, ndërsa shumë shpejtë u tha që, ata që punojnë i kanë pagat shumë të ulëta, nëse nuk gjeneron punësim, nuk mund të flasim për paga fare. Prandaj nuk shkojnë këto dy gjëra lidhur edhe me pas investime edhe mos me reflektuar në punësim. Ne mund ta diskutojmë a e ka pasur efektin e duhur dhe a janë realizuar pritjet e duhura, por nuk mund t'i shkëputim këto dy gjëra mes veti.

Sa i përket, edhe një herë po e them projeksioneve që kanë pasur të bëjnë me të hyrat nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, sigurisht se këto do të reflektohen në dokumentin e rishikuar.

Nuk kam nevojë unë t'ua shpjegoj kolegëve të mi ekonomistë projeksionet, sepse ata e dinë. Në këtë dokument, nuk ka punuar ministri i Financave vetëm. Në këtë dokument kanë punuar profesionistët të cilët kanë përgatitje, kanë përvojë dhe janë numër i madh i tyre, prandaj unë dua t' i përgëzoj për punën e tyre, ndërsa sa i përket politikave, është përgjegjësi e jona.

Nuk mund të flasim për rritje ekonomike 5% edhe të njëjtën kohë për recesion. Ne mund të flasim se rritja ekonomike është e mjaftueshme 5% apo Kosovës i duhet rritje ekonomike minimumi 7%, që të mund të ketë efekte pozitive, mirëpo të flasim për rritje ekonomike prej 5% edhe të njëjtën kohë të themi që Kosova është në recesion, profesionalisht është vështirë për ta arsyetuar. Nuk mund të flasim për ulje të hyrave në

doganë. Ne e dimë që dogana dhe Administrata Tatimore për periudhën deri në qershor, ka pasur një ngritje prej 18%, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ne mund ta diskutojmë ndryshimin e raportit të hyrave nga të hyrat në kufi të kalojmë në mbledhjen e tyre në brendi, por nuk mund të flasim që situata aktuale ka ndikuar që ne të kemi zvogëlim të hyrave në dogana dhe në Administratën Tatimore, kur të dhënat zyrtare flasin diçka tjetër.

Bilanci tregtar. Kosova ka bilanc tregtar të pafavorshëm, ka deficit të bilancit tregtar. Dhe, nëse themi që bilanci tregtar rritet në shifër absolute, nuk do të thotë kjo që kur e krahasojmë bilancin tregtar në raport me GDP-n, dhe e shohim që në vitin 2008, bilancin tregtar në raport me GDP-n ka qenë rreth 43%, tash është rreth 40%, shumë është lart, të gjithë po pajtohemi, po ka një trend negativ, domethënë kemi një rritje të eksporteve në krahasim me importet.

Rritja e varfërisë. Kosova varfërinë e ka trashëguar. Ne nuk po themi se jemi në gjendje të mirë. Nuk po dua të jem subjektiv, por ju lutem referojuni raporteve të fundit të institucioneve ndërkombëtare ku flet për rënien e varfërisë ekstreme dhe të varfërisë. Prapë është mjaft e lartë edhe është shumë e lartë.

Çmimi i autostradës në buxhet. Çmimi i autostradës është i paraqitur duke përfshirë ndërtimin e këtij projekti, duke përfshirë shpronësimin dhe normalisht edhe mbikëqyrjen. Kur jemi te çështja e shpronësimit, unë e them që ky është një vlerësim, ende vlerësimi nuk ka përfunduar dhe me rastin e përfundimit të vlerësimit, mund të devijojë nga kjo që është paraqitur në buxhetin e Kosovës, sepse pronat, sidomos në pjesën rreth Prishtinës, ende nuk janë vlerësuar dhe kanë një çmimi tjetër në raport me atë që është atje. Dhe, krejt në fund, duke i vlerësuar shumë pozitive të gjitha kritikën që u ngritën, duke i mirëpritur shumë alternativat ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, vazhdojeni edhe pak...!

MINISTRI BEDRI HAMZA:... unë do të vazhdoj t'i marrë me kujdes të gjitha këto që ngritën dhe do t'i reflektojmë në dokumentin e rishikuar, të cilin planifikojmë ta bëjmë gjatë korrikut dhe gushtit dhe ky dokument t'i paraprijë buxhetit të vitit 2012 dhe buxheteve të viteve të ardhshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Visar Ymeri, replikë, dhe Ardian Gjini. Nga dy minuta i keni.

VISAR YMERI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues!

Për sa i përket rritjes së punësimit, ministër, i shtrembërova fjalët që i thashë unë, ndoshta nuk ke dëgjuar me vëmendje. Unë nuk thashë që investimet nuk sjellin punësim dhe kjo është natyrisht e palogjikshme. Unë thashë që këto investime për të cilat keni treguar ju se do të ketë investime, pra investimet në Aeroport dhe investimet e

mundshme në PTK, nuk do të gjenerojnë punësim aq të madh sa të ndikojë në punësimin e gjithmbarshëm. Pra, siç është dëshmuar që autostrada, kontrata me Bechtel & Enka, natyrisht që i ka punësuar 2000 e diçka punëtorë, mirëpo edhe ata që i ka punësuar, i kanë rrogat shumë të vogla, a në shkallën e gjithmbarshme të papunësisë kjo nuk ka luajtur kurrfarë roli, për shkak se dimë që efektet anësore, ato që i thonë anglisht eksteen enele, se ti sigurisht e di çka janë, është që një pjesë e madhe e punëtorëve tash rrezikojnë ta humbin vendin punës, për shkak se kompanitë vendore që merren me ndërtimin e rrugëve, kanë mbetur pa punë. Pra, më shumë është shkaktuar papunësi se sa që është rritur punësimi me një kontratë- projekt.

Për sa i përket rritjes ekonomike, vetëm desha diçka të shtoj këtu që e përmendët ju, rritja ekonomike në Kosovë, edhe nëse është 5%, domethënë ta dimë se çfarë cilësie ka ajo rritje ekonomike. Domethënë çka po ndikon në atë rritje ekonomike? Ju vetë e keni thënë në kornizën tuaj afatmesme të shpenzimeve se rritja ekonomike përgjatë viteve 20012 edhe 2013, do të bazohet kryesisht në konsum. Pra, kjo nënkupton se nuk do të kemi rritje të aseteve produktive, fikse, të cilat do të jenë vendore, pra nuk do të ketë rritje të prodhimit, nuk do të ketë rritje fabrikave të Kosovës edhe rritje të punësimit, po do të ketë rritje të qarkullimit, të kapitalit edhe mallrave të huaja nëpër territor të Kosovës, për përfitimin e vendeve të origjinës prej nga vjen kapital dhe mallra. Pra do ta kemi të vazhduar dhe të rritur avazin e njëjtë me të cilin po ballafaqohemi edhe tash kur Kosova, përveç sheh para duke u endur nëpër këtë territor, nuk sheh kurrfarë rritje tjetër ekonomike e aq më pak rritje të cilësisë së jetës së qytetarit. Ju faleminderit

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar! Shumë shkurt. Prapë kishte shtrembërim të fjalëve se në Kosovë ka rritje prej 5%, nuk thashë unë, por po thotë ministri. Unë thashë se sipas dokumentit të ministrit që e ka prodhuar vetë dhe e ka sjellë vetë para nesh, se ky e nënshkruan e jo ata ekspertët që punojnë, bruto produkti vendor në vitin 2012 parashihet të bie nga 5.4 në 5. Dhe unë thashë me 33 mijë frymë të reja, nuk mund të ketë rritje ekonomike, nëse bruto produkti vendor bie edhe ky duhet të na shpjegoj se ndoshta di më mirë.

Te doganat, definitivisht se do të ketë rënie për shkak se janë duke i plaçkitur bizneset në doganë, po iu marrin para më shumë se sa që duhet edhe në fund të vitit, duhet për t'ua kthyer. Me ligj janë të obliguar.

Fjalë tjetër që është jashtëzakonisht irituese është trashëgimi i varfërisë. Ne atë e dimë dhe nuk kemi nevojë të tregojmë përralla këtu, por Qeveria ekziston për ta ulur varfërinë e jo të na thotë e kemi trashëguar varfërinë. Çka domethënë kjo e kemi trashëguar varfërinë? Çfarë shpjegimi është ky?

Te autostrada po e ndajnë copa- copa. Unë thashë sa kushton, çka është me rëndësi a i qoni disa për ta paguar kontraktin e disa për të eksproprijuar, e disa, janë shpenzime,

ne po i paguajmë, çka ka lidhje? Çka po i ndanë ashtu? Edhe fundi i fundit qa janë ofiçiente 800 milionë ero për 3000 vende të punës, shpjegoja dikujt? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! A po doni tani t'iu përgjigjeni. Në rregull.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit!

Prapë do të thotë rritja ekonomike, nëse e shikojmë me kujdes kornizën afatmesme të shpenzimeve, nuk i referohet veç konsumit. Konsumi është një nga elementet që ndikon në rritjen ekonomike, por janë edhe investimet edhe eksportet.

Është fjalë paksa e rëndë edhe unë gjithnjë e di që ka mundësi gjithmonë të thuhet ajo çka mendohet, por të thuhet me fjalë pak të zgjedhura se është lëndim edhe mos të them ofendim për Doganën, si institucion shumë i rëndësishëm i këtij vendi, të thuhet se po i plaçkit bizneset. Nuk mund t'i marrë kurrkush kurrkujt më tepër se sa që e obligon ligji. Edhe nëse dikush i ka marrë dikujt më tepër se sa që e obligon ligji, atëherë ka bërë shkelje të ligjit dhe duhet të përgjigjet. Prandaj, besoj që ne duhet të jemi të kujdesshëm në zgjedhjen e fjalorit kur të flasim për institucionet tona.

Sa i përket varfërisë, është shumë e vërtetë që e thashë që në Kosovë varfëria ekziston edhe nga e kaluara, mirëpo është inkurajuese, është mirë nuk është e mjaftueshme që ka filluar të ndalet ai trendi i varfërisë edhe të ketë progres në këtë drejtim. Këto ishin sqarimet e mia. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Replikë ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: E falënderoj shumë ministrin. Me të vërtetë është pak problem për ta mbrojtur një dokument i cili vë kornizat dhe kufijtë për shpenzimet, investimet dhe të hyrat për tri vjetët e ardhshëm, për t'iu mbrojtur prej një ministri, se ky dokument është bërë prej një numri supozoj më të madh të njerëzve siç e pandehu më herët edhe ministri.

Sa i përket Fondit Monetar Ndërkombëtar, një marrëveshje është prishur marrëveshja stand by është prishur, nuk është ajo më. Në pikën 8, të deklaratës përfundimtare të publikuar në ueb faqen e Fondit Monetar Ndërkombëtar, me datën 30 maj thuhet: "Marrëveshja stand by është prishur edhe thuhet pikërisht për shkak të rritjes së pagave dhe nuk ka pasur harmonizime". Marrëveshja që jemi tash, është marrëveshje e re. Ne këtë e shohim si degradim nga pozita e përfituesit në pozitën e të monitoruarit.

E dyta, donacionet kanë humbur. Kreditë, nëse kthehemi në pozitën e përfituesit në vitin 2012, ne mund t'i marrim këto kredi, por nuk i marrim kreditë që kemi mundur t'iu marrim për vitin 2011, por i marrim kreditë që do të kishim mund t'iu marrim për vitin 2012, edhe po t'iu kishim marrë ato për vitin 2011.

Sa u përket tatimeve, unë e paraqita si mundësi që Qeveria për t'iu plotësuar këto 157 milionë euro, ndoshta do t'iu rritë tatimet. Ne kemi rritur dy ditë përpara në

Komisionin për Buxhet dhe Financa, kemi rritur akcizën në veturat e importuara, duke e shndërruar Kosovën në një varrezë për makinat të cilat dalin nga përdorimi në vendet e Bashkësisë Evropiane dhe vendet e tjera të zhvilluara. Edhe diçka tjetër, sa u përket alternativave, ne nuk jemi këtu ta bëjmë kornizën, sepse ju keni fituar zgjedhjet qysh i keni fituar dhe duhet të na sillni dokumente, ne i diskutojmë. Ajo, që ne e kërkojmë prej Qeverisë, është të vijë një dokument real, siç e thashë edhe më herët në baza reale, i cili bazohet në të hyra reale e jo fiktive...

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kundër replikë, ministri.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja Bajrami!

Marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar, nuk i ka dokumentet veç një pikë dhe pikën 8, është pika 8, por janë edhe një 20 pika tjera. Dhe, kur të flasim për një dokument, nuk është mirë të flasim në mënyrë të segmentuar. Është mirë të flasim edhe për pikat 9, 10, 11 edhe pikën 26. Prandaj, mos të bëjmë përpjekje, të flasim në mënyrë të segmentuar dhe të shkëputim veç diçka çka është negative. Prandaj, ju lutem, referojuni edhe komunikatës edhe dokumenteve tjera të Fondit Monetar Ndërkombëtar, jo ato çka po i themi ne.

Sa i përket çështjes së fondeve dhe kredive, ne duhet të kemi të qartë që

Kosova ka të drejtë që deri në 40% mbi bazën e Ligjit për huazime, të ketë borxhin publik dhe çdo para, duhet ta këqyrim edhe kualitetin e asaj kredie se ku mund ta investosh që e merr, ta rritë nivelin e borxhit publik dhe ta zvogëlon këtë pjesën tjetër që mund ta përdorë për kredi investive. Ndërsa, sa i përket donacioneve, sot në takimet që kam pasur me ambasadorët e vendeve që i kanë ambasadorët e tyre në Kosovë, përfaqësuesit e Bankës Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, përfaqësuesi i Komisionit Evropian, deklaroi që, nëse Kosova është në marrëveshje të re me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe e respekton këtë marrëveshje, Komisioni Evropian, do të vazhdojë t'ia japë përkrahjen direkte buxhetore. Dhe sa i përket çështjes së makinave, e kam shpjeguar dhe po ri përsëris sot. Ma thoni një vend në Evropë që e ka homologimin dhe kufizimin e vjetërsisë. Ka pasur ngritje të akcizave sidomos për veturat që e kanë vjetërsinë më të madhe, mirëpo në të njëjtën kohë, është stimuluar edhe blerja e veturave të reja dhe veturat me kilometrazh zero, zero, akciza është zero, domethënë ka pasur në të njëjtën kohë edhe zvogëlim të normës së akcizës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Blerim Shala e ka fjalën.

BLERIM SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Dokumenti për të cilën ne sot po flasim, pra korniza afatmesme e shpenzimeve, në fakt është një dokument strategjik për ekonominë, gjegjësisht për drejtimin që do ta marrë ekonomia e Kosovës, ndërsa në bazë të zhvillimeve ekonomike, mund të supozojmë dhe çfarë zhvillime politike do të ketë në vend.

Natyrisht, si dokumenti i tillë synon të ofrojë garanci që do të ketë zhvillim ekonomik stabil, që do të ketë rritje të punësimit apo ulje të papunësisë, që do të ketë një stabilitet social apo do të arrijë mirëqenien sociale. Asnjëri prej këtyre synimeve, nëse lexohet me kujdes, ky dokument nuk garantohej. Në fakt edhe ministri në fjalën e tij të djeshme, në një mënyrë e bëri një distancim të lehtë duke thënë se do të ketë rishikim të këtij dokumenti në korrik. Sot e ritheksoi këtë duke thënë që do të merren parasysh edhe zhvillimet që kanë ndodhur gjatë muajit maj me Fondin Monetar Ndërkombëtar, por siç thanë edhe disa kolegë, më parë një kornizë afatmesme e shpenzimeve çfarë na është prezantuar neve këtu, nuk mund të ndërtohet mbi dy opsione, mbi atë opsionin bazik të negociuar të marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe opsionin e dytë i cili është i ndërtuar mbi të ashtuquajturin vizion për zhvillim ekonomik, i cili në fakt nuk përkthehet si duhet në fakte të cilat do të garantonin këtë zhvillim ekonomik.

Së pari, sa i përket rritjes ekonomike, e dini që, në dokumentin që po e shqyrtojmë, është versioni i cili është klasifikuar siç thashë më parë si vizion i zhvillimit ekonomik, ku flitet për një zhvillim prej 7 deri në 8% dhe, nëse i trajtoni synimet për të arritur këtë zhvillim ekonomik në faqet 19 e 20, shihni që ka dallime thelbësore dhe që objektivisht kjo është një listë dëshirash e jo një mundësi reale për të pasur zhvillim ekonomik. Zhvillimi ekonomik, prapë në thelb bazohet në ndërtimin e një autostrade, në autostradën kah Shkupi e cila do t'i sillte 600 milionë euro para në qarkullimin e Kosovës, ndërsa objektivisht e dimë që ky si projekt është goxha joreal. Po ashtu, përmenden që për çdo vit prej vitit 2013 do të ndërtohen nga 100 megavat të rrymës në kuadër të projektit “Kosova e Re”, që do të thotë që objektivisht me këtë dinamikë, ne nuk do të kemi 700 megavat deri në vitin 2019 apo 2020, që është mjaft depresive për konsumatorët e Kosovës.

Po së treti përmendet që ky zhvillim ekonomik do të ndërtohet, siç thuhet, në një rritje të ndjeshme të eksportit të Kosovës dhe një rënie të ndjeshme të importeve në Kosovë. Këto pohime janë në kundërshtim të plotë me tabelën në faqen 20, ku kur të krahasohen skenari bazë i marrëveshjes me FMN-n dhe skenari i cili ka të bëjë me vizionin e zhvillimit ekonomik, del përkundrazi që do të ketë rritje të importit në vitet në fjalë e jo ulje të ndjeshme të importit, për më shumë, natyrisht për shkak të rritjes së importit, do të ketë edhe rritjes të doganës. Pra, kemi një kundërthënie brenda dy faqeve, kemi kundërthënie të cilat tregojnë që vetë Qeveria dhe vetë Ministria nuk e ka që qartë në fakt se si do ta mbërrijë zhvillimin ekonomik prej 7 deri në 8%.

Tema e dytë shumë e rëndësishme, normalisht për të gjithë neve është ulja e papunësisë. Qeveria e Kosovës dhe ministri, në dokumentin që po e shqyrtojmë pohojnë se do të ketë një ulje të ndjeshme vjetore prej 8 deri 10% të papunësisë. Kjo ulje e papunësisë, nëse e shihni synohet të arrihet përmes trajtimit të një fusnote. Në fusnotën e faqes ku flitet për papunësi, pohohet se në Kosovë janë të regjistruar 330 mijë të papunë. Me siguri është ashtu, por objektivisht shkalla e papunësisë është shumë më e lartë dhe ne e dimë sipas raporteve të Bankës Botërore, që vetëm 1 prej 4 të aftëve për punë në Kosovë, është i punësuar. Pra shkalla është shumë më e lartë se sa ajo që paraqitet në këtë dokument. Por le të supozojmë që është vetëm kjo shkallë e papunësisë, që vetëm 330

mijë janë të papunë. Nëse themi se do të ulët papunësia për 8- 10%, kjo do të thotë se ne do të krijojmë diku për çdo vit 25.000 deri në 30.000 vende të reja të punës. Por, njëkohësisht u përmend edhe prej kolegëve të mi, ne e dimë që objektivisht për çdo vit në tregun e punës, me moshën madhore, hyjnë diku midis 25.000 deri 28.000 vetë. Do të thotë që për ta realizuar këtë synim të Qeverisë së Kosovës, ne jo që duhet të krijojmë diku 80.000 vende të reja pune, por objektivisht duhet të krijojmë rreth 50.000 vende të punës që ta kemi uljen reale të papunësisë 8 deri 10%. Nëse nuk e krijojmë këtë shkallë të rritjes së punësimit, në fakt edhe me këto synime të Qeverisë, ne vetëm do të vetënumërojmë, pra do ta mbajmë shkallën e sotme të papunësisë.

Për ta mbërritur një punësim prej 50.000 – 60.000 vetave në vjet, objektivisht neve na duhet një rritje ekonomike jo prej 7 deri 8 %, por minimum prej 10-12%, gjë që është objektivisht joreale. Pra edhe kjo shifër del , edhe ky synim del që është joreal.

Sa i përket rrogave, u pranua edhe prej vetë ministrit, në kornizën afatmesme të shpenzimeve, e shohim qartë që në tri vjetët e ardhshëm, nuk do të ketë rritje reale të rrogave, por është synimi që të ketë qëndrueshmëri të rritjes që është arritur, pra që rritja e rrogave të përcjellë shkallën e inflacionit.

Kjo do të thotë që për punëtorët, për ata që janë të punësuar, ka lajme të këqija, nuk do të ketë rritje reale, pra faktikisht fuqia blerëse, duke ditur se inflacioni do të jetë më i madh se sa që është projektuar, këtë po e pranojmë të gjithë ne. Deri para pak javësh, ne kemi fol për një inflacion 5%, 5% e gjysmë, tashmë po flasim për 10%. Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin e vet flet për një e inflacioni i cili mund të jetë diku 9% gjatë këtij viti.

Pra, kur t'i marrim parasysh të gjitha këto, edhe parimisht në krejt dokumentin del që ne nuk kemi vizion zhvillimor. Duhet të flasim hapur, nuk do të flasim, po e përmend këtë jo si deputet i opozitës, prej një qytetari të Kosovës. Nuk ka vizion zhvillimor nëse 90% të hyrave bazohen në dogana, absolutisht. Ne po synojmë të hyjmë në Bashkimin Evropian, e dimë fare mirë se çka ndodhë kur t'i ofrohemi Bashkimit Evropian dhe çfarë janë të hyrat nga doganat. Ne nuk e favorizojmë prodhuesin vendor, ne kemi plotë gojën favorizim të prodhuesit vendor, por ne e kemi, e tatimojmë edhe lëndën e parë, e tatimojmë edhe makinerinë për prodhim, gjë që është e pakuptimtë dhe është e paprecedencë.

Në përgjithësi, mendoj që mund të konkludohet që ky dokument fatkeqësisht është joreal, fatkeqësisht, nëse e lexojmë me kujdes, do të dalë se nuk do të ketë zhvillim ekonomik 7 – 8%. Fatkeqësisht del që nuk do të ketë ulje të papunësisë 8 deri 10%. Del po ashtu se nuk do të ketë rritje të rrogave dhe konkludimi është që ne po shkojmë në mënyrë të shpejtë drejt një krize të madhe ekonomike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Shqipërisë Muja e ka fjalën.

SHAIPI MUJA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë u mundova që të nxjerr një arsyeshmëri të prononcimeve të opozitës lidhur me paraqitjen në këtë pikë të bisedave të cilat janë duke u bërë më shumë emocionale dhe dua të paraqes për publikun, meqë jemi në TV direkt, dhe po krijohet përshtypja sikur dikush do të na vështroj neve dhe çka po bisedojmë.

Dua t'ia përkujtoj LDK-së, për shembull, që gjatë fushatës është premtuar më 23 nëntor në Mitrovicë, 100% rritja e pagave dhe është thënë se kryeministri në ikje po iu ofron 50, ne do t'i bëjmë 100% dhe atë do t'i bëjmë në Parlament, dhe sot është realizuar kjo me 50% dhe besoj që parametrat nuk janë luhatur shumë ekonomik- shqetësues.

Sa i përket problemit të autostradës, më shumë po i mundon sukcesi se sa mënyra se si është duke u realizuar me një transparencë të plotë dhe qasja e opozitës e cila është për të krijuar vetëm një botëkuptim para opinionit publik, se këtu është duke u bërë një katastrofë në ndërtim edhe një mos transparencë, është më shumë për konsumim politik. Njëjtë është me fatin e PTK-së, e cila paragjykohet dhe është paragjykuar dhe është dëmtuar dhe është ndihmuar që të manifestohet më shumë rruga se sa të manifestohet logjika e zhvillimit të tregut të lirë dhe të biznesit në përgjithësi. Ndërsa, sa i përket imazhit të Qeverisë dhe në përgjithësi mendoj që Kosova imazhin e vet nuk e ka vetëm në duart të Qeverisë, por e ka në duart edhe të opozitës për sjelljet e veta, për ata të cilët na monitorojnë se çka po flasim dhe çka po propozojmë.

Ne nuk jemi duke propozuar asnjëherë rrugëzgjdhje, nuk po dëgjojmë rrugëzgjdhje nga opozita, përveç kritika pse, pse, pse? Dhe nëse në “pse, pse, pse”, flitet, atëherë domosdoshmërisht kuptohet se nuk kanë rrugëzgjdhje të tjera të bazuara. Dhe, mendoj që ky material edhe që do të jetë i sjellë Parlament, pas dy muajsh i plotësuar, nëse, ose të rishqyrtohet, unë nuk e shoh shumë pozitive edhe angazhimin e kolegëve tanë këtu në Parlament, të cilët angazhohen më shumë në krijim të një opinioni jo të qartë, por më shumë në një kritikë e cila nuk mund të zërë vend dhe e cila nuk na bën nderë neve edhe si deputetë dhe në këtë mënyrë humbim edhe kohë të cilat nuk janë të vlefshme as për opinionin po as për neve të cilët jemi këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për çka një minutë? Unë mendoj që në emër të grupit parlamentar nuk mundet secili. Fjalën e ka pasur deputetja Bajrami. Ka replikuar besoj në fjalën e saj ose e ka kundërshtuar, pasi nuk është kryetari, le të flet zonja Bajrami dhe kaq. Unë nuk e besoj që mund të komunikojmë në këtë formë, kush dëshiron. Në qoftë se e ka autorizuar dike zoti Beqiri, në rregull është, unë nuk kam kurrgjë kundër. Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Ju faleminderit shumë. E falënderoj kolegun. Ne nuk jemi sot duke diskutuar se çka ka premtuar LDK-ja në Mitrovicë edhe pse besoj që nuk e kemi premtuar, nuk e kemi pasur ne në program ne rritjen e pagave 100%, ne kemi thënë që do t'i rrisim pagat sa do të ketë rritje ekonomike, duke mos dashur për ta dëmtuar. Dhe, nuk jemi kundër rritjes së pagave, nuk jemi kundër autostradës as ne, asnjë qytetar i Kosovës, asnjë deputet i Parlamentit të Kosovës. Këtë po e konfiguroni ashtu ju siç po ju konvenon edhe është mirë domethënë të diskutoni në terma real. Ne po e diskutojmë

dokumentin i cili po bazohet në të hyra fiktive, në të hyrat që nuk ekzistojnë, pse nuk po flet për atë? Mos u kap atje te fushata se nuk është në rregull.

KRYESUESI: Kundër-replikë zoti Muja, një minutë e ke.

SHAIP MUJA: Meqë tha nuk më kujtohet edhe nuk e besoj që ka thënë, ia kujtoj, e ka në arkivin e informacionit ku më 23 nëntor, kryetari, lideri i Lidhjes Demokratike thotë kështu: “Kryeministri në ikje, thotë 50% do t’i rritë pagat, ne ju garantojmë se do t’i rrisim 100% edhe atë do ta bëjmë në Parlamentin e Republikës së Kosovës,” dhe këtë e them me pot përgjegjësi edhe kështu që mos i ikni memories tuaj. Unë mbi kornizën afatmesme, po rrokeni edhe te rrogat. Këtu po reflektohet. Edhe kështu që ju, nëse keni nevojë ua sjell unë dokumentin origjinal ku keni thënë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Bajrami ka një minutë dhe nuk ka më.

HYKMETE BAJRAMI: Në atë kohë, edhe nëse ka thënë kryetari, shumë mirë që i paske dokumentet dhe po i arkivon këto gjëra, krejt në rregull, edhe nëse e ka thënë me e arsyeshme ka qenë ta thotë kryetari i Lidhjes Demokratike, i rrisim rrogat 100% se kur ka marrë vendim kryeministri i Kosovës, si cili ka qenë në dorëheqje, ka qenë vendim jo kushtetues, e ka thyer Kushtetutën. Nuk ka qenë, domethënë, ka qenë Qeveri në dorëheqje. Më e logjikshme ka qenë dikush të premtojë dikush i cili ka qenë në fushatë 100%, rritje të rrogave se sa të marrë vendim një ministër në dorëheqje. Edhe mbyllim me kaq.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Korniza afatmesme e shpenzimeve, shërben si dokument kryesor për planifikimin e politikave qeveritare dhe korniza afatmesme e shpenzimeve për vitin 2012-2014, që e kemi këtu para vetes, do t’i paraprijë hartimit të buxhetit për vitin 2012. Atëherë, çfarë paralajmëron korniza afatmesme e shpenzimeve për sektorin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Para së gjithash, është dëshpëruese të kuptohet se shëndetësia do të vazhdojë të mos trajtohet prioritare për politikën e Qeverisë sonë edhe përkundër gjendjes tejte të rëndë në të cilën ndodhet aktualisht ajo. Në vitin 2011, 5.5% nga buxheti i gjithmbarshëm është ndarë për Ministrinë e Shëndetësisë, që është së paku dyfish më ulët se sa në vendet e rajonit. Për vitin 2012, buxheti për shëndetësi parashikohet të jetë rreth 85 milionë euro, për vitin 2013, rreth 86 milionë euro dhe për vitin 2014, rreth 91.5 milionë euro.

Një qeveri e cila do të mendonte ta rimëkëmbte shëndetësinë, do të vepronte së paku si vendet fqinje, të cilat investojnë prej 10% deri në 26% nga buxheti i gjithmbarshëm

për shëndetësi. Dhe, kjo, zoti ministër Hamza, është një alternativë apo rrugëzgjdhje siç po shprehën deputetët, pra mund thjesht të ndiqni shembujt e vendeve në rajon.

Nëse Mali i Zi, është në gjendje të ndajë 26% nga buxheti i vet për shëndetësinë, gjithnjë duke u referuar në statistikën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, pse nuk është në gjendje Qeveria jonë të ndajë të paktën 10% për sektorin e shëndetësisë? Kështu për vitin e ardhshëm, alternativa të cilën po ua ofrojnë, shifra prej 140 milionë euro për shëndetësinë, do të ishte minimumi po që se Qeveria është e shqetësuar me gjendjen që do ta quaja lirisht alarmante në të cilën është sot shëndetësia kosovare. Por, nga korniza afatmesme e shpenzimeve më lë të kuptohet se qeveria jonë do të vazhdojë ta trajtojë shëndetësinë afërsisht si Azerbajxhani, Bolivia, Egjipti, Iraku, Nikaragua, Paragvaji e Zimbabvea, me të cilat do të krahasohej Kosova, në listën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për shpenzime që bën një qeveri për kokë banori.

Rritjet në sektorin e shëndetësisë, sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve, do të bëhen kryesisht në shpenzimet kapitale, të cilat patën shënuar një rënie të dukshme në vitin 2011, për shkak të rritjes së paplanifikuar të pagave.

Kështu, shpenzimet kapitale për vitin 2012, parashihen të jenë rreth 13 milionë e 200.000 euro, afërsisht sa kanë qenë edhe në vitin 2009. Mallrat dhe shërbimet, nga ana tjetër, do të rriten nga 33 milionë në 34 milionë euro gjatë viteve 2012 deri 2014, vlerë kjo e cila definitivisht konsideroj se do të jetë e pamjaftueshme për të rregulluar situatën e rëndë në këtë sektor. Sa për ilustrim, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, e cila ofron shërbime shëndetësore terciare, aktualisht mungojnë rreth 40% të barërave nga lista esenciale dhe rreth 70% të materialit shpenzues, duke përfshirë këtu edhe gjërat elementare siç është: leukoplasti, gjilpërat, dorëzat sterile, gazat sterile e tjerë, edhe pse këtu na është thënë se ka kaluar koha kur duhet të shpresojmë vetëm për burimet e Qeverisë, por, investimet vijnë edhe në mënyrat tjera, por edhe 4 muaj pas formimit të këtij kabineti, gjendja në shëndetësi në Kosovë, vazhdon të jetë e njëjtë, e rëndë madje do të thosha shumë, shumë e rëndë.

Sa i përket subvencioneve dhe transfereve, mjete këto që dedikohen për shërim jashtë vendit, për vitin 2012- 2014, planifikohen të jenë në shumë prej 2 milionë eurosh, sasi kjo për 450.000 euro më e vogël se në vitin 2009.

Vlera prej 2 deri 2.5 milionë euro, është treguar gjithmonë e pamjaftueshme për shërimet jashtë vendit. Ofrimi i këtyre shërbimeve në vend, jashtë institucioneve publike, siç është planifikuar të bëhet tani e tutje, sërish mendoj se nuk do të mund të mbulohet me këtë sasi mjetesh. Për aq më tepër, nuk shoh t'i është dhënë hapësirë financiare apo të jenë paraparë objektiva strategjike në këtë dokument, të cilat do të capinin mundësi zhvillimit të fushave deficitare për të cilat dërgohen pacientët jashtë vendit. Ndërkaq, sa i përket pagave dhe shtesave, lajmi për punëtorët shëndetësor është se nuk do të ketë asnjë rritje pagash gjatë tri vjetëve të ardhshëm, natyrisht e gjithë kjo mund të ndërrojë tërësisht nëse në skenë dalin zgjedhjet e parakohshme. Atëherë, jo vetëm që do të ketë rritje pagash, por edhe do të ndërrojë rrënjësisht shpërndarja e shifrave nëpër tabelat që i kemi para vetes. Si rrjedhojë mund të konstatoj lirisht se dokumenti që kemi para vetës

dhe të cilën jemi duke e shqyrtuar sot, nuk paraqet ndonjë dokument strategjik me vlerë, pasi që ndryshimet në të ndodhin sipas tekeve të partisë politike në pushtet. Për mua, ndërrimet do të ishin të arsyeshme vetëm për shkak të ndonjë fatkeqësie natyrore në vend, e cila natyrisht vjen e paparalajmëruar apo ndërrimeve të papritura në skenën ekonomike botërore, apo diçka e ngjashme, por assesi për shkak të përfitimit të votës së qytetarit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Lutfi Haziri, nuk është . Mirë Arben, cili dëshironi....
Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Bazuar në financimin e planifikuar në këtë dokument, respektivisht në kornizën afatmesme të shpenzimeve, sektorët më të rëndësishëm apo ndër më të rëndësishmit të jetës dhe zhvillimit në Kosovë, nuk do të përjetojnë fare progres, gjatë periudhës 2012-2014. Kur them sektorët, atëherë mendoj në sektorin e drejtësisë dhe luftimet e korrupsionit, sektorin e zhvillimit ekonomik dhe në sektorin e arsimit të lartë.

Vërtet hartuesi i dokumentit për reformën në drejtësi dhe luftimin e korrupsionit, ka përpiluar disa fraza të bukura dhe optimiste, të cilat më shumë shërbejnë siç thotë populli për t'i qitur hi syve popullatës së Kosovës, se sa që do të realizohen në praktikë gjatë periudhës 2012-2014. Kështu në kornizë thuhet, citoj: "Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për të përkrahur përmirësimin e infrastrukturës fizike, të gjykatave si dhe aplikimi në të arriturave më të reja nga fusha e teknologjisë informative, në të gjitha strukturat e sistemit gjyqësor", por kur shikohet propozimi për financimin e organeve të drejtësisë dhe atyre që merren me luftimin e korrupsionit, atëherë shohim se nuk do të ketë ngritje të përkrahjes së tyre financiare, por përkundrazi në shumë pika ka rënie. Kështu për shembull, te pozicioni i prokurorit të shtetit, si një organ i rëndësishëm në luftimin kundër korrupsionit, vërehet se në vitin 2011, ka buxhetin prej 4,6 milionë euro, kurse në vitet 2013 dhe 2014, do të ketë buxhetin më të vogël, respektivisht nga 4,4 milionë. Pra, do të ketë reduktime financiare për prokurorin e shtetit në periudhën kohore kur zyrtarisht pritet inflacioni në shkallë mbi 5%, gjë që drejtpërdrejt do të ndikojë në motivimin dhe punën e përgjithshme të organit kryesor të ndjekjes penale në Kosovë.

Thuaja se të njëjtin fat financiar do ta ketë edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si institucion më i rëndësishëm për administrimin e gjyqësorit të Kosovës, për të cilin në vitin 2011, është paraparë buxheti prej 17 milionë euro, ndërsa në vitin 2012, do të ketë 16,8 milionë, respektivisht në vitin 2013, buxhetin prej 15,9 milionë euro apo për afër 6% më pak se sa që ka në vitin 2011.

Edhe për Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij dokumenti parashihet një reduktim financiar. Kështu në vitin 2011, Gjykata Kushtetuese si autoriteti përfundimtar në Kosovë, për interpretimin e Kushtetutës, ka buxhetin në lartësi prej 1,53 milionë euro, kurse në vitin

2013, do të ketë në dispozicion 1,46 milionë, respektivisht në vitin 2014, do të ketë 1,48 milionë, që janë vlera më të vogla se sa ato aktuale.

Financim më i mirë nuk parashihet as për Agjencionin Kundër Korrupsionit, i cili për vitin 2011, ka të aprovuara 534.000 euro, kurse në vitet pasuese 2012-2014, për institucionin më të rëndësishëm për luftimin e korrupsionit, janë paraparë nga 504.000 euro për vit, respektivisht nga 30.000 euro më pak për secilin vit veç e veç. Ndërsa, për institucionet ndihmëse të drejtësisë kosovare, siç janë Komisioni për Ndihmë Juridike dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës, financimi për periudhën e mbuluar me dokument 2012-2014, do të mbetet i njëjtë.

Për ilustrim më të mirë të këtij financimi të këtillë të drejtësisë kosovare, do ta përmend një fjalë të urtë popullore, e cila thotë: “Sa pare aq muzikë”. Kjo do të thotë që duke pasur parasysh financimin e varfër që planifikon Qeveria për organet e judikaturës së Kosovës, të tillë pra, të varfër, do ta kemi edhe drejtësinë e Kosovës gjatë viteve 2012-2014. Pra, drejtësia do të jetë e stërngarkuar me lëndë të pazgjedhura, do të jetë joefikase, e ndikuar politikisht edhe besa materialisht.

Në anën tjetër, derisa kjo Qeveri nuk ka resurse të mjaftueshme financiare për rritjen e buxhetit të gjyqësorit të drejtësisë kosovare, kur bëhet fjalë për Zyrën e kryeministrit dhe administratën jo të vogël të saj, atëherë ajo disi gjendet dhe e ngrit buxhetin e saj prej 8,8 milionë që e ka në vitin 2011, në 9,8 milionë për vitin 2014, që paraqet rritje prej 11%.

Nën dy, edhe në rrafshin e zhvillimit ekonomik, sipas këtij dokumenti, ka një mospërputhje ndërmjet asaj që proklamohet deklarativisht dhe asaj që parashihet të financohet realisht. Kështu në dokument thuhet, citoj: “duke qenë në pajtueshmëri me vizionin e Qeverisë së Kosovës, të aprovuar në prill 2011, është zhvilluar skenari alternativ i bazuar në realizimin e politikave të reja, përmes të cilave synohet një rritje mesatare prej 7,8% për periudhën 2011-2014. Po e përsëris rritje mesatare prej 7,8%. Por, kur analizohet propozimi financiar që bën Qeveria për ministritë përkatëse të sektorit ekonomik, atëherë e kemi të qartë se kjo përqindje prej 7,8 është më shumë dëshirë utopike se sa që synim i realizueshëm.

Kështu për shembull, Ministria e Infrastrukturës, në vitin 2011, ka të aprovuar buxhetin prej 276 milionë euro, ndërsa për vitin 2014, Qeveria i ka planifikuar 179 milionë euro apo afër 100 milionë më pak se sa që i ka në këtë vit.

Më tutje, edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në vitin 2011, ka buxhetin prej 56,2 milion, kurse duke filluar prej vitit 2012 e tutje, do të ketë zvogëlim të buxhetit financiar. Kështu, në vitin 2012, do të ketë 35,1 milionë, ndërsa buxhetin më të ulët do ta ketë në vitin 2014, me gjithsej 26,8 milionë, që është përmby 50% më i vogël se sa buxheti i vitit 2011 për këtë ministri.

Edhe te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, vërehet një rënie e buxhetit, por jo aq drastike, sa te ajo e Zhvillimit Ekonomik. Në këtë ministri, do të ketë rënie prej 7,2 milionë të paraparë për vitin 2011, në 6,8 milionë sa do të ketë në vitin 2012. E vetmja

Ministri nga sektori i zhvillimit ekonomik, e cila do të ketë një ngritje të theksuar në sferën e financimit për periudhën 2012-2014, është Ministria e Bujqësisë.

Kur jemi te sektori i ekonomisë, gjithsesi duhet analizuar dhe veçuar financimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Konkretisht, financimi i këtij agjencioni, do të ketë një ngritje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme gjatë periudhës 2012-2014, në krahasim me vitin 2011. Kështu në vitin 2011, ka buxhetin prej 9 milionëve, ndërsa për vitin 2014 parashihet buxheti i Agjencionit prej 11, 1 milionë euro apo mbi 20% se sa buxheti i vitit 2011.

Mendoj se është e paarsyeshme ngritja e buxhetit të Agjencionit me punën dhe aktivitetin e të cilit pjesa më e madhe e popullatës së Kosovës, është e pakënaqur dhe në rrethanat kur pjesa dërmuese e ndërmarrjeve shoqërore, tanimë veç është privatizuar.

Në fund, do të ndalesha edhe në sektorin e arsimit të lartë, i cili, sipas këtij dokumenti përbëhet nga MASHT, Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave, Këshilli Kosovës për trashëgimi kulturore. Për habinë time, në dokument nuk theksohet fare financimi as i Universitetit të Prizrenit, i themeluar vitin e kaluar e as i Universitetit të Gjilanit dhe ai i Pejës, i cili i pat premtuar nga partia në pushtet, elektoratit të tyre dy qyteteve, në dy zgjedhjet e fundit në Kosovë.

Andaj, duke pasur parasysh premtimet pa bazë e jo të sinqerta, do të shfrytëzoja rastin që t'ju përkujtoj por edhe të kërkoj prej qytetarëve të Kosovës që gjatë zgjedhjeve të ardhshme, mos t'u besojnë atyre që u premtojnë universitete, lokale qoftë në Gjilan, Pejë apo gjetiu, se premtimet e tilla nuk janë serioze, sepse në dokumentet zyrtare financiare, nuk janë paraparë fare, por premtohen vetëm për mashtrime elektorale sa për të marrë votën prej tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Afrim Kasolli, e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Korniza afatmesme e shpenzimeve buxhetore 2012-2014 për të cilën po diskutojmë sot, nuk është asgjë tjetër pos një retorikë boshe dhe sterile politike e kësaj Qeverie e shprehur tashmë në stilin e saj të njohur të broçkullave mediatike dhe e tillë nuk paraqet kurrfarë vizioni të qartë, konkret dhe përmbajtjesor, i cili do të mundë të shndërrohej në dokument për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social të kësaj shoqërie gjatë viteve në vijim. Madje, duke qenë i artikuluar mbi bazën e dy dokumenteve të mëhershme, si ai i buxhetit të Kosovës për këtë vit si pseostrategji e zhvillimit ekonomik, të miratuar në Banjsko, korniza nuk mund të jetë gjë tjetër pos konsekuencë e natyrshme e këtyre dy dështimeve politike të mëhershme të kësaj Qeverie. Për më tepër, vetë ky dokument po ashtu përmban shumë kontradikta ndërmjet pjesëve të tij dhe të pa vërteta të shumta që nuk e përshkruajnë gjendjen dhe faktet reale që aktualisht dominojnë. Madje, ndoshta ky dokument pa relevancë shoqërore dhe

ekonomike, si i tillë edhe është shtyrë për kot, sepse do të ishte më mirë që të ruhej e të mos harxhohej letra e bardhë dhe ky material shpenzues t'i ofrohej për shembull spitalit rajonal të Prizrenit, ku nga përvoja ime aty kam parë se në atë institucion shëndetësor mjekët nuk kanë as letër të bardhë kompjuteri për ta përshkruar, diagnostifikuar dhe analizuar trajtimin e pacientit dhe në fund për ta shkruar fletlëshimin e tij.

Sidoqoftë, ndër pjesët më problematike të kësaj kornize vlejné të veçohen ato që kanë të bëjnë me sferën e mirëqenies sociale, si dhe atë të arsimit. Me këtë rast, bie fjala në sferën e mirëqenies sociale pranohet se papunësia ka arritur shifra rekord, kurse varfëria dhe mjerimi në përmasa alarmante, duke u bërë një mallkim për shumicën e shoqërisë. Këtu vlen të veçohet sidomos fakti se sipas të dhënave të Entit të Statistikës së Kosovës, përpos shkallës së lartë të papunësisë, po ashtu 55% e fuqisë punëtore është nën kualifikim të mesëm dhe ky fakt e demanton njërin prej broçkullave kryesore të kryeministrit dhe të kësaj Qeverie se kjo ka qenë e përkushtuar për ndërtimin e një shteti të dijes, sepse rezultatet në këtë gjendje demonstrojnë të kundërtën, duke e thelluar edhe më tej krizën. Pra, shihet qartë se një nga dështimet substanciale të kësaj qeverie ka qenë pikërisht mos investimi në resurset humane, investim ky që po të kishte ndodhur, do të mund të shndërrohej në mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Paradoksalisht, Ministria e Mirëqenies Sociale në zbutjen e kësaj gjendjeje shtron para vetes dy objektiva, e para, si hartimin e Projektligjit për pensionet e financuara nga shteti, si dhe ngritja e mirëqenies dhe mbështetja e familjeve përmes ofrimit të ndihmave sociale dhe shërbimeve sociale për kategoritë e rrezikuara të shoqërisë dhe, dy – avancimin e zbatimit e politikave në ngritjen e shkallës së punësimit në nivel vendi.

Për sa i përket realizimit të objektivit të dytë, kjo Qeveri synon që këtë qëllim ta realizojë, bie fjala, në mundësinë e zhvillimit të bashkëpunimit me vendet e rajonit, anëtare të BE-së dhe atyre jashtë BE-së për rritjen e mundësive për punësim të fuqisë punëtore nga Kosova apo edhe për punësim sezonal. Ndonëse ky objektivi është i pa realizueshëm për shumë shkaqe, po edhe sikur të ishte i realizueshëm, atëherë na del se kjo Ministri nuk na qenka ministri e mirëqenies sociale, por ministri e emigracionit që qëllim kryesor ka ofrimin e perspektivës për qytetarët e saj jo brenda, por jashtë vendit.

Përgjithësisht, kjo logjikë nënkupton vazhdimin e kësaj katrahure ekonomike dhe sociale, të mbështetur mbi idenë e suspendimit të prodhimit si mjet për zhvillim dhe punësim dhe në vend të saj vazhdimin e kulturës së konsumit dhe importit në saje të mjeteve që do të vinë nga ky punësim jashtë, fenomen kyç me të cilin jemi duke u përballur deri më tash.

Po ashtu, në anën tjetër kjo kornizë thotë se për shkak të kufizimeve buxhetore, kategoria e skemës sociale për vitet në vijim duhet t'u përshtatet mundësive buxhetore të ndara për këtë program me qëllim që të mos ketë rritje të përfituesve mbi mundësitë buxhetore, pra numri i përfituesve do të sillet në rreth 35.000 përfitues.

Gjykuar sipas kësaj logjike, shihet qartë se Qeveria nuk ka strategji për të ulur nevojën e qytetarëve për asistencë sociale nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës dhe kështu numri i nevojtarëve do të jetë edhe më shumë se 35.000, por ajo do të mbështesë vetëm këtë shifër, kurse pjesa tjetër do të lihet nën mëshirën e fatit dhe e zhytur brenda rrjetit

vicioz të varfërisë konstante dhe gjendjes së përhershme të mjerimit ekonomik dhe social, duke bërë që përfitues të mbështetjes sociale gjatë viteve në vijim të mos jenë ata që vërtetë do të kenë nevojë për asistencë dhe pa paragjykim, por ajo kategori që e përcakton Qeveria mbi bazën e kriterëve politike të partisë në pushtet. Pra, kjo tregon se edhe objektivi i parë strategjik do të jetë i pa realizueshëm, sepse numri i atyre që do të mbështeten do të jetë i kufizuar.

Të nderuar deputetë,

Logjika e degraduar e kësaj kornize manifestohet edhe në pjesën që ka të bëjë me sferën e arsimit, ndonëse në fillim të përshkrimit është përsëritur ai slogani i njohur pseudo-iluminist i atyre që e kanë artikuluar dhe jam i bindur se s'e kuptojnë se kjo shoqëri objektiv kryesor të saj e ka bazimin në sferën e dijes, megjithatë faktet flasin për diçka krejt tjetër. Madje, ndër sektorët, pajtohem me kolegun Demolli, që përmenden në sektorin e arsimit, konsiderohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Këshilli i Kosovës për trashëgiminë Kulturore, por mungon pikërisht një përshkrim i detajuar i investimeve në Universitetin e Prizrenit, që dikur ishte shndërruar në slogan kryesor të partisë në pushtet.

Ajo që është më skandaloze në këtë segment dhe që është një e pa vërtetë e madhe, gjendet në pjesën që ka të bëjë me Universitetin e Prishtinës, ku thuhet se ky institucion i arsimit të lartë është një institucion autonom publik për arsimin e lartë që zhvillon arsimim akademik, e është e ditur se në Kosovës nuk ka institucion më të politizuar të arsimit se sa Universitetit të Prishtinës. Këtu vlen të përmendet sidomos fakti i fundit i emërimit dhe uzurpimit të Këshillit drejtues të UP me militantë politikë të Partisë Demokratike të Kosovës, militantë këta që i karakterizojnë deficitet e tmerrshme shkencore dhe akademike. Me këtë strategji të nënshtrimit, të dominimit, shihet qartë se kjo qeveri synon që këtë institucion ta mbajë edhe më tej në gjendjen e një dinozauri me trup të madh e kokë të vogël, duke e pushtuar politikisht, degraduar në nivelin akademik dhe degjeneruar në aspektin etik. Përfundimisht, kjo kornizë nuk dallon asgjë tjetër nga fushatat elektorale të Partisë Demokratike të Kosovës, ashtu siç edhe dikur kishte qenë zotim i kryeministrit Thaçi kur pati premtuar se do ta shndërrojë Kosovën në një luginë silikoni, nëse e mbani mend, por që fatkeqësisht sot e ka shndërruar në luginë lotësh nga varfëria, mjerimi dhe skamja, duke e bërë jetën për shumicën e qytetarëve të Kosovës ferr, të pa shpresë dhe të përçudnuar. Dhe akuza e Qeverisë se neve kemi vetëm kritika dhe jo alternativa, simptomatikusht shpreh tendencën mendore të kësaj qeverie që pasi e rrënoi politikisht, ekonomikisht dhe shoqërisht, kërkojnë që gradualisht ta eliminojnë edhe kritikën si të vetmin instrument të demokracisë, por alternativë është - edhe mos i bëni dëm vendit! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Më ka pëlqyer ky hap të Qeverisë për ta diskutuar këtë kornizë afatmesme dhe realisht kam pritur që vërtetë opozita të jap propozime për të implementuar pastaj në këtë kornizë,

ngase edhe ky ishte qëllimi i Qeverisë të debatojë me ne dhe me opozitën bashkërisht, të kemi një Kornizë afatmesme të shpenzimeve me kërkesat dhe me projektet të cilat do ofrohen.

Unë kam pritur që ekspertë të ekonomisë nga opozita të ofrojnë propozime konkrete, por jo. Ajo çka u prezantua këtu nga një pjesë e opozitës, është një teori që jemi mësuar ta dëgjojmë çdo ditë në media, duke filluar domethënë se këto nuk pat, u tha, domethënë se nuk ka pasur rritje për invalidë të luftës dhe për familje të dëshmorëve, gjë e cila ka ndodhur dhe se vërtet varfëria ekziston dhe është prezente në Kosovë, këtë s'mund ta mohojë askush, mirëpo mos të harrojmë se tani kemi një pagë minimale të draftuar, e cila është 170 euro, e cila deri para disa ditësh ishte nën minimumin e mundshëm dhe se çdo herë, domethënë, vazhdohet me kritika, ia ka huq Qeveria për 50, 100 milionë, domethënë fjalë të cilat realisht nuk përkojnë as me realitetin, po as nuk janë zgjidhje konkrete.

Qytetarët e Kosovës janë lodhur duke parë grindje në mes nesh, grindje të cilat bëhen me logjikën - ma mujte, ta mujta - por jo edhe konkurrencë projektsh konkrete. PDK-ja dhe Qeveria e Kosovës ka afruar një kornizë, ka ofruar projekte të planifikuara, të programuara me një buxhet stabil dhe krejt tendencat për të futur huti te qytetarët u demantuan nga ky dokument këtu. Nuk themi se është një dokument perfekt, mirëpo mund të jetë një dokument i cili mund të jetë i zbatueshëm dhe mund të integrohen pastaj edhe propozimet të cilat mund të japin kolegët nga opozita.

Qeveria ka afruar bazë për zhvillimin ekonomik me një rritje të pagave. Tani është pak e pa kulturë këtu që thuhet se Qeveria nuk duhet të jetë servile, më përpara edhe nuk duhet të jetë servile në raport me instancat ndërkombëtare dhe se po e shti Kosovën borxh me kredi dhe gjëra të tjera, ndërsa tash po ankohen pse janë prishur ose pse janë shtyrë për një kohë të caktuar këto kredi për një mirëqenie qytetare, për një ngritje të pagave të theksueshme në të gjithë sektorët.

Qytetarët do ta vlerësojnë se a është bërë mirë kjo rritje e pagave apo jo, ata do të japin vlerësimin e tyre. Të gjithë ekonomistët në shumicën e debateve kanë kërkuar të luftohet kontrabanda dhe ekonomia jo formale. Do të thotë, kur kjo ndodh nga kjo qeveri, atëherë ndodhin akuza të pa baza se po plaçkiten qytetarët e çka po afrohet si zgjidhje. Domethënë, vazhdohet që në kufij të Kosovës të hyjë mall nga India, të hyjë mall bualli në vend të viçit të Brazilit dhe të hyjë mall tjetër, të vazhdojë të jetë mall i cili është kontrabanduar me data dhe pa kontroll ushqimor. Prandaj, në vend të kësaj do të duhej që të ofrohen zgjidhje dhe projekte konkrete. Besoj se kjo kornizë do të avancohet edhe nga ky debat dhe do të kemi një zhvillim më të mirë ekonomik të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kuadër të Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2012 – 2014, unë do të fokusohem pikërisht tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për të cilën nga ky

institucion, nga kjo ministri është paraqitur edhe gjendja e tanishme, ku thuhet se mjedisi në Kosovë është larg standardeve mjedisore të Bashkimit Evropian. Ekzistojnë probleme serioze në lidhje me cilësinë e ujërave, menaxhimit të mbeturinave, ndotjes së ajrit, ndotjes së tokës dhe humbjes së llojllojshmërisë biologjike të menaxhimit.

Pra, me një fjalë, kemi të bëjmë me një situatë jo të mirë të ambientit në Kosovë dhe kur të merret për bazë buxhetin i cili është planifikuar në Kornizën afatmesme 2012 – 2014 dhe kur të shikohet buxheti për vitin 2009 dhe 2010 dhe njëkohësisht 2011 dhe 2012, shohim se në vitin 2009 kemi pasur një buxhet në vlerë prej mbi 12 milionë euro, në vitin 2010 kemi një buxhet në vlerë prej 11 milionë eurove, ndërsa në vitet që do të vijnë paraprak kemi një ulje drastike të këtij buxheti, ku të lë përshtypje se situata e ambientit në Kosovë do të thotë është e rregulluar. Prandaj, me një buxhet të tillë i cili i është ndarë Ministrisë së Ambientit për vitet që do të vijnë, është një buxhet i pamjaftueshëm dhe një buxhet i cili nuk do të ndikojë në rregullimin e çështjes së ambientit në përgjithësi.

Një situatë e tillë paraqitet edhe tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, shihet se në kuadër të kësaj ministrie do të thotë ka një rritje të dukshme, një rritje të vogël të buxhetit, mirëpo karshi kërkesave dhe prioriteteve të cilat janë paraqitur në këtë ministri, sidomos tek investimet kapitale, kur bëhet fjalë për objektin e Teatrit dhe Operave “dr Ibrahim Rugova” me një buxhet i cili është paraqitur deri në vitin 2013, ky prioritet i caktuar nga kjo ministri do të thotë vështirë se me një buxhet të tillë do të rregullohet, kur dihet se ky investim, ky projekt dhe ky investim kapital kap shumë në vlerë prej 33 milionë eurove. Kjo do të thotë që deri në vitin 2015 me një buxhet të tillë ky objekt i cili është shumë i nevojshëm si infrastrukturë kulturore, nuk do të ndërtohet.

Po ta marrësh për bazë edhe buxhetin sa i përket çështjes së rinisë në përgjithësi për vitin 2011, do të thotë aktualisht kemi një buxhet shumë të limituar dhe po të llogarisim me Ligjin i cili përcakton, përkufizon rininë në Kosovë, me Ligjin për... dhe pjesëmarrje të rinisë, e cila kufizon moshën 14 deri në moshën 24 vjeçare, për një kokë një të riut në Kosovë kemi buxhetin 50 centë dhe kjo në bazë të parashikimeve të cilat janë paraqitur, ky buxhet në vitin 2012 dhe 2013 ky buxhet i tillë për kokë të riut në Kosovë do të vazhdojë me 50 centë buxhet vjetor.

Prandaj, do të ishte mirë që të rishikohet buxheti nga Qeveria e Kosovës, pikërisht me insistimin e këtyre dy ministrive, të rishikohet një buxhet i tillë edhe për Ministrinë e Mjedisit dhe po ashtu për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që ky buxhet të ketë një rritje akoma më të madhe, sidomos në prioritetet e caktuara dhe sidomos kur kemi të bëjmë me çështjen e rinisë në përgjithësi në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne pikësepari duhet ta shohim se çka po diskutojmë këtu sot. Dhe arsyeja pse ne po diskutojmë këtë Kornizë afatmesme buxhetore janë disa elemente të cilat e shtyjnë që të

hartohet një kornizë e tillë. E para, është disiplina fiskale. E dyta, është orientimi strategjik dhe, e treta, planifikimi zhvillimor.

Po, të flasim pak për disiplinën fiskale. Çka ka ndodhur me disiplinën fiskale dhe si ka rrjedhë kjo në këto vitet e fundit, sidomos në këta muajt e fundit. Muajt e fundit kemi një konfirmim edhe prej organizatave ndërkombëtare, prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian, por sidomos prej Fondit Monetar Ndërkombëtar që institucionet e Kosovës nuk kanë disiplinë fiskale dhe si rezultat i shkeljes së disiplinës fiskale, prishen edhe marrëdhëniet kontraktuale që Fondi Monetar Ndërkombëtar ka me Qeverinë e Kosovës dhe kalon në një fazë tjetër, ku dëmi që i bëhet Kosovës është një dëm shumë i madh, sepse ekonomia e Kosovës, tregu i Kosovës nuk do të ketë mbi 150 milionë euro në qarkullim për këtë vit. Ndoshta mund t'i ketë vitin e ardhshëm, kjo është ndoshta, sepse është hipotezë, sepse nuk dihet se a do ta përkrah apo nuk do, a do t'ia krijojë këto kushte Fondi Monetar Ndërkombëtar Kosovës apo nuk do t'ia krijojë që të kthehet në stand-by agreement. Prandaj, jemi në një qasje ku planifikimi, t'i shkojmë elementit të dytë, që është orientimi strategjik. Cili është orientimi strategjik i ekonomisë së Kosovës? Ekonomia e Kosovës duhet të ketë disa elemente kryesore, që janë të hyrat vetjake ose burimet natyrore që i ka Kosova, donacionet që vijnë dhe investimet e jashtme që duhet të vijnë. Me këtë çast ne kalojmë në një element tjetër, që është elementi i planifikimit zhvillimor. Si planifikojmë ne që të zhvillohen këto?

Planifikimi është konceptualisht i gabuar, teoretikisht i pa pranueshëm dhe konkretisht i pa realizueshëm. Pse? Sepse ne kemi një marrëdhënie kontraktuale me Fondin Monetar Ndërkombëtar, i cili ka ngrirë mbi 150 milionë euro dhe kjo ngrirje mbi 150 milionë euro do të thotë që tregu i Kosovës, ekonomia e Kosovës nuk do t'i ketë këtë vit. Paramendoni se sa është efekti i multiplikatorit ose llogaritne, ndoshta ministri edhe e llogarit sa është efekti i multiplikatorit të 150 milionë euro në një ekonomi të varfër si ekonomia e Kosovës. Strategjikisht qysh mund të planifikosh ti që të rriten investimet e jashtme, si mund të pritësh ti që të ketë investitorë seriozë që kanë për të ardhur dhe të investojnë në Kosovë, ku në të gjitha raportet ndërkombëtare, tashti edhe në ueb-faqet zyrtare të organizatave më të rëndësishme për çështjet ekonomike dhe financiare, si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar apo Komisioni Evropian, vendi ku ne synojmë të anëtarësohemi dhe të marrim predispozitat kryesore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, krijohet një situatë e tillë ku thuhet që institucionet e Kosovës nuk kanë disiplinë fiskale, nuk respektojnë marrëdhëniet kontraktuale dhe si rezultat i kësaj - cili investitor potencial serioz do të vinte dhe të investonte në Kosovë? Kush do të vinte dhe të investonte milionat e veta në Kosovë, kur institucionet e Kosovës nuk respektojnë marrëdhëniet kontraktuale?!

Prandaj, jemi në një situatë të tillë ku krijohet një gjendje faktike. Gjendja faktike e cila përballet, përplasjet realisht shumë rënd me orientimin strategjik dhe me planifikimin zhvillimor. Gjendje faktike kemi, shkelje të marrëdhënieve kontraktuale me Fondin Monetar Ndërkombëtar, gjendje faktike kemi prishje të marrëdhënies kontraktuale me Fondin Monetar Ndërkombëtar, si kundër reagim i Fondit Monetar si rezultat i veprimit të Qeverisë së Kosovës dhe pasojat cilat janë? Pasojat janë që mund të kemi krizë shumë

të madhe buxhetore dhe mungesë të kapaciteteve për gjenerim të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik dhe social.

Prandaj, kjo i jep edhe elementin tjetër të problemit, elementi i besueshmërisë ndërkombëtare të institucionet e Kosovës.

Kjo çështja e Kornizës afatmesme buxhetore apo e planifikimit zhvillimor apo orientimi strategjik zhvillimor është çështje më shumë e komplikuar se sa mund ta paraqesë një ministër i financave, sepse ministri i Financave mund t'i shohë numrat, por qasjet e planifikimit zhvillimor janë më komplekse. Është qasja e besueshmërisë së institucioneve, është qasja e qëndrueshmërisë fiskale, është qasja e futjes së koncepteve sociale të zhvillimit ekonomik dhe të zhvillimit social, është qasja e ndërtimit të institucioneve dhe kapaciteteve institucionale të vetë qëndrueshme dhe të gjitha këto bien në kundërshtim me këtë kornizë e cila po na prezantohet sot këtu.

Pastaj, vijmë në një element tjetër. Ku do të shkojmë ne? Ku thotë Qeveria se do të shkojmë? Kjo Qeveri thotë se do të kemi një zhvillim dhe rritje ekonomike, por realisht do të kemi një krizë dhe krizë e cila po prodhohet edhe në aspektin ekonomik, edhe në aspektin fiskal. Aspekti fiskal, sepse nuk do të hyjnë në buxhetin e Kosovës me qindra milionë eurove që janë premtuar, komunat dhe institucionet tjera nuk do të kenë mundësi të nënshkruajnë marrëdhënie kontraktuale dhe Ministria e Financave nuk do të mund të jetë garantues për nënshkrimin e marrëdhënieve kontraktuale me Bankën Gjermane për Zhvillim për ndërtimin e ujësjellësit apo për ndërtimin e elementeve tjera, impiantit të trajtimeve të ujërave të zeza, të gjitha këto elemente nuk do të bëhen, sepse Qeveria ka qenë e pa përgjegjshme në veprimet e veta. Ne duhet të kalkulojmë jo vetëm humbjen direkte të 150 milionë apo 160 milionë euro, si rezultat i sjelljes së papërgjegjshme të Qeverisë, por duhet të kalkulohej edhe efektet anësore, si do të silllet Banka Botërore, si do të silllet Banka Gjermane për Zhvillim, si do të silllet Banka Evropiane për Zhvillim, si do të sillen faktorët tjerë ekonomik që mund të jenë operatorë ekonomikë privatë, si do të sillen operatorët ekonomikë të cilët do të vijnë dhe ta privatizojnë Postë-Telekomunikacionin e Kosovës? Ata nuk do të kenë besim, operatorët seriozë nuk do të kenë besim në këto institucione me këtë Qeveri që do të respektojë kontratën që do ta nënshkruajë dhe nuk do të vijnë operatorët seriozë, do të vijnë ndoshta operatorë më pak serioz ose operatorë matrapazë të lidhur me elemente të Qeverisë.

Vijmë te një problem tjetër. Çka do të ndodhë me Operatorin e shpërndarjes të energjisë elektrike? A do të garantojë, a do të japë fletën e garancisë Banka Botërore për të krijuar besueshmëri të operatorët ekonomikë që do të vijnë dhe të investojnë? Gjasat janë që nuk do të japë, sepse besueshmëria në këto institucione është cenuar.

Prandaj, lindin këto problematika në qëndrueshmërinë e konceptit të zhvillimit ekonomik, sepse zhvillimi ekonomik është koncept, është koncept i cili ndërtohet dhe pastaj mbi bazën e këtij koncepti orientohet strategjia zhvillimore dhe ekonomike, edhe sociale, po edhe fiskale, po dalin disa problematika shumë të mëdha. Problematika kryesore është qëndrueshmëria ekonomike dhe sociale, sepse duke mos pasur orientim të qartë se kah do të orientohet kjo ekonomi, ky koncept që është prezantuar këtu është një koncept i cili jep

predispozita të qëndrueshme për zhvillim pozitiv, prandaj mendoj se do të duhet të ishim më të qartë në kuptimin e qëndrueshmërisë dhe qasjes së seriozitetit. Serioziteti dhe banaliteti i kësaj Qeverie shkon deri në atë pikë sa ministrat nuk mund të vijnë as në Parlament të prezantojnë, Qeveria nuk është as në Parlament për të prezantuar, sepse ky Parlament, kjo shumicë parlamentare është e pa përgjegjshme, kjo shumicë parlamentare nuk merr përsipër që të obligojë ata të cilët duhet t'i mbrojnë, që të vijnë dhe prezantojnë dinjitetshëm atë çka e kanë bërë këtu.

Prandaj, konceptualisht është e pa pranueshme, teoretikisht është e pa justifikueshme, politikisht është një dështim politik i këtyre që po pretendojnë se duhet ta qeverisin Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Justina Pula.

JUSTINA PULA: I nderuari kryesues,
Ministra,
Deputetë,

Krahasuar me KASH-ët e periudhave paraprake, mendoj se ka avancim në disa drejtime të përgatitjes dhe paraqitjes së këtij dokumenti, por ka edhe vend për të tërhequr vëmendjen për më shumë kujdes dhe koordinim më të mirë në finalizimin e dokumentit të këtij karakteri.

Konkretisht, do t'i jap disa sugjerime në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012 – 2014, që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë dhe minierave. Më vjen keq që duhet t'i drejtohem ministrit të Financave, pasi që këtu nuk është ministri përkatës e që ka të bëjë me sektorin e energjisë dhe minierave.

Dokumenti duhet të përmirësohet për t'u përputhur më mirë me politikat zhvillimore dhe prioritetet e vendosur në programin e Qeverisë. Unë konstatoj se ka mos përputhje apo mos përfshirje në KASH-in 2012 – 2014 në disa prioritetet të rëndësishme të Kosovës.

Konkretisht, për sektorin e energjisë dhe minierave, në objektivat afatmesme nuk përmendet ndërtimi i Termocentralit “Zhur”, që është pjesë e Strategjisë së energjisë 2009 – 2018, të miratuar nga ky Kuvend, si dhe riaktivizimi sa më i shpejtë i bizneseve fitimprurëse të Trepçës nëpërmjet partneritetit publik privat. Pra, minierat dhe Trepça nuk përmenden fare në prioritetet e Ministrisë në këtë Kornizë afatmesme dhe kjo është shumë shqetësuese.

Ky Kuvend duhet t'i kërkojë Qeverisë, përkatësisht Ministrisë përkatëse që shumë shpejt të paraqet një plan të detajuar masash dhe aktiviteteve që do të ndërmerren për Trepçën. Ky plan ka qenë gati në vitin 2010, por individë dhe institucione ndërkombëtare, por edhe ato vendore nuk e përkrahën programin për ristrukturimin e Trepçës, por për çdo kusht kërkuan likuidimin e saj. Nëse Qeveria, përkatësisht ministria përkatëse nuk lëviz, atëherë duhet që ky Kuvend të marrë masa të duhura dhe këtë ta bëjë në mënyrë transparente.

Në programin e Qeverisë shkruhet se do të maksimizohen të ardhurat dhe benefitet për Kosovën nga burimet natyrore, gjegjësisht ato minerare, por kjo politikë nuk reflekton si duket në KASH-in 2012 – 2014. Konkretisht po flas për ato që i shënojmë në KASH-in me emrin Tantiema. Për sqarim, në këtë kategori përfshihen edhe ato të ardhura që ne i kemi quajtur si rentë ekonomike nga burimet natyrore apo minerale. Konkretisht, këtu përfshihen të ardhurat në buxhet nga e drejta që Kosova jep për shfrytëzimin e mineraleve si linjiti, ferronikeli, guroret dhe të tjera minerale që janë asete të gjithë popullit.

Këto asete duhet të valorizohen sipas vlerës së tyre në tregjet ndërkombëtare, kjo sidomos për nikelin, linjitin apo edhe plumbin, zinkun e të tjera minerale. Të ardhurat nga kjo kategori ekonomike, pra nga shfrytëzimi i resurseve, për vitin 2012 parashihet të jenë 15 milionë euro. Si u llogarit kjo shifër? A ka një politikë qeveritare për tantiemat, pra për caktimin e vlerës së burimeve minerare. Askush nuk mund të besojë se burimet minerale të Kosovës, që sot shfrytëzohen dhe do të shfrytëzohen nga investitori i Termocentralit “Kosova e Re”, “Ferronikeli”, investitorët tjerë në Trepçë dhe shfrytëzimi i guroreve nga gurthyetit vlerësohen vetëm 15 milionë euro.

Qeveria dhe të gjithë ne themi vazhdimisht – zhvillimi ekonomik do të jetë shfrytëzimi racional i burimeve natyrore. Këtë duhet ta materializojmë në praktikë sa më parë. Kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së një regjimi të tantiemave apo të rentës ekonomike për Kosovën në nivel të krahasueshëm me vendet tjera të botës që vërtet zhvillohen nga shfrytëzimi i burimeve të tyre minerare.

Qeveria, përkatësisht ministria nuk duhet të presë që në këtë sistem të ndërtojë investitorët dhe këshilltarët të huaj për ne. Ata s’kanë për të bërë këtë, bile edhe ndokush prej tyre mund të kundërshtojë, siç ka ndodhur edhe në periudhat e mëhershme.

Unë mendoj se Kuvendi duhet t’i vendosë një afat Qeverisë, përkatësisht ministrisë përkatëse që ajo të përgatisë dhe paraqesë në Kuvend në regjim për tantiemat, ashtu që të sigurohen të ardhura të mira për buxhetin. Të mos presim që këtë ta bëjë Rregullatori për Miniera dhe Minerale, i cili duhet të zbatojë politikat e Qeverisë dhe vendimet e Kuvendit. Kjo është detyrë e Qeverisë, sepse kjo është politikë ekonomike dhe ne duhet të sillemi si çdo vend tjetër që nuk lejon të abuzohen resurset, siç ndodh rëndom në Kosovë, me përkatësinë se krijohen disa vende të punës. Kush ka logjikë ekonomike, por edhe ndjenjë kombëtare nuk pranon të falen resurset për disa qindra vende të punës në industri, që ndot në mënyrë të pa riparueshme mjedisin.

Tabela 8 përmbledhëse e të hyrave dhe shpenzimeve të Qeverisë duhet të rishikohet. Kujdes duhet të kihet që të përkthehet titulli, jo siç është konkretisht në KASH-in 2012-2014. Të hyrat dhe shpenzimet e Qeverisë së përgjithshme, sikur paskemi edhe ndonjë qeveri të veçantë. Unë besoj se këtu ka qenë më shumë përkthimi nga gjuha angleze, prandaj duhet të shikohet.

Në të njëjtën mënyrë apo në të njëjtën tabelë janë të evidentuara edhe donacionet apo kredia nga Fondi Monetar, mirëpo ministri e arsyetoi që pas dy muaj do të bëhet rishikimi

i kornizës dhe unë mendoj se kjo do të jetë më e arsyeshme dhe do të parashikohet në një periudhë të ardhshme.

Nga tabela 3, duket po ashtu se nuk do të ketë dividend nga ndërmarrjet publike, pas vitit 2011. Parashikohet që PTK-ja do të privatizohet 75%, pra i mbetet që nga 25% fitimi i PTK-së private t'i mbetet aksionarit, përkatësisht Qeverisë. Pra, Qeveria duhet të planifikojë se do të ketë 25% si dividend në buxhet. Këtë të ardhur nuk e vërejtëm në KASH, apo është futur në ndonjë tjetër kategori, që nuk e besoj.

Përsëri nga tabela 3 duket se KEK-u do të kthejë në vitin 2013 vetëm 5 milionë euro nga kreditë që i ka dhënë Qeveria. Po, pas këtij viti, a nuk do të kthejë KEK-u kredinë të cilën e ka marrë apo këtë obligim do ta marrë investitori i Termocentralit "Kosova e Re". Të gjitha kreditë që i mori KEK-u nga Qeveria, kush dhe si do t'i kthejë këto kredi? Bëhet fjalë për të hyra mjaft të mëdha në buxhetin e Qeverisë nga kthimi i këtyre kredive, apo ndoshta është menduar që kjo kredi të transformohen si aksione të reja plotësuese, përkatësisht aksione të Qeverisë në Termocentralin "Kosova e Re" përpos aksioneve që janë nën negociatë me projektin e termocentralit.

Në objektivat afatmesme të KASH-it 2012 – 2014, privatizimi i Distribucionit, rrjetit dhe furnizimit nuk duhet të parashihet, sepse Qeveria ka planifikuar përmbylljen e këtij procesi në vitin 2011. Siç paraqitet në tabelën 3, faqe 51 dhe në tabelën 2, faqe 84, në po këtë paragraf shënohet kërkesa shtesë që ka të bëjë me rritjen e subvencioneve për import të energjisë elektrike. Nëse Distribucioni dhe furnizimi i energjisë elektrike do të privatizohen brenda vitit 2011, atëherë nuk ka si të parashihen kërkesat buxhetore për import. Po kjo çështje si qëndron sipas ministrisë së Zhvillimit Ekonomik? Kjo nuk duhet të ndodhë, investitori privat do të duhej të jetë përgjegjës për furnizimin e importit të energjisë, përndryshe s'kemi pse të privatizojmë atë sektor në këtë fazë pa e ngritur performancën e KEK-ut.

Jo realiste më duket edhe fillimi i ndërtimit brenda vitit 2012 i rrugës 6, asaj Prishtinë – Shkup, në vlerën prej 600 milionë euro. Pyetja është, kush e ka para vlerësuar apo testuar se mund të ndërtohet me koncesion? Interesi në parim i ndonjë investitori nuk do të thotë se tentativat për të ndërtuar këtë rrugë me investime private do të jetë e suksesshme deri në fund të vitit 2012. Unë e kuptoj rëndësinë dhe prioritetin...

(Ndërprerje na regjia)

KRYESUESI: Shtoja kohën pak deputetes, 2 minuta!

JUSTINA PULA: ... që i jep Qeveria kësaj rruge, por nuk jam dakord me afatin për fillimin e ndërtimit të saj. Rrugët nuk ndërtohen me koncesion se duam ne, por kur rezulton ekonomikisht dhe financiarisht e pa pranueshme për investitorin privat. Prandaj, kjo rrugë kërkon që Qeveria të parashih fillimisht punët përgatitore përkatëse për këtë projekt dhe bazuar në kohën që këto përgatitje kërkojnë, të gjykohet për afatin e fillimit dhe realizimit. Këto përgatitje kërkojnë edhe buxhet dhe kjo duhet të parashikohet në KASH-in 2012 – 2014.

Në fund të faqes 84, shënohet rehabilitimi i rrjetit të Ngrohtores qendrore. Nuk është e definuar a mendohet për ngrohtoren e qytetit të Prishtinës, apo për ngrohtore të tjera në Kosovë. Ngrohtorja nuk është pronë e Qeverisë, por e komunës, prandaj çdo financim për ndërmarrjet komunale nuk duhet të kalojnë në ministri, por t'i kalohet komunës me tjera rrugë – vi buxhetore.

Zbërthimi i objektivave duhet të plotësohet në përputhje me objektivat që duhet të rishikohen. Në faqen 85 parashikohet ndërtimi i instituteve, muzeve, zyrave komunale. Në këtë paragraf nuk është shënuar nevoja për themelimin e Agjencionit të Efiçencës së Energjisë, i cili është paraparë me ligjin përkatës si qëndron kjo çështje.

Janë edhe disa analiza dhe disa parashikime, mirëpo unë mendoj, ministër, që atë mundemi ta diskutojmë. Qëllimi është që sektori i energjisë ka qenë me shumë projekte dhe është një prej sektorëve shumë strategjikë për zhvillimin e ekonomisë dhe mendoj që nuk i janë dhënë hapësirë shumë projekteve në këtë sektor.

Unë shpresoj që ju me këtë rishikim do të merrni parasysh të gjitha këto sugjerime dhe propozime dhe KASH-i 2012 – 2014 do t'i plotësojë të gjitha projektet dhe efektet e zhvillimit ekonomik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Një ndër sferat më të diskutuara kohëve të fundit, e që na bie vazhdimisht ta shohim edhe në media, është pa dyshim bujqësia.

Tani që ekonomia e Kosovës nuk po arrin të ngrihet më lartë, dhe madje është në një përkeqësim të vazhdueshëm, këtë gjendje të rëndë Qeveria natyrisht që synon ta kamuflojë përmes retorikës për zhvillimin në të ardhmen e afërt, e për të qenë më e besueshme në këtë gjë, ku ka tjetër përpos të flasësh për bujqësinë dhe të ardhmen e saj, pasi tanimë është e qartë nga të gjithë se orientimi nga prodhimi, respektivisht edhe nga bujqësia është njëra ndër rrugët kryesore të zhvillimit të Kosovës.

Pra, për këtë qëndrim u deshtë që të ndodhë krizë, të shteren shpresat për përmirësim dhe u deshtë pra që të bëhej e qartë që rritjen e çmimit të bukës ne nuk mund ta zbusim dhe nëse përgjithësisht kemi ngritje të çmimeve kudo, tek ne kjo manifestohet me ngritjet më të larta, e kjo ndodh për shkak të mungesës së prodhimit të brendshëm. Pra, është kriza ajo që solli në temë bujqësinë, prodhimin, mbrojtjen e prodhimeve dhe jo vizioni i Qeverisë, se po të kishte Qeveria vizion me kohë, do të merreshin me këtë punë dhe qysh tash do të kishim ato kapacitetet e nevojshme, e që fjala kapacitete është justifikimi kryesor për buxhetin aktual që e kemi, për buxhetin e paktë aktual të bujqësisë.

Por, të mos harrojmë se kriza e solli retorikën e Qeverisë, por jo edhe zgjidhjen. Për zgjidhje mbetet të shihet dhe do të donim që edhe të shpresohet, e që të shpresohet është e

domosdoshme që t'u hedhim një sy kornizave të kaluara afatmesme të shpenzimeve dhe që t'i besosh dikujt, është e domosdoshme që ta vlerësosh besueshmërinë e tij nga përvoja që ke me të.

Tek sfera e bujqësisë, po qe se i hedhim një sy edhe kornizave të kaluara, një gjë menjëherë bie në sy tek përshkrimi i objektivave strategjike. Në kornizat e kaluara vërehet se prioriteti kryesor ka qenë toka bujqësore, konsolidimi dhe mbrojtja e saj dhe njëri ndër prioritetet tjera ishte edhe përmirësimi i strukturës së pyjeve. Këto dy çështje në kornizën e tanishme nuk figurojnë më si prioritete.

A konsideron Qeveria se i ka zgjidhur apo përmirësuar këto dy çështje me rëndësi dhe tani këto hiqen nga prioriteti, apo si është puna?

Edhe për sa i përket konsolidimit të tokave dhe mbrojtjes së tyre, këtu nuk dua ta përmend çështjen e ... të vreshtave, nuk dua ta fus në aspektin e dështimeve, e po ashtu edhe në sektorin e pylltarisë gjendja jo që mbetet e mjerueshme, por është në përkeqësim të vazhdueshëm. Toka bujqësore është në zvogëlim të vazhdueshëm nga ndërrimi i destinimit dhe kryesisht në atë ndërtimore

Edhe në aspektin e pylltarisë, po ashtu sipërfaqet e pyllëzuara janë gjithnjë e në zvogëlim. Çështja e pyjeve është çështje që duhet trajtuar posaçërisht për shkak të gjendjes tejte të rëndë. Trajtimi se si u bëhet pyjeve sot, nuk mund të themi me sigurinë më të madhe dhe shikuar nga çdo aspekt se madje edhe pushtuesit në të kaluarën nuk i kanë trajtuar më keq. Prandaj, çështja e pyjeve do të duhej patjetër të ishte si një ndër prioritetet. Madje, kur bëhet fjalë edhe për trajtimin e Ligjit për pyjet, të shohim se ky ligj është shtyrë deri në fund të vitit dhe rrezikon madje të mos trajtohet fare edhe këtë vit.

Heqja nga lista e prioritetëve të çështjeve që nuk kanë fare përmirësim, është një tregues për dështim. Ligjet janë, nuk implementohen, sistemi nuk funksionon, ka përkeqësim të vazhdueshëm dhe është totalisht e pakuptimtë që të hiqet diçka nga lista e prioritetëve.

Në fakt, mund të ketë një kuptim. Ndoshta pas heqjes nga prioriteti, këto dy sfera të bujqësisë mund të përmirësohen me gjasë se kudo dhe për çfarë do që është nën prioritet, ne kemi përkeqësime.

Në këtë kornizë, natyrisht, kemi edhe trajtimin me tabela e shifra deri për vitin 2014. Ajo që bie në sy menjëherë, është se shifrat janë të dhëna në përgjithësi dhe të pa detajuara, ashtu të përgjithshme kryesisht të shumëzuara me 3, që lidhet me premtimet për rritjen e buxhetit për bujqësi. Kjo është një tregues që nuk kemi analizë të duhur dhe serioze të problemeve, por vetëm trajtim sipërfaqësor.

Në kornizën, ta zëmë, të vitit 2009 – 2011, kemi një analizë shumë më të hollësishme të shpenzimeve dhe pse një gjë e tillë të mos ndodhte edhe me këtë kornizën e tanishme, pra për vitet 2012 – 2014, por vetëm ta kemi sipërfaqësisht.

Dhe, tjetra, është se kur i bëjmë një krahasim kornizave në mes veti, posaçërisht të asaj 2009-2011 dhe të kësaj të tanishmes, vërejmë që shifrat e prezantuara për vitin në të cilin bëhet raporti apo bëhet korniza në krahasim me vitin e fundit të raportit, është një kontrast shumë i madh ku synon gjithnjë të tregohet qysh Qeveria ka vizion për në të ardhmen, qysh pas dy-tre viteve do të kemi shumëfishime. Ta zëmë, për shpenzimet kapitale në Kornizën afatmesme të shpenzimeve të vitit 2009-2011, për bujqësinë figuron se në vitin 2011 do të kemi shpenzime 9.5 milionë dhe kjo krahasohet atëherë me vitin 2009, që ishte 5.5 milionë, pra potencohet se si do të kemi dyfishim, se si pra nga viti 2009 në vitin 2011 investimet kapitale do të dyfishohen. Raporti asokohe pra, kishte një vizion që për vitin 2011 të kemi 9.5 milionë, e në fakt ne i patëm 2.86 milionë, që në fakt kjo si bie gjë tjetër, pos një përgjysmim. Premtohej dyfishimi dhe ndodhi përgjysmimi. Kjo ndodhi në kornizat e vazhdueshme vit pas viti duke u zvogëluar deri sa arriti në përgjysmimin e plotë.

Pak më parë ministri e përmendi fjalën rifreskim. Nëse rifreskimi nënkupton që vit pas viti të ndryshojë dhe viti i fundit i çdo kornize afatmesme të ndryshojë pas rifreskimeve pas tre vitesh, kjo i bie që ky farë rifreskimi s'po i përngjanë send tjetër përpos një sharre. Për shembull, në këtë raport për vitin 2014 parashihen 17.86 milionë dhe kjo tash nëse krahasohet me vitin 2011, që është 2.86, i bie që do të gjashtëfishohet. I njëjti stil i shumëfishimit është përdorur edhe për kornizën afatmesme 2009 – 2011. Kjo pra nuk është gjë tjetër, veç se një manipulim që ndodhi në të shkuarën dhe që po ndodhë edhe sot, shifra të larta, shumëfishime, para gjithandej, e në realitet krizë buxhetore që Qeveria po na futë gjithnjë e më thellë, e që nuk ka rrugë tjetër për të dalë nga ajo, përpos duke i shitur pasuritë e patundshme të vendit.

Po ashtu, do të doja të theksoja edhe diçka tjetër. Në tabelat për bujqësinë, te Korniza afatmesme shohim që të hyrat totale për vitin 2011 – 2012 do të jenë 1 miliard e 312 milionë dhe për vitin 2014 1 miliard e 431 milionë dhe thuhet se, sipas planit, Qeveria për bujqësinë do ta rritë buxhetin për 3%. Nëse ne e llogarisim për 3%, i bie 42 milionë, ndërsa në anën tjetër, kur e shohim këtu në tabela, i bie 31 milionë, që i bie pak më shumë se 2%. Pra kur vije në një anë të shfrytëzohet, të thuash shumë lehtë përdoret trefishimi i buxhetit, ndërsa kur e shohim në shifra konkrete, ajo nuk i bie më tepër se sa 2.2%.

Po ashtu, kur të flasim tash, është logjikë e njëjtë që përdoret edhe nga Ministria e Bujqësisë, ta zëmë kur vije fjala te subvencionet e tokave, kur duhet të thuhet që sa hektarë sipërfaqe do të subvencionohen, thuhet shifra 43.000 hektarë dhe kur e krahason këtë me shumën e buxhetit të ndarë për subvencione, i bien diku 50 euro. Kur i thua ministrit që 50 euro është subvencioni dhe jo 100, siç po premton, atëherë ai e mban këtë 100 eurëshin për subvencione dhe e zbret sipërfaqen e cila do të subvencionohet. Pra, ja janë 43.000 hektarë, ja janë 30.000 hektarë, ja janë 100 euro, ja janë 50 euro. Kjo varësisht nga cila anë, se qysh e kanë interesin.

Po ashtu, në gjithë këtë unë vetëm i përmenda disa aspekte të kornizës, nuk i përmenda frazat e vazhdueshme që përsëriten nga një kornizë në tjetrën, siç janë rritja e

produktivitetit, aftësi konkurruese, ndërtim i tregjeve, promovim, eksport, zhvillim institucional e ndërkohë bujqësia dhe prodhimi është i mbytur nga produktet e huaja.

Nuk po arrij të përmend feramat e shumta që janë mbyllur për të mos pasje leverdi si pasojë e mallrave të huaja që hyjnë pa doganë dhe njëkohësisht që janë të subvencionuara nga vendet e tyre. Pra, ne fusim në Kosovë mallra pa doganë, të cilat i subvencionojnë qeveritë e atyre vendeve dhe ne nuk i doganojmë ato. Ato futen, qeveritë pra i subvencionojnë mallrat e veta, i sjellin tek ne pa doganë dhe ne as përafërsisht nuk kemi shans t'i subvencionojmë ashtu siç i subvencionojnë ato qeveri dhe këtu gjasat për konkurrencë në treg pamundësohen plotësisht.

Kur flasim tash te subvencionet, do të doja t'i bëja një analizë të shkurtër analizës së subvencioneve për bujqësinë, pra për vitet e ardhshme në vijim deri në vitin 2014, subvencionet synojnë të zvogëlohen vazhdimisht dhe ato në vitin 2014 do të arrijnë në 26.6%.

(Ndërprerje)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

LIBURN ALIU: Nëse e krahasojmë me vendet e BE-së, vendet e BE-së subvencionimet për bujqësi i kanë deri në 50%. Kur flasim për subvencionet, përpos pra në një aspekt që buxheti për subvencionin është tejet i vogël, është edhe aspekti tjetër që subvencionohet kryesisht produkti bazë, produkti themelor i cili pastaj eksportohet për industrinë e vendeve tjera, jo që të subvencionohet prodhimi, respektivisht të subvencionohet përpunimi i prodhimeve që dalin nga bujqësia.

Pothuaj vërejtje të ngjashme do të mund të thuheshin edhe për Ministrinë e Mjedisit, që nuk po zgjatëm pra më tepër, si në aspektin e investimeve kapitale, si dhe në atë të shpenzimeve. Kësaj sfere Qeveria vazhdon të mos i kushtojë rëndësi, pasi trajtimi i drejtë i mjedisit bie drejtpërsëdrejti në kundërshtim me politikën aktuale të eksploatimit më të vrazhdët të mundshëm të të mirave natyrore dhe me politikën e ndërtimit të pa kontrolluar.

Tipi i politikës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Fjalën e ka ministri Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe një herë më lejoni që t'i falënderoj të gjithë deputetët për kontributin e tyre. I vlerësoj shumë lartë diskutimet e tyre.

Dokumenti është i përkthyer, është i përkthyer prej shqipes në gjuhë tjera. Autorësia mirë-keq, është e njerëzve që punojnë në institucionet e Kosovës.

I vlerësoj kritikën, mirëpo disa ish ministra kanë hise në këtë dokument, sepse kjo është një vazhdimësi e punës dhe nuk është hera e parë që edhe korniza bëhet në Kosovë, por është një vazhdimësi prej se ka filluar të bëhet.

Shpejt pritet për të ardhur në Kosovë, në Kuvend, më falni, ligje shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë edhe me riorganizimin e Trepçës, edhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, edhe të Dhomës së Veçantë dhe unë shpresoj se do ta kenë përkrahjen e deputetëve.

Nuk desha t'ju lodhë me shifra dhe nuk do t'ju lodhi dhe do të jem shumë i shkurtër, vetëm për qëllime të korrektësisë do t'i përmendi disa.

Nëse e krahasojmë 2007 me 2011, del se të hyrat për buxhetin pritet të rriten për 30% brenda kësaj periudhe.

Nëse i krahasojmë shpenzimet nga 689 milionë në 2007, pritet që në vitin 2011 të jenë 1 miliardë e 334 milionë, që është 117% më e lartë.

Nëse i krahasojmë investimet kapitale nga 155 milionë, në 2007, priten të jenë në 572 milionë në 2011, që është 270% më shumë.

Dhe, do ta krahasoj vetëm edhe një pozicion. Në 2007 fatura e pagave ka qenë 209 milionë, tash pritet që të jetë mbi 383 milionë, që është një rritje për më shumë, afërsisht aty rreth 100%.

Çka garanton ky dokument? Ky dokument, e thashë, e ripërsëris, nuk është perfekt. Ka nevojë që të përmirësohet. Të futen edhe të dhëna dhe zhvillime të reja në të. Mirëpo, Kosova do të ketë dhe do të vazhdojë me rritje ekonomike. Kosova do të ketë trend pozitiv të hyrave. Në Kosovë do të ruhet niveli mjaft i lartë i investimeve kapitale, që është diku rreth 40% e GDP-së.

Unë i vlerësoj shumë të drejta kërkesat dhe diskutimet e deputetëve, që kërkojnë më shumë fonde për shëndetësinë, më shumë të drejtë, kërkojnë më shumë fonde për bujqësinë, më shumë të drejtë, kërkojnë më shumë fonde për ambientin, më shumë të drejtë, mirëpo këto të gjitha duhet të bëhen brenda mundësive reale buxhetore. Mbi të gjitha këto duhet të ruhet stabiliteti makro-fiskal dhe në projeksionet e parapara është që brenda periudhës së ardhshme makro-fiskale deficiti buxhetor të jetë brenda kriterëve të Kopenhagës, që është rreth 3% e GDP-së dhe nëse e vërejmë me kujdes, ne kemi planifikuar që në vitin 2014 të hyrat e rregullta buxhetore t'i balancojmë me të dalat e rregullta buxhetore dhe deficitin ta mbajmë në parametrat normal.

Unë edhe një herë dua t'ju falënderoj shumë për kontributin. I marr me seriozitetin dhe i vlerësoj shumë lartë propozimet e juaja dhe jam i gatshëm që në çdo kohë, edhe vërejtjet e shkruara me shkrim, edhe propozimet, po të kemi edhe diskutime me qëllim që në këtë

dokument ta përmirësojmë dhe ta bimë në gjendjen që është e dëshirueshme për gjithë neve. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Me kaq, debati lidhur me Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2012 – 2014, përfundoi. Shpresoj që ministri ka evidentuar, ashtu siç janë edhe të regjistruara të gjitha fjalët e deputetëve dhe në rishqyrtimin e kësaj Kornize afatmesme të shpenzimeve do të inkorporohen edhe vërejtjet të cilat kanë të bëjnë me këtë. Faleminderit të gjithëve!

Tani, besoj se jeni lodhur, për një pauzë dreke deri në ora 15:00, janë edhe tri pika të rendit të ditës. Faleminderit! Në ora 15:00 fillojmë, mirë kishte qenë të mos vonohemi.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Mbledhjen e drejton: Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Vazhdojmë! 64 deputetë janë në sallë, mund të fillojmë punën. Pika në vazhdim është:

12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryetari i komisionit, a e do fjalën? Safete Hadërgjonaj, pastaj Ali Sadriu.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin financiar vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit. Sipas nenit 13, paragrafi 7 të Ligjit Numër 2002/7 për Telekomunikacionin, Autoriteti Rregullator është i obliguar ta dorëzojë një raport vjetor mbi punën e Agjencionit Rregullativ të Telekomunikacionit, mirëpo në kuadër të këtij raporti duhet të përfshihet edhe raporti financiar. Kështu, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit me kohë e ka sjell raportin vjetor, pjesë e të cilit është edhe Raporti financiar, të cilin ne në Komision e kemi shqyrtuar në mbledhjen e 6 qershorit.

Në Raportin e punës së ART, të dhënat mbi raportin financiar ishin të kufizuara, kështu që me kërkesën e Komisionit për Buxhet e Financa Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit e ka dorëzuar një raport të metalizuar financiar për vitin 2010, i cili është shqyrtuar në Komision dhe i është bashkëngjitur si shtojcë raportit vjetor.

Nga raporti vërehet se Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit i ka shfrytëzuar mjetet vetëm 50%, domethënë mjetet e buxhetit të cilat janë ndarë në fillim të vitit i ka shfrytëzuar vetëm 50%, çka do të thotë se nga 1.546.488 euro të parapara në buxhet, janë shpenzuar 777.158 euro.

Buxheti për paga e mëditje është shpenzuar 99%, për mallra dhe shërbime 87%.

Në Komisionin për Buxhet e Financa objekt diskutimi ka qenë mosshfrytëzimi i mjeteve të ndara për kategorinë – shpenzime kapitale, ku nga 875.000 euro të parapara në buxhet, janë shpenzuar vetëm 126.658 euro, pra vetëm 14% të mjeteve.

Megjithatë, Komisioni për Buxhet e Financa, pas sqarimit të disa pyetjeve dhe çështjeve të ngritura ka vlerësuar njëzëri se raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësiive Numër 03/L-048 dhe Ligji Numër 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i komisionit funksional, Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24.5.2011, ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës për vitin 2010 të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit. Komisioni ka vlerësuar se Raporti vjetor i punës për vitin 2010 i këtij autoriteti është në pajtim me nenin 13 të Ligjit Numër 2002/7 për Telekomunikacionin dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare, deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë desha ta marrë fjalën që në fillim para se të hyjmë në këtë pikë, me një propozim të vetëm që çështjet t'i kanalizojmë në mënyrën funksionale të trajtimit të çështjes.

Këtë raport që ne sot po pretendojmë ta shqyrtojmë, e ka hartuar ART-ja dhe është në natyrën shumë normale të njeriut që për çdo veprim të vetin të bëjë një justifikim, por është e drejtë apo e pa drejtë, shumë më mirë një palë e tretë ta gjykojë atë veprim.

Është për çudi se ky raport ka ardhur më 18.5. 2011 në Kuvend. Para tij ka ardhur me 5.5.2011 pasqyra e audituar prej Zyrës së Auditorit Gjeneral. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar atë dhe Auditori ka gjetur një varg parregullsish dhe shkeljesh.

Nëse e miratojmë ne sot, ne duhet t'i gjykojmë automatikisht dy organe tona, ai është Këshilli Mbikëqyrës, i cili ka paraqitur shumë vërejtje dhe kanë kontest gjyqësor dhe Organi Shqyrtues, i cili e ka dënua me 30.000 euro për veprime të jashtëligjshme.

Prandaj, unë edhe në dy rastet e mëhershme e kam ngritur çështjen që është mirë të gjitha këto agjencione apo këshilla, që janë drejtpërdrejt të lidhura me Kuvendin, këto janë bë ministri pa ministra dhe nëse Kuvendi nuk bën një monitorim më të afërt, ka rrezik që në të ardhmen ata edhe më tutje, flas për të gjithë, në mënyrë të përgjithësuar, po fjalën e kam edhe për këta, devijojnë.

Ka qenë shumë më e natyrshme me këtë raport vjetor të jenë edhe pasqyrat e audituara prej njerëzve profesionistë të kësaj natyre. Ne kemi mbajtur mbledhje dhe në mbledhje ka pasur ballafaqim të Bordit të ART-së dhe të drejtorit gjeneral të Zyrës së Auditimit dhe çështjet janë në proces që duhet trajtuar. Prandaj, nuk është mirë në këtë formë që po vijnë dy institucione të Kuvendit me dy vlerësime jo të njëjta. Unë i kuptoj dy komisionet. Ata e kanë dhënë gjykimin në bazë të këtij materiali që e kanë dhe në këtë material po ju lexoj se çka shkruan: "Zyra e Auditorit", thotë, "ka dhënë opinion të pa kualifikuar me theksim të çështjes, që në fakt është paraqitje e vlerësimit më të lartë të bazuar në standarde të raportimit dhe menaxhimit të fondeve".

Jo, zotëri, nuk qëndron ashtu! Raporti i pa kualifikuar po, por jo me theks të çështjeve të caktuara. Ky nuk është raport i mirë. Dhe unë për ata kërkoja që në fillim të bisedojmë, meqë i kemi tabelat e gatshme, i keni edhe ato tabela dhe bëni gjykimin për këtë raport, pa u lëshuar në nuanca të caktuara. Meqë ai ka për të ardhur, ne mundemi ta miratojmë kështu, se po e shoh disponimin, por unë po ju garantoj, për një javë vjen tjetri dhe do e shohim se është krejt në binarë tjerë.

Komisioni për Mbikëqyrje nuk qet shifra aty, bën vlerësim mbi ato shifra që i ka gjetur Zyra e Auditorit Gjeneral, njerëzit ekspertë. Kjo është ajo që unë desha të jap kontributin. Faleminderit!

KRYETARI: Nëse keni diçka, kryetarët e komisioneve që folët më herët, meqenëse këtu kemi të bëjmë me dy raporte të ndryshme dhe, natyrisht, Raportin e Autoritetit Rregullator e bëjnë ata vetë, dhe Raportin e mbikëqyrjes financiare të Auditorit e bën dikush tjetër dhe sigurisht se është mirë që ka edhe dallime.

A e do ndokush tjetër fjalën prej komisionit? Jo. Atëherë, shkojmë në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pajtohem paraprakisht që Kuvendi përfundimisht duhet t'i trajtojë shumë mirë, shumë më ndryshe se sa gjithherë më parë, jo vetëm raportet, por edhe zbatimin e ligjit në përgjithësi dhe funksionimin e gjitha agjencive dhe institucioneve tjera që janë në varësi direkte të Kuvendit. Ne dje e trajtuam po ashtu një raport të tillë.

Dëshiroj të them që raporti i këtij autoriteti është një raport, krahasuar me raportet e viteve të kaluara, një raport shumë më përmbajtësor si nga cilësia e tij, si raport, po ashtu edhe nga numri i angazhimeve dhe i punëve të cilat reflektojnë të shkruara në këtë raport, ndonëse ka ende edhe si autoritet shumë sfida përpara dhe ka pasur sfida edhe në të kaluarën.

Ne në Komision, po ashtu, tash meqenëse u përmend edhe raporti financiar, kemi trajtuar gjatë raportin financiar dhe po ashtu kemi dhënë pyetjet dhe kemi marrë përgjigjet nga autoriteti edhe për një kontekst, sepse ky autoritet nuk është pajtuar me raportin e auditorit gjeneral dhe po ashtu ka kontest gjyqësor, i cili mendoj që organet përkatëse kompetente duhet ta trajtojnë deri në fund. Po, ajo që duhet të trajtohet nga ky institucion, nga Kuvendi i Kosovës, është në përgjegjësi puna e këtij autoriteti, aspekti i legjislacionit, angazhimet strategjike të tyre, angazhimet e përditshme të tyre e tjera, që janë çështje jetike tash për të rregulluar këtë fushë dhe në përgjithësi një pjesë të mirë të bizneseve që kanë të bëjnë me telekomunikacionin.

Raporti në përgjithësi afron dhe siguron informacione përmbajtësore mbi progresin e angazhimeve të ART-së në arritjen e qëllimeve të saj strategjike të cilat kanë qenë të vijueshme dhe theksohen veçanërisht për vitin që lamë pas.

Ky raport, po ashtu, përmbledh edhe një pasqyrë të ngjarjeve të rëndësishme në tregun e telekomunikimeve dhe të dhënat thelbësore teknike komerciale për aktivitete të rregulluara në këtë sektor në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, ky vit raportues parasheh ose përmend edhe një fakt që ka qenë ndër më të ndjeshmet për sa i përket edhe kompetencave të ART-së, e që ka të bëjë me eliminimin e infrastrukturës boshtore të operatorëve ilegalë të telefonisë mobile. Ky vit karakterizohet edhe me përpjekjet e para të ART-së më serioze në këtë drejtim dhe, po ashtu, realizimin e përmbushjes së disa objektivave nga ART.

Korniza ligjore këtë institucion e përcakton përgjegjës për një varg angazhimesh, prej atyre më teknike me çështje të licencimit e deri te rregullimi dhe aplikimi i standardeve unike për gjithë ofertuesit e shërbimeve telekomunikuese, zhvillimin e politikave jo diskriminuese ndaj të gjithë atyre që dëshirojnë të hyjnë në këtë treg dhe për çka unë mendoj se tashmë është një kornizë e mjaftueshme.

Sektori i telekomunikimeve në Republikën e Kosovës, si rezultat i liberalizimit, ka regjistruar investime të ndjeshme nga sektori privat dhe rrjedhimisht mekanizmat e konkurrencës njihen me shumë shërbime për të cilat kërkesa tanimë është e theksuar dhe është në rritje.

Vlen për të theksuar se ka shenja për t'u avancuar edhe ana ligjore, do të kompletohej me anën e Ligjit për komunikime elektronike, është një çështje që mendoj se krahas zhvillimeve të tregut, nevojitet edhe adaptimi i kornizës ligjore.

Ajo që vlen të theksohet, që është shumë me rëndësi, nga krejt ky proces që është theksuar me liberalizimin dhe hapjen e tregut, pastaj me pengimin e operatorëve ilegalë mobilë në Republikën e Kosovës, kemi pasur 1.7% rritje të ardhurave të përgjithshme të operatorëve ose një total prej 230 milionë eurosh për periudhën për të cilën po raportohet.

Po ashtu, kemi një shtim të bashkëpunimit. Është theksuar për bashkëpunimin e këtij institucioni në këtë raport me institucionet gjegjëse. Këtë kohë kemi intensifikuar bashkëpunimin ose relacionet edhe me komisionet respektive të Kuvendit, për çka i referohet dhe kanë obligim ligjor. Pastaj, ka disa arritje në procesin e ndërkombëtarizimit, edhe pse këtu domethënë ende në rezultatin e fundit ose rezultati kryesor do të ishte kodi dhe çështjet tjera që janë me interes për të qenë konkurrues dhe të barabartë me të tjerët, por megjithatë janë shënuar disa angazhime konkrete në relacion me ITN, kemi pasur një bashkëpunim dhe po ashtu një komunikim pjesëmarrjeje në konferenca, në aktivitete të ndryshme që mendoj se janë një element pozitiv.

Ky autoritet është mbështetur, po ashtu, edhe prej mekanizmave të tjerë. TAEX ka ndihmuar, është program i veçantë i Komisionit Evropian, ART-në dhe janë theksuar mbështetjet praktike dhe po ashtu shtete të veçanta, si Republika e Shqipërisë, Republika e Turqisë dhe e Kroacisë e kanë mbështetur në forma të ndryshme, për çka kemi të pasqyruar në raport.

Ajo çka mendoj se mbetet sfida dhe që ne jemi qetësisht të interesuar, janë që të punohet në disa drejtime. E para, të vazhdohet puna në kodin, të intensifikohen aktivitetet në ndërkombëtarizimin ose në bashkëpunimin me institucionet tjera ndërkombëtare. Mendoj që kjo është edhe çështje politike dhe edhe tjerat institucionet tjera duhet mbështetur në këtë drejtim. Duhet të mbështetet më shumë ky autoritet nga institucionet tjera për të mos lejuar operatorët ilegalë dhe ajo që është esenciale, duhet ta përcjellim me legjislacionin përkatës, në mënyrë që konkurrenca në rritje dhe sidomos arritjet teknologjike të mos e gjejnë këtë autoritet në gatishmëri jo të mirë ose në pa gatishmëri që t'i përmbushë kërkesat konkurruese dhe sidomos këtë shpejtësi të avancimit të teknologjisë, me çka sipas të gjitha gjasave shumë më shpejt do të ketë kërkesa të reja sipas trendeve të tregut ndërkombëtar, kështu që ky autoritet pret edhe mbështetje prej të gjithë nesh që anën e legjislacionit ta ketë ose legjislacioni t'i paraprijë kësaj kërkesë të konkurrencës dhe të arritjes së teknologjisë.

Edhe një diçka që mendoj do të jetë temë tjetër e Kuvendit për ta trajtuar, tabela e planit radiofrekuencor. Ky autoritet e ka përgatitur këtë plan dhe ne e kemi trajtuar, po ashtu, dhe po ashtu edhe kjo që nuk është përfshirë në këtë agjendë të këtij raporti, është një element shumë i rëndësishëm që duhet ta rregullojë këtë fushë. Kemi pasur një plan që është bërë shumë më herët nga autoritetet e UNMIK-ut, atëherë ndërkombëtarëve është, tash koha kur tregon edhe pjekurinë e këtij institucioni dhe në vetë faktin se do të jetë para Kuvendit, shpejt ky plan, tregon që kemi një avancim, një arritje.

Edhe një diçka krejt për fund, te Raporti i Progresit, ku jemi të financat, Raporti i Progresit, i fundit, parasheh si sfida një pavarësi financiare. Mendoj krahas asaj që ne duhet t'i bëjmë një monitorim sa më të madh të krejt shpenzimit të buxhetit, duhet ta

kemi të qartë që këto autoritete, për shkak të vet kritereve, standardeve të BE-së, kërkojnë që ta kenë një mbështetje më të mirë dhe një pavarësi financiare. Dhe, krejt në fund, në emër të grupit parlamentar, kërkoj që ky raport të mbështetet, të aprovohet me kërkesë që të vazhdohet monitorimi, jo vetëm i anës financiare, po i krejt zbatimit të ligjit edhe i aktiviteteve tjera të këtij institucioni. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryetar!

Para se t'ia nis, për këtë raport, unë desha, pasi askujt nuk iu kujtua, desha t'ia uroj zonjës Myzejene Selmanit, që është emëruar për kryetare të Grupit Parlamentar edhe që e ka përmirësuar pak strukturën gjinore të shëfave të grupeve, e shpresoj se do ta ngrehë këmbën zhag e të ketë një përmirësim në këtë nivel. Urime, Myzejene! Ishalla edhe në Kryesi të Kuvendit, shpejt.

Mirë, po vazhdoj me raportin e ART-së. Kryetar, mos m'i llogarit tash këta minutat që po m'i marrin këta të tjerët. U bë. Mirë.

Po fillojmë me Raportin e ART-së. Raporti i ART-së për vitin 2010, është një raport i cili ka qenë në Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik dhe është shqyrtuar dhe ky bord, është bordi i cili për herë të dytë raporton në këtë komision. Edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së, është shqyrtuar ky raport. Por, desha të tërheq vëmendjen, që në këtë rast, ku kishim një raport ta quaj të punës apo një raport teknik, në të cilin shprehimisht tregohet puna e ART-së edhe sukseset e ART-së, ndërsa në anën tjetër, një disproporcionalitet me këtë punën që e bën ART-ja, me tabelat e auditimit, mendoj që duhet të kemi një koordinim më të mirë në mes të komisioneve parlamentare, por gjithsesi edhe raportet e këtij lloji, të mos vijnë në momentin e fundit edhe të jenë në hapësirë të vogël kohore për ta shqyrtuar.

Në raportin e ART-së, të cilët ne si Komision e kemi marrë, thuhet që ka një numër të përmirësimeve dhe sukseseve dhe në Raportin e Progresit, thuhet që është, që ka ta theksoj si progres signifikant. Mendoj që këta të Raportit të Progresit, nuk i kanë marrë ende këto tabelat e auditimit dhe nuk e di çfarë do të dalë ky raport tash në të ardhmen, raporti i ri.

Si sukses tjetër, këtu llogaritet hartimi i planit kombëtar të frekuencave, plan i cili paraqet përparim në aspektin shtetëror, pasi deri me tani Kosova nuk ka qenë ajo e cila ka hartuar planin frekuencor dhe mund të llogaritet si një prej sukseseve.

Eliminimi i i infrastrukturës boshtore të operatorëve ilegal, gjë e cila u ka sjellë rritje të hyrave operatorëve legal, por ky sukses mungon në veri të vendit, ku këta operatorë operojnë lirshëm dhe shfrytëzojnë brezin frekuencor.

Liberalizimet e nëntregjeve të telefonisë mobile, mendojmë se në mandatin e kaluar ka pasur afera të cilat tash së fundit përsëri janë aktualizuar dhe ne do të kërkojmë në

vazhdimësi që ART-ja të japë shpjegime shtesës në lidhjet me aferat me Dardafonin dhe të tjera.

Nga 2010, ka filluar monitorimi i planifikuar i licencave, ndonëse ende nuk është kompletuar infrastruktura e plotë si stacioni fikës monitorues dhe laborator dhe njejt e internetit. Kjo çështje duhet të jetë në vëmendje të veçantë të ART-së. Këtu në raport shihet se ndonëse janë hartuar 52 akte administrative, aty mungon edhe një numër i madh i akteve administrative të cilat duhet të plotësojnë boshllëqet.

Sa më shpejtë të hartohet ligji i ri i telekomunikacionit, në të cilin Komisioni Evropian dhe partnerët tjerë kanë ndarë mjetet e nevojshme, ky ligj duhet t'i eliminojë pengesat ekzistuese si për shembull, gjatë alokimit të brezave të rinj për operatorët ekzistues e tjera. Rekomandojmë që ART-ja të jetë vazhdimisht në rrjedhë me kërkesat e operatorëve të licencuar për nevojat aktuale, por edhe të bëjë planifikime strategjike dhe të parashih trendët moderne botërore, në lëmin e telekomunikacionit, në planifikimin e teknologjive të reja, të gjeneratës të tretë apo katërt, dhe nevojat e ndryshimeve në tabelën e frekuencave, në mënyrë që këtu të kryhen përgatitjet për gjeneratat e reja të teknologjisë.

Çështje tjetër për të cilën kemi kërkuar dhe kemi diskutuar është ai 16 milionëshi i famshëm, i cili ende nuk është zgjidhur. Nga ART-ja kemi marrë një shpjegim që është bërë padia dhe që pritet që kjo padi të zgjidhet, shpresojmë që të zgjidhet shpejt në dobi të Kosovës.

Kërkojmë që ART-ja të jetë aktive, pasi Kosova ende nuk ka kodin telefonik dhe domenin e internetit, gjëra të cilat do të duhej të zgjidhen në të ardhmen, ndonëse janë çështje më tepër politike se teknike që varet më tepër nga ATU-ja, si mekanizëm i OKB-së.

Ne si grup parlamentar, kërkojmë shumë më tepër transparencë, shumë më tepër komunikim më të shpeshtë me ART-n për çështje të ndryshme dhe pa marrë parasysh që raporti tregon suksese kah aspekti i punës dhe teknik, ai nuk është i mjaftueshëm në qoftë se ka probleme serioze në raportet e auditimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes”, Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Lama, të lutem, mos ma gaboni mbiemrin!

KRYERARI: Lama, mirë! I kemi ngatërruar këta mbiemra me...

ALMA LAMA: Po ngatërrohen mbiemrat që s'janë të njohur, jo ata që janë të njohur. Okej. Faleminderit, zoti kryesues!

Këtu u dha një argument shumë i rëndësishëm që ART-ja është në gjyq me auditorin...

(Reagime nga salla)

... Vazhdojmë? Faleminderit, zoti kryesues! Këtu u dha një argument shumë i rëndësishëm... Kryetari është edhe kryesues, domethënë, nuk është ndonjë... Më vjen keq që nuk keni shumë informacion në aspektin gjuhësor.

(Reagime nga salla)

Thashë, sa kohë që ART-ja është në proces gjyqësor me auditimin, ndoshta edhe ky diskutimi ynë është i pavlefshëm, do të duhej të kishim pritur përfundimin e procesit gjyqësor për të dalë në përfundime. Sido që të jetë, ne si lëvizje na intereson më shumë performanca e ART-së, e cila në bazë të raportit duket se nuk është e mirë. E kam fjalën veçanërisht për çështjen e operatorëve të ndryshëm në Kosovë, kryesisht ata serbë. Po udhëtove me veturë në cilindo relacion në Kosovë, gjithë rrugës janë prezent B92 dhe RTS, pra, dy televizionet serbe, të mos flasim për radiot lokale të enklavave serbe, që mund të jenë të licencuara.

Njëjtë është edhe me televizionet. Janë së paku tre lokacione prej nga emetohen RTV-të dhe stacionet serbe. ART ka planifikuar të shpenzojë shuma të mëdha për Qendrën Nacionale për Monitorim të Spektrit Fikse dhe Mobile. Mund të themi që ART ka pasur mundësinë që të bashkëpunojë me Shqipërinë për sa i përket softuerit të ETU-së, gjë të cilën nuk ka bërë, por në vend të kësaj paguan para në mënyrë të panevojshme.

Për sa i përket aktivitetit rregullator, ky është problemi madhor. Në Kosovë ende funksionon telefonia mobile serbe, në veri dhe në disa enklava. Në disa raste, si për shembull edhe këtu në Prishtinë, në Dardani dhe në parkun e Gërmisë, del operatori malazez Telenor. Ka dyshime që serbët në enklave i përdorin këto stacione bazë të telefonisë mobile, meqë romingu i numrave të tyre serbë në këtë rrjet është gati falas. Në Kolegj dhe me një qendër telekomunikuese, është Telekom Srbija. Në një pikë të lartë afër fshatit Runik në Skenderaj, gjithashtu.

Në tentimin e parë ART këtu ka qenë e penguar t'i heqë pajisjet nga pika e fundit. Ka kudo në Kosovë pika të tilla telekomunikuese, ndërkohë besoj të gjithë kujtojmë rastet kur antenat e IPKO-s janë hedhur në erë në pjesën veriore.

Telefonia fikse e Telekomit të Serbisë funksionon, përveç se në veri, edhe në të gjitha enklavat serbe. Ndërkohë, në Kosovë ka, gjithashtu, për sa i përket fushës së internetit, operatorë të palicencuar, të cilët e dëmtojnë tregun, realisht. Për sa i përket dukurisë së Sim to Sim, besoj është e njohur, tashmë kanë filluar dhe hetimet, kohëve të fundit duket se është luftuar kjo dukuri dhe është mirë, për të kuptuar që Sim to Sim është vjedhje realisht ose trafiku telefonik, i cili shfrytëzohet nga operatorë në mënyrë të paligjshme dhe dikush përfiton. Pra, në parim, luftimi i kësaj është i mirë, por për sa i përket këtij aktiviteti ilegal, që është zhvilluar në të shkuarën, më shumë kanë fituar operatorët serbë dhe maqedonas, ndërsa shqiptarët kanë mbledhur në njëfarë mënyre thërrimet edhe kualiteti i thirrjeve që vjen në bazë të kësaj teknologjie, është shumë i dobët.

Në Kosovë, Telekom Serbia fut trafik në telefoninë fikse, si nga thirrjet që origjinën pra e kanë nga vetë Serbia, si trafik telefonik që mbledh nga tërë bota, sidomos nga operatorët ... me ç'rast fiton shumë. Ka të dhëna se këtë gjë e bën edhe vetë Maqedonia.

Posta e Serbisë është në të gjitha fshatrat deri në atë masë sa ka pas filluar të ofrojë edhe shërbime financiare Western Union. Këto të fundit janë ndërprerë me intervenim të një operatori privat legal që është në këtë shërbim.

Ne nuk do ta miratojmë këtë raport për arsyen që e thashë në fillim të fjalimit, sepse është në proces gjyqësor, ndërkohë që vetë raporti është shumë i mangët ashtu siç konstatoi edhe kryetari i Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar AAK, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i ka shqetësimet rreth këtij raporti të një autoriteti, i cili në të vërtetë është me rëndësi në Kosovë për arsye se i sjellë të hyra buxhetore Kosovës.

Unë do ta kisha ndarë këtë pjesë të raportit të Komisionit funksional dhe të Komisionit të Buxhetit dhe Financave dhe të Komisionit për Kontroll Financiare, të Komisionit funksional, po i besojmë kolegëve tanë që janë në atë komision, ndërsa sa i përket anës financiare dhe buxhetore edhe pse ne si komision i buxhetit, ndajmë buxhet për këtë autoritet dhe ne kemi kërkuar pse autoriteti, ky rregullator nuk e ka shfrytëzuar 50% , pse investimet kapitale nuk i ka shfrytëzuar 100% dhe të gjitha këto, kemi marrë një përgjigje, mirëpo na lind dyshimi tek pasqyrat e audituara për arsye se Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk e ka këtë të drejtë, por nuk do të ishte mirë që Komisioni për Buxhet dhe Financa, tani ta kalojë këtë raport, dhe pas dy ose tri javëve del komisioni tjetër i kontrollit financiar dhe të paraqet se auditori ka paraqitur dhe paraqet shkelje të mëdha që i ka bërë ky autoritet. Prandaj, do të kishte qenë mirë, ne e dimë që me ligj duhet t'i raportohet dhe t'i silllet raporti Komisionit për Buxhet, por është mirë që këto dy komisione t'i rregullojnë mes veti që këto raporte, Komisioni i Buxhetit ndan buxhet, ndërsa kontrollin e buxhetit dhe raportimi financiar të bëhet në Komisionin për Kontroll Financiare për arsye se ata do të bëjnë kontrollin me bazë të pasqyrave të auditimit.

Unë, po më duket e palogjikshme që tani ne të pranojmë këtë raport financiar dhe pas një muaji, në këtë Kuvend të dalim dhe të raportojmë se janë bërë shkelje, se auditori ka gjetur shkelje të mëdha ose nuk po paragjykoj, ndoshta nuk ka shkelje, mirëpo do të ishte mirë që të merret mendimi edhe i Komisionit të Kontrollit Financiar. Ne i kemi arritur dhe ky Kuvend i bën disa ligje dhe me ligj ka raportuar në Komision të Buxhetit, por ne mundemi t'i ndryshojmë edhe datat, por edhe të cilët komisione duhet

raportuar. Do të kishte me qenë mirë që për shpenzime të mjeteve, jo vetëm ky autoritet, por të gjitha agjencionet buxhetore raport financiar tani e tutje të bëjnë te Komisioni për Kontroll Financiar. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, nuk ka nevojë se realisht ne po i kemi edhe dy raporte që janë të veçanta dhe ne konkludojmë mbi bazën e raportit. Tani e kemi raportin e Auditorit të Telekomunikacionit dhe mbi bazën e këtij. Kur të vjen raporti i auditorit, diskutojmë për raportin e auditorit, janë të ndara. Prandaj, vazhdojmë me Grupin Parlamentar Kosova e Re.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Myzejene Selmani. Edhe unë po ja uroj detyrën e kryetares!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Falënderoj zonjën Teuta dhe shpresoj që femrat janë edhe më të zonja se sa për një shef të grupit parlamentar.

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2010.

Grupi Parlamentar i Koalicionit të Kosovës e Re ka shqyrtuar Raportin e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, i cili është i bazuar në bazë të Ligjit të telekomunikacionit dhe njëkohësisht në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si autoritet apo si agjencion i pavarur i cili raporton Kuvendit të Kosovës.

Raporti paraqet të dhëna dhe zhvillimet në tregun e telekomunikacionit, aktivitetet e rregulluara në sektorin e telekomunikacionit në bazë të Ligjit të telekomunikacionit. Duke ditur se ART-ja si rregullator i telekomunikacionit në këtë raport ka paraqitur çështjen e telekomunikacionit si është i zhvilluar në gjithë Republikën e Kosovës. Duke marrë parasysh se në politikat e telekomunikacionit, bartësi i politikave është vetë Qeveria, ndërsa Autoriteti Rregullativ i telekomunikacionit vazhdon punën në bazë të Ligjit të telekomunikacionit, rekomandojmë që Qeveria sa më shpejtë të sjellë ligjin e ri të telekomunikacionit në bazë të zhvillimeve të teknologjisë informative e cila ka ecë aq lart dhe i duhen këtij sektori.

Në përgjithësi i gjithë raporti mund të them se është një raport i gjendjes faktike e cila është në republikën e Kosovës, në çështjen e telekomunikacionit dhe Koalicioni për Kosovën e Re e përkrah këtë raport. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Pridružujemo se čestitkama koleginići Selmani na mestu šefa parlamentarne grupe.

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala je izveštaj o radu autoriteta Regulatora za telekomunikaciju i podržava usvajanje godišnjeg izveštaja.

Mislimo da je dosta sadržajan i sveobuhvatan i da ispunjava ciljeve u radu autoriteta Regulatora za telekomunikaciju. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” pas shqyrtimit të detajizuar të Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2010 dhe pas vlerësimit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, vlerëson se ky raport është në pajtim me nenin 13/7 të Ligjit numër 2002/7 për telekomunikacion, dhe mendojmë se ky raport i përmbush të gjitha obligimet e nevojshme për miratim.

Pra, Grupi Parlamentar “6+” do ta votojë si të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi nuk kemi të lajmëruar për debat, diskutim, hyjmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 40 vota “për”, 16 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Auditorit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2010.

Vazhdojmë pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:

13. Emërimi i anëtarit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarit- kryesues të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e këtij propozimi.

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 12 të Ligjit numër 03-L/084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, Komisioni për përzgjedhjen, në përbërje të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, si kryesues, auditorit gjeneral dhe sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si anëtar, i ka propozuar Kuvendit emërimin e një anëtarë në cilësinë e anëtarit për përfaqësimin e interesave të punëdhënësve dhe kryesuesin për Bordit drejtues të Trustit Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Në bazë të nenit 14 të Ligjit në fjalë, Kuvendi emëron anëtarët e Bordit drejtues duke përfshirë edhe kryesuesin, bazuar në rekomandimet e komisionit për përzgjedhje pas konsultimit me Qeverinë, e cila ia dorëzon opinionin Kuvendit brenda 15 ditëve nga data e pranimit të kërkesës nga Kuvendi për konsultim.

Qeveria në vendim i ka dërguar opinionin e saj Kuvendit ku ka mbështetur kandidatët e propozuar nga Komisioni për përzgjedhje.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2011, shqyrtoi propozimin e Komisionit për përzgjedhje për emërimin e kryesuesit dhe anëtarit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe vlerësoi se kandidatët e propozuar për anëtarë të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale i plotësojnë kushtet formale- juridike të paraparë me nenin 11 të ligjeve të cilat i ceka më parë për Fondin Pensional të Kosovës, në përfaqësimin dhe këshillimin e interesave të punëdhënësve, përkatësisht kanë eksperiencën e kërkuar në fushën e pensioneve, financave, investimeve, sigurimit.

Bazuar në këto të dhëna Komisioni i rekomandon Kuvendit të miratojë propozimin e Komisionit për përzgjedhje për emërimin e zotit Ejup Qerimi, anëtar të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në cilësinë e anëtarit për përfaqësimin e interesave të punëdhënësve me mandat 3 vjeçar siç e parasheh ligji dhe zotin Imer Havolli, kryesues i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, me mandat deri më 30 prill 2012, pasi që i njëjti është anëtar aktual dhe ushtrues detyre i Bordit të Trustit të Kursimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Kalojmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi ose emëroi Ejup Qerimin, anëtar me mandat 3 vjeçar dhe Ymer Havollin, kryesues të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës deri më 30 prill 2012. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës:

14. Emërimi i një anëtari të Komisionit Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për emërimin e një anëtari në Komisionin shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit, deputetin Nait Hasani, për arsyetimin e propozimit. E ke fjalën, Nait!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, më 30 maj 2011, ka shqyrtuar kërkesën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për emërimin e një anëtari të Komisionit shqyrtues dhe vendosi që Kuvendit t’i rekomandojë për emërim kandidatin Ylber Aliu, master i shkencave politike, nga fshati Gadime, komuna e Lipjanit për Komisionin shqyrtues pranë Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, i cili do të jetë në këtë komision në cilësinë e kryesuesit.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur domethënë ka arsyetuar në bazë të kërkesës së operatorit dhe të gjithë deputetët e kanë edhe biografinë kandidatit që ka propozuar komisioni dhe kërkoj që Kuvendi ta miratojë dhe ta votojë. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet, a ka mandat? Kur e mbaron mandatin?

NAIT HASANI: Kryetar, në bazë të ligjit për bordet që janë këtu është edhe këtu në bazë të një kërkesë, rregullatori e ka ligjin e vet dhe në bazë të ligjit është afati 3 vjeçar sa e dimë ne.

KRYETARI: Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash: Konstatoj se me 43 vota “për”, 12 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi e emëroi zotin Ylber Aliu, anëtar të Komisionit shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Minerale. Faleminderit!

Edhe s’ kemi më.

Mirupafshim në seancën e të hënës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve

